



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

T R A N S K R I P T

I SEANCËS PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, TË  
MBAJTUR MË 23 e 24 KORRIK 2009

SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA, ODRŽANE 23. i  
24. JULA 2009. GODINE

KORRIK – JULI  
2009

Seancën e kryesoi **Jakup KRASNIQI**, Kryetar i Kuvendit.

KRYETARI: Të nderuar deputetë,  
I nderuar Kryeministër,  
Të nderuar ministra të Kabinetit qeveritar,

I hap punimet e seancës plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Konstatoj se në sallë janë të pranishëm 81 deputetë, që do të thotë se janë plotësuar kushtet për t'ia filluar punës.

Ju njoftoj se në pajtim me Rregullën 6.2 dhe 23 të Rregullores së Punës së Kuvendit, Kryesia e Kuvendit, në marrëveshje me grupet parlamentare, ka përgatitur dhe Kuvendit i ka paraqitur rendin e ditës për seancën e sotshme plenare.

Në pajtim me rregullat procedurale për rendin e ditës, fjalën e ka kërkuar kryetari i Grupit Parlamentar të AKR- së, Ibrahim Makolli.

IBRAHIM MAKOLLI: I nderuar zoti Kryetar,  
Të nderuar anëtarë të Kabinetit qeveritar,  
Të nderuar kolegë deputetë,  
Duke u bazuar në Rregullën 23.2 të Rregullores së Punës së Kuvendit, si dhe në marrëveshjen e arritur me shefat e grupeve parlamentare për shkak të rëndësisë dhe aktualitetit që ka, propozoj riradhitje, përkatësisht zhvendosje të pikave, si vijon:

1. Pika e nëntë e rendit të ditës- Ratifikimi i marrëveshjes për përvetësimin e kredisë në mes Republikës së Kosovës dhe Bankës Ndërkombëtare për rindërtim dhe zhvillim, si dhe memorandumit të Misionit të Thesarit të Bankës Botërore, 23 – 25 qershor 2009, të radhitet si pikë e tretë, pas pyetjeve parlamentare.

2. Pika e tetë e rendit të ditës - Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-105 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2009, të radhitet si pikë e katërt.

Ndërsa pika e shtyrë nga seanca e kaluar - Shqyrtimi i rekomandimit të Komisionit ad-hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për anëtarë të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës, nga komuniteti serb, të radhitet si pikë vijuese e kësaj seance.

Lus deputetët që ta miratojnë këtë propozim. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Kush është për mocionin e paraqitur nga deputeti? Faleminderit! A ka kundër? Me shumicë votash miratohet mocioni. Faleminderit!  
Fjalën e ka kërkuar edhe deputetja Besa Gaxherri.

BESA GAXHERRI: Faleminderit, zoti Kryetar!

I nderuar Kabinet qeveritar,  
Të nderuar kolegë deputetë,  
Lidhja Demokratike e Dardanisë ka vendosur sot ta ngritë shqetësimin e saj për mosfunksionimin e seancave plenare. Duke pasur parasysh që vërtet më shumë se një vit në Kuvendin e Kosovës bëhet thyerja e rregullave demokratike, etikës dhe kulturës

parlamentare, njëkohësisht shkelja e Rregullores së Kuvendit, siç është ndryshimi i rendit të ditës gati në çdo seancë, në radhë të parë, nga Qeveria jashtë normave të Rregullores së Kuvendit. Pra, rast konkret kemi edhe sot me rendin e ditës për çka duhet të reagojnë shefat e grupeve parlamentare, sepse pikat që kanë rëndësi të veçantë, zakonisht vendosen në fund të rendit të ditës, kur vërtet nuk ka transmetim publik.

Kemi raste konkrete, siç është mbi 80 vota që deputetët kanë nënshkruar për Ligjin për deputetë dhe nuk sillet ose nuk aprovohet Ligji për deputetët. Kemi mbi 10 mijë nënshkrime që ka mbledhur Shoqëria Civile për mos ngritjen e çmimit të energjisë dhe ajo fare nuk është sjellë në Kuvend.

Kemi ndërhyrjet e Kryeministrit që hyn në mes të seancës jashtë pikës së rendit të ditës, që është jashtë Rregullores së Kuvendit, sepse ne e dimë të gjithë se Kryeministri mund ta mbajë fjalën, natyrisht në fillim të seancës plenare, por jo kur të dojë dhe në cilën pikë të rendit të ditës të ndërhyjë dhe të kalojë në pikë tjetër të rendit të ditës.

Kemi mospjesëmarrjen e ministrave në seanca plenare dhe deputetët nuk kanë kujt t'ia bëjnë pyetjen që e radhitin në procedurë të rregullt karshi Rregullores së Punës së Kuvendit.

Kemi, zoti Kryetar, përdorim të gjuhës jo parlamentare që vërtet ende asnjëherë ju si Kryetar i Kuvendit nuk ua keni tërhequr vërejtjen apo nuk keni marrë masa duke u bazuar në Rregulloren e Punës së Kuvendit, sidomos për deputetët e mazhorancës ...

**KRYETARI:** Faleminderit!  
Fjalën e ka kërkuar deputeti Ibrahim Makolli.

**IBRAHIM MAKOLLI:** Faleminderit, zoti Kryetar!  
Të nderuar kolegë,  
Unë do të shtroj një shqetësim, për të cilin besoj që Ministria për Arsim, Shkencë dhe Teknologji, do të duhej të na jepte përgjigje. Rekomandimet e tri komisioneve të Kuvendit të Republikës së Kosovës për magjistrat e mjekësisë drejtuar Ministrisë, Rektoratit dhe Fakultetit të Mjekësisë, nuk janë zbatuar në praktikë. Pyes dhe po shpreh njëkohësisht shqetësimin pse nuk zbatohen rekomandimet e Kuvendit të Republikës së Kosovës? Është shqetësim yni dhe besoj është shqetësim edhe i gjithë atyre të cilët nuk po arrin t'i realizojnë të drejtat e tyre të parapara me ligj, por në veçanti çështja është te moszbatimi i vendimeve dhe i qëndrimeve të Kuvendit të Republikës së Kosovës. Faleminderit!

**KRYETARI:** Faleminderit! Këta ishin deputetët që paraprakisht kanë kërkuar fjalën për t'i ngritur shqetësimet që i kanë. Kërkesa të tjera nuk ka. Vazhdojmë me pikën e parë të rendit të ditës:

## **1. Miratimi i Procesverbalit të seancës plenare të mbajtur më 9 e 10 korrik 2009**

Ju njoftoj se Procesverbali dhe Transkripti i seancës plenare të mbajtur më 9 dhe 10 korrik 2009, u është shpërndarë deputetëve. Pyes deputetët, a kanë vërejtje në procesverbal? Fjalën e ka kërkuar deputeti Driton Tali.

**DRITON TALI:** Faleminderit, zoti Kryetar!

Nuk kam vërejtje për procesverbal, por për transkript. Një lëshim të vogël do ta jepja. Në faqen 44, në paragrafin e fundit, thuhet, biznesi personal, pra solltrejder- diçka kanë shkruar këtu që në realitet duhet të ishte soletrader, ky është, domethënë biznesi privat. Vetëm kjo të përmirësohet për shkak të rëndësisë që ka. Faleminderit!

KRYETARI: A ka ndokush tjetër? Atëherë, kërkoj nga administrata që ta bëjë përmirësimin e caktuar, dhe konsideroj se Kuvendi miratoi Procesverbalin e seancës të 9 e 10 korrikut 2009.

Pika e dytë e rendit të ditës:

## **2. Pyetjet parlamentare**

Ju njoftoj se në pajtim me Rregullën 26.1 të Rregullores së Punës së Kuvendit, koha për pyetjet e deputetëve për Qeverinë është e kufizuar në 50 minuta, por sot kemi më pak pyetje, kështu që po fillojmë menjëherë me pyetjen e parë.

Deputeti Riza Smaka, pyetje për ministrin e Bujqësisë, të Pylltarisë dhe të Zhvillimit Rural, zotin Idriz Vehapi. Pasi që deputeti nuk është këtu, vazhdojmë.

Deputeti Driton Tali, pyetje për zëvendëskryeministrin apo ministrin e Ekonomisë dhe të Financave, zotin Ahmet Shala.  
Zoti deputet, e ke fjalën.

DRITON TALI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Çështja është kjo: Kohë më parë u publikua se Qeveria i ka dhënë 5.7 milionë euro Kompanisë Izraelite Saatchi & Satchi për përmirësimin e imazhit të Kosovës. Pyetja është: - Në cilën fazë të implementimit është ky projekt, sepse opinioni kosovar është i informuar pak lidhur me atë se çka po ndodh me këtë projekt? Faleminderit!

KRYETARI: Zoti ministër,

MINISTRI AHMET SHALA: I nderuar zoti Kryetar,  
I nderuar zoti Kryeministër,  
Të nderuar ministra,  
Të nderuar deputetë,

I nderuar zoti deputet, së pari më lejoni të bëj një korrigjim në konstatimin tuaj, se Qeveria e Republikës së Kosovës nuk ia ka dhënë 5,7 milionë euro kompanisë në fjalë. Në fakt, tenderi për imazhin e Kosovës, është e vërtetë se fitues është prej 5.7 milionë euro, por në bazë të Ligjit të menaxhimit të financave publike dhe të Ligjit për prokurimin, sipas procedurave në fjalë, çdo kompani që fiton mund t'i jepet një avancë deri në 20%. Dhe, besoj që pas aprovimit të planit, i cili është paraqitur para Komisionit ndërministror që përbëhet nga: Ministria e Punëve të Jashtme, Zyra e Kryeministrit, Ministria e Ekonomisë dhe Financave, Ministria e Arsimit dhe ministrinë ose institucionet tjera relevante, kjo kompani do të ketë mundësi të ketë pjesën prej 20%.

Sipas kushteve të kontratës, pra 20% do jetë 1.140.800 euro, të cilat në momentin kur grupi ndërministror, i përbërë prej institucioneve që thashë e aprovon modelin dhe planin, të cilin para disa ditësh patëm fatin ta shohim dhe konsideroj që është një punë e shkëlqyeshme që është bërë pas një konsultimi edhe me institucione të rëndësishme tjera, qofshin qeveritare, qofshin joqeveritare, ka dalë një solucion që vërtet të gjithë ju do të

jeni krenar me atë që besoj së shpejti do të shihni nëpër masmediat botërore, qofshin ato elektronike, qofshin të shkruara. Sigurisht, për çfarëdo informacioni tjetër më detal ne jemi të gatshëm të japim informacione të hollësishme për punën dhe besoj që edhe opinionin do t'i shohë disa produktet finale, që do të paraqesin imazhin e vërtetë të Kosovës dhe besoj që do të reflektojnë mjaft fuqishëm në arenën ndërkombëtare. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, ministër! Deputet, a ke pyetje shtesë?

DRITON TALË: Po, zoti ministër, s'di tash jam edhe më keq i informuar me këtë përgjigje tënde sesa që isha më parë, për shkak se Saatchi & Saatchi kur kanë aplikuar për tender, a nuk e ka treguar biznes-planin se çfarë do të bëjë për atë shumë të parave. Duke marrë parasysh se ky tender i është dhënë në nëntor të vitit 2008, tash jemi në korrik të vitit 2009, domethënë janë një 9 – 10 muaj. Si ka shkuar procedura? Së pari ua keni dhënë tenderin Saatchi & Saatchi, që më pastaj t'ua sjellin biznes-planin. Apo paraprakisht kanë ardhur me biznes-plan, unë sinqerisht nuk po i di këto procedurat tuaja të prokurimit. Nëse nuk përtori, ju lutem, m'i shpjegoni, sepse jam shumë kureshtar ta di? Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Ministër, e ke fjalën.

MINISTRI AHMET SHALA: Driton, nuk është turp mos ta dish. Konsideroj që njeriu gjatë gjithë jetës mëson dhe besoj që do të kesh rastin të njoftohesh për të gjitha detajet.

Nuk mund të sjellë asnjë kompani paraprakisht se çfarë ne dëshirojmë të japim për imazhin e Kosovës. Mund të jetë një plan se si do të veprojnë- një metodologji si do t'i qaset, kurse çfarë do të paraqesim në CNN, në Euro News, do të vendosë ky grup ndërministror dhe ne, pas sugjerimeve, konsultimeve dhe të gjitha që janë bërë në muajt e kaluar që i përmendët, kemi pasur fatin të shohim një koncept i cili vërtet reflekton vlerat e Kosovës. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, ministër!

Deputeti Riza Smaka, përsëri nuk është këtu. Deputeti Arsim Rexhepi, pyetje për ministrin e Ekonomisë dhe Financave, zotin Ahmet Shala. Deputet, e ke fjalën.

ARSIM REXHEPI: Zoti Kryetar, nëse ka mundësi pyetjen do ta shtyj për seancën e ardhshme për shkak se prioritetet e mia kanë qenë të koncentruara në një gjë të cilën opinionin tashmë e di dhe e cila për shkak të çuditshmë po bllokohet.

KRYETARI: E dërgojmë në botim atë. Deputeti Driton Tali, pyetje për ministren e Energjetikës dhe e Minierave, zonjën Justina Shiroka- Pula.

DRITON TALË: Faleminderit, zoti Kryetar!

Zonja ministre, siç e dimë, për shkak të situatës në KEK jemi të detyruar të importojmë rrymë elektrike. Pyetja ime është: - Sa megavatë janë importuar vitin e kaluar dhe me çfarë çmimi mesatar dhe mundësisht të na tregoni se sa milionë euro janë shpenzuar vjet për import të rrymës? Faleminderit!

KRYETARI: Ministre, e ke fjalën.

MINISTRJA JUSTINA PULA- SHIROKA: Faleminderit, i nderuar Kryetar!

I nderuar Kryeministër,

Ministra dhe deputetë,

Konsumi i energjisë elektrike në Kosovë në vitet e fundit ka një indeks të rritjes. Prodhimi apo gjenerimi i energjisë elektrike nga kapacitetet gjeneruese ekzistuese nuk i mbulon këto nevoja, prandaj, jemi të obliguar të importojmë energji elektrike.

Mirëpo, pavarësisht nga importi i energjisë elektrike, prodhimi i kapaciteteve gjeneruese nga viti 2000 deri në 2008 paraqet një rritje të dukshme. Në vitin 2000 kemi pasur diku 1800 gigavatë orë, në vitin 2008 mbi 4451 gigavatë orë, që do të thotë se kemi një rritje të dukshme në vitin e fundit, mirëpo pavarësisht kësaj, nuk e mbulojmë konsumin e energjisë elektrike.

Rritja e prodhimit në fakt, nëse e krahasojmë me vitin 2000, është 33% më e madhe, ndërsa në vitin 2008 në krahasim me vitin 2007, rritja e prodhimit të energjisë elektrike është diku mbi 12.6%, që do të thotë se me kapacitetet gjeneruese ekzistuese diku 87.6% mbulohen me prodhimin vendor, vetëm 12.6% mbulohen me importin e energjisë elektrike.

Importi i energjisë elektrike në vitin e kaluar ka qenë diku 457 apo 460 gigavatë orë, që do të thotë se është relativisht vetëm 12.6%. Çmimi i energjisë elektrike në vitin 2008 ka qenë 34% më i lartë se në vitin 2007, prandaj për këtë sasi të importuar diku është mbi 51 apo 52 milionë euro. Mirëpo, duhet të cekim. Nëse marrim raportin e bruto importit, pra sa i përket blerjes së energjisë elektrike dhe shkëmbimit të energjisë elektrike në vitin 2008 këtë raport e kemi pasur shumë më të mirë, që do të thotë se vetëm 70% të importit e kemi blerë, ndërsa 30% të importit kemi bërë shkëmbime me vende të tjera në krahasim me vitin paraprak, i cili ka qenë 87% të blerjes së importit të energjisë elektrike dhe vetëm 13% ka qenë shkëmbimi.

Thashë, edhe më tutje duhet të bëjmë import të energjisë elektrike për shkak se kemi zvogëlim apo nuk e plotësojmë konsumin e energjisë elektrike me kapacitetet gjeneruese.

KRYETARI: Faleminderit, ministre!

Deputet, a ke pyetje shtesë? Urdhëro!

DRITON TALI: Zonja ministre, të lutem, ma shpjegoni, se unë nuk jam kah kuptoj. Si është e mundur KESH-i shqiptar, domethënë, Korporata Energjetike e Shqipërisë, në të njëjtën kohë si KEK-u, importon rrymë nga e njëjta kompani Zvicerane EFT, Energy Financing Team, megavatin me 52.95 euro. Ja ku e kam kontratën, gjersa KEK-u, po flasim për dhjetorin e vitit 2008, nga e njëjta kompani e importon rrymën nominale me 123.7 euro gjersa... pikun për 128.6 apo 2.4 herë më shtrenjtë.

Pastaj, si është e mundur KESH-i në janar të vitit 2009 nga EGL-ja zvicerane, përsëri nuk po flas për këto kompanitë e Serbisë nga të cilat importoni edhe ju, edhe KESH-i, por nga EGL-ja, megavatin e blen për 49 euro, gjersa KEK-u nga EGL-ja, megavatin e blen, ta këqyri këtu 119.7 euro, përsëri 2.4 herë më shtrenjtë. Pra, nga 52 milionë euro këtu po bie nja 30.33 milionë euro si diqysh po humbin këtu për shkak se paguajmë rrymë elektrike më të shtrenjtë. Po flas për të njëjtën periudhë për dy korporata simotra dhe bile- bile KESH-i këto kontrata i ka nënshkruar me procedurë të përshpejtuar për shkak të situatës emergjente, gjersa KEK-u, sipas, të paktën kësaj kontrate që e keni publikuar, është marrë vendimi me tender të hapur, d.m.th me tender të rregull, më 9 dhjetor 2008, por me çmime shumë më të shtrenjta, tash mbase keni marrë rrymë më

kualitative se KESH-i, apo mbase kështu keni qenë të këshilluar nga miqtë ndërkombëtarë, nga ekspertët e Bankës Botërore, po çka është shpjegimi në këtë rast? Faleminderit!

KRYETARI: Ministre, regjia ia ka zgjatur një minutë më tepër.

MINISTRJA JUSTINA PULA- SHIROKA: Zotëri Tali, pyetja për mua ka qenë: - Sa keni importuar energji elektrike dhe me cilin çmim dhe unë ju dhashë atë përgjigje. Më falni, nuk e kam pasur pyetjen prej kujt kemi importuar, si kemi importuar dhe nuk e kam pasur pyetjen të shoh se si importon KESH-i dhe në çfarë rrethanash importon? Domethënë, duhet ta dini pyetjen cilën ma keni bërë - e kam dhënë përgjigjen. Nëse doni këtë pyetje, atëherë ma bëni tjera herë dhe e shohim.

E dyta, unë mund të flas vetëm për raportin e KEK-ut se si importon dhe prej të cilave firma për të cilën nuk mund tani t'ju them se nuk jam në procesin e importit të energjisë elektrike në KEK. Unë thashë atë çka më bëre pyetje dhe çka iu dhashë përgjigje, ajo është juaja.

Mirëpo, duhet ta dimë edhe një proces tjetër se KEK-u dhe KESH kanë një koncept tjetër dhe mundësi tjetër të importit të energjisë elektrike në tregun vendor në krahasim me vendet e tjera. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Kemi përfunduar rendin e ditës, pyetjet parlamentare.

Veç kisha dëshiruar që vërtet kur të bëhen pyetjet parlamentare, të jenë të sakta dhe të mos ketë polemika.

Vazhdojmë me pikën e tretë të rendit të ditës:

## **2. Ratifikimi i Marrëveshjes për përvetësimin e kredisë në mes Republikës së Kosovës dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, si dhe i Memorandumit të Misionit të Thesarit të Bankës Botërore të 23 dhe 25 qershorit 2009**

Qeveria e Republikës së Kosovës e ka proceduar për ratifikim në Kuvend Marrëveshjen për përvetësimin e kredisë në mes Republikës së Kosovës dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim si dhe të Memorandumit të Misionit të Thesarit të Bankës Botërore të 23 dhe 25 qershorit 2009.

Komisioni për Buxhet dhe Financa, në pajtim me dispozitat e Rregullores së Punës së Kuvendit ka shqyrtuar marrëveshjen për përvetësimin e kredisë në mes Republikës së Kosovës dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim si dhe Memorandumin e Misionit të Thesarit të Bankës Botërore të 23 dhe 25 qershorit 2009 dhe Kuvendit ia ka rekomanduar për miratim në seancë plenare.

Ftoj Kryeministrin e Republikës së Kosovës, zotin Hashim Thaçi, që në emër të Qeverisë së Republikës së Kosovës, para deputetëve të Kuvendit, të prezantojë marrëveshjen në fjalë.

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Të nderuar deputetë,

Kabinet qeveritar,

Sot është një ditë edhe mund të them edhe akt solemn, sepse kemi krijuar mundësinë e ratifikimit të kësaj marrëveshje. Siç e dini, para pak ditësh në Uashington, Presidenti dhe unë, si Kryeministër i Kosovës, nënshkruam anëtarësimin e Kosovës në Fondin Monetar Ndërkombëtar dhe Bankën Botërore. Pra, Kosova, shteti i Kosovës u anëtarësua në dy organizatat më të fuqishme financiare. Ky anëtarësim i shtetit të Kosovës u përkrah nga 138 shtete, 62 prej të cilave e kanë njohur shtetin dhe të tjerat që janë në proces të njohjes.

Anëtarësimi i Kosovës në Bankën Botërore dhe në Fondin Monetar Ndërkombëtar paraqet fuqizimin në procesin e konsolidimit të plotë të shtetit të Kosovës. Ky anëtarësim e fuqizon shtetin e Kosovës edhe në raport me bashkësinë ndërkombëtare.

Ky anëtarësim i shtetit të Kosovës në Fondin Monetar Ndërkombëtar dhe Bankën Botërore hap perspektivë për njohje të reja për shtetin tonë, hap perspektivë të sigurt për integritet euroatlantike.

Ky anëtarësim i shtetit të Kosovës hap mundësi për fillimin real të zhvillimit ekonomik të shtetit të Kosovës. Ky anëtarësim për shtetin e Kosovës hap mundësi të reja, hap perspektivë, hap dritare të reja dhe natyrisht dhe shteti i Kosovës merr përgjegjësitë që i takojnë si shtet. Sipas Kushtetutës, natyrisht, në Uashington e nënshkruam edhe marrëveshjen me OPK-në, që siguron investime, por në të njëjtën kohë edhe që mbështet projektet.

Në të ardhmen shumë të afërt ne presim që shteti i Kosovës të anëtarësohet edhe në IBRD, prandaj, sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës, ky anëtarësim duhet të ratifikohet edhe nga Parlamenti i Republikës së Kosovës. Ky është një akt solemn para të cilit kemi të gjithë përgjegjësi, por në të njëjtën kohë merita për arritjen e këtij suksesi historik të Republikës së Kosovës.

Prandaj, para se të paraqesë edhe ministri disa aspekte të tjera më në detaje, do t'ju ftoj në emër të Qeverisë së Republikës së Kosovës për një votim unanim. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, Kryeministër!

Vazhdo, ministër.

MINISTRI AHMET SHALA: Faleminderit, i nderuar Kryetar!

Të nderuar deputetë,

Më lejoni që në fillim t'ju informoj se vetëm ca ditë më parë Fondi Monetar Ndërkombëtar ka propozuar ndarjen e re të aksioneve, përkatësisht të ashtuquajturave Ezdiars chpechedroin grajtes- të drejtës speciale të tërheqjes ose detirazhit, siç përkthehet në gjuhën shqipe, për Kosovën dhe atë në vlerë prej ekstra 43, 7 milionë ezdiarë. Pra, kjo e drejtë, kjo rritje e forcës së aksioneve i mundëson Kosovës që të ketë edhe të drejtën e tërheqjes më të madhe dhe kjo është një shenjë e mirë, që vetëm pak ditë pasi që Kosova u bë anëtare e Fondit Monetar Ndërkombëtar dhe Bankës Botërore, jo vetëm Kosovës, por me qëllim që Fondi Monetar Ndërkombëtar të ketë një fuqi më të madhe për intervenimet në kushte të ndryshme të krizave, të kenë mundësi që shtetet në mënyrë vullnetare, natyrisht të blejnë, përkatësisht të kenë të drejtën e tërheqjes më të lartë, dhe unë propozoj që përmes një procesi të votimit, pra edhe të miratimit të

ratifikimit të kësaj, ne në të njëjtën kohë, mbase në një pikë të veçantë më vonë, s'do të thotë sot, ta miratojmë edhe këtë çështje.

Në linjë me këto ne kemi marrë kërkesë nga Fondi Monetar Ndërkombëtar që guvernatori, ju e dini që me aktin e pranimit ne kemi vendosur që Kosovën në Bankën Botërore ta përfaqësojë ministri i Ekonomisë dhe Financave, ndërsa në Fondin Monetar Ndërkombëtar- guvernatori i Bankës Qendrore, që është praktikë po thuaj se edhe e shumë shteteve në regjion dhe më gjerë. Kërkohet që guvernatori ynë, pra, të votojë në propozimin e Fondit për ndryshimin e disa amendamenteve të akteve për anëtarësim.

Para se guvernatori ynë të mund të votojë, pra, kërkohet deklarimi i Parlamentit nëse i mbështet këto propozime të Fondit Monetar Ndërkombëtar, që ne të kemi mundësi të blejmë, përkatësisht të kemi mundësi ta rritim forcën e votimit në Fondin Monetar Ndërkombëtar, që konsideroj që është për të mirën e Kosovës.

Për të qenë edhe më i saktë, Fondi Monetar Ndërkombëtar ka kërkuar deklarimin e të gjithë anëtarëve, pra jo vetëm të Kosovës, dhe do të ishte mirë që edhe ne si anëtar i ri ta aprovojmë këtë propozim, andaj në mënyrë që të jemi në harmoni me ligjet tona dhe Kushtetutën, siç e propozoi edhe Kryeministri i Republikës së Kosovës, ne, nën një, së pari duhet të miratojmë formalisht anëtarësimin e Kosovës në Fondin Monetar Ndërkombëtar dhe në Grupin e Bankës Botërore, por në mënyrë që ne t'i përmbushim kërkesat e brendshme ligjore, duhet që sot ta miratojmë Marrëveshjen për anëtarësim, si akt final i këtij procesi. Prandaj, propozoj që pasi ta aprovojmë kështu, ashtu siç është e paraparë edhe në agjendë, ne ta ratifikojmë marrëveshjen për përvetësimin edhe të huas, përkatësisht për pranimin e huas të ashtuquajtur "huaja e konsoliduar C". E dini që ish-Jugosllavia ka pasur hua të ndryshme me Bankën Botërore. Ka qenë huaja e konsoliduar A, B dhe C, ku projekte të caktuara të Kosovës janë financuar nga këto hua, të cilat do t'i ... më vonë, në pikën e veçantë të rendit të ditës.

Prandaj, propozoj që këto që u përmendën, të aprovohen në paketë dhe t'i jepet po ashtu mundësia që me një amendamentim të caktuar të amendamentohen disa akte normative të cilat janë të rëndësishme me qëllim që t'i jepet mundësi ose fuqi guvernatorit që të votojë për rritjen e aksioneve, përkatësisht të drejtës speciale të tërheqjes së Republikës së Kosovës në Fondin Monetar Ndërkombëtar dhe kështu ne të arrijmë në 159 milionë dollarë.

Një shtet ka të drejtë të tërheqë fuqi financuese nga Fondi Monetar Ndërkombëtar, pra brenda vitit, dyfish nga forca tërheqëse. Në qoftë se ne do ta ngrisim 159 milionë dollarë të drejtën e tërheqjes, atëherë dyfishi i kësaj brenda një viti do të ishte diku 300 milionë euro, andaj besoj që me qëllim që t'i përmbushim nevojat dhe kërkesat tona të projekteve që janë paraqitur para Qeverisë dhe popullit të Kosovës, një ngritje e aksioneve të Kosovës ose e të drejtës së tërheqjes do të mundësonte realizimin e këtyre projekteve më shpejt dhe mundësinë e mbështetjes më të fuqishme nga Fondi Monetar Ndërkombëtar.

Në qoftë se ka nevojë që çështjet tjera të diskutohen më herët, ju lutem, unë jam këtu dhe detajet për huan do të shpjegohen në pikën e rregullt të rendit të ditës që është tani. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Sipas radhës, fjalën e ka kryetari i Komisionit për Buxhet dhe Financa, Gani Koci.

GANI KOCI: Faleminderit, zoti Kryetar!

I nderuar Kryeministër,

Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Komisioni për Buxhet dhe Financa në mbledhjen e vet të mbajtur dje ka shqyrtuar kërkesën e Qeverisë për miratimin e Marrëveshjes për përvetësimin e kredisë dhe ia ka dhënë vizën që kjo marrëveshje të ratifikohet në Kuvend. Dhe, dua t'ju njoftoj se sipas të gjitha procedurave zakonisht ratifikimi i marrëveshjeve ndërkombëtare bëhet me një census të caktuar dhe në këtë rast është me 2/3 e Kuvendit, dhe se ndryshimi eventual ose kërkesat për ndryshimin eventual të kësaj marrëveshje nuk janë të mundura, për shkak se ne po bëjmë ratifikimin.

Dua të ngre edhe një çështje në vargun po them të proceseve që kanë ardhur deri këtu lidhur me çështjen që duhet ta ratifikojë sot. Ky Kuvend në qershor ka miratuar Ligjin për anëtarësim në Fondin Monetar Ndërkombëtar dhe i ka dhënë vizën Qeverisë, respektivisht Kryeministrit dhe Presidentit që të nënshkruajnë marrëveshjen që më 23 dhe 25 qershor dhe ajo marrëveshje e anëtarësimit që ka pasuar pastaj me nënshkrimin e përfaqësuesve të Kosovës është dashur të ratifikohet paraprakisht, para kësaj marrëveshje në këtë Kuvend.

Prandaj, unë konsideroj se ne sot kemi dy çështje për të cilat do të duhej të votonim dhe të dyja kërkojnë atë censusin prej 2/3. Një, në radhë të parë ratifikimin e anëtarësimit të Kosovës në Fondin Monetar Ndërkombëtar, dhe nën dy, ratifikimin e Marrëveshjes për përvetësimin e kredisë, prandaj Kuvendi është ai që duhet të vendosë për këto çështje. Dhe, unë mendoj në radhë të parë, kërkesën e dytë po them, që do të duhej të ishte e para e kemi marrë me vonesë ne si Komision dhe nuk kemi arritur ta shqyrtojmë, po për shkak se procedurat janë të njëjta sikurse në të parën që kemi shqyrtuar dje, konsideroj se ne nuk bëjmë ndonjë shkelje procedurale, përkundrazi gjërat i vendosim në radhën e vet, në vijën e vetë dhe prandaj lus që të votojmë për këto dy çështje të cilat janë shumë të rëndësishme. Ne së shpejti do ta kemi edhe nënshkrimin e Marrëveshjes me Shtetet e Bashkuara të Amerikës për investimet, që është në procedurë dhe do të diskutohet, edhe ajo e ka karakterin e një marrëveshje ndërkombëtare, por që mund të bëhet në një seancë tjetër.

KRYETARI: Faleminderit!

Sipas radhës, fjalën e ka kryetari i Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, zoti Ramë Buja.

RAMË BUJA: I nderuar zoti Kryetar!

I nderuar zoti Kryeministër,

Kabinet qeveritar,

Të nderuar dhe të respektuar kolegë deputetë,

Unë sot kam kënaqësinë që bart disponimin unanim të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike për ratifikimin e Marrëveshjes së parë ndërshtetërore - Marrëveshjes për përvetësimin e kredisë në mes Republikës së Kosovës dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, si dhe të Memorandumit të Misionit të Thesarit të Bankës Botërore 23 – 25 qershor 2009.

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike do të votojë për ratifikimin e kësaj marrëveshje.

KRYETARI: Faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës, deputeti Lutfi Haziri e ka fjalën.

LUTFI HAZIRI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Kryeministër, ministra të Kabinetit qeveritar,

Grupi Parlamentar i LDK-së e mbështet ratifikimin e Marrëveshjes, si dhe e mbështet ratifikimin e protokollit të Thesarit të Bankës, po ashtu. Ne besojmë që jemi në pikën e procesit ku Parlamenti po e merr rolin për ratifikimin e marrëveshjes që Kosova po hyn në aspektin ndërkombëtar. Faleminderit shumë!

KRYETARI: Faleminderit!

Sipas radhës, në emër të Grupit Parlamentar të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, deputeti Ardian Gjini e ka fjalën.

ARDIAN GJINI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Edhe Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës e mbështet këtë ratifikim në dy pozicionet. Mendojmë që është një moment kur ne e përmbushim premtimin të cilin e kemi dhënë më herët – po i marrim mbi vete obligimet e mëparshme. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Fjalën e ka kryetari i Grupit Parlamentar të AKR-së, Ibrahim Makolli.

IBRAHIM MAKOLLI: I nderuar Kryetar i Kuvendit,

I nderuar Kryeministër,

Të nderuar kolegë,

Ratifikimi i Marrëveshjes për përvetësimin e kredisë në mes Republikës së Kosovës dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, si dhe Memorandumi i Misionit të Thesarit të Bankës Botërore, 23 – 25 qershor 2009, është ndër aktet më të rëndësishme të Kosovës, pas Deklaratës së Pavarësisë dhe miratimit të Kushtetutës së Kosovës.

Kosova është zotuar se do t'u përgjigjet obligimeve ndërkombëtare dhe çdo herë kur është në pyetje interesi shtetëror, Grupi Parlamentar i Aleancës Kosova e Re do ta përkrahë, prandaj edhe në këtë rast, Grupi Parlamentar i AKR-së e përkrah unanimisht ratifikimin e kësaj marrëveshje. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, kryetari i Grupit, Lulzim Zeneli e ka fjalën.

LULZIM ZENELI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Dardanisë mbështet Marrëveshjen për përvetësimin e kredisë në mes Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim dhe Republikës së Kosovës dhe duke qenë në të njëjtat gjatësi me Komisionin për Buxhet, konsiderojmë që çështja e parë dhe çështja e dytë duhet të trajtohen të ndara, në mënyrë që të mos krijohet alibi apo mos të krijohen mangësi në procedurën dhe në punën e Komisionit për Buxhet sa i përket çështjes së dytë. Për çështjen e parë japim mbështetje, duke konsideruar si pjesë të afirmimit të shtetësisë së Kosovës në marrjen e obligimeve ndërkombëtare. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar “7+”, deputeti Xhezair Murati, e ka fjalën.

DŽEZAIR MURATI: Hvala, gospodine predsedniče!

Dosvolite da pozdravimo Premijera i njegov kabinet,

Kolege, goste,

Parlamentarna grupa „7+“, kao što smo izjavili i prilikom sastanka šefova grupa, podržava u potpunosti potpisivanje sporazuma između Svetske banke i Kosova, smatrajući to isključivo državnim pitanjem, nimalo političkim ili partijskim, i mi u potpunosti podržavamo ratifikaciju ovog sporazuma i prihvatamo ga, normalno, u punoj meri, smatrajući to jednim izuzetnim ekonomskim pitanjem u ovom ekonomskom trenutku pa i političkom trenutku naše države. Toliko.

KRYETARI: Faleminderit!

Në emër të SLS-së nuk ka të paraqitur. Nuk ka as deputetë të tjerë të paraqitur për diskutim.

Të nderuar deputetë, hymë në fazën e votimit dhe kemi dy votime.

Në sallë kemi 90 deputetë. Së pari votojmë ratifikimin e anëtarësimit të Kosovës në Fondin Monetar Ndërkombëtar dhe Grupin e Bankës Botërore.

Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim. Votojmë tash.

Konstatohet se me 89 vota “për”, asnjë “kundër” dhe 1 abstenim, Kuvendi miratoi ratifikimin e anëtarësimit të Kosovës në Fondin Monetar Ndërkombëtar dhe në Grupin e Bankës Botërore. Faleminderit!

(Duartrokitje)

Dhe, çështja e dytë për të cilën do të votojmë është:

Ratifikimi i Marrëveshjes për përvetësimin e Kredisë në mes të Republikës së Kosovës dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, si dhe Memorandumin e Misionit të Thesarit të Bankës Botërore të 23 - 25 qershorit 2009.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim dhe votojmë tash.

Konstatohet se me 82 vota “për”, 1 “kundër” dhe 3 abstenime, Kuvendi miratoi ratifikimin e Marrëveshjes për përvetësimin e kredisë në mes të Republikës së Kosovës dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, si dhe Memorandumin e Misionit të Thesarit të Bankës Botërore të 23 – 25 qershorit 2009.

Ju faleminderit!

Atëherë, po e bëjmë një pauzë 15 minuta, pas këtij votimi kaq të mirë.

### **Vazhdimi i seancës pas pauze**

KRYETARI: Të nderuar deputetë. Vazhdojmë me pikën e katërt të rendit të ditës:

### **3. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-105 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2009**

Qeveria e Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 25 të Ligjit për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë ka hartuar dhe Kuvendit ia ka paraqitur për shqyrtim dhe miratim Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2009.

Projektligji u është shpërndarë deputetëve. Ftoj Kryeministrin e Republikës së Kosovës, zotin Hashim Thaçi, që para deputetëve të Kuvendit të paraqesë fjalën hyrëse.

**KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI:** Faleminderit!

I nderuar Kryetar Krasniqi,

Të nderuar deputetë,

Të nderuar ministra,

Më lejoni që shkurtimisht t'ju paraqes platformën tonë për rishikimin e buxhetit për vitin 2009. Ky rishikim është duke u bërë në kohën ku veç kemi kaluar gjysmën e parë të vitit dhe tani kur kemi shumë më tepër informata për performancën e ekonomisë për këtë vit, në veçanti për performancën e të hyrave buxhetore dhe të shpenzimeve. Njësoj sikurse buxheti fillestar i vitit 2009, ky rishikim i buxhetit ka për bazë Kornizën afatmesme të shpenzimeve, që është dokument kryesor udhërrëfyes për politikat e Qeverisë në tri vjetët e ardhshëm.

Që në fillim po them se ky është mesazhi kryesor- ajo e cila kemi punuar, është se ky rishikim buxheti lirisht mund të konsiderohet si rishikim i brendshëm, pa lëvizur kufijtë e përgjithshëm fillestar dhe pa ndikim në bilancin e përgjithshëm bankar.

Është po thuaj se e natyrës që jo të gjitha kërkesat e organizatave buxhetore të mund të akomodohen me këtë rishikim të buxhetit, megjithatë falë vendosmërisë sonë për të gjetur kursime në fusha të caktuara ne, me këtë rishikim kemi propozuar financime shtesë në shumë prej 108.9 milion euro.

Këto kursime vijnë kryesisht nga vendimi ynë për të zvogëluar kreditë fillestare të KEK-ut, nga ridestinimi i mjeteve të parapara për shërbimin e borxhit të jashtëm, si dhe nga projeksionet më të larta për të hyrat vetjake të komunave.

Falë këtyre kursimeve ne kemi mundur që të ndajmë mjete shtesë për projekte me rëndësi të veçantë për rritjen ekonomike dhe përmirësimin e kualitetit të jetës së qytetarëve tanë. Gjithashtu, këto mjete shtesë vijnë edhe si rezultat i luftës pa kompromis kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar.

Ne me këtë rishikim kemi ndarë mjete për të filluar edhe ndërtimin e autostradës Vërmicë – Morinë, Prizren – Prishtinë – Mendare, autostradë që përfundimisht do ta lidhë Kosovën me gjithë rrjetin e transportit rrugor dhe detar evropian. Kjo edhe një herë tregon përkushtimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës për reformat e mëdha që janë garanci për një të ardhme më të mirë për të gjithë qytetarët. Ne do t'i vazhdojmë reformat tona në fushën e arsimit. Kemi ndarë mjete shtesë për hapësira të reja si dhe për modernizimin e këtyre hapësirave.

Gjithashtu, për blerjen e teksteve shkollore për të gjithë nxënësit nga klasa e parë deri në klasën e nëntë dhe shpërndarjen e tyre gratis. Gjithashtu projekti për informatizimin, kompjuterizimin e 1200 shkollave anekënd territorit të Republikës së Kosovës.

Me qëllim të përmirësimit të shërbimeve në sektorin e shëndetësisë, ne edhe në këtë rishikim buxheti kemi ndarë mjete shtesë për barna esenciale. Kjo padyshim se do t'u mundësojë institucione përgjegjëse të shëndetësisë të jenë shumë më produktive, ndërsa qytetarëve të marrin shërbime më kualitative.

Një fushë tjetër me rëndësi për vetëpunësim dhe rritje ekonomike është ajo e bujqësisë, që do të përfitojë mjete shtesë për subvencionimin e këtij sektori. Kjo rritje nuk është e para dhe nuk do të jetë as e fundit. Jemi të përkushtuar që me buxhetin e viteve të ardhshëm, sektorit të bujqësisë t'i japim përkrahje edhe më të madhe.

Në anën tjetër sa i përket të hyrave buxhetore nuk presim ndonjë ndryshim të theksuar nga parashikimet tona fillestare. Përkundër krizës globale, të nderuar deputetë, ne jemi në rrugë të mirë për të realizuar planin fillestar të hyrave, falë përkushtimit të Qeverisë dhe institucioneve përgjegjëse për mbledhjen e të hyrave që ky plan të realizohet.

Të nderuar deputetë,

Gjithashtu dua të theksoj se edhe përkundër krizës globale financiare Kosova është në trend pozitiv të zhvillimit ekonomik në gjashtë mujorin e parë të këtij viti.

Për më tepër, me këtë rishikim buxheti, ne kemi propozuar edhe deklarimin e dividendit nga PTK-ja në shumë prej 200 milionë euro.

Dhe, në fund më lejoni t'ju informoj se ne vazhdimisht kemi qenë në kontakt me institucionet ndërkombëtare që veprojnë në Kosovë dhe besoj se jemi në harmoni edhe me rekomandimet e tyre. Ne kemi vlerësuar dhe maksimalisht kemi respektuar edhe këshillat e tyre, por vendimet janë të Qeverisë së Republikës së Kosovës. Faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit!

Ftoj ministrin e Ekonomisë dhe Financave, zotin Ahmet Shala, që në emër të Qeverisë së Republikës së Kosovës, para deputetëve të Kuvendit të prezantojë arsyeshmërinë e projektligjit.

MINISTRI AHMET SHALA: I nderuar zoti Kryetar i Parlamentit,

I nderuar Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Kam nderin dhe kënaqësinë e veçantë që sot para jush në mënyrë mbase më të detajizuar të paraqes Propozim-projektin e rishikimit të buxhetit të vitit 2009.

Ky rishikimi i buxhetit paraqitet para jush pas një sërë takimesh dhe konsultimesh me të gjithë ministrat dhe stafin teknik të secilës organizatë buxhetore që ka zgjatur mbase dy muaj e gjysmë.

Qëllimi kryesor i rishikimit të buxhetit natyrisht është akomodimi i kërkesave me prioritet nga organizatat buxhetore të cilat për arsye të ndryshme nuk kanë mund të përfshihen në buxhetin fillestar, apo buxheti e bën riakomodimin e kërkesave të reja ose rialokimin e brendshëm, varësisht prej kërkesave dhe mundësive të shtetit, në këtë rast Kosovës.

Përderisa objektivi ynë ka qenë dhe mbetet që çdo rishikim të bëhet brenda kufijve fillestar të buxhetit, në rast se gjinden gjithmonë burime shtesë të financimit, pa rrezikuar qëndrueshmërinë fiskale të shtetit dhe pa rrezikuar kufijtë e stabilitetit makroekonomik,

Qeveria e Republikës së Kosovës mund t'i propozojë Kuvendit për plotësimin dhe financimin e shtesave të reja dhe besoj që ne kemi arritur t'i identifikojmë burimet e reja, përkatësisht kursimet të cilat nuk janë të nevojshme të mbeten të pashfrytëzuara.

Në këtë rishikim kemi pasur një kombinim të akomodimit të kërkesave të organizatave buxhetore brenda rregullimeve të brendshme si dhe financime shtesë të cilat, siç e thashë, janë mundësuar nga kursimet dhe rishikimet që kemi bërë nëpër ministri të ndryshme të linjës.

Sa i përket financimeve shtesë, të gjitha organizatave buxhetore thotë përfshinë një shumë prej 108,9 milionë euro, shumica e të cilave do të dedikohen për investime kapitale me prioritet të Qeverisë së Republikës së Kosovës, më saktësisht, rreth 55 milionë euro do të shkojnë në projektet e reja kapitale, ndër të cilat do përmendja atë që mendoj se është ndër projektet më të rëndësishëm të shtetit të Kosovës, autostrada Morinë – Merdare, si dhe projekte të tjera në Ministrinë e Shëndetësisë, në Ministrinë e Arsimit, Ministrinë e Bujqësisë dhe dikasteret e tjera.

Për më tepër, siç mund të shihni nga materialet që janë dhënë më herët, po thuaj se të gjitha organizatat buxhetore kanë përfituar nga ky rishikim duke rritur buxhetet e tyre kapital.

Në të njëjtën kohë dhe në linjë me zotimet e Qeverisë së Republikës së Kosovës për t'u afruar shërbime më të mira publike dhe rritje të kualitetit të jetesës së qytetarëve të Kosovës, ne kemi ndarë mjete shtesë për Sektorin e energjisë me qëllim të sigurimit të furnizimit të mjaftueshëm me energji elektrike për qytetarët e Kosovës dhe biznesin kosovar.

Ne po ashtu kemi ndarë mjete shtesë për sektorë të tjerë me prioritet, siç e ceka edhe më herët: sektorin e arsimit, shëndetësisë, bujqësisë, dhe dikasteret tjera të rëndësishme për të cilat ju jeni të informuar përmes materialeve në vijim.

Financimi i këtyre projekteve dhe kërkesave të reja shtesë është mundësuar nga kursimet dhe racionalizimi i shpenzimeve në të gjitha nivelet. Këtu kryesisht po i referohen kursimeve që vijnë nga kredia fillestare që i është alokuar Korporatës Energjetike të Kosovës nga ridestinimi i mjeteve të parapara për shërbimin e borxhit të jashtëm si dhe nga projeksionet e reja për të hyrat vetjake të komunave të cilat kapin shumë prej 3,8 milionë euro.

Të nderuar deputetë,

Ju e dini që me buxhetin fillestar ishte paraparë që KEK-ut t'i jepej një kredi prej 150, 4 milionë euro. Tani kur ka kaluar gjysma e vitit, në konsultim me bordin e KEK-ut dhe me menaxhmentin e KEK-ut, është vlerësuar se ajo shumë nuk do të mund të ekzekutohet në tërësi në këtë vit, prandaj ne kemi propozuar shkurtimin e kredisë nga 150 milionë në 100 milionë euro, që do të thotë një kursim prej 50,4 milionë euro.

Siç e thashë edhe më herët një burim shtesë tjetër prej 55 milionë euro vjen nga ridestinimi i mjeteve të parapara për shlyerjen e borxheve të jashtme të Republikës së Kosovës. Këtu më lejoni t'ju them se me buxhetin e vitit të kaluar, pra të vitit 2008, me qëllim të shërbimit të borxhit të jashtëm, pra pagesës së borxheve eventuale që Republika e Kosovës, pas anëtarësimit në Bankën Botërore, do të duhej t'i paguante, ishin ndarë 55 milionë euro. Po ashtu një shumë prej 56 milionë eurosh është ndarë edhe me buxhetin

fillestar të këtij viti, që do të thotë që ndarjet e vitit të kaluar të cilat janë të depozituara në një llogari të veçantë në Bankën Qendrore të Kosovës dhe ndarjet me buxhetin e vitit 2009 fillestar në total janë 111 milionë euro.

Duke ditur tani se maksimumi që mund të kërkohet për vitin në vijim nuk do të kalojë shumë prej 56 milionë euro, ne kemi parë të arsyeshme që shumë prej 55 milionë euro mos ta vendosim në xhirollogarinë e Bankës Qendrore të Kosovës, por ta përdorim për investime kapitale, ndërsa shumë e nevojshme për ta shlyer borxhin, ta planifikojmë për vitin 2010.

Edhe ky rishikim buxheti, ashtu sikur se edhe buxhetet fillestare, është përgatitur duke marrë parasysh zhvillimet e përgjithshme ekonomike dhe fiskale në Kosovë dhe rajon.

Me të vërtetë bazë për këtë rishikim ka qenë korniza afatmesme e shpenzimeve që është përgatitur javë më parë, natyrisht duke marrë parasysh edhe ndryshimet e përgjithshme në ambientin që nga koha kur kjo kornizë është miratuar- reflektohet në ekonominë e Kosovës.

Edhe sot kur kanë kaluar më shumë se gjashtë muaj nga përgatitja e buxhetit fillestar, analizat tona të brendshme tregojnë se të hyrat e rregullta buxhetore do të jenë ashtu siç i kemi planifikuar në fillim të buxhetit rreth 956 milionë e 500 mijë euro. Dhe, konsideroj se kriza ekonomike, pa marrë parasysh një frike psikike që ka ndodhur në Kosovë, fatmirësisht në të hyrat tona të përgjithshme nuk ka filluar të ndikojë dhe planifikimet tona kanë qenë të sakta deri më tani.

Kjo tregon për punën kualitative në vijueshmëri të institucioneve tona të mbledhjes së taksave, por mbase edhe të ngritjes së vetëdijes së qytetarëve.

Duke u mbështetur në politikat e Qeverisë së Republikës së Kosovës për përfshirjen e sektorit privat në disa nga ndërmarrjet publike, ne me rishikim kemi inkorporuar deklarin e dividendit nga Postë-Telekomunikacioni i Kosovës në shumë prej 200 milionë eurosh. Duke e ditur se Qeveria ka synim të vetin involvimin e sektorit privat në ndërmarrjet publike është e natyrshme që mjetet likuide që posedojnë këto ndërmarrje, përkatësisht Postë- Telekomunikacioni i Kosovës, pronari, pra Qeveria e Republikës së Kosovës mund t'i shpallë në formë evidente, sepse nuk do të ishte e rrugës që paratë kesh eventualisht të përfshihen në asetet e sektorit publik për t'u transferuar në sektorin privat.

Është me rëndësi këtu të thuhet se pavarësisht deklaramit të kësaj dividende shuma e mjeteve prej 200 milionë euro që aktualisht është e depozituar në sistemin bankar të Kosovës do të vazhdojë të mbetet në këtë sistem. Pra, përmes kësaj politike ne sigurojmë qëndrueshmërinë dhe funksionalitetin e sistemit bankar që është motori i lëvizjes ekonomike në Kosovë. Në këtë kontest i vetmi ndryshim është se pronari i këtyre, pra Qeveria e Republikës së Kosovës këto mjete do t'i ndërrojë në aspektin kontabël dhe do t'i deklarojë si pronë të vetes dhe jo si pronë të ndërmarrjes publike.

Siç jemi pajtuar edhe ju, me institucionet ndërkombëtare, përfshirë Fondin Monetar Ndërkombëtar edhe me këtë rishikim ne do vazhdojmë të mbajmë rezervën stabilizuese prej 200 milionë euro, të cilat mjete do të përdoren në rast të ndonjë të papriture.

Më lejoni tani që në pika të shkurta t'i jap disa nga financimet shtesë.

Për Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale janë ndarë shtesë 4.41 milionë euro.  
Për Ministrinë e Bujqësisë - 2.100.000 euro,  
Për Ministrinë e Punëve të Brendshme – 4.360.000 euro,  
Për Ministrinë e Shëndetësisë – 5. 555.000 euro,  
Për Ministrinë e Financave dhe të Ekonomisë, përkatësisht për ndërmarrjet publike. KEK-un dhe ndërmarrjet tjera publike, siç është KLMC-ja dhe të tjera, janë ndarë 30.6 milionë euro.  
Për Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor – 3.22 milionë euro.  
Për Ministrinë e Arsimit, të Shkencës dhe të Teknologjisë - 8,1 milionë euro.  
Për Ministrinë e Drejtësisë - 2,1 milionë euro, dhe  
Për Ministrinë e Postë-Telekomunikacionit -37 milionë euro si dhe për komunat, siç e thashë edhe më herët, rreth 5 milionë euro. Nuk shkova në shifrat më të ulëta, sepse të gjithat i keni të detajizuara, por shuma totale shtesë e financimeve kryesisht...

KRYETARI: Regjia, t'i vazhdohet koha e diskutimit.

MINISTRI AHMET SHALA: Pra, shuma shtesë totale është 108.888.000 euro, prej të cilave siç e theksova, mbi gjysma është për investime kapitale të cilat shkojnë në projektet sipas prioritetit të Qeverisë së Republikës së Kosovës, të miratuara edhe në programin e saj.

Me kaq po e përfundoj. Jam i sigurt që ka sugjerime nga ana juaj dhe kërkoj që ta mbështetni këtë projekt e ta votojmë sot, në parim. Pra, besoj që komisionet për hir të kohës do të punojmë intenzivisht për të përmbyllur rishikimin sa më herët, sepse kjo do të ndihmojë që projektet shtesë prej 108 milionë euro, të kenë mundësi të ekzekutohen deri në fund të vitit. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Fjala është e kryetarit të Komisionit për Buxhet dhe Financa, deputetit Gani Koci. Kisha kërkuar nga deputeti Koci që të na tregojë, mendoj që edhe juve ju intereson se kur mund të bëj raportin me rekomandime për të mbajtur leximin e dytë të projektligjit.

GANI KOCI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Komisioni për Buxhet dhe Financa ka shqyrtuar propozimin e rishikimit të buxhetit për vitin 2009, dhe në parim e ka mbështetur këtë propozim dhe ka sugjeruar që Kuvendi ta miratojë në parim. Për dallim nga herët tjera që kemi pasur një vërshim të kërkesave të organizatave buxhetore gjatë procesit të rishikimit të buxhetit, kësaj radhe nuk kemi asnjë kërkesë nga organizatat buxhetore që të bëhen plotësime eventuale në buxhetet e tyre dhe me që ne nuk kemi kërkesa të tilla as nga organizatat buxhetore të Qeverisë të nivelit qendror dhe as nga ato lokale që kishim herëve të kaluara dhe, duke pasur parasysh që kërkesat që gjatë procesit të rishikimit që kanë qenë shumë serioze në kuptimin e asaj në plotësimin e buxhetit në rishikim janë të përfshira, Komisioni për Buxhet dhe Financa është i gatshëm që në afat shumë të shkurtër, eventualisht të bëjë amendamentimin, sidomos në pjesën normative ta quaj që duhet disa ndryshime më tepër teknike se sa substanciale. Pra, në këtë drejtim ne jemi të gatshëm që të punojmë dhe natyrisht në momentin kur Kuvendi kërkon, t'ia paraqesim ndryshimet eventuale ose amendamentet eventuale. Po them amendamentet eventuale, sepse nuk kemi asnjë kërkesë që të ndryshohen linjat e propozuara këtu në Kuvend.

Mendoj që duke pasur parasysh edhe ato që i tha Kryeministri edhe ministri në shpërndarjen e kësaj shtese, ta quaj buxhetore, në këtë drejtim po them kanë përfituar të gjitha nivelet dhe të gjitha agjencionet buxhetore, dhe shtim të buxhetit kanë edhe komunat, siç i shihni në tabelat e tyre. Pra, nga kjo përfitojmë të gjithë dhe sa më shpejtë që të jetë e mundur ne jemi të gatshëm që të procedojmë me ato ndryshime eventuale.

KRYETARI: Sa më shpejt, është nesër. Faleminderit!

Radha është e shefave të grupeve parlamentare ose e deputetëve që janë këtu. Fillojmë me Partinë Demokratike. Fjalën e ka deputetja Safete Hadergjonaj.

SAFETE HADERGJONAJ: Faleminderit, zoti Kryetar!

Përsëndetje për Kryeministrin, zotin Hashim Thaçi,

Për zëvendëskryeministrin,

Për Kabinetin qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Është hera e dytë që Qeveria i paraqet Kuvendit rishikimin e buxhetit në mesin e vitit. Nëse shikojmë me kujdes këtë material, vërejmë se Qeveria ka ndërhyrë për të bërë përmirësime me qëllim të rritjes së kapaciteteve të përdorimit të fondeve publike dhe për t'i shpejtuar programet e saj të reformave për arritjen e objektivave që ia ka parashtruar vetes.

U tha këtu edhe nga ministri i Ekonomisë dhe Financave se si rezultat i rishikimit të kredisë së KEK-ut prej programimit të borxhit të jashtëm si dhe rritjes së të hyrave vetjake të komunave, Qeveria ka arritur t'i sigurojë 108.9 milionë euro dhe të parashikojë në mënyrë të arsyeshme se kush do të përfitojë më shumë në gjysmë vjetorin e dytë të vitit 2009.

Kryesisht fondet janë kanalizuar në zhvillimin e sektorëve socio-ekonomik duke u orientuar mjetet në investimet kapitale si në: infrastrukturë, në arsim, në shëndetësi, në bujqësi, për nevojat e invalidëve të luftës, në reformën e pushtetit lokal si dhe në ndërtimin e diplomacisë shtetërore, e po ashtu edhe në shpenzime publike që janë në interes të qytetarëve, prioritetet këto të cilat Qeveria shumë mirë i ka paraparë në kornizën afatmesme të shpenzimeve.

Qeveria ka mbështetur me këtë rishikim të buxhetit rritjen e shpenzimeve për investime në krahasim me ato operative. Kjo përbën edhe një nga qëllimet dhe objektivat të cilat Qeveria ia ka parashtruar vetes.

Më rishikim Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale ka përfituar fonde shtesë prej 3 milionë e 370 mijë euro, kur janë rritur transferet sociale për pensione bazë si dhe pensionet e invalidëve të luftës.

Shtimi i mjeteve kapitale për 8 milionë e 311 mijë euro për Ministrinë e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, që do të përdoren për investime në ndërtim, në rehabilitimin e shkollave, pajisjen e ambienteve shkollore si dhe sigurimin e librave për nxënësit deri në klasën e nëntë, është dëshmia më e mirë se për Qeverinë arsimi është një nga prioritetet kryesore, e bindur se investimi në kapitalin njerëzor është dhe parakusht për zhvillimin ekonomik të Kosovës.

Ministria e Shëndetësisë ka përfituar nga ky rishikim i buxhetit për vitin 2009 shumë prej 7 milionë e 716 mijë euro, që kryesisht janë të destinuar për blerjen e

medikamenteve dhe nëse shikojmë këtë material që na është ofruar, janë shtuar edhe për mjete të cilat sigurojnë shërim jashtë vendit.

Ministria e Transportit dhe Postë- Telekomunikacionit, po ashtu ka përfituar nga ky rishikim i buxhetit, ku nga 115 milionë e 897 mijë sa kanë qenë të planifikuara tani janë shtuar fondet në 160 milionë e 980 mijë euro, rritje kjo që ka destinimin në ndërtimin e rrugës Merdare – Morinë dhe projekteve të reja të rëndësishme që japin efekte në zhvillimin ekonomik.

Është bërë rritja e fondit për subvencionim në bujqësi, nga 1 milion e 168 mijë në 4 milionë e 768 mijë euro, që do të jetë një mbështetje e fuqishme për bujqit, sidomos tani në sezonin e mbjelljeve vjeshtore.

Ndërsa Ministria e Punëve të Brendshme po ashtu ka përfituar nga rishikimi i buxhetit, ku nga 67 milionë e 698 mijë sa kanë qenë, ka pasur rritje në 76 milionë e 80 mijë euro, të cilat kryesisht nëse shikojmë me kujdes këtë material shohim se mjetet kanë shkuar në ndërtimin dhe rikonstruktimin e objekteve, pajisjeve, mjeteve të transportit si dhe për përkujdesje të personelit të Shërbimit Policor.

Ministrisë së Drejtësisë po ashtu i janë shtuar mjete për 2 milionë e 534 mijë euro për ndërtimin dhe konstruimin e objekteve dhe për rritjen e pagave të Shërbimit Korrektues.

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve me rishikim të buxhetit në gjashtëmuorin e dytë të këtij viti do të përfitojë afër një milion euro, mjete këto të mbështetura, që i mbështesin projektet e ndryshme kulturore si dhe investimet kapitale në infrastrukturën sportive në Kosovë.

Është rritur dukshëm edhe buxheti i komunave ku janë shtuar mjete për 10 milionë e 467 mijë euro.

Qeveria është treguar e gatshme për të investuar në projekte të konsoliduar për zhvillimin e komunave, pra është angazhuar që të ketë investime aty ku përfitojnë më së shumti taksapaguesit e Kosovës.

Nëse analizojmë me kujdes këtë material që na është ofruar për shqyrtim, vërejmë se rivlerësimi i buxhetit është dëshmi e rezultateve të qarta të suksesit të reformave të ndërmarra në këtë periudhë të qeverisjes nga koalicionin qeverisës i drejtuar nga Kryeministri Hashim Thaçi, si rezultat i hapave të guximshëm që ka bërë në luftë kundër aferave korruptive, kontrabandës, evazionit dhe informalitetit.

Mes destinimi kryesor i mjeteve në këtë rishikim është në investime kapitale. Është më se e domosdoshme që të gjithë faktorët vendimmarrës në nivelet e qeverisjes qendrore dhe lokale të ndjenë përgjegjësinë e realizimit të projekteve dhe detyrimeve financiare ligjore, të ndjejnë përgjegjësinë e shfrytëzimit me efikasitet të këtyre mjeteve, sepse çdo mos përgjegjësi ka efektet negative në sektorin financiar brenda vitit.

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e përkrah Projektin për rivlerësim të buxhetit. Jam e bindur se do të ndikojë në përmirësimin e jetës së qytetarëve. Faleminderit!

Drejtimin e seancës e merr zoti Ibrahim Gashi, anëtar i Kryesisë

KRYESUESI IBRAHIM GASHI: Faleminderit, e nderuara deputete!

Në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, fjalën e ka kërkuar deputeti dhe kryetari i Grupit Parlamentar, zoti Lutfi Haziri.

LUTFI HAZIRI: Faleminderit, zoti kryesues!

Zoti Kryeministër,

Zëvendëskryeministër,

Ministra të Kabinetit qeveritar,

Grupi Parlamentar i LDK-së, natyrisht që ka punuar sa i përket rishikimit buxhetor, sepse është një nga agjendat tona politike shumë të rëndësishme për mbarrëvajtjen e procesit të stabilitetit, buxhetit dhe shpenzimeve të planifikuara. Me vetë faktin që ne kemi votuar dhe e kemi mbështetur buxhetin e vitit 2009, natyrisht që në parim e mbështesim edhe rishikimin buxhetor, por paraqes shqetësimet e Grupit Parlamentar që do të reflektohen sot nëpërmjet deputetëve që në grupet e ndryshme sektoriale i kanë bërë analizat, krahasimet dhe këto ne do t'i paraqesim në mënyrë që anëtarët tanë në Komisionin e Buxhetit të vazhdojnë të jenë konstruktiv, të jenë pozitiv në përmbylljen e këtij procesi shumë të rëndësishëm.

Zoti Kryeministër,

Deklarata përmbyllëse e misionit të stafit të FMN-së e 24 qershorit ka adresuar shqetësimet e veta në Qeveri dhe unë besoj shumë që ministri apo ministrat e autorizuar nga ju kanë arritur që disa nga kriteret e kësaj deklarate t'i përfshijnë për shkak të garantimit të stabilitetit buxhetor në Kosovë, stabilitetit fiskal që është i domosdoshëm, nën një.

Nën dy, prioritetet apo shtrirja e investimeve sipas prioritetëve në terren në pozita të ndryshme në Kosovë duhet të shikohen me kujdes për t'i kënaqur interesat e qytetarëve të sektorëve të ndryshëm që mbulon Qeveria me investime, bashkëfinancime, me autoritetet komunale dhe gjithçka që është paraparë në kuadër të këtyre angazhimeve buxhetore. Është moment i mirë që mund t'i përmirësojmë lëshimet që i kemi bërë në votimin e buxhetit të vitit 2009, që disa nga projektet të rishikohen me kujdes dhe të kënaqen interesat e komuniteteve dhe qytetarëve në gjithë Kosovën. Është momenti i mirë që t'i balancojnë këto prioritetë në gjithë Kosovën e jo t'i koncentrojmë gjeografikisht në Kosovë. Mendoj se ndoshta nëse shihet me kujdes mund të vërehen këto.

Unë besoj shumë që me angazhim pozitiv do t'i përballojmë deri në leximin e dytë të gjitha këto shqetësime tona, në mënyrë që vota jonë edhe në leximin e dytë të jetë, natyrisht, për miratimin e rishikimit buxhetor. Faleminderit, shumë!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet!

Në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, fjalën e ka kërkuar deputeti Haki Shatri.

HAKI SHATRI: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar deputetë,

Kryeministër, ministra të pranishëm,

Projektligji që sot po e shqyrtojmë, sipas vlerësimeve të Grupit Parlamentar të AAK-së, është dokumenti me më shumë mangësi që deri sot Qeveria e Kosovës ka sjell në Kuvend për shqyrtim dhe miratim.

Ky dokument ka aq shumë lëshime teknike dhe përmbajtjesore sa që edhe në Komisionin për Buxhet kemi qenë të dezorientuar dhe s'kemi pasur mundësi të diskutojmë fare përveç disa informatave që i kemi marrë nga përfaqësuesi i Ministrisë, disa sqarimeve që i kemi kërkuar, përndryshe as teknikisht s'ka qenë e mundur ta diskutojmë dokumentin, prandaj nuk ka as rekomandim prej Komisionit për Buxhet për seancën për miratim në parim.

Nuk është përkrahur pra nga Komisioni, por vetëm kemi rekomanduar si zgjidhje oportune që të diskutohet në seancë ky dokument.

Dobësitë teknike sot nuk kemi kohë as nuk janë në rend të dite t'i diskutojmë, sepse dobësitë përmbajtjesore janë shumë më të rënda dhe ato janë pengesë për ta përkrahur këtë dokument në parim.

Ky dokument si i tillë që është ofruar paraqet shkelje të rëndë në radhë të parë të Ligjit për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, pra paraqet shkelje të rëndë të principeve themelore, të menaxhimit të parasë publike, degradim dramatik të sistemit fiskal buxhetor të Kosovës të ndërtuar me jo pakë sakrifica. Pse? Projektligji nuk është i harmonizuar, po e citoj dhe po e theksoj, me kornizën afatmesme shpenzimeve që është miratuar në këtë Kuvend, para pak muajsh.

Projektligji nuk i plotëson as kriteret, dispozitat elementare të Ligjit për menaxhimin e financave publike. Më vonë do t'i përmend vetëm 2 – 3 shembuj për të treguar se ku janë shkeljet.

Projektligji është në kundërshtim me parimet elementare të qeverisjes së mirë në segmentet e menaxhimit të parasë publike dhe si i tillë bie ndesh me rregullat në këtë fushë që përcaktojnë edhe institucionet financiare ndërkombëtare. U përmend këtu qëndrimi i fondit Monetar Ndërkombëtar që është i publikuar në ueb faqen e MEF-it para dy javësh.

Unë frikohem që marrëveshja që e ratifikuam me shumë kënaqësi në pikën paraprake të rendit të ditës deri në fund të vitit do të vijë në pikëpyetje pikërisht për shkak të një sjellje të tillë me paranë publike nga ana e Qeverisë.

Prandaj, duke i pasur parasysh të gjitha efektet negative që derivohen nga miratimi eventual i këtij dokumenti me këtë përmbajtje dhe strukturë shpreh brengën e Grupit Parlamentar për pasojat në sistemin buxhetor në rrjedhat e shpenzimeve publike, me efektet në ekonomi te donatorët, te investitorët e jashtëm dhe deri te mundësia e falimentimit të sistemit fiskal. Prandaj, propozojmë që dokumenti t'i kthehet hartuesit për përgatitje më të mirë dhe jemi të vetëdijshëm që kthimi, prolongimi për një kohë të nevojshme për përmirësim nuk e cenon funksionimin normal të institucioneve, të asnjë institucioni shtetëror të Kosovës.

Cilat janë arsyet e këtij propozimi? Me këtë dokument është ndryshuar mbi 30% materia e ligjit bazë. Pra, nuk është bërë rregullimi i brendshëm siç u prezantua nga ministri i Ekonomisë dhe Financave, nuk ka praktikisht asnjë rregullim, ka ndryshim deri në 30% edhe të hyrave edhe të destinimit të shpenzimeve. Llogaritni shumat, do t'i shihni.

Pra, është ndryshuar ligji bazik mbi 30%. Të hyrat tatimore, pjesa e të hyrave në kufi është zvogëluar për 20 milionë, shumë e cila është plotësuar me disa projekte te të

hyrat vetjake te organizatat qendrore dhe te komunitat. Pa asnjë sqarim, pa asnjë argument ashtu siç është miratuar është hequr, është anuluar huadhënien, por unë do t'ju them këtu që heqja e huadhënies nuk është kursim. Ju lutem, në pozicionet e buxhetit e keni edhe si dalje në vitin 2009 të projektuar edhe si hyrje. Ka qenë një fizkulturë e mirë, por tash hiqen 50 milionë si shpenzim, kurse si hyrje hiqet në tërësi, pra si burim i të hyrave për vitin 2009 është hequr në tërësi, këtë duhet ta themi dhe ta kemi të qartë. Në vend të tyre janë propozuar që të merren disidencat e PTK-së. E di se Qeveria ka të drejtë të disponojë, të menaxhojë me paranë- kursimet e ndërmarrjeve publike, por, ka dy probleme esenciale. Në qoftë se këta dividendë tërhiqen me vendim që është ligj pas miratimit në Kuvend, këto 200 milionë do të tërhiqen nga depozitat e bankave vendore që depozitat e PTK-së në bankat vendore përbëjnë 17% të depozitave të gjithëmbarshme. Tërheqja e tyre siç obligon Ligji për menaxhimin e financave do t'i bjerë në buzë të falimentimit disa nga bankat vendore afariste.

Dhe, çështja e dytë, këta dividendë që tërhiqen, ne jemi që të tërhiqen dhe në kohë të përshtatshme të destinohen për shpenzim, jo për shpenzime, por për investime kapitale, për investime të cilat do të jenë bazë për zhvillimin ekonomik të Kosovës. Dhe, ne po shohim që propozimi për shpenzime këtu pjesa më e madhe ka shkuar te shpenzimet, rritja e kufijve, ndryshimi ka shkuar te shpenzimet, jo te investimet kapitale.

Përkundër përcaktimit që Kosova, domethënë, ka marrë para të donatorëve, janë shkelur edhe kriteret më esenciale që janë në harmoni me Komisionin Evropian edhe Fondin Monetar. 18 milionë është shtuar kategoria e mallrave dhe shërbimeve, domethënë nga dividendi tash po shkojnë paratë në mallra dhe shërbime.

Kemi pastaj 38 milionë në subvencione dhe transfere, që është prapë në kundërshtim me marrëveshjen me donatorë. 38 milionë subvencione nga të cilat 25 milionë shtohen në importimin e energjisë, që do të thotë këtë vit Kosova jep mbi 70 milionë euro për importimin e energjisë elektrike edhe në anën tjetër nuk kemi asnjë veprim i cili e përmirëson performancën e KEK-ut në veçanti inkasimin e faturave të KEK-ut.

Edhe pse janë ndarë rreth 58 milionë për investime kapitale dua të them se në këtë termin hyjnë edhe shpenzimet të cilat s'mund të konsiderohen fare investime kapitale. Unë kam llogaritur vetëm te organizatat qendrore i kemi rreth 12 milionë euro të pastra për blerje të veturave. Ju lutem e kam edhe regjistrin 12 milionë euro për blerje të veturave janë në kategorinë e investimeve kapitale, që do të thotë kjo kategori nuk është vërtet kategori e investime kapitale, dhe brenda investimeve kapitale struktura e tyre ka devaluuar në atë masë sa nuk konsiderohen bazë e zhvillimit, por vetëm si shpenzime të parasë publike.

Prandaj, duke pasur parasysh këto dhe defektet të tjera të shumta të cilat nuk ka mundësi brenda 10 minutash të përmenden, konsideroj që është e dobishme edhe për Qeverinë, edhe për popullin e Kosovës që ky dokument të tërhiqet, të ripunohet. Jemi të gatshëm t'ju ndihmojmë, t'i evitojmë lëshimet dhe kundërshtimet me ligjin dhe në shtator të miratohet, sepse nuk paraqet asnjë lloj pengese për funksionim të institucioneve. Faleminderit, shumë!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet!

Në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, fjalën e ka kërkuar kryetari i Grupit, Ibrahim Makolli, edhe pse më herët i kishim do letra të tjera.

IBRAHIM MAKOLLI: Faleminderit, zoti kryesues!

Letrat janë për pika të tjera të rendit të ditës.

Faleminderit, zoti kryesues!

I nderuar Kryeministër,

Më lejoni që në emër të Grupit parlamentar ta paraqes qëndrimin tonë, i cili që në fillim është negativ sa i përket këtij projektligji. Kur është miratuar në fillim projektligji, me të gjitha vërejtjet që i kemi pasur, po e them pa hezitim tash se ka qenë shumë më i mirë se ky që na është ofruar sot.

Një vërejtje, ministër, ky material është gati i palexueshëm, nuk po besoj që është strategji juaja e Ministrisë, por seriozisht na keni bërë të pamundur që të shqyrtojmë me saktësi të plotë, sepse shkronjat janë aq të ima, ndërkaq shpenzimet për letër dhe ngjyrë janë aq të mëdha sa që nuk janë kurrkund në pajtueshmëri me njëra tjetrën.

Sikur e thashë, Grupi Parlamentar i AKR-së nuk do ta përkrah këtë projektligj. Kolegët e mi do t'i paraqesin detajisht vërejtjet, por më lejoni që unë t'i them vetëm disa prej çështjeve të cilat konsideroj se janë me interes.

Nuk di sa keni paraparë, zoti ministër, që të hyrat e tashme janë të rrezikuara dhe unë besoj që jeni të vetëdijshëm dhe keni statistika se sa janë përmbushur parashikimet gjatë këtyre 6 muajve të hyrave në dogana dhe ju e dini shumë mirë që në dogana janë detyruar që të ketë disa lëvizje në mënyrë që të realizojnë ato pritje që janë bërë.

Vetëm po i shtroj disa pyetje, sepse seriozisht është e vështirë që të kuptohen, unë besoj që e keni vështirë edhe ju.

E shohim, këtu po na dalin që disa rrugë po shtrohen, pra të njëjtat rrugë nga dy herë edhe tash më është e paqartë se kush shtron rrugë në këtë vend, kush merret me ndërtim të rrugëve, cilat ministri, sepse po na dalin disa ministri që po ndërtojnë rrugë. Merrni me mend, po përmendi vetëm një rast, në Gjilan brenda Qendrës Spitalore një rrugë, që nuk i besoj që i ka një 500-600 metra po kushtuaka 100 mijë euro. Nuk di çfarë kategorie atë rrugë doni ta ndërtoni, se nuk ka vend për autostradë brenda asaj.

Është paraparë një numër mjaft i madh i renovimit të kulmeve të shkollave dhe të ambulancave. Zoti ministër, këto po na ndodhin çdo dy vjet, sepse mbas katër muajve që po rinovohen, këto kulme po shemben. Dhe, unë besoj që keni shembuj të freskët dhe të mjaftueshëm për kualitetin dhe shembjen e këtyre.

Po ashtu, një gjë që bie në sy edhe në praktikë, por edhe në letra. Qysh po ka mundësi që shkollat e njëjta të madhësisë së njëjtë të kushtojnë disa 100 mijë euro e tjetra 400 mijë euro ose 500 mijë euro? E njëjta, mund të ketë një dallim, por nuk mund të ketë dallim të trefishtë. Këtë edhe në praktikë mund ta dëshmojmë, mund të shkojmë e t'i shohim shkollat e njëjta të cilat kanë diferencë aq të madhe të çmimit, ose ndërtohen në fshatra ku janë gjithsej 30 nxënës, ndërtohet një shkollë me kapacitet për 700 – 800 nxënës, si duket vetëm sa për ta shpenzuar buxhetin.

E përmendi edhe kolegu të veturat, seriozisht po dua t'ju pyes diçka? Ku po gjeni këto vetura kaq të shtrenjta në kohën kur çmimi i tyre ka rënë në tregun botëror për shkak të krizës financiare? Unë besoj që edhe tjerët do t'ua kishin lakmi edhe jashtë që t'i gjejnë këto çmime të veturave të cilat i keni gjetur ju.

Mungesa e investimeve, këtu shihet që ka mungesë të investimeve që garantojnë zhvillim ekonomik të vendit. Dhe, ajo çka bie në sy drejtpërdrejt tash se investimet janë koncentruar në rajone të veçanta. Diku rreth 60% të investimeve janë koncentruar në një rreth shumë të ngushtë të rajoneve që gjithsesi nuk është në pajtim me shpërndarjen se si do të duhej të jetë ky debat.

Edhe njëherë po theksoj ky projektligj nuk do ta ketë përkrahjen e Grupit Parlamentar të AKR-së. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet!

Në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Dardanisë, fjalën e ka kërkuar deputetja Besa Gaxherri.

BESA GAXHERRI: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Qëndrimi i Lidhjes Demokratike të Dardanisë është kundër këtij dokumenti dhe, natyrisht, do të mundohemi t'i japim arsyet e këtij projektligji për plotësimin dhe ndryshimin për buxhetin e vitit 2009, nga Qeveria. Ky projektligj është miratuar më 14 korrik, ndërsa në sefat e deputetëve është shpërndarë diku më datën 16 – 17 korrik dhe po shqyrtohet sot.

A është kjo kohë e mjaftueshme që të përgatitet një draft kaq i rëndësishëm për popullin e këtij vendi? Pse kjo urgjencë? Materiali teknikisht, të nderuar kolegë deputetë, është i papranueshëm, sidomos për opozitën që nuk ka mundësi të ketë material tjetër, përveç këtij që e kemi marrë nëpër sefat tonë. Ju kisha lutur të jeni korrekt që të gjithë deputetët dhe ta konfirmojmë sepse ky dokument është i palexueshëm, aq më shumë fotokopjohet dhe pastaj s'mund të nxirret asgjë nga ky material. Vetëm për këto arsye, pra teknike, ky draft është dashur të kthehet pa hyrë në përmbajtjen e tij, pa hyrë në procesin e rishqyrtimit.

I nderuar kryesues,

Ky rishqyrtim është në s'përputhje të plotë me kornizën afatmesme të shpenzimeve. Unë do të ndalem në vija të trasha, dua të filloj nga të hyrat. Totali i të hyrave pa dividendin e PTK-së është 956.5 milionë euro, totali i shpenzimeve llogaritet një miliard 203.3 milionë euro. Qeveria kërkon që me ligj t'i futë këto para, pra dividendin e PTK-së në buxhet, ndërsa thotë vjen nga drejtori i buxhetit që theksoi në Komisionin e Buxhetit se nuk do të shpenzohen në vitin 2009 këto para, pra dividendi i PTK-së. Atëherë pse po ndodh kjo, pse po kërkon t' i fusni në buxhetin e vitit 2009, kur e dimë se natyrisht bankat vendore 17% e depozitave bankare janë pra nga dividendi i Postës? Pse kjo Qeveri nuk themelon Post-bankën që të trumbeton çdo ditë e thotë që po, po e përkrahim themelimin e Post-bankës, ndërsa dividendin e kësaj kompanie pretendon ta futë në buxhetin e vitit 2009? Pikërisht dje guvernatori i Bankës e pohoi se askush ende s'ka bërë asnjë lloj kërkesë për licencim pra për Post-bankë, pra çka, po ndodh? Domethënë kjo Qeveri çfarë do të bëjë me këtë buxhet, do t'i futë në buxhetin e vitit 2009, do të krijoj Postë-bankën, s'do t'i shfrytëzojë këto para fare në vitin 2009, d.m.th. kjo është një s'përputhje apo një lajthitje shumë e papranueshme për qytetarët e Kosovës dhe natyrisht për deputetët e Kuvendit. Aq më pak për të marrë këtë shumë e nderuara Qeveri, ishte dashur të ketë projekte konkrete, janë në pyetje 200 milionë euro dhe asnjë projekt konkret kapital, sidomos nuk paraqitet për këtë shumë të parashikuar që pretendoni me ligj ta keni në vitin 2009.

Ndryshimi i buxhetit të rishikuar në total është 108.877 milionë euro dhe në mallra dhe shërbime shtesë 10 milionë, ta potencojmë, sepse ju po pretendoni që keni bërë kursime, ndërsa me rishikim në mallra dhe shërbime shtesë i keni 10 milionë 779 euro. Shpenzime komunale mbi 300 mijë euro, subvencione dhe transfere 43.594 milionë euro, shpenzime kapitale 60 milionë euro, rezerva është zvogëluar për 5 milionë e 280 mijë euro. Nga kjo analizë shohim qartë se vërtet ky buxhet është buxhet shpenzues e kurrsesi buxhet zhvillimor. Marrim shembull Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave- me mallra dhe shërbime nga 9 milionë e 500 mijë euro në rishikim është 14 milionë e 800 mijë euro. Në subvencione dhe transfere nga 50.993 milionë në 77.038 milionë, domethënë në kuadër të kësaj parashikohen plus 25 milionë për import të energjisë elektrike të Kosovës. Në total nga 176 milionë euro pra në 186.193 milionë euro vetëm në këtë organizatë buxhetore.

Të gjithë po shohim se çfarë investimesh kapitale po bëhen pra në kuadër të këtyre investimeve kapitale po e përsëris edhe unë parashikohet edhe blerja e veturave deri 12 milionë euro. Dhe, përveç se nuk ka ndonjë projekt që vërtet kapital zhvillimor në këtë dokument shohim rrugë të cilat kanë përfunduar ndërtimi i tyre në vitin 2008 dhe që kanë kushtuar me miliona euro, ndërsa në këtë dokument parashikoni prapë me miliona euro për të njëjtat rrugë, sepse natyrisht ato janë shkatërruar. Por, të nderuar qeveritarë, ato rrugë së paku me kontrata duhet ta kenë bile 3 vjet mirëmbajtjen e jo të ndani buxhet prapë nga buxheti i Kosovës për të njëjtat rrugë që janë ndërtuar dhe janë paguar obligimet.

Keni parashikuar në kuadër të ndërtimit të rrugëve autostradën që keni theksua që do të fillojë ndërtimi në nëntor, të nderuar kolegë. Në nëntor e dimë çfarë mund të ndërtohet dhe çka mund të bëhet në Kosovë, por në nëntor është fushata e zgjedhjeve lokale në Kosovë dhe kjo është e papranueshme që të thuhet ndahen 20 milionë kur e dimë sa do të kushtojë ajo autostradë dhe të fillojë në nëntor. Kjo është vërtetë sa për t'u hedhur hi syve qytetarëve të Kosovës dhe për të mos bërë asgjë si zakonisht deri më sot.

Dhe, çka është edhe e papranueshme tërësisht kur shohim buxhetin e KQZ-së. Është zbritur për afër 80 mijë euro, por ka ngritje në paga dhe mëditje për KQZ- në.

Të nderuar qeveritarë, që po munguaka Kryeministri sot këtu, edhe Presidenti ndoshta na dëgjon. Lidhja Demokratike e Dardanisë shfrytëzon rastin edhe një herë këtu të kërkojë që zgjedhjet duhet të monitorohen me kamera, dhe ky projekt kushton jo shumë, po në rishqyrtimin e këtij buxheti duhet t'i parashikoni mjetet për vëzhgimin e zgjedhjeve që këto zgjedhje të jenë demokratike, jo si zgjedhjet e kaluara që vërtet vota është vjedhur. Dhe, nuk është mundësia që të vëzhgohet në mënyrën e mirë demokratike në qoftë se nuk na realizoni këtë mundësi që është krejtësisht demokratike dhe e drejtë dhe krejtësisht e mundshme, e qartë kur shohim ndarje të mjeteve në organizata buxhetore krejtësisht të paarsyeshme dhe nuk keni menduar t'i ndani në këtë vij buxhetore.

Natyrisht edhe një herë për fund, Lidhja Demokratike e Dardanisë nuk e përkrah këtë dokument dhe realisht kërkon që të rikthehet ky dokument, të plotësohet dhe natyrisht që të respektohet procedura e rregullt ligjore edhe e Rregullores së Kuvendit për miratimin në leximit të dytë të këtij ligji. Nuk kemi nevojë të ngutemi dhe ta kryejmë ligjin për 2 – 3 ditë, aq më shumë kur bëhet fjalë për jetën e qytetarëve të Kosovës për një vit. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zonja deputete.

Në emër të Grupit Parlamentar “7+” është paraqitur Myfera Shinik.

MÜFERA ŞİNİK: Sayın Başkan yardımcısı, Sayın Bakanlar, Değerli Milletvekilleri

Bu gün burada Kosova Cumhuriyetinin 2009 yılına ait Bütçe Tasarısının değişiklikleri ve eklemelerinin birinci görüşülmesi yapılmaktadır.

Yıl içerisinde en önemli Yasa Tasarılarından biri olarak bu Yasa Tasarısı hakkında konuşulacaklar vardır. Ancak Kosova genelinde bütçenin görüşülmesi yapıldığı için Kosova geneline bakılması gerekmektedir.

2009 yılına ait bütçenin ayrıldığına yani dağılımına baktığımızda, çoğunlukta olmayan toplulukların memnun olmadığı görülmektedir.

2009 yılına ait bütçe planlaması yapıldığında, çoğunlukta olmayan toplulukların da ihtiyaçları belirtilmiştir. Çünkü Kosova multi etnik bir ülkedir. Kosovanın multi etnik olması dünyaya bir örnektir. Kosovada Arnavutlar dışında Türkler, Boşnaklar, Sırlar, Goralılar, Romlar ve diğer topluluklar yaşamaktadır. Bu toplulukların hakları Kosova Cumhuriyetinin Anayasası ve yasalarıyla garanti altına alınmıştır. Buna göre çoğunlukta olmayan toplulukların hakettikleri şekilde yaşamaları için maddi olarak ta desteklenmesi gerekmektedir.

Kosova Cumhuriyeti Hükümetinin kısmen desteklenmesi yeterli değil. Çünkü birçok bakanlıklarda, niceki Yerel Yönetim Bakanlığı, Çalışma ve Sosyal Hizmetler Bakanlığı, Çevre ve Alan Planlama Bakanlığı gibi Bakanlıklarda çoğunluk olmayan topluluklara ait projeler yer almamaktadır.

Bunun dışında KEBTB’nda Prizren’deki “Motrat Qiriazı” Okulu’na 2009 yılı bütçe planlamasında 200.000 E istenen ek bina yapma masrafları 100.000 E olarak amandman verilmiştir. Bu 100.000 Euroluk amandman Kosova Cumhuriyetinin n büyük organı olan Mecliste onaylanmıştır.

Bu gün 2009 yılına ait bütçenin yeniden görüşülmesinde ayrılan bu 100.000 E yerine (0) sıfır görülmektedir.

“Motrat Qiriazı” Okulu’na bu gün ek bir bina yapılmaktadır. Ancak eskiden sunulan ve USAİD-in bir projesi olarak gerçekleşmektedir.

Kosova Cumhuriyeti Meclisinin onayladığı 100.000 Euronun “Motrat Qiriazı” Okulu’na neden verilmediğini, ne zaman verileceğini ya da hiç verilmeyecekse, bu meblağın nereye gideceğini bilmek istiyoruz.

Bu güne kadar varolan eksiklerin düzeleceğine inandığımızı vurgulamak istiyorum. Çünkü çoğunlukta olmayan toplulukların kazancı, çoğunlukta olan topluluğun kazancıdır.

Bütün bunları gözönünde bulundurarak, 7+ Parlamento Gurubu olarak bu Yasa Tasarısının birinci okunuşunu kabul ediyoruz, öneri ve uyarılarımızı Fonksiyonel Komisyona sunmuş olacağız.

Teşekkür ederim.

KRYESUESI: Faleminderit, zonja deputete!

Në emër të Grupit Parlamentar SLS, nëse dikush është paraqitur për fjalë, mund ta marrë fjalën. Unë nuk po shoh se kemi të paraqitur.

Vazhdojmë me diskutimet e deputetëve, sipas radhës. Fjalën e ka deputetja Gjylnaze Syla, le të përgatitet deputeti Armend Zemaj.

Regjia, le ta qesë për një moment listën e të paraqiturve për diskutim në monitor.

GJYLNAZE SYLA: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar ministra,

Të nderuar deputetë,

Me shumë kujdes e kam analizuar rishikimin e buxhetit për vitin 2009. Çfarë bie në sy menjëherë, është shtimi i shpenzimeve pa arsyetimin e tyre. Është interes nacional që buxheti të menaxhohet brenda kufijve ashtu siç është aprovuar në këtë Kuvend buxheti për vitin 2009. Në fund të fundit, shpenzimi i parave publike është i definuar mirë në Ligjin për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, neni 17.1 thotë se paratë publike do të përdoren vetëm për qëllime të miratuara publike dhe asnjë autoritet publik, organizatë buxhetore, person apo ndërmarrje nuk mund të devijojnë, keq zbatojnë, ekspozojnë apo përdorin në mënyrë të parregullt paratë publike. Pikërisht këtë e ka bërë Qeveria e Kosovës.

Ndryshimet që i ka propozuar Qeveria e Kosovës për rishikimin e buxhetit 2009 nuk janë tjetër pos përbirje e tij e paautorizuar. Është e vërtetë e dhimbshme se sikur Qeveria ta përdorte vetëm përvojën e familjeve në Kosovë dhe principet e tyre që të shpenzohet aq sa kanë fituar, sigurisht që qytetarët e Kosovës nuk do të paguanin çmimin e dështimeve të Qeverisë.

Shumë premtime të dhëna nga Qeveria dhe detyrat që ka marrë me aprovimin e buxhetit 2009, nevoja urgjente për rritjen e punësimit, cilësinë e shkollimit, ruajtjen e shëndetit të popullatës, tanimë me këtë rishikim jo vetëm që nuk zgjidhen këto probleme, por të shtohen probleme.

Të nderuar deputetë,

Gjatë shqyrtimit të buxhetit 2009 kemi tërhequr vërejtjen se do të vijë deri te rritja e shpenzimeve, por Qeveria nuk i ka marrë parasysh mbase pse jemi opozitë. Të shohim se çfarë është ndryshuar dhe cilat ndryshime kërkohen.

Unë do të përqendrohem edhe pak, ashtu si deputeti Shatri, në dividendin e postës. Edhe pse Postës i kërkohet ti merret dividendi prej 200 milionë euro, unë kërkoj nga ministri i Ekonomisë dhe Financave të më tregojë saktë se a është kjo vërtetë dividendë. Pra, z. ministër, a jeni duke e marrë dividendin e Postës apo kapitalin e Postës? Sepse, në qoftë se e merrni kapitalin e Postës, ju po e dobësoni Postën dhe po ia ulni vlerën, që do të thotë se Posta do të shitet në vlerë shumë më të ulët dhe me këtë jepni mundësinë vetit që ju ta blini ose dikush tjetër nga Qeveria? Është dashur saktë ta sillni informatën për bilancin e Postës për ta ditur se a po preket kapitali i Postës apo vetëm dividendi.

Gjithashtu, siç e tha deputeti Shatri, nëse merren 200 milionë, ju po dobësoni sistemin bankar në Kosovë. Prandaj jam kundër aprovimit të buxhetit të rishikuar për vitin 2009. Me një fjalë, puna me Postën është e papërgjegjshme dhe e paarsyeshme. Të merren para prej Postës e të ndahen për shërbime dhe mallra, transfere dhe subvencione, është e paarsyeshme dhe e papërgjegjshme.

Rritjet ose shpenzimet e brendshme të cilat janë paraparë, janë pagat dhe mëditjet 4.8 milionë euro, mallra dhe shërbime 18.2 milionë euro, subvencione dhe transfere 38.6 milionë euro dhe shpenzimet për ndërtimin e autostradës Morinë – Merdare 50 milionë euro. Shpenzimet e Kryeministrit rriten për 100%, pra prej buxhetit të vitit 2009, ku janë paraparë afërsisht 4.903.000, me rishikim parashihihen 8.322.000, do të thotë është rritur edhe numri i punëtorëve prej 310 punëtorëve, me rishikim rriten 481 punëtorë. Më vjen keq që s'është Kryeministri këtu, do të ishte shumë më e arsyeshme sikur ta rriste buxhetin e shëndetësisë për 100%.

Rrugët nuk ndërtohen vetëm duke u shpenzuar buxheti i Kosovës, rrugët e Kosovës mund të ndërtohen edhe në mënyra dhe alternativa tjera, por natyrisht që Qeveria nuk është e interesuar për këto mënyra të tjera, sepse do të bëjë tenderë dhe dihet se çka bëhet me këto tenderë.

Edhe pse Qeveria pati proklamuar se e ka prioritet shëndetësinë dhe arsimin, megjithatë shkohet kah transporti. Vetë ministri i Ekonomisë dhe Financave tregoi se përfituesi më i madh sërish është Ministria e Transportit me 37 milionë euro.

Mbase prioritet pa tjetër duhet të ishte shëndetësia, ashtu siç deklaroi edhe vet Qeveria, sepse nuk jam e sigurt se kush do t'i gëzojë këto rrugë në qoftë se kemi popullatë të sëmurë. Sa do të kemi njerëz që do të jenë në gjendje të ecin nëpër këto rrugë në qoftë se nuk janë në gjendje për ta blerë një hap ose për ta marrë një hap për shërim.

Pse nuk po rriten kapacitetet e shëndetësisë? Pra, shëndetësisë i është rritur një buxhet prej 5.5 milionë euro, nuk ka pagesa për punëtorët shëndetësorë prej 44 euro, e mos të flasim për rritjen e pagave të punëtorëve shëndetësorë, nuk ka krijim të shtyllës së sistemit shëndetësor në krijimin e sigurimeve shëndetësore.

Edhe një herë e theksoj se patjetër që rishikimi duhet të bënte rritjen e buxhetit të Ministrisë së Shëndetësisë, duke marrë parasysh nevojat e popullatës për sistem shëndetësor të qëndrueshëm. Investimet në shëndetësi janë nën mesataren e rajonit.

Zot ministër, ju ftoj të më përgjigjeni në pyetjen se sa janë saktësisht obligimet për borxhet e jashtme dhe kur duhet të paguhet? Me standarde ndërkombëtare është e paraparë që kur të bëhet likuidimi i firmës ose shtetit, përdoret parimi i ndarjes në asetë dhe obligime. Ju keni marrë obligimet, por jo edhe asetet që i takojnë Kosovës prej ish-Jugosllavisë. Pse nuk përdoret ky parim?

Sa i përket FMN-së, me qenë se nuk i keni përfillur rekomandimet e Fondit Monetar Ndërkombëtar, unë shtroj pyetjen se si do të kërkojë Qeveria përfitime financiare në qoftë se nuk e keni marrë parasysh rekomandimet e Fondit Monetar. Çfarë është dash të bëhet?

E para, vetë mënyra e raportimit të Kuvendit, zoti ministër, merreni dokumentin, shikoni, shkronjat janë të vogla. Nuk ekziston fare shtylla në të cilën do të ishte buxheti i vitit 2009, që të mund të bëhet krahasimi me pjesën e rishikuar të buxhetit.

Është e qartë pra se Qeveria nuk do që populli i Kosovës t'i dijë detajet rreth ndryshimeve, edhe pse këto janë paratë publike, nuk janë paratë e Qeverisë. Po ashtu, keni shkelur ligjin, sepse nuk është publikuar në Gazetën Zyrtare.

E dyta, është dashur të bëni kursime në kategorinë e shpenzimeve dhe mallrave, transfereve dhe subvencioneve dhe jo t'i rritni këto shpenzime.

E treta, siç e thashë, sa u përket projekteve kapitale, për rrugë është dashur të gjeni forma të tjera të financimit si kredi, koncesione, subvencione e tjerë.

E katërta, prioritetet që keni parashtruar, sidomos ato që kanë të bëjnë me shëndetësinë duhet të plotësohen, por edhe me cilësinë e arsimit dhe jo vetëm me ndërtimin e shkollave.

Kështu si i ka sjell Qeveria, ndryshimet jo vetëm që nuk përmirësojnë gjendjen e tanishme dhe nuk i zgjidhin problemet e popullatës, por i rrisin këto probleme.

Të nderuar qeveritarë,

Është koha për ndryshime. Ajo çfarë ju keni propozuar të ndryshohet, është në interesin tuaj, ajo çfarë duhet ndryshuar, është që të mendoni dhe punoni për interesin e popullatës dhe jo të vetvetes. Çfarë duhet vërtet të ndryshohet, është kjo Qeveri. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zonja deputete!

Fjalën e ka deputeti Armend Zemaj, le të përgatitet deputeti Fatmir Rexhepi.

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Unë personalisht do ta kem rastin që edhe në Komisionin për Buxhet dhe Financa t'i paraqes ato shqetësime të mia, për të cilat mendoj që ndoshta mund të jap edhe këtu një kontribut duke marrë parasysh se ky është një rishikim i buxhetit në këtë 6 muaj dhe mendoj që personalisht kërkoj ndonjë sqarim nga ministri për Ekonomi dhe Financa në pika të shkurtra rreth asaj që unë e kam këtu diskutabile apo që mendoj që duhet të jetë një kujdes i veçantë.

Kuptohet që rritja e shpenzimeve tani duhet të jetë e kujdesshme dhe me arsye shumë të plotë. Në këtë rast e di që edhe e dimë të gjithë ne kemi një sektor bankar të qëndrueshëm tani për tani është stabil, por, cili do të jetë viti pasues ndoshta këtu ministri do të na ndihmojë me këtë shpërndarje apo me këto kërkesa që janë bërë buxhetore.

E dyta është që unë e di cilat janë instruksionet e Ministrisë për Ekonomi dhe Financa drejtuar të gjitha organizatave buxhetore. Dhe, këtu e shoh që me këto alokime që do të bëhen pas miratimit të këtij buxheti, mendoj që janë edhe në kundërshtim me politikat e Ministrisë për Ekonomi dhe Financa, sepse e di që kanë pasur metoda strikte kërkesat për rritje të shpenzime. Në anën tjetër, mendoj që ka presione të ndryshme edhe nga organizata tjera buxhetore që ndonjëherë për mua këto janë shumë të paarsyeshme. Këtë dua ta them me sinqeritet, nëse i shohim shpenzimet e bëra deri më tani në këtë gjashtëmuaj nga ministrinë e linjës ose nga organizatat tjera buxhetore dhe, cili do të jetë kapaciteti i tyre, i harxhimit të buxhetit deri në fund të vitit 2009 në këtë rast edhe me këto rritje të kërkesave të tyre dhe aprovimit apo mos aprovimit tani që ne do t'i japim në Parlament?

Për mua është shumë e kuptueshme që është e nevojshme t'i ndihmohet Ministrisë së Bujqësisë të ketë subvencion për mbjelljet vjeshtore. Është shumë e nevojshme rritja e kërkesave për barna esenciale dhe shërim, në këtë rast jashtë vendit edhe pse ndonjëherë

duhet të shikohen me kujdes të veçantë. Edhe ajo që ne jemi pajtuar që gjithë që fëmijët tanë mos të kenë nevojë të blejnë libra, por t' u jepen gratis.

Por, zotëri ministër, nëse në projektet kapitale lejohet rritja e shpenzimeve për blerjen e veturave po thuaj në të gjitha organizatat buxhetore, unë vetëm këtë arsyetim e kisha dashur nga Ministria për Ekonomi dhe Financa dhe nga Qeveria se si është lejuar në këtë kohë që ka rritje apo aprovim të kërkesave për blerje të veturave? Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet!

Fjalën e ka deputeti Fatmir Rexhepi, le të përgatitet deputetja Myzejene Selmani.

FATMIR REXHEPI: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar ministra,

Kolegë deputetë,

Dokumentit që është ofruar lidhur me rishikimin e buxhetit nga ana e Ministrisë së Ekonomisë dhe Qeverisë, në leximin e parë mendoj që duhet t'i kushtojmë rëndësi të veçantë për arsye të ndikimit të madh që ka në politikën e investimeve, në stabilitetin makro-ekonomik që u përmend këtu, por edhe disa tregues tjerë të cilët flasin për politikën e Qeverisë a është politikë e drejtë apo është politikë selektive në investime? Është dokument që është nënshkruar nga Kryeministri dhe unë mendoj që mirë është të ishte edhe vetë Kryeministri për të debatuar me deputetët, për arsye se ju e dini që Kryeministri na ka lexuar bajagi gjatë një orë e gjysmë këtu lidhur me kornizën dhe investimet që i ka bërë nëpër Kosovë dhe është mirë të jetë këtu dhe për të debatua drejtpërdrejt me këto tabela, me këto figura, me këtë politikë të investimeve që e ka bërë në gjitha terrenet e Kosovës dhe këto janë fakte për të cilat kanë nevojë ta dinë gjithë qytetarët e vendit, prandaj është mirë të jetë këtu, edhe e ftoj që të kthehet në sallë, të mos pijë kafe përjashta.

Vërejtjet e mia të korniza gjatë debatit këtu kanë qenë po ashtu parimore të cila kanë të bëjnë me stabilitetin makro-ekonomik, me potencialin pra ekonomik që e ka vendi, por edhe me planifikimin jo objektiv dhe rural të hyrave që e dëshmon edhe ky rishikim i buxhetit, i cili mendoj që tregon për performancën dhe obligimet që i ka Qeveria do të thotë për kapacitetet e veta, qoftë planifikim, por edhe shpenzimet buxhetore dhe realizimin e projekteve që duhet të ndikojnë drejtpërdrejt në ndërtimin dhe zhvillimin e vendit.

Një vërejtje tjetër që ka të bëjë me këtë pikë është këtu ajo që u tha nga ministri lidhur me investimet e mëdha- investimet kapitale. Unë mendoj që ky buxhet i një vendi më të varfër në Kosovë sërish e ri potencoj atë që nuk mund të bartë investime të mëdha, por ju lutem që me Ligjin për koncesionet dhe partneritetin privat- publik të filloni të ndërtoni autostrada dhe këto mjete dhe këtë politikë apo orientimet buxhetore t'i qoni në atë drejtim ku do të ndihmoni zhvillimin e gjithë sektorëve të tjerë që janë prioritet dhe kanë rëndësi shumë më e madhe për stabilitetin e brendshëm vetë dhe për të krijuar një partneritet dhe një zhvillim social më të mirë se sa që e kemi, jemi vendi më i varfër me 50% të popullsisë me varfëri të lartë. Prandaj, konsideroj që vërejtjen duhet ta keni parasysh.

Faktet flasin se sërish ky rishikim nuk ofron pra ndarje të drejtë të fondeve për investime kapitale. E tha edhe shefi i Grupit Parlamentar të LDK-së këtu, dhe të shkojë do të thotë një vërejtje e madhe për Qeverinë, sepse kemi një koncentrim regjional, andej kah vjen Kryeministri me dhjetëra e dhjetëra miliona shkojnë në investime nëpër rrugë, nëpër

male, ndërsa qendrat urbane që lidhen prej një qendre në qendrën tjetër, kanë mbetur pa asnjë euro investime, qoftë rehabilitim, qoftë ndërtim i ri e tjera. Prandaj, a është kjo politikë e drejtë apo s'është politikë e drejtë le të vlerësojnë dhe të gjykojnë deputetët e Parlamentit, sepse ministrat, pjesa më e madhe, nuk donë të dëgjojnë për këtë punë dhe Kryeministri as që lodhet për këtë punë.

Faktet nga tabelat dhe politika e investimeve atë ditë që na ka lexuar Kryeministri më vjen keq, por unë u detyrova që para dy netëve të shkoj t'i blejnë një parë syza. Boll i kam sytë e mirë- shoh shumë, por nuk kam mund, prandaj u detyrova për të blerë syza edhe dikur vonë, pra natën t' i lexoj këto për të mund të vijë t'i them disa argumente dhe fakte. Në gjuhën angleze dhe në gjuhën serbokroate figurat janë krejt tjera, në gjuhën shqipe kjo përgatitje teknike nuk është mirë, ani pse është vërejtje teknike, por për mua flet shumë.

Dhe, po t'i shikojmë këto tabela, unë po ndalem vetëm te faktet lidhur me politikën e investimeve, nënshkruar nga Kryeministri, ministri i Transportit dhe ministri i Ekonomisë dhe Financave. Rehabilitimi dhe ndërtimi i rrugëve për vitin 2009 kap shumën prej 135 milionë euro. Prej tyre i kemi 64 milionë në rehabilitim, 22 milionë subvencionim së bashku me komunat dhe 46 milionë ndërtime të reja. Unë po ju them, do me thanë vërejtjet e ngjashme që i thanë dy deputetë këtu, zoti Haki Shatri edhe zoti Ibrahim Makolli që ishin shumë parimor dhe shumë me vend sa i përket këtyre politikave.

Ju zotërinj ose Qeveri në fjalë e Kryeministri Hashim Thaçi edhe pse jemi partner të koalicionit, unë mendoj që për rajonin e Gjilanit ka bërë sërish një fasadë politike, është hera e tretë që unë e ngriti këtë çështje. Kam shpresuar që gjatë debatit prej buxhetit 2009, gjatë kornizës afatmesme dhe tash është hera e tretë dhe mendoj është e mjaftueshme pra e treta që megjithatë të shikohet me shumë seriozitet dhe të korrigjohen këto. Fasada politike ka të bëjë edhe çështje gjeografike, i keni përmendur tri projekte të vogla. Flitet për ndërtimin e një rruge të re prej 46 mijë euro në Stançiq, një pjesë që lidh nja 300 – 400 metra atje në kufij e thuhet rrugë rajonale ose rrugën Pogradjë – Stublinë, që është e vitit 2008, aspak nuk është e vitit 2009 u përmend këtu dhe ne e vërejmë. Apo rruga tjetër që është Kishnapole – Gadime, që absolutisht pra, nuk e përmbush asnjë prioritet që i duhet këtij rajoni, mungojnë, zotëri Kryeministër, miliona që duhet të investohen prej qytetit të Gjilanit në drejtim të Ferizajt, në drejtim të Preshevës, në drejtim të Bujanovcit, në drejtim të Prishtinës dhe merreni e shikoni sa mjete prej 135 milionë asnjë cent që ku e keni, zero, zero, zero, zero, edhe tash shtrohet pyetja çfarë politike investimeve dhe çfarë politike është kjo dhe a ka ndarje selektive? Këtu një deputet më herët thoshte mos i përmendni rajonet. Jo, unë s'jam për këtë, po e përmend këtë, sepse faktori kryesor që e ka vendosur një politikë të këtillë selektive është Kryeministri me ministrat e vetë dhe unë nuk pajtohem me këtë politikë. Nuk është në interes të zhvillimit harmonik të vendit, nuk është në interes të pjesëmarrjes së barabartë të zhvillimit, sepse taksapagues ka edhe ai rajon, me dhjetëra- mijëra firma, me dhjetëra mijë afaristë, me qindra mijëra qytetarë që ndajnë taksa dhe për vitin 2009 dhe kjo çka keni planifikua asnjë cent të mos investoni, ju lutem urdhëroni përgjigjuni para këtyre qytetarëve.

Dhe, a ka kuptim të shkoni çdo javë të pini kafe ose t'u premtoni arsimtarëve atje se do t'ia rritni rrogat në Gjilan, kur këtu nuk e kemi paraparë fare, nuk ka kuptim? A ka kuptim të premtohet auto-udha, auto-hekurudha, hekurudha dhe të tjera - kjo nuk ka kuptim? Prandaj, këtë vërejtje po ua bëj me qenë se jemi partnerë të koalicionit dhe këtu unë e ngriti çështjen, për Kryeministrin, për ministrin e Ekonomisë dhe Financave, për

ministrin e Transportit dhe shefin e Grupit Parlamentar, që duhet të ulen bashkërisht deri në leximin e dytë dhe ta korrigjojnë këtë.

Unë kërkoj për hir të gjithë qytetarëve, pra ata janë 400 mijë njerëz atje që s'e keni ndarë asnjë cent, ata janë taksapagues të këtij vendi, të kësaj pavarësie, të kësaj Republike, që ta korrigjoni këtë dhe 10 milionë euro nga kjo të mos i futni aspak në këtë rishikim, po t'i leni për vitin 2010, t'ia leni komunës së Gjilanit ta ndërtojë rrugën prej qendrës kah Ferizaj, prej qendrës kah Presheva, prej qendrës kah Prishtina edhe prej qendrës kah Bujanoci, për arsye sepse atje me mijëra qytetarë në ditë nuk mund të dalin- të ecin rrugës, nuk kanë trotuare as rrugë dhe ngushtica të mëdha, ndërsa nuk kemi nevojë për fasada gjeografike të kësaj natyre në projekte politike. Këtë çështje po e kundërshtoj për herë të tretë, dhe lus pra që ta keni në konsideratë dhe duhet ta dini qëndrimin tim, në qoftë se kjo nuk korrigjohet, unë kam për të votuar kundër. Në të njëjtën kohë do të kërkoj nga Grupi Parlamentar gjatë rishikimit të dytë, në qoftë se nuk i aprovojnë, kam për të kërkuar politikisht nga Kryesia e partisë, nga Grupi Parlamentar ta rishikojë koalicionin dhe partnerin në koalicion dhe se këto politika janë tejte të dëmshme, nuk i pranoj si parimore për koalicionin që i kemi.

Mua si deputet në tri mandate dhe si njeri themelues të LDK-së nuk më pëlqen kjo politikë se është në dëm të vendit, e bën selektive, ndanë regjione, nuk i duhet Kosovës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet!

Fjalën e ka deputetja Myzejene Selmani, le të përgatitet deputetja Mimoza Ahmetaj.

MYZEJENE SELMANI: Faleminderit, zoti kryesues!

Përshëndetje për ministrat që janë këtu,

Përshëndetje për të gjithë deputetët që janë këtu,

Pikë së pari gjatë shqyrtimit të këtij projektbuxheti të rishqyrtuar për mundësinë që ministri është sot prezent këtu, mund t'i them se më është dashur me llupë t'i shikoj shifrat, zotëri ministër. Nuk e di çka është problemi ashtu- kështu në Kuvendin e Kosovës harxhohet letër mjaftë shumë, shpenzimet për mallra dhe shërbime janë të ngritura aq shumë sa që do të ishte e rrugës të bëhen një mënyrë tabelare me shifra pak më të mëdha, po të them shumë sinjerisht është dashur me llupë shumë shifra të shikohen se nuk janë parë. Pra, ku qëndron arsyeja nuk e di?

Në rast se e shohim gjatë projektimit të parë të buxhetit 2009 shumë qartë është se këtu të hyrat e buxhetit janë 956 milionë euro, ndërsa totali i daljes është 1.4 milionë euro. Duke marrë parasysh si është bërë rishqyrtimi mund të them se duhet të paraqiten edhe fakte dhe vërejtjet e Fondit Monetar Ndërkombëtar për arsye se Kosova tash është anëtare e Fondit Monetar Ndërkombëtar dhe e Bankës Botërore në aspektin e rreziqeve fiskale për shkak të ndikimit të tij në bilancin bankar të Qeverisë.

Duke marrë parasysh se Qeveria dhe Ministria e Ekonomisë dhe Financave kanë marrë vërejtjet shumë kohë më parë, e dinë mjaftë mirë ku do të paraqiten këto rreziqe fiskale. Kjo parashihet se nëse rritjet e shpenzimeve si u pa vetëm në tremujorin e parë tash do t'ju jap një tabelë shumë të qartë të këtij viti, në krahasim me vitin e kaluar janë shumë të rritura.

Do ta jap një raport shumë të shkurtër për tre muajt e parë ku është janar – mars 2009 dhe janar – mars 2008, shpenzimet e udhëtimit janë 716.097 mijë euro, ndërsa në vitin 2008

340 mijë e 634 euro që do të thotë janë rritur 110%. Duke marrë parasysh se është përfillur shumë nga kjo Qeveri se do të ketë shpenzime edhe në telekomunikim brenda kabinetit qeveritar edhe këtu është një rritje për tremujorin e parë. Në rast se e marrim rishqyrtimin total të këtij projektbuxheti që ende sipas ligjit është projektbuxhet deri pas shqyrtimit të dytë që do të bëhet nga Komisioni Parlamentar dhe me vërejtjet të cilat do të jepen, mund të them se ky rishqyrtim është bërë deri në muajin maj. Nëse e kemi një bazë të dhënave të shifrave se çdo gjë është paraparë të jetë ashtu siç është pasqyruar në këtë rishqyrtim, shihet qartë se të hyrat janë në rënie 23%, ndërsa shpenzimet janë në rritje 39%, ende nuk mund të bindet Qeveria se si do të mund të mbyllë dhe të fillojë projektimi i buxhetit 2010. Shihet si janë dallimet mes vitit 2008 dhe 2009, duke marrë parasysh se Kosova vetëm është goditur nga kriza globale financiare, rritjet e pagave dhe mëditjeve kur dihet se mjaftë mirë se çfarë bruto produkti vendor, ka Kosova në këtë vit 3.1%.

Ndërsa shpenzimet kapitale janë 347.1% për 2008, ndërsa në buxhetin e vitit 2009 kanë qenë 470.5. Pra, dihet mjaftë mirë se këto edhe nuk realizohen për shkak të mungesës së vizionit të ministrave të linjës dhe aspektit menaxherial me parane publike në mënyrë jo transparente.

Mund të jap një shembull konkret nga vetë ministri i Ekonomisë dhe Financave që është prezent me menaxhimin e parasë publike brenda Ministrisë- linjës ku shumë konkretisht mund të them se prej 1.12.2008 deri më 19.12.2008, pra vitit të kaluar për mbylljen e vitit fiskal brenda 19 ditësh janë shpenzuar 237 milionë euro për mallra, shërbime, paga, mëditje, investime kapitale, shumë shpenzime të komunave vetëm që të mos ngelin paratë e paratë janë të qytetarëve, të taksapaguesve të Kosovës.

Në rast se kalojmë te tabela e Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave që dhe pse kam pasur vështirësi kam pasur mundësi të shoh se çka po ndodh këtu, mund të shihet se aty janë 5 milionë kur janë ndarë në projektbuxhet për vitin 2009, 5 milionë euro për shpronësim, ndërsa tash nga gabimet e planifikimit për KEK-un për të cilin shuma e parave ka qenë 150 milionë euro dhe për të hapur minierën e Sibovcit ku edhe ushtruesi i detyrës së drejtorit menaxhues të KEK-ut për çështjen e ngritjes së tarifave të energjisë e arsyetonte se duhet të bëhet hapja e Sibovcit dhe duhet të ngritën tarifën, tash po del se është planifikuar keq. Tash duhet 55 milionë borxheve të jashtme dhe 50 milionë nga kjo të destinohen për autostradën Morinë – Merdare.

Duke marrë parasysh se edhe folësi para meje potencoi se tash kemi mundësinë të marrim investime nga partneriteti publiko-privat dhe koncesione nuk është nevoja që një buxhet i varfër siç është buxheti i Kosovës të hymë në projekte madhore. Pra, të gjithë e duam Kosovën, të gjithë ja duam të mirën investimeve kapitale në Kosovës, mirëpo investimet kapitale bëhen në bazë të një strategjie të mirëfilltë të Qeverisë dhe të Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave. Prapëseprapë do të ketë para për blerjen e energjisë që gjatë projektimit të buxhetit 2009 të mos ndodhë privatizimi i KEK-ut dhe ato borxhe do të kthehen, mirëpo tash po del arsyeja se ato borxhe nuk do të kthehen.

Kisha për t'u ndalur vetëm te tabela ku janë të hyrat nga tatimet kufitare- doganat, planifikimet e të hyrave ka qenë 665.30, ndërsa të hyra të mbledhura janë 215.03, kthimet nga doganat janë minus 2, të hyrat e mbledhura nga dogana janë minus 025, tatimet vendore, Administrata Tatimore. Zotëri ministër edhe pse unë si opozitë ju kam përkrahur në idenë tuaj për biznese që të ... një anulim që ata të mund të paguajnë taksën tatimore, mirëpo siç po shihet kjo 200.50-ën ka ngelur që shumë vite, ndërsa të hyrat e

mbledhura nga administrata tatimore edhe pse janë bërë tri ndërrime të drejtorit të administratës tatimore i ke 88.58% . Kthimet nga ATK-ja minus 23 tash prapë se prapë je minus 11.87. Të hyrat jo tatimore nga niveli qendror i ke 58.50 të planifikuara, ndërsa të arritura i ke 30.7. Të hyrat vetjake i ke 57.20 plani të hyrave, ndërsa të arritura i ke 30.7. Në nivel qendrorë i ke plani i të hyrave 20, ndërsa të mbledhura i ke 14.1. Komunat 37.20, ndërsa të mbledhurat janë 16.5.

Me përgjegjësi si deputet i këtij Kuvendit të Kosovës dhe si taksapagues i Kosovës kërkoj në mënyrë shumë transparente dhe në mënyrë shumë të mirë menaxheriale duke i marrë parasysh se vërejtjet e Fondit Monetar Ndërkombëtar dhe të gjitha vërejtjet për organizatat e huaja ndërkombëtare që parashihen edhe me kornizën afatmesme të shpenzimeve deri në vitin 2012 shihet mjaftë mirë se projeksioni i buxhetit duhet të ketë kujdes shumë të madh për arsye se Kosova nuk po shkon nga ngritja e GDP me sa po më duket është kah shkon nga rënia e GDP. Edhe pse vullneti i juaj ndoshta është shumë i madh është që të shkon nga ngritja e GDP me sa po shihet pasqyrat reflektojnë të kundërtën e juaj.

Jeni përgjegjës si ekzekutiv që të tregoni paranë publike si po menaxhohet dhe kah po shkon. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zonja deputete!

Një njoftim, në ndërkohë në dollapët e deputetëve ndodhet materiali, i njëjti material, por i shkruar me format më të madh me shkronja më të mëdha. Luten deputetët që në ndërkohë të pajisen me atë material dhe për këtë le të më fal deputetja Ahmetaj. Propozoj një pauzë nga tani deri në orën 14:00 e cila le të shfrytëzohet edhe për drekë. Atëherë, insistimi është për orën 14:30, po ta dini se duhet të vazhdojmë deri vonë, sepse janë paraqitur për diskutim mjaftë deputetë.

Në orën 14:30, ju lutem, të gjithë të jeni këtu.

#### Vazhdimi i seancës pas pauze

KRYETARI: Të nderuar deputetë, mund të fillojmë vazhdimin të seancës.

Por, para se t'ia japë fjalën, po ju njoftoj se kemi 17 deputetë të lajmëruar për debat. Nëse jeni dakord, e kufizojmë kohën për diskutim në 5 minuta. Kush është “për”, lë ta ngrit dorën? Faleminderit! A ka “kundër”? Dy “kundër”. Vazhdojmë, 5 minuta, pra. Urdhëro, Besa, a je dakord? Fjalën e ka deputetja Besa Gaxherri.

BESA GAXHERRI: Zoti Kryetar,

Nuk është duke të funksionuar koalicioni qeveritar. Qe sa herë po prishet seanca plenare për kuorum. Sot diskutohet buxheti, rishqyrtimi dhe nuk i ke deputetët e koalicionit qeveritar. Nëse do merri 5, nëse do 10 minuta, ne mund edhe të shkojmë krejt, por në seancën e kaluar, para kësaj, vërtet, ju keni marrë vendim që do t'ua hiqni mëditjet për shkak kuorumit. Zoti Kryetar, nuk është korrekte, opozita nuk bën që t'ua mbajë kuorumin juve si mazhurancë që jeni këtu. Ne vijmë në Kuvend për shkak të votuesve tanë dhe për shkak të çështjeve të caktuara, jo që t'ua bëjmë kuorumin. I keni 80 vota në koalicion dhe duhet ta keni kuorumin. Prandaj, unë mendoj se duhet t'ia fillojmë menjëherë, se edhe ashtu jemi vonuar, shiko ora është 14:45. Kryeministrin nuk e ke këtu, Kabinetin nuk e ke, nuk po funksionon, zoti Kryetar.

KRYETARI: Mirë, faleminderit! Pra, ministrin për Ekonomi dhe Financa e kemi këtu, debatin mund ta zhvillojmë. Debati mund të zhvillohet edhe me 40 deputetë. Këtë mendoj që duhet ta kemi të qartë. Do të thotë, mund të kalojmë në 5 minuta, se kështu u votua.

Fjalën e ka deputetja Mimoza Ahmetaj, lë të përgatitet Lulzim Zeneli.

MIMOZA AHMETAJ: Faleminderit, zoti Kryetar!

Të nderuar ministra,

Të nderuar deputetë,

Së pari, e përgëzoj Qeverinë që në rishikimin e buxhetit që e ka bërë, sidomos me prioritetet iu ka dhënë lëmenjve të caktuar të shoqërisë së shtetit tonë. Rëndësi e posaçme që i është dhënë bujqësisë, sidomos në subvencionimin e mjeteve të ndryshme për bujqësi dhe sidomos për mbjelljet vjeshtore, duke ndarë një shumë të caktuar të mjeteve nga paratë e ndara për shtesë për buxhetin në pjesën tjetër të vitit.

Po ashtu një rëndësi e posaçme i është kushtuar edhe Ministrisë së Shëndetësisë duke shtuar listën esenciale të barërave, buxhetin për listën esenciale të barërave në plus 4 milionë, përveç atyre të cilave kanë qenë, si dhe për trajtimin e pacientëve jashtë vendit në shumë prej një milion eurove.

Ndarja e mjeteve dhe krijimi i institucioneve të reja, siç është Zyra për Çështje të Trashëgimisë së TMK-së në kuadër të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale. Gjithashtu edhe ndarja e 4.4 milionë eurove për Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale për skemat sociale dhe për ato pensionale duke marrë parasysh se kohë më parë ne në Kuvend e kemi debatuar ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për skemën sociale dhe pika në të cilën jemi ndalur dhe i kemi kushtuar pikërisht vëmendje ka qenë çështja se a ka Qeveria mjete të cilat ishin të nevojshme që të shtohen në mënyrë që ky ligj të bëhej funksional? Prandaj e përgëzoj sidomos në këtë pikë që mjetet të cilat janë kërkuar janë ndarë nga Qeveria.

Po ashtu ndarja e mjeteve për autostradën Merdare – Morinë si dhe Ministria e Arsimit e cila ka ndarë mjete të caktuara për libra për shkolla dhe për bursa për studentët.

Më herët u përmend nga disa parafolës ndarja e mjeteve e shumës së caktuar për Zyrën e Kryeministrit. Desha vetëm të sqaroj për ata të cilët ose nuk e kanë lexuar me vëmendje ose nuk e kanë kuptuar që mjetet e tilla janë ndarë për Zyrën e Kryeministrit me qëllim që të bëhet kalimi i Agjencionit të Veterinës nga Ministria e Bujqësisë në Zyrën e Kryeministrit, si dhe u përmend rritja e numrit të punëtorëve. Me qenë se këta 10 punëtorë kalojnë bashkë me Agjencionin në kuadër të Zyrës së Kryeministrit, domethënë, kjo ishte ajo pika në të cilën ndahen dhe për të cilën janë ndarë mjetet e caktuara.

Mendoj që vlen të përmenden edhe disa përparësi dhe disa të mira, anë pozitive që i ka ky rishikim i buxhetit. Domethënë, e para ishte që është bërë rritja e të hyrave në shumën prej 200 milionë eurove, është bërë rritja e kufirit të shpenzimeve prej 108.9 milionë eurove. Rritje e kufirit të shpenzimeve është bërë gjithashtu në lëmin e investimeve kapitale. Përveç rritjeve të cekura më lart është arritur që nga kursimet e buxhetit të fillohet edhe me projekte të reja investive. Është arritur që me rishikim të buxhetit të ndahen mjete edhe për krijimin e institucioneve të reja ashtu siç e përmenda më herët - Zyra për Çështje të Trashëgimisë së TMK-së në kuadër të Ministrisë së Punës, si dhe përmes këtij procesi është ruajtur neutraliteti buxhetor. Me një fjalë aq sa ka qenë rritja e të hyrave kemi pasur edhe ndarje të reja apo rritje të kufirit të shpenzimeve.

E përkrah buxhetin dhe, domethënë, votoj për rishikimin e këtij buxhetit. Faleminderit.

KRYETARI: Faleminderit edhe për kohën!

Fjalën e ka deputeti Lulzim Zeneli, le të përgatitet Ibrahim Gashi.

LULZIM ZENELI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Së pari, fjala e Kryeministrit ishte aq inkurajuese sa që domosdoshmërisht lind nevoja që të përgjigjet në një pyetje ministri i Financave, në këtë rast që e kemi këtu prezent dhe ajo qëndron. Në deklarimin e Kryeministrit, citoj: “Ky ligj apo ky propozim ndryshim i Ligjit të buxhetit për vitin 2009 është në përputhje të plotë me Kornizën afatmesme të shpenzimeve buxhetore” të cilën Qeveria e Republikës së Kosovës e ka miratuar para 4 – 5 jave, nëse s’gabo. Kjo ose është një keqkuptim, ose është një lapsus që është bërë për arsye se ky projektligj është në kundërshtim të plotë me Kornizën afatmesme të shpenzimeve buxhetore, të cilën Qeveria e Republikës së Kosovës e ka miratuar, siç thashë më herët, para 4 – 5 jave.

Do t’i marrë 2 – 3 shembuj, unë besoj që do të jenë të nevojshëm që deputetët e Kuvendit të Kosovës ta kenë parasysh se për çfarë dokumenti bëhet fjalë sot që po diskutojmë dhe si komunikon Qeveria e Republikës së Kosovës me organizatat financiare dhe, në këtë rast me Fondin Monetar Ndërkombëtar dhe çfarë komunikimi i shëndosh mund të ndërtohet në këto relacione?

Ligji parasheh në këtë dokumentin që e kemi përpara se totali i të hyrave për 2009 parashihet të jetë 956.5 milionë. Sipas kornizës, të cilën e ka miratuar kjo Qeveri, totali i të hyrave është 914 milionë. Shpenzimet që parashihen me këtë projekt janë 1.2 miliardë, kurse sipas kornizës afatmesme që e ka miratuar Qeveria e Kosovës deri në vitin 2011, parasheh 1.1 miliardë. Pra, këtu duhet të japë dikush përgjigje, çka është kjo? Mospërputhje e shifrave, ose është ta vëmë në lajthitje vetveten. Kjo formë e komunikimit po e rrezikon raportin e Kosovës me FMN-n të cilin pak më herët e miratuam. Nuk po flas për letrën që më 24 qershor 2009 iu ka adresuar deklarata përmbyllëse e FMN-së dhe adreson vërejtje substanciale lidhur me shpenzimet që ndodhin nga ana e Qeverisë së Kosovës.

Së pari, zotëri ministër i Ekonomisë dhe Financave duhet të jepet përgjigje pse ndodh kjo kështu? Qeveria e Kosovës me FMN-n ose komunikon përmes këtij ligji apo komunikon përmes kornizës afatmesme të shpenzimeve buxhetore. Pra, kjo duhet të sqarohet.

Ndërsa pjesa tjetër është shumë periferike në raport me këtë problematikë.

E para, deklaratimet e mëhershme se gjithmonë kjo Qeveri ka shkuar në politikat ku t’i ulur shpenzimet, për ta ulur luksin qeveritar dhe për të kursyer paranë publike, sipas këtij projekti që kemi përpara del e kundërta. Nëse e marrim vetëm një shembull konkret-mallrat dhe shërbimet rriten për 38 milionë. Ajo çka ka qenë deri më tash është 158 milionë, kurse me këtë rishikim kemi 197 milionë, pra për këtë duhet të jepen përgjigje. Ajo çka do të ishte në interesin tonë është që ministri i Ekonomisë dhe Financave të japë përgjigje para këtij Kuvendi.

Deficiti buxhetor që parasheh Qeveria e Kosovës brenda vitit 2009 në kornizën afatmesme të shpenzimeve buxhetore thirret 2 deri 3%. Ajo çka shihet në bazë të kësaj

tabele që kemi në këtë projektligj sillet më shumë se 11%. Prapë edhe kjo meriton një koment nga ana e Qeverisë.

KRYETARI: Ibrahim Gashi e ka fjalën, le të përgatitet deputeti Agim Veliu.

IBRAHIM GASHI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Të nderuar ministra prezentë,

Sigurisht që i bashkohem asaj keqardhjeje që disa kolegë deputetë e thanë lidhur me mos prezencën e Kabinetit qeveritar kur diskutohet një pikë tepër e rëndësishme, ku mendoj secili ministër do të kishte pjesën e vet për të dëgjuar dhe për të thënë pastaj diçka. Dhe tash unë nuk e di se si do të thonë ata diçka, bëhet fjalë për shtimin e buxhetit të disa dikastereve dhe ministrat as nuk janë këtu për ta arsytuar, mbase edhe nuk e dinë që ka pasur shtesa të buxhetit në ato ministri, sepse na e pamë që kishim këtu, domethënë me rastin e rishikimit kemi burime shtesë të të hyrave që për mua janë goxha të diskutueshme se a janë reale apo janë hipotetike?

Së pari unë e përshëndes optimizmin edhe të Kryeministrit edhe të ministrit të Ekonomisë dhe Financave kur flet për projeksionin e të hyrave dhe për trendin pozitiv të zhvillimit ekonomik nëpër të cilin ka ecur Kosova në këtë gjashtëmujor. Unë do të isha shumë i lumtur nëse vërtet është kështu dhe nëse vërtet në gjysmën e dytë të vitit në të cilin po hymë edhe më tutje në Kosovë nuk do të kemi impakt të krizës financiare globale.

Nëse keni përcjell veç pak debatet e këtyre ditëve, ekspertët e ekonomisë dhe të financave kanë paralajmëruar se Kosova assesi nuk do të jetë dhe nuk mund të jetë immune dhe pikërisht tash në këtë pjesë të dytë të vitit buxhetor ka filluar të ndihet, përkatësisht të shprehet ndikimi negativ i krizës financiare globale edhe në ekonominë e Kosovës. Dhe, do të thotë, është tepër inkurajuese të besosh se do të realizohet projeksioni i të hyrave edhe në gjysmën e dytë ashtu si është paraparë. Kjo është e para që konsideroj se do të duhej ndoshta Qeveria të jetë më dorështrënguar me ato burime shtesë që i ka për t'i destinuar menjëherë në projekte të investimeve kapitale kur mund të kemi problem me realizimin e të hyrave të parapara deri në fund të vitit, duke parë dhe trendët e realizimeve në tremujorin e parë, përkatësisht në gjashtëmujorin e parë të këtij viti.

Kur vijmë te të hyrat shtesë ose burimet që janë krijuar në ndërkohë e që ishte një shumë që u dha prej 108 milionë eurosh e rrumbullakuar ashtu, e cila do të destinohet mbi gjysma e saj diku 60% e saj në investime kapitale dhe atë në infrastrukturë. Pra, kur kemi parasysh investimet që kanë ndarë, kemi ndarë dhe ne e kemi miratuar kur e ka votuar "për" Projektbuxhetin e këtij viti një shumë relativisht të madhe karshi një buxheti të vogël për investime në infrastrukturë, ka qenë shumë i madh karshi rrethanave financiare dhe ekonomike që ka vendi ynë. Dhe, tash plus edhe një donacion shtesë, ndërkaq edhe realizimi i këtyre projekteve në praktikë për ata që udhëtojnë përditë nëpër rrugët që po ndërtohen, ritmi është mjaft

i ngadalshëm. Dhe, unë nuk e di se ne mund të ndajmë mjete po a do të realizohen këto apo do të kemi suficit? Nëse mund të jetë suficit, unë nuk jam ekspert, ndoshta, si të them, kontraktimi i punëve bëhet e punët kryhen pas tri vjetësh por nga kjo që po shohim ka rrezik, do të thotë, që edhe këto mjete që i kemi ndarë për infrastrukturën rrugore s'mund të realizohen deri në fund të vitit, me dinamikën po them që e vërejmë për çdo ditë që është mjaftë e ngadaltë.

U përmend këtu politika selektive në investime. Unë nuk do të shtoj më shumë, sepse konsideroj që ne së pari me sistemin tonë të mbrapshtë zgjedhor që e kemi pasur me një zonë zgjedhore nuk është mirë që të flasim në emër të një regjioni, sepse jemi deputetë të një zone zgjedhore, deputetë të gjithë Kosovës dhe unë s'kisha dashur t'i shoh ngushtë ashtu projektet zhvillimore të vendit tonë, ne jemi edhe ashtu vend i vogël dhe ndoshta s'duhet ....

Konkretisht e mbaj shumë mend shumë mirë veten çka kam thënë, ndoshta jo për ta cituar, por për ta parafrazuar po. Pra, tash një vit kur kemi folur për rishikimin e buxhetit të Kosovës në këtë kohë kam thënë që në sektorin e agrarit ku Kosova ka resurse pak është duke menduar kjo Qeveri. ....

KRYETARI: Anëtar i Kryesisë i ka 10 minuta.

IBRAHIM GASHI: Mendoj që në Sektorin e Agrarit, ku thashë Kosova ka resurse të cilat me investime të vogla mund t'i riaktivizojë, jemi prapë në një fazë, në një pjesë të rëndësishme, në një stinë të rëndësishme të vitit kur mund të korrigjojmë diçka dhe kur mund që atij 2 milionëshi t'i shtojmë edhe nja 10 milionë tjerë, sepse, të nderuar deputetë, nëse ju kujtohet vitin e kaluar një thes i plehut artificial në Kosovë ka kushtuar 30 euro, derisa në Maqedoni dhe Serbi, në dy shtetet fqinje ka kushtuar 10 euro. Diçka i tillë është raporti edhe sot e ato vende nuk e prodhojnë me shpenzime me të vogla, por janë intervenimet, subvencionet e shtetit për të regresuar si të them, investimet në bujqësi dhe pastaj kjo i ka dy efekte të drejtpërdrejta, inkurajimin e bujqve që të punojnë tokën dhe zbutjen e papunësisë, përfshirjen e familjeve të tëra që të punojnë në këtë sektor të rëndësishëm. Për mendimin tim një buxhet prej 8 milionësh në bujqësinë e Kosovës është tepër i vogël, kur ka mundësi që atij t'i shtohet edhe një 10 milionësh, sepse unë konsideroj se kjo drejtpërdrejt do të ndikojë në zbutjen e papunësisë në Kosovë. Ju mund të merrni dhe keni si të them impute nga zonat rurale, njerëzit janë dekurajuar që të punojnë tokën pikërisht, sepse importet që hynë në Kosovë e shkatërrojnë edhe atë pak bujqësi që zhvillohet tek ne.

Diçka që mund ta kem unë gabim është çështja e rezervave shtetërore dhe çështja e devidentes së Postë- Telekomit të Kosovës. Mendoj që ato 200 milionë është thënë diku nga autoritetet financiare ndërkombëtare që duhet të ruhen për rezervë shtetërore deri në vitin 2012 dhe nëse ne pikërisht atë dividend, ato 200 milionë euro që do t'i merrnim nga PTK-ja mund t'i destinojmë për shpenzime apo investime kapitale, prapë konsideroj që mund të bëjmë ndonjë gabim, sepse ato nuk janë të parapara për një destinim të tillë.

Dhe, përveç efekteve tjera negative që mund t'i kenë në rrezikimin e sistemit bankar të Kosovës nëse hiqet një depozitë aq e madhe rreth 30% e depozitës të përgjithshme në sistemin bankar të Kosovës. Këto janë disa thekse që sigurisht ekspertët mund t' i argumentojnë edhe më shumë, por këtu në këtë dokument që e kemi në shqyrtim sot nuk po duhet shumë të jesh ekspert, sepse po vërehen shumë defekte të cilat po i identifikojmë lehtë.

Unë uroj që këto defekte që sot po i vëren opozita të mos jenë të vërteta, të jenë ato që i thanë autoritet që e kanë propozuar këtë dokument, por, konsideroj që edhe ky krahu këndeje merr vesh diçka nga ekonomia, merr vesh nga financat dhe, natyrisht ne nuk mund të mbështesim diçka që nesër do t'i kushtonte këtij vendi me një prapambetje ekonomike ose me një humbje të një mundësie të menaxhimit të mirë të resurseve ekonomike që i ka ky vend. Faleminderit, zoti Kryetar dhe të nderuar deputetë!

KRYETARI: Faleminderit!

Fjalën e ka deputeti Agim Veliu, le të përgatitet deputeti Ardian Gjini.

AGIM VELIU: Faleminderit, Kryetar!

I nderuar zëvendëskryeministër,

Të nderuar ministra,

Kolegë deputetë,

Kur është aprovuar buxheti i vitit 2009, nga Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike janë bërë vërejtjet të cilat kanë qenë të argumentuara, por për të cilat sot nuk do t'ju marr kohë.

Një prej vërejtjeve që unë do të ndalem sot në rishikimin e buxhetit, konkretisht është shpërndarja jo e drejtë dhe, do të thosha, e koncentruar në disa pjesë të caktuara të territorit të Kosovës, duke i lënë anash disa komuna të Kosovës.

Nëse i bëjmë krahasimet ndërmjet komunave me territore të njëjta apo me numër të banorëve, del një disproporcion i dukshëm që nuk mund të quhet ndryshe vetëm diskriminim. Shembulli im do të jetë komuna e Podujevës e cila në këtë vit edhe pse është prej komunave më të mëdha me territor dhe me numër të banorëve, ka më së paku investime nga Qeveria e Kosovës.

Investimet nga pushteti qendror do të thosha deri tash janë diku 250 mijë euro nga Ministria e Pushtetit Lokal. Nga Ministria e Arsimit këtë vit ka filluar ndërtimi i një shkolle 5 klasëshe. Nuk ka investime nga Ministria e Ambientit, nuk ka investime nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale edhe pse në komunën e Podujevës diku 170 familje jetojnë në kontejnerë, në një lagje me kushte shumë të vështira për jetesë. Po ashtu nuk ka asnjë projekt që financohet nga Ministria e Telekomunikacionit. Domethënë edhe pse komuna e Podujevës ka bërë kërkesë për 18 projekte, nuk është investuar asnjë prej këtyre projekteve. Disa prej rrugëve janë edhe rrugë regjionale, mirëpo kjo ministri nuk ka financuar asnjë projekt deri tash. Këto kërkesa janë përsëritur edhe për rishikimin e buxhetit, mirëpo nuk kanë hasur në mirëkuptim.

Kur jemi te objektet shkollore, komuna e Podujevës ka nevojë për dy shkolla në qytet, një shkollë të mesme dhe një shkollë fillore për nga 1000 nxënës për arsye se shkollat në qytet punojnë me 3 ndërrime dhe janë tepër të ngarkuara. Sa për informacion për Ministrinë e Arsimit, këtë vit në komunën e Podujevës do të mbesin 1000 nxënës pa u regjistruar në shkollë të mesme për shkak të mungesës së hapësirave.

Po ashtu nëse nuk rregullohet edhe çështja e 68 paraleleve, gjegjësisht shtimi i numrit të punëtorëve në arsim rrezikojnë 68 paralele të brezit kufitar të mbyllën. Kështu që këto do të ishin kërkesat kryesore dhe do të ishte një kërkesë që do ta bëjmë edhe në formë të amendamentit për rikonstruimin e rrugës Podujevë – Dumnice – Përpellac – e cila është në një gjatësi diku rreth 11 kilometra që është rrugë rajonale. Faleminderit!

Drejtimin e seancës e rimerr zoti Ibrahim Gashi, anëtar i Kryesisë

KRYESUESI IBRAHIM GASHI: Faleminderit, zoti deputet!

Fjalën e ka deputeti Ardian Gjini, le të përgatitet deputeti Driton Tali.

ARDIAN GJINI: Faleminderit, zoti kryesues!

Shpresoj që regjia të mos ma ndal zërin si herën e kaluar, t'i ndihmoj pak demokracisë, të mos e fyej vendin edhe Parlamentin. Edhe nuk e di pse anëtarët e Kryesisë kanë më shumë minuta, kujt i ka rënë ndër mend për ta shpikur këtë temë? I dua edhe unë minutat e mia, se jam kryetar i grupit pak më të madh, dhe qenka zor veç me një dorë të flas.

Çdo gjë në botë e ka një karakter, domethënë, një tërësi e karakteristikave jo sikur ndërtesave e gjykatave që po ndërtohen në Kosovë, që se kanë asnjë shtyllë që t' i karakterizojë dhe nuk e di çka është shtëpi, a ambulante, a gjykatë, edhe unë po flas për karakteristika, për karakter.

Edhe ky projekt- propozim që na ka ardhur për rishikim të buxhetit, domethënë Projektligji për ndryshimin e Ligjit për buxhetin e vitit 2009, ka karakter të vetin, i ka shumë karakteristika krejt të këqija, por unë dua t' ju them veç për disa, sepse nuk mund t' i përmend krejt, nuk më premtan koha.

Një prej karakteristikave është që ka mjete të pa definuara saktë, për shembull, shihni i keni 5 milionë e 750 mijë euro në Ministri të Arsimit, thotë për ndërtim të shkollave pa specifikim. Domethënë, karakteristikë e këtij buxheti është se ka mjete të ndara pa precizim e që është shkelje. Dikush këtu e përmendi shkeljen e ligjit me zë të vogël, ndërsa kur flasim për shkelje të Rregullores së Punës, bërtasim. Shkelja e ligjit është shumë më e rëndësishme se shkelja e Rregullores së Punës, është duke u shkelur ligji, shtini në krye një herë edhe është tepër e rëndësishme dhe Kuvendi po i mbyll sytë, paramendoni çfarë vendi jemi duke ndërtuar.

Karakteristikë tjetër është që paradoksalisht edhe njëherë ndahet buxhet për rrugët për të cilat është ndarë buxhet vitin e kaluar, që domethënë se rrugët po ndërtohen edhe po shkatërrohen edhe po duhet për të ndarë buxhet për së dyti. Tash, mbani në mend, nëse dikujt i doket që është lehtë të marrë 10% e 20% tall, nuk është 20%, në pyetje është 100%, është duke u shkatërruar krejt projekti, janë duke shkuar krejt dëm të hollat se dikush i ka vjedhur 10 ose 20% edhe po duhet krejt për së pari për t' i ndërtuar rrugët. Paramendoni çfarë dëmi është duke iu bërë vendit, çfarë dëmi është duke iu bërë shtetit të ri të Kosovës. Dhe, po ju lus, mendoni mirë dhe mos pranoni të bëheni pjesë e kësaj katastrofe.

Tjetra është, po dua ta përmend pak, dikush tha edhe kjo pjesa di diçka për ekonomi, s'ka nevojë të dijë hiq, zoti kryesues. Çka ka nevojë të jesh ekonomist, të dish që 12 milionë euro po shpenzohen për të blerë vetura. A duhet të jem ekonomist unë? Absolutisht jo. Kurrkush nuk ka nevojë të jetë ekonomist. Hiq nuk ka lidhje as të ketë shkuar në shkollë. 12 milionë euro blen vetura, nëse ju kujtohet juve para tri vjetëve nja 5 muaj krejt gazetatat, krejt televizionet edhe nja 20 herë Kuvendi ka debatuar për një veturë, për një veturë të një zyrtari.

Pjesë tjetër karakteristike e këtij propozimi janë 200 milionë euro të dividendit të PTK-së. 200 milionë euro janë mbledhur për 10 vjet nga pak dhe çka ndodh tash, i tërheq përnjëherë Qeveria, ka drejtë me ligj, por nuk është gjithçka aty, edhe nëse e shohim në fund të vitit të ardhshëm çka ka ndodhur me ato 200 milionë euro, besomëni, keni për të konkluduar - kurrgjë hiq, janë shkrirë si flluskë sapuni, se janë shkuar xhepave, rrugicave, sokaqeve, përderisa Qeveria krejt kohën thotë, ne duam të ndërtojmë autostrada. Pse të paktën nuk i dedikojnë për autostrada që ta dinë nëse i kemi sakatuar disa banka lokale se ua tërheqim pjesën më të madhe të kursimeve, nëse e kemi sakatuar PTK-në deri në një farë mase, themi po, po e kemi ndërtuar autostradën, nuk kemi

ndërtuar trotuare sokaqeve e maleve, shembull, edhe kjo është karakteristikë e këtij propozimi, domethënë, që i çon diku 200 milionë euro në pa kthim

Çështje tjetër është diçka që u përmend prej kolegëve më përpara, prej kolegut Rexhepi, ish- ministrit, është ndarja rajonale. Shumë shpesh na kanë thënë - mos bëni ndarje rajonale, po ndarja rajonale po ndodh, lexoni buxhetin. Kjo që po bëjmë ne sot kur po themi mos bëni ndarje rajonale, po e ngrisim zërin për të mos e sakatuar Kosovën, mos ta ndajmë Kosovën. A po kujtoni ju që nuk e dinë qytetarët e Gjakovës, të Deçanit, të Podujevës e të vendeve të tjera çka është duke ndodhur? Ata e dinë çka ka ndodhur, edhe ndarja po ndodh, ne po e provojmë që ta ndalim, kur po flasim këtu, po provojmë t'u themi mos bëni kështu, mos e pranoni këtë logjikë se kjo logjikë e kthen Kosovën në vitin 1950 edhe më përpara. Kjo logjikë e prishë Kosovën dhe prapëseprapë njerëzit heshtin, e mbyllin gojën, këqyrin seri, i hapin sytë si peshk edhe vetëm votojnë. Po ju lutna, mos bëni kështu.

KRYESUESI: Regjia, ia vazhdoni edhe pak, si shef i Grupit.

ARDIAN GJINI: Çështja tjetër, është shpenzuar shumë kohë, pra krejt energjia trunore që është shpenzuar në këtë dokument, është shpenzuar për t'i kamufluar keqpërdorimet. Ministri dëshiron për të blerë 70 mijë euro veturë, krejt në rregull, po nuk e di çfarë veture? Shembull, ta marrim, ministri i Ekonomisë dhe Financave, lexoni aty, e keni, 70 mijë euro veturë, çka po di unë çfarë veture dëshiron për të blerë, por duhet të tregojë se po ju them edhe njëherë, 6 muaj kanë shkruar mediet për një veturë të një zyrtari shumë më të lartë se ministri i Ekonomisë dhe Financave.

Çështje tjetër, marrëveshja me Fondin Monetar Ndërkombëtar dhe me Bankën Botërore, mund të rrezikohet, e përmendi një koleg im përpara, mund të rrezikohet se njerëzit shohin çka po i bëjmë vetes ne, çka është duke ndodhur me mjetet tona. Nëse shkruhet, po e përmendi një karakteristikë tjetër për të njëjtën gjë, vetëm po e shoh prej një këndi tjetër, nëse thotë në projektbuxhet se 12 milionë euro për vetura janë investim kapital, është duke ju mashtruar juve, është duke mashtruar edhe popullin. Veturat nuk janë investim kapital, veturat prishen, bëjnë ndeshje për çdo ditë bëjnë ndeshje, shkojnë. Pra, nuk është investim kapital vetura, po pse po e shkruajnë që është investim kapital, vetëm për të mashtruar.

A ju kujtohet juve, Kryeministri i Kosovës kur ka thënë se kanë për t'u hequr krejt veturat, do t'i ulim shpenzimet për vetura... Veç këqyrni çka është duke ndodhur.

Me këtë unë mund t'ju them që disa karakteristika ju tregova, po e përfundoj duke e përsëritur se talli prej 10% e 20%, që e ka përmendur një koleg i nderuar këtu para dy ose tri seancave, është duke i çuar dëm krejt investimet kapitale. Pra, nuk është duke i çuar dëm vetëm ato farë mjete që i vjedhin nëpër xhepa, por krejt projektin është duke shkatërruar. Ky buxhet ju dëshmon se ato projekte ku është vjedhur, duhet ndërtuar prej së pari. Edhe vëndojani mendjen mirë kësaj pune, po ju them edhe një herë, mos u bëni pjesë e kësaj, mos e votoni, ktheni le ta ripunojnë se kjo dëshmon se Kosova ka hyrë në rrugën të cilën do të kemi nevojë për shumë energji në Qeverinë e ardhshme për ta nxjerrë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit. Fjalën e ka deputeti Driton Tali. Zoti deputet, ministri e ka kërkuar, një reagim.

MINISTRI AHMET SHALA: Unë emra s'dua të përmend për të mos provokuar reagim ndoshta, por sinqerisht është goxha vështirë për të debatuar në nivele të ndryshme profesionale të kuptimit të disa gjërave. Dhe, më vjen shumë keq që mbase imazhet e caktuara të njerëzve që janë profesionistë për disa gjëra, dëshmojnë edhe me këtë debat që nevojitet një rivlerësim ndoshta edhe publik, që nuk dua ta shfrytëzoj këtë audiencë ta bëj, por sigurisht populli e vlerëson vetë.

Për hir të të gjithave çka u thanë deri më tani, unë dua të them për rastin e veturave në Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave. Unë kam ndarë mjete 70 mijë euro për blerjen e veturave dhe atë kam insistuar dhe është shpallur konkursi, të përdorura, sepse, të lutem, nuk dua që të përdor vetura të reja të 70 mijë eurove, por unë në treg sipas informacioneve që kam, të njëjtën veturë mund ta blejë me 30 mijë euro, dhe do të blejë dhe do të jeni dëshmitarë, nëse dëshironi ejani kur të doni pasi që të përfundojë procesi i prokurimit, unë jam i sigurt që 2 – 3 vetura me ato 70 mijë euro kemi për t'i blerë. Jo s'po shkruan një javë, po, po shkruan për blerjen e veturave në Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave, e vërtetë është për Ministrinë, dhe dy, dje mu ka prishur dhe më ka lënë në rrugë bile në dash ta dish, e vjetra që e kam trashëguar. Por, desha të them edhe një çështje tjetër. Më lejoni të shpjegoj tash temën më të rëndë që u tha 12 milionë euro për vetura.

Çështja e shumë institucioneve të Kosovës, duke përfshirë edhe ambasadat, kanë nevojë për pajismëni edhe të veturave. Ju kisha lutur shumë, nuk dua tash të debatoj pa rend këtu, por nuk janë vetëm 12 milionë euro për vetura, aty ka edhe elemente të tjera të cilat kanë të bëjnë me shpenzimet që mund të krijohen për blerjen e veturave. Dhe, në qoftë se ne kemi trashëguar një park të automjeteve, unë të paktën në Ministrinë time kam parkun e automjeteve 10 vjet të vjetra dhe më shtrenjtë kushton mirëmbajtja se sa blerja e të reja. Orientimi im dhe në të ardhmen është një filozofi komplet tjetër e cila do t'i kushtojë buxhetit të Kosovës shumë më pak se sa kjo që është, dhe unë besoj për vitin 2010 do ta bëjmë këtë, sepse edhe në vitin 2007, mbase edhe në vitin 2008 mirëmbajtja e veturave ka kushtuar shumë më shtrenjtë se sa sikur të kishim gjetur një formë tjetër më moderne e që Ligji për lizingun tani që e keni miratuar ju, e lejon, dhe unë besoj që këtë do ta tejkalojmë. Nuk e di a e mbuloja këtë temë krejt, sigurisht unë mendova që ta lë për fund për të sqaruar çdo detaj, të gjitha shifrat janë në tabela të cilat faktikisht e kundërshtojnë këtë çfarë u tha publikisht me aq pompozitet. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti ministër!

Replikë Ardian Gjini, ka të drejtë të ndërlihet me diskutimin, do të thotë replikë është.

ARDIAN GJINI: Faleminderit, zoti kryesues!

Po ia nisi me një tregim. Unë thashë që nuk jam ekonomist, por nuk më vyen të jem ekonomist për ta ditur që 12 milionë euro po blihen vetura edhe nuk ka nevojë të kontestohet profesionalizmi im, se unë tregova që s'jam ekonomist, por ka definitivisht nevojë për t'u kontestuar profesionalizmi i ministrit të Financave, që thotë se është ekonomist e s'di kurrë hiq, fillimisht.

Edhe çështja e dytë është, 12 ambasada i ka. Pse po na i përziën ambasadat? 12 ambasada nga 50 mijë euro për një veturë, bëjnë 600 mijë euro, ku janë edhe 11 milionë e 400 mijë euro të tjera, zotëri ministër? Riparimi i veturave nuk ka të bëjë me blerjen e veturave, zotëri ministër, është krejt diçka tjetër, janë vija krejt të ndryshme, mos na shit dushk për gogla, trego nëse do ose mos e merr fjalën hiq. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Ibrahim Makolli, replikë lidhur me diskutimin apo çka.

IBRAHIM MAKOLLI: Faleminderit!

Jo, desha veç te ministri, është e vërtetë ne mund të mos jemi profesional sa iu përket çështjeve ekonomike, por dimë të lexojmë. Unë po e përmend vetëm këtë. Thotë, blerja e veturës, nuk thotë blerja e veturave, blerja e veturës nënkupton një, dhe thotë 70 mijë euro, tjetra është 50 mijë euro. Nënkuptohet që është një veturë dhe unë po përsëris edhe një herë, në kohën kur në tregun ndërkombëtar çmimi i veturave ka rënë për shkak të krizës globale, te ne ky çmim është rritur.

KRYESUESI: Faleminderit! Ministri do përgjigje lidhur me këtë replikë.

MINISTRI AHMET SHALA: Unë mendova që në fund t'i debatojmë secilën një nga një, por megjithatë më lejoni që t'i shpjegoj.

Ministria e Mbrojtjes përkatësisht Forca e Sigurisë së Kosovës nuk ndërtohet pa blerjen e automjeteve. Shikoje, e ke aty të lutem shumë dhe nuk dua ta..... e ke saktë, lexoje pak më saktë dhe i ke, t'i kam sjellë edhe në formatin A3 të gjitha këto gjëra, dhe lexoje mirë. Nuk është pra çështja e 12 milionë eurove vetura për ministra, por është çështja e veturave për ndërtimin e shtetit dhe të dikastereve të reja, duke përfshirë edhe atë që thashë më herët.

KRYESUESI: Faleminderit, ministër!

Vazhdojmë diskutimet, Driton Tali e ka fjalën, le të përgatitet Rita Hajzeraj.

DRITON TALI: Faleminderit, zoti kryesues!

Paraprakisht më lejoni, zoti kryesues, që t'ia japë një sqarim opinionit lidhur me dy pyetjet që i bëra, se nuk mu dha rasti, u sulmova se kam bërë tjetër pyetje, që nuk është e vërtetë. Pyetja ime origjinale ka qenë, ministres së Energjisë dhe Minierave se sa megavat janë importuar vitin e kaluar dhe me çfarë çmimi mesatar dhe mundësisht na tregoni se sa milionë euro janë shpenzuar vjet për import të rrymës? Domethënë, në mënyrë konkrete kam pyetur, nuk kam pyetur se sa ka qenë rritja e importit, eksportit në tremujorin e parë, tremujorin e dytë, po thjeshtë sa ka qenë çmimi dhe kam dhënë krahasime të çmimit, domethënë ku shihet se KESH-i blen rrymë shumë më lirë prej të njëjtit furnizues se sa KEK-u. Domethënë, tash mbase KEK-u ka marrë rrymë më kualitative, çka di unë.... e KESH-i ka marrë rrymë Fiçë. Kjo është shumë me rëndësi, kjo krejt është me KESH-in, jo me buxhetin, është kjo një sqarim se me buxhetin shumë para janë duke hyrë në KEK, krejt ka të bëjë me buxhetin, kurrgjë s'është jashtë buxhetit. Zoti ministër është këtu edhe le të ma shpjegojë edhe një herë punën si është bërë ofertomi i tenderit? Për aq sa di unë, kur të konkurrohet në tender, jepet oferta në mënyrë konkrete kur, çka, tek, jo masë 9 muajve të merren vesh.

Po kthehem tash te buxheti. Nëse ju kujtohet, në dhjetor të vitit 2008 kur na është sjellë buxheti, unë isha pak i ashpër me ministrin dhe disa deputetë të nderuar u quan në mënyrë protestuese dhe tash po shihet, duke pasur parasysh edhe Kornizën afatmesme të shpenzimeve, se sa të drejtë kam pasur në kuptimin e planifikimit të buxhetit, ku në secilën linjë nuk përputhen statistikën, figurat.

Nuk do t'ju lodhi shumë për shkak se veç i prekën në mënyrë të ndryshme deputetët e nderuar, por ajo që do të doja ta prekja është punësimi, ku shihet se ka rritje nga ajo që

është planifikuar dhe nga viti 2008, 35.8 milionë apo 15.76% përkundër faktit se është premtuar që të rritet efikasiteti në aparatin shtetëror, domethënë kjo vetëm se dokumenton atë se është kah bëhen punësime masive në Qeveri dhe atë me partizanë politikë, arsyetim tjetër nuk ka.

Tjetër çka desha të flas dhe shumë shkurtër, është puna e 200 milionë eurove të marra nga Posta. Sot ministri përsëri e ngatërroi rolin e Qeverisë, unë nuk di pse se lexon Ligjin për ndërmarrjet publike. Ligji për ndërmarrjet publike thotë se Qeveria e luan rolin e aksionarit, aksionari i ndërmarrjeve publike është qytetari i Kosovës, dhe këta njerëz këtu janë përfaqësues të qytetarëve të Kosovës dhe po ta kishin respektuar Ligjin për ndërmarrjet publike, Qeveria është dashur që këtë çështje ta hapë këtu, d.m.th para përfaqësuesve të aksionarit të vërtetë, para se të marrë vendimin. Shumë mirë thotë ligji, e keni ligjin, kapeni dhe lexoni të nderuar, neni 5, neni 7, 7.3, neni 8, vetëm se duhet lexuar mirë edhe mos ta lexoni kështu të kufizuar. Dhe, pasi u çel muhabeti, nuk mund të mos jap një koment të shkurtër për punën e blerjes së kerreve të vjetruara. Unë s'po e shoh të arsyeshme blerjen e veturave të vjetra, sepse edhe ashtu të vjetra i ka Ministria e Ekonomisë dhe Financave. Pse ka për të blerë kerre të vjetra që s'është kah më hyn në krye, përsëri ka për të shpenzuar para aty për mirëmbajtje dhe, siç tha vetë ministri i nderuar, mirëmbajtja është shumë më e shtrenjtë, atëherë pse të shpenzohet edhe vitet e ardhshme?

Sidoqoftë, për shkak se punën e planifikimit të buxhetit Qeveria ende nuk e ka mësuar, përkundër betimit se do të punësojë ekspertë të mirëfilltë, unë nuk mund ta përkrah, ashtu siç nuk e kam përkrahur edhe buxhetin, por po më vjen mirë që tash nga kolegët të koalicionit qeveritarë nuk po më fishkëlajnë edhe nuk po protestojnë me dalje nga seanca. Më vjen mirë që më në fund edhe ata e kanë kuptuar se kam pasur të drejtë. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet!

Fjalën e ka deputetja Rita Hajzeraj, le të përgatitet deputeti Xhevdet Neziraj.

RITA HAJZERAJ: Faleminderit, zoti kryesues!

I nderuar zëvendëskryeministër,

Të nderuar Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Sot po e shqyrtojmë rishqyrtimin e Projektbuxhetit për vitin 2009 dhe po ashtu është shqetësuese fakti se ky projektbuxhet fare nuk korrespondon me kornizën afatmesme të shpenzimeve.

Në vija kryesore deficitit buxhetor pritet të jetë 8 deri 11% të vlerës së përgjithshme. Kjo po tentohet të mbulohet me përdorimin e dividendit të PTK-së që është rreth 200 milionë euro dhe rialokime të tjera në vlerë 109 milionë euro. Është mirë që publikut t'i rikujtohet se kur është miratuar buxheti i vitit 2009 e gjithë ekonomia botërore ishte në recesion, ndërsa Qeveria e Kosovës as që e lodhte veten të merrej me pasoja të kësaj krize në Kosovë.

Po ashtu, do të ishte e dobishme që të vendoset në formë krahasuese përqindja e tyre, ndarja buxhetore sipas kategorive, investime kapitale, mallra dhe shërbime, paga dhe transfere, subvencione. Këto të dhëna të krahasohen me ndryshime të propozuara prej 309 milionë eurove. Këto para nuk janë kursime, këto para janë mjete të vjela në formë të

rregullt që Qeveria po synon t'i harxhojë thjesht pa pasur kujdes se si do ta mbushë buxhetin për vitin 2009.

Unë nuk jam ekonomiste me profesion, por gjithashtu nuk duhet filozofi e madhe që t'i shohim këto gjëra dhe janë mjaftë shqetësuese edhe për popullin dhe për qytetarët e Kosovës.

Dhe, dua të ndalem te të hyrat nga kufiri, doganat që janë të hyrat më të mëdha për buxhetin e Kosovës, ndërsa këtu parashihet minus 20 milionë euro.

Kemi kthime të cilat janë minus 20 milionë prapë, kemi të hyrat jo tatimore që është minus 85% , do të thotë kjo tregon se sa funksion ligji në Republikën e Kosovës.

Totali i shpenzimeve, e kemi plus 119 milionë euro. Zyra e Kryeministrit apo rezerva tjera që janë plus një milionë euro në kohën kur Kryeministri deklaronte që neve do t'i ulim shpenzimet, këtu janë rritur për një milion euro.

Zoti ministër,

Më intereson të dijë sa 200 milionë euro të cilat janë marrë nga PTK-ja se ku do të investohen, ta dimë specifikimin e tyre? Unë vetëm dua ta citoj një fjali të Kryeministrit i cili e ka mbajtur më 19 dhjetorë 2008, kur e kemi miratuar Projektbuxhetin e vitit 2009 i cili thotë se ky buxhet dëshmon të kundërtën nga ajo se çka kanë menduar të tjerët më herët, citoj:” Së bashku ne përgatitim një buxhet të drejtë dhe të balancuar”. Unë i drejtohem Kryeministrit dhe e pyes se si e konsideroni ju të balancuar këtë projektbuxhet të Republikës së Kosovës duke pasur parasysh edhe kritikën nga Fondi Monetar Ndërkombëtar dhe po ashtu nga Korniza afatmesme e shpenzimeve.

Pastaj citoj prapë, nga fjalimi i mbajtur më 19 dhjetor 2008 nga Kryeministri i cili thotë:” Ne të gjithë duam stabilitet, përparim dhe zhvillim ekonomik”. Prapë i drejtohem Kryeministrit dhe pyes se si do të jetë ky zhvillim ekonomik kur në vitet e ardhshme buxheti i Kosovës do të jetë në ulje dhe jo në ngritje. Nëse e shihni korespondimin e Kornizës afatmesme të shpenzimeve dhe këtë rishqyrtim tani që kemi janë në disproporcion njëra me tjetrën.

Shikoni, në vitin 2010 do të thotë ulet buxheti, ndërsa Kryeministri jep premtime se do të rritet zhvillimi ekonomik e tjera. Shikoni vitin 2011, prapë do të ulet buxhet dhe po ashtu në vitin 2012. Dhe, këto janë kritika dhe pyetje njëkohësisht që dua t'i dëgjojë edhe nga ministri i Financave, po ashtu edhe nga Kryeministri i Kosovës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, deputete!

Nëse Kryeministri do replikë. Vazhdojmë, deputeti Xhevet Neziraj, le të përgatitet deputetja Qamile Morina.

XHEVDET NEZIRAJ: Faleminderit, zoti kryesues!

I nderuar Kryeministër,

Zëvendëskryeministër,

Të nderuar deputetë,

Unë mendoj që për çështjet e buxhetit është mirë të flasin ekonomistët, por nuk ka nevojë të flasin vetëm ekonomistët, sepse mund të flasin edhe të tjerët, sepse janë tabelat, janë projektet para nesh. Dhe, fillimisht do të them që duhet të zbatohet në Parlamentin e Kosovës që debatet kur të bëhen për buxhet dhe rishikimin e buxhetit me të vërtetë të

kalojnë ndoshta edhe ditë që diskutohen dhe të qiten prioritetet çfarë i ka shoqëria kosovare.

Tash jemi edhe te një problem se tek 12 milionë të veturave që u përmendën dhe thanë që janë për Forcën e Sigurisë, për ambulanca dhe për shumëçka tjetër, këtu në këtë raport del diçka tjetër, do të thotë se automjetet për Forcën e Sigurisë duhet të jenë në buxhetin e Forcës së Sigurisë, për ambulanca duhet të jenë në Ministrinë e Shëndetësi e kështu me radhë.

Pra, unë do të ndalem në një diçka tjetër, në projektet e Ministrisë për Komuniteteve dhe Kthim, ku edhe në fillim, edhe me rishikim të buxhetit në këtë ministri vetëm të lexohen projektet shihet shumë qartë se për cilin komunitet është fjala. Dhe, lirisht secili deputet, secili ministër, Kryeministër, zëvendëskryeministri, le t'i shikojë emrat e projekteve dhe do të shohim se projektet janë dedikuar vetëm për një komunitet. Atëherë pse këto komunitete tjera paguajnë tatim, atëherë pse këto komunitete tjera jetojnë në Kosovë dhe a duhet vetëm një komunitet t'i shfrytëzojë projektet e tilla dhe të jenë top- prioritet. Unë mendoj se kjo strategji duhet një herë e përgjithmonë të ndërpritet dhe të fillohet me një strategji shumë të re të harxhimit të buxhetit. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet!

Fjalën e ka deputetja Qamile Morina, le të përgatitet deputeti Sadik Idriz.

QAMILE MORINA Faleminderit, zoti kryesues!

Kabinet qeveritar,

Deputetë të nderuar,

Ky rishikim i buxhetit që po e diskutojmë sot është shqetësues nga fakti se çdo vit fillohet me një ankim dhe me një pakënaqësi institucionale për buxhet të pamjaftueshëm për të zbatuar projektet e parapara, mirëpo gjithmonë ndodh që në fund të kemi suficit, që po ndodh edhe këtë vit. Ky suficit vlerësohet të jetë mbi 100 milionë euro, kurse Qeveria me fjalorin e saj këtë e trajton si kursime.

Ky suficit i buxhetit dëshmon mungesën e vizionit të qartë se si duhet të zbatohen projektet kapitale, mos efikasitetin qeveritar dhe nga e gjithë kjo gjithherë pëson popullata, pësojnë qytetarët që i kanë paguar këto tatime.

Përfituesit, gjegjësisht ministrinë që më së shumti përfitojnë nga ky rishikim i buxhetit janë: Ministria e Transportit dhe Postë-Telekomit, me mbi 45 milionë, Ministria e Arsimit, me mbi 8 milionë euro, Ministria e Ekonomisë dhe Financave, afro 8 milionë euro dhe Ministria e Shëndetësisë, afro 7 milionë euro.

Pas rishikimit të buxhetit unë besoj se ne të gjithë i gëzohemi rritjes së buxhetit sado pak kozmetik që është për shëndetësi, se shëndetësia ka nevojë për buxhet shumë më të lartë, mirëpo punëtorët shëndetësorë edhe pas rishikimi të këtij buxheti do të mbeten me paga denigruese të vlerës së ndihmës sociale. Andaj kërcënimet e vazhdueshme të punëtorëve shëndetësorë janë plotësisht të arsyeshme ngase asnjë premtim Qeveria nuk e mbajti karshi punëtorëve shëndetësorë.

Ne të gjithë jemi dëshmitarë se ky vit është përcjell me mungesë të madhe të barnave edhe pse kemi pasur dyfishim të buxhetit për barëra, edhe pse tenderi për barëra është dashur të realizohet në fillim të vitit ai është ende në procedurë. Kjo është papërgjegjësi e llojit të vetë. Fatkeqësisht ngritja e buxhetit për barëra nuk na inkurajon se do të kemi

me të vërtetë barna, po që se ende lejohet të veprohet në këtë mënyrë ku asnjëri nuk ka guxim t'i prishë llogaritë e dikujt tjetër dhe të gjithë bëjnë kompromise në kurriz të qytetarëve të cilët po e paguajnë këtë çmim.

Në këtë rishikim të buxhetit parashihet rritje e buxhetit edhe për investime kapitale në Ministrinë e Shëndetësisë. Duhet të pranoj se me projektet e Ministrisë së Shëndetësisë për vitin 2009 po përsëritet e kaluara. Nuk ka planifikim sipas prioriteteve, nuk ka projekte të përgatitura me plane të zbatueshmërisë, projektet po përsëriten me afate të shkurtra kohore dhe ajo më e rëndësishmja nuk ka racionalitet gjatë planifikimit. Shembuj konkret janë, zoti ministër, renovimi i njeve sanitare në QKUK, ju rikujtoj se ky renovim është kryer në vitin 2001 – 2002 me kosto prej 11 milionë marka nga Difidi dhe Ministria e Shëndetësisë, si dhe projekti i rrjetit të avullit është kryer nga Difidi, kurse renovimi i sallave të gjinekologjisë është absurditet, ngase këto salla janë rinovuar para 3 vjetëve.

Renovimi i kulmit të Klinikës Infektive i kalon të gjitha kufijtë e arsyeshmërisë, më tepër se 5 vjet investohet në te dhe nuk dihet se kur do të kryhet dhe çfarë destinimi do të ketë. Projekti i Radioterapisë dhe Onkologjisë është më se frustrues, kemi CT të cilësisë së lartë, magnet- rezonancë, dy ekceleratorë për rrezatim, që do të na kishin zili të gjithë fqinjët në rajon, po për fat të keq këto nuk funksionojnë dhe Ministria vazhdon të paguajë para të majme për rrezatimin e pacientëve jashtë vendit.

Shumica e këtyre projekteve edhe si të tilla ende nuk kanë filluar të realizohen dhe duhet të jetë brengë për të gjithë ne se prapë do të përsëritet skenari i viteve të kaluara kur në nëntor dhe dhjetor bëhen pagesat më të mëdha dhe se këto mjete të pashfrytëzuara mund të keqpërdoren.

Ajo që është shqetësuese është edhe rritja e shpenzimeve të parapara në rritjen e pagave në sektorin publik: polici, gjyqësi, institucionet tjera, si Ministria e Pushtetit Lokal dhe KQZ-së. Duke rritur pagat në periudhën parazgjedhore mund të konsiderohet që ky buxhet pas rishikimit më shumë i ngjason një buxheti parazgjedhor. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zonja deputete!

Fjalën e ka deputeti Sadik Idriz, le të përgatitet deputeti Riza Smaka.

SADIK IDRIZ: Hvala predsedavajući!

Pozdrav vladinom kabinetu,

Svim poslanicima,

Mi smo očekivali da će prva vlada nezavisnog Kosova imati više razumevanja za integrisane zajednice. Kada danas raspravljamo o rebalansu budžeta, možda je jedino Kosovo u regionu i šire da ima više sredstava i da ne smanjuje budžet rebalansom, nego ga povećava. To je isključivo zahvaljujući dividendi koja je dobijena od PTK-a od 200 miliona i jedini je razlog što se rapravlja o tome da se neke pozicije povećaju u odnosu na budžet koji je ovaj Parlament usvojio početkom godine, odnosno na kraju godine.

Kad su u pitanju kapitalne investicije za manjinske zajednice, govorim za integrisane manjinske zajednice, taj budžet je u nekim ministarstvima na nuli. Pomenuću 5 ministarstava u kojima je budžet za ostale zajednice na nuli: to su Ministarvo za lokalnu upravu, Ministarstvo za rad i socijalu, Ministarstvo za ambient, Ministarstvo za povratak i Ministarstvo za zdravstvo. U ovim ministarstvima nema ni centi za ostale zajednice, odnosno integrisane zajednice. Takođe, jedino se može u Ministarstvu za obrazovanje i

delimično u Ministarstvu za transport nači neki projekat koji je posvećen ostalim zajednicima.

Kada je u pitanju Ministarstvo za transport, više puta smo ukazivali da se pomogne završetak puta Dragaš – Restelica, koji će verovatno biti završen ove godine, kao i puta u opštini Leposavić za selo Hrvatska, gde žive Bošnjaci, to je najsevernija tačka na Kosovu i to je jedna napuštena sredina od svih kosovara, inače su to Bošnjaci koji su lojalni Kosovu, kosovskim institucijama i priznaju kosovske institucije, i pored ponuda iz Srbije, oni žele da to uradi Kosovo, ali mi nismo uradili dovoljno za njih.

Na drugoj strani, nas očekuju izbori, kako da motivišemo naše građane da izađu na ove izbore. Govorim za predstavnike manjina koji su do sad redovno izlazili na izbore i koji priznaju ovu državu, znači glasali su preko predstavnika za sve što je bilo. U nekoliko stvari smo nazadovolji po procesu decentralizacije čekamo da neki drugi prihvate, pa da mi dođemo na red.

Po pitanju infrastrukture takođe, tri ipo euro i dalje plaćamo za signal televizije koji ne dobijamo, i u takvoj situaciji pitamo se kako motivisati naše ljude da izađu na prestajuće lokalne izbore. U svakom slučaju, naša parlamentarna grupa za sad u ovom trenutku ima dilemu oko toga da li će podržati ovaj budžet. Videćemo ako se do drugog čitanja ne izvrše određene korekcije, mi ćemo tu dilemu zadržati. Hvala!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet!

Fjalën e ka deputeti Riza Smaka, le të përgatitet deputeti Vezira Emrush.

RIZA SMAKA: I nderuar zotëri kryesues!

Zotëri Kryeministër, ministra,

Deputetë të respektuar,

Do të përqendrohesha, referuar Projektligjit për ndryshimin e Ligjit nr. 105 për Buxhetin e Republikës së Kosovës, aspekt juridik.

Pa fije dyshimi do të duhej të ridefinohej, të riformulohej, se ka shumë defekte, e tash është fjala se piktura shprehet me vizatim artistik, ndërsa ligji në fjalë, se dikush thotë jo gjuha, jo. Kjo është shumë relevante, se nëse shkohet kësisoj, ashtu duhet të interpretohet, ashtu duhet të aplikohet, e natyrisht nëse nuk shkruhet mirë, atëherë vjen aplikimi i keq. Kjo është çështje esenciale.

Në procedurë me siguri do të angazhohem më konkretisht që të shtohet një paragraf, paragrafi 2, alineja e dytë, ku jepet mundësia, krijohet bazë juridike për marrjen e paradhënies së të punësuarve që udhëtojnë jashtë. Kjo është në rregull e mirë, kjo duhet të jetë, mirëpo duhet të krijohet edhe baza juridike obligative që duhet ta barazojë llogarinë ai/a jo që merr avancë për udhëtim në botën e jashtme, po e zëmë, e t'i kthejë paratë, tepricën. Ju lutem, le të shikohet atje pozicioni, ka shumë funksionarë publikë, ka shumë deputetë që marrin para nga buxheti dhe nuk i kthejnë ato që nuk janë të tyre. Të krijohet këtu një bazë, edhe afati, edhe sanksionet.

Tjetër, një koleg nuk më kujtohet parafolës, porse që u angazhua kundër ekstra profitit. Unë do të isha angazhuar, zoti ministër Shala, juve ju takon më tepër që Ministria e juaj ta bëjë një propozim, po e zëmë, procedurë për amendim, për të krijuar bazë juridike që ekstra profiti i organizatave biznesore, që kanë pozita monopoliste në treg edhe kanë ekstra profit jo në bazë të punës, por në bazë të pozitës së privilegjuar, që ajo pjesë,

kështu veprohet në të gjitha shtetet moderne, në botën kontemporare, ato para duhet medoemos në buxhet, se ato janë të popullit, ju lutem, nuk janë rezultat i punës, i djersës, i dijes, porse i pozicionit të privilegjuar edhe kjo duhet medoemos, se nuk ka këtu pro et contra.

Unë do të isha angazhuar që MEF-i t'i hartonte disa kriteriume objektive për distributimin e buxhetit, do të diskutoheshin, do të miratoheshin më në fund edhe pastaj me sisteme të automatizimit do të bëhej distributimi i buxhetit. Është fjala për komuna, se ka shumë vërejtje për komuna me madhësinë përafërsisht të njëjtë, që janë dy herë të deprivileguara apo të privileguara. Nuk është në rregull dhe këtu gjithmonë krijohet baza për shpjegim pse kjo, pse ashtu? Nëse i bëjmë bazat, kriteriumet, atëherë mund të kritikohet edhe më tutje, po do të ishte krejtësisht e pabazë.

Ju lutem, del se minoritetet kooperative duhet të disfavoredohen edhe duhet të favorizohet ai që nuk është kooperativ, që nuk e njeh rendin juridik të Kosovës, prandaj, kjo çështje duhet të rishikohet me seriozitet.

Dhe, përfundimisht, ju lutem, nuk është në rregull të privilegjojen disa kategori, ky është anëtar i Kryesisë, ka të drejtë 10 minuta. Atëherë, anëtari i Kryesisë paska të drejtë edhe 2 paga të një deputeti, po e zëmë, që nuk është në rregull. Paska para për rritjen e pagave të anëtarëve të Kryesisë, s'paska para për deputetët. Pra, çështjet duhet në kompleks edhe në kontekst kolegjal edhe korrekt të trajtohen.

Përfundimisht, do të isha angazhuar, sidomos e shfrytëzoj rastin t'i adresohem kolegut të nderuar Bajramit, që Ligji për pagat të qitet një herë më në fund në këtë Kuvend, se ka shumë laramani dhe favore edhe disfavore të paarsyeshme. Ta bëjmë një ligj dhe të veprojmë sipas ligjit. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet!  
Kryeministri e ka kërkuar fjalën.

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: Faleminderit, zoti udhëheqës i kësaj seance!  
Duke dashur që t'ju falënderoj të gjithëve për diskutimet, më lejoni që edhe unë ta jap kontributin tim në sqarimin e disa paqartësive apo pasaktësive që janë paraqitur edhe sot këtu.

Së pari, mendoj se rishikimi i buxhetit nuk dua të shndërrohet në një fillim kampanje elektorale për zgjedhjet lokale. Gjithashtu, u potencua këtu nga individë të caktuar se ka orientime të investimeve në regjione të caktuara dhe mos investim në regjione të caktuara atje.

Unë dua të theksoj se është fat që kurrë s'kam menduar as s'kam vepruar dhe filozofia ime edhe kombëtare dhe politike ka qenë e Kosovës si tërësi, unike dhe në interes të të gjithë qytetarëve të Kosovës dhe respektim i Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe assesi duke punuar me mentalitet të së kaluarës, të lagjes, të fshatit, të qytetit prej nga vijmë apo edhe me mentalitet kanunor.

Por, nuk mund të mos sqaroj, jo për të polemizuar, por për të sqaruar deputetin, kolegun Fatmir Rexhepi.

E përmenda, ndoshta është herët për ta nxehur skenën politike me fushatë se është shumë herët, shumë është herët për t'i ngarkuar njerëzit me kampanja, shumë është herët të marrim anshmëri apo që nuk duhet marrë fare në kuptimin e këtyre angazhimeve shtetërore që kemi, por dua të theksoj edhe parashitjet, natyrisht edhe pyetje me qëllimin më të mirë se angazhimet e Qeverisë së Republikës së Kosovës, të institucioneve të Kosovës kanë qenë angazhime plotësisht në përputhshmëri dhe në harmonizim me përkushtimet dhe prioritetet edhe të komunave, të gjitha komunave të Republikës së Kosovës. Prandaj, dua të theksoj pasi që zoti Rexhepi është kandidat, me gjasë, për kryetar të komunës së Gjilanit, por edhe Ahmet Isufi, në rregull kjo demokracia, prandaj po sqaroj për të dytë, nëse doni edhe për Ahmetin edhe për Fatmirin, por para së gjithash për qytetarët e Gjilanit.

Në vitin 2007, në infrastrukturë, në atë mandat kur keni qenë ju ministër deri sa jeni larguar, në infrastrukturë kur Qeverinë e ka udhëhequr partia e Ahmet Isufit, deputetit të nderuar Ahmet Isufi, vetëm në Gjilan janë investuar një milion e 800 mijë euro. Vetëm një milion e 800 mijë euro do të thotë në periudhën kur ka udhëhequr Qeverinë e Kosovës partia e Ahmet Isufit dhe kur ke qenë edhe ti ministër, zoti Rexhepi.

Në vitin 2008 janë investuar në infrastrukturë 11 milionë euro për Gjilan, ndërsa në vitin 2009 planifikojmë deri në 15 milionë euro. Po t'i përmendi tash edhe me emra edhe rrugët edhe shkollat, mos u mërzi, jo kjo punë nuk mbulohet as nuk fshihet, njerëzit i shohin.

Projektet të cilat janë financuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës, zoti Rexhepi dhe Ahmet Isufi janë: Ndërtimi i urave Blinicë – Pogradje – Livoç i Ulët, lagjja Černiku, ndërtimi dhe asfaltimi i rrugës Ponesh – Zhegovc, ndërtimi dhe asfaltimi i rrugës në lagjen Dardania 2, numër 6 dhe 7, ndërtimi dhe asfaltimi i rrugës “Hysen Tërpeza”, ndërtimi dhe asfaltimi i rrugës në fshatin Pasjak, ndërtimi dhe asfaltimi i rrugës “Kodra e Dëshmorëve”, ndërtimi dhe asfaltimi i rrugës në fshatin Malishevë, ndërtimi dhe asfaltimi i rrugës Pogradje – Stublinë – brezi kufitar, ndërtimi dhe asfaltimi i rrugës “Fadil Jakupi”, ndërtimi dhe asfaltimi i rrugës Caparë – Bukovik, ndërtimi dhe asfaltimi i rrugës, rruga qarkore Livoç i Epërm, asfaltimi i rrugës “Mustafë Koka”, asfaltimi i rrugës në fshatin Zhegër, në Bresalc, Verbicë, dhe Kmetovc, ndërtimi i rrugës “Dardania 2”, rruga 5, rruga “Naser Azemi”, asfaltimi i rrugës Cernicë – Gumnishtë, asfaltimi i rrugës “Malësia”- lagja e Banjës, te Posta kah Presheva dhe “Zija Shemsiu,” asfaltimi i rrugës te Muhaxherët e Livoçit-“ Ibrahim Temo”, asfaltimi i rrugës Llashticë – Lladovë, asfaltimi i rrugës në fshatrat: Përlepnicë, Velekincë, Kodra e Dëshmorëve, asfaltimi i rrugës Pogradje – Dobrotin- brezi kufitar, asfaltimi i rrugës në fshatrat Uglarë dhe Pogradje. Gjithashtu, po fillon rikonstruimi i rrugës regjionale Bresalc – Kishnapolë – Gadime – Vrellë, 17 kilometra.

Por, në këtë angazhim është edhe kjo periudhë kohore kur po flasim, asfaltimi i rrugëve në fshatin Lladovë, përgjegjësitë që janë marrë dhe mjete që po ndahen, asfaltimi i rrugëve në fshatin Ponesh dhe Bresalc, asfaltimi i rrugës “Hasan Remniku”, lagja numër 8, asfaltimi i rrugës qarkore “Jugu 1”, asfaltimi i rrugëve në lagjen “Arbëria.”

Duke vazhduar me investimin, i nderuari zoti Fatmir Rexhepi, Ahmet Isufi, të dytë kandidatë për Gjilan, sqarim për qytetarët e Gjilanit, investimin për ndërtimin apo rregullimin e shtratit të lumit 1.5 milionë euro, dhe duke vazhduar me projektet të cilat janë investuar po në Gjilan për ndërtimin e shkollave të reja, zgjerimin e hapësirave. Vetëm në vitin 2004, për të dytë kjo vlen edhe për Ahmet Isufin edhe për Fatmir

Rexhepin, vetëm në periudhën e vitit 2004 – 2007 është ndërtuar vetëm një aneks i shkollës, ndërsa në vitin 2008 janë ndërtuar 4 shkolla nga Qeveria e Republikës së Kosovës, e në këtë vit planifikohen edhe 3.

Po e përmend, aneksin nuk e kam gjetur askund, se diku është ndërtuar kjo është e vërtetë, për 3 vjet është ndërtuar një aneks në këtë periudhë, ndërsa në periudhën që qeverisim ne po i përmendi shkollat zoti Rexhepi, zoti Isufi.

Shkolla fillore në qytet, shkolla fillore në lagjen e qytetit, shkolla fillore në Zhegër, shkolla fillore në Bukovik. Në vitin 2009, shkolla e mesme në qytetin e bukur të Gjilanit.

**KRYESUESI:** Regjia, ia vazhdoni fjalën Kryeministrit!

**KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI:** Ndërsa, për tërë periudhën 2004 – 2007 është ndërtuar vetëm një aneks në shkolla, por për vitin 2008 dhe në këtë periudhë që jemi, janë ndërtuar katër dhe tri janë në proces ndërtimi, do të thotë shtatë shkolla.

Unë dua të theksoj se gjithë këto investime janë bërë edhe në ujësjellës, edhe në kanalizime, edhe në ambient. Gjithashtu, janë zbritur edhe taksat, ju e dini nga autoritetet komunale për biznes- blerjen e 20% që merr nuk ka ndodhur. Dua të theksoj se këmbëngulës dhe shumë luftarak në realizimin e objektivave dhe vullnetit të qytetarëve të Gjilanit dhe projekteve madhore për ndryshimin e Gjilanit ka qenë kryetari aktual, Qemajl Mustafa, të cilin e përgëzoj për punën e mrekullueshme që e ka bërë.

Ndalemi të takimet me arsimtarët dhe mësuesit.

I nderuar deputet Rexhepi, Ahmet Isufi, keni qenë të ftuar të dytë në takim. Unë i kam takuar, nuk keni ardhur i injoroni mësuesit, okej, është puna e juaj, vendimi i juaj, unë i kam takuar dhe i takoj tradicionalisht, sepse i jam mirënjohës çdo mësuesi, çdo arsimtari në Kosovë për kontributin e jashtëzakonshëm që ka dhënë për ndërtimin e shtetit të Kosovës, demokracisë, por edhe tash për kryerjen e obligimeve shtetërore.

Prandaj, ajo çka s'ka ndodhur më herët po ndodh tani. Është e vërtetë unë kisha premtuar rritjen e pagave për punëtorët e arsimit dhe ndihem tepër mirë dhe shumë i përgjegjshëm që kjo ka ndodhur dhe rritja ka ndodhur nga shtatori i vitit të kaluar në bazë të gradimit për çdo arsimtar e mësues deri në 47%. Prandaj i kam takuar edhe kësaj radhe, do t'i takoj edhe vitin e ardhshëm dhe për sa jam në politikë gjithmonë do të jem pranë tyre, me ta dhe në angazhime të plota në realizimin e objektivave të tyre që të kemi investim në edukim, si qëllim kryesor për ndërtimin e shtetit dhe demokracisë qytetare në Kosovë.

Kam premtuar rritjen e pagave për punëtorët e arsimit përsëri dhe të jeni të bindur se gjatë këtij mandati kjo do të ndodhë. Kam premtuar për të gjithë nxënësit e Kosovës, 380 mijë nxënës, do të jenë librat gratis, nga klasa e parë deri në klasën e nëntë, kjo do të ndodhë nga 1 shtatori, zoti Rexhepi dhe zoti Ahmet Isufi. Kam premtuar gjithashtu kompjuterizimin e gjitha shkollave në Kosovë, ai projekt madhor është në proces dhe të jeni të bindur se kjo do të ndodhë. Gjithashtu dua të theksoj sa i përket aspektit politik zoti Rexhepi votës tuaj pro apo kundër këtij projektbuxheti, ai është vendimi i juaj personal, sa i përket ftesës së dytë nuk është ndonjë ftesë e re nga ana juaj personalisht. Ju nuk e keni votuar personalisht as Qeverinë aktuale që funksionon kur është formuar. Gjithashtu nuk është befasi, sepse nuk e keni votuar as votimin për President të Republikës së Kosovës, dr. Fatmir Sejdiu.

Prandaj, ky ishte vetëm sqarim për ju personalisht, për deputetët dhe për qytetarët e dashur të Gjilanit. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, Kryeministër!

Fjalën për replikë e ka kërkuar deputeti Fatmir Rexhepi.

FATMIR REXHEPI: Fatkeqësisht, Kryeministri mendoj që rrëshqiti në një terren ku aspak nuk e dha asnjë arsytim, edhe këto të fundit që i tha, nuk qëndrojnë nuk janë të vërteta. Për hir të së vërtetës, domethënë, sa i përket votimit për Qeverinë dhe Presidentin, nuk ka kuptim, sa i përket manipulimit me mësues, po ashtu nuk ka kuptim, nuk është e vërtetë ftesa juaj dhe ajo çka keni thënë atje, por ajo çka folët ju, ju folët për 2007 dhe 2008 në projektet në vazhdim, ndërsa ne sot kemi pasur leximin e rishikimit të buxhetit për vitin 2009 dhe nuk e thatë asnjë fjalë.

Kjo letër, zotëri Kryeministër, është në emër të Hashim Thaçit, që kjo këtu që e kem përpara rishikimin. Ju ma keni dërguar letrën si deputet, dhe këtu shkruan 136 milionë-projekte- rehabilitim, ndërtim dhe investime, në qoftë se ajo nuk është e vërtetë ju që keni dërguar, atëherë a keni ndonjë projekt tjetër që flisni ju, keni ndonjë dokument tjetër, është çështje juaja. Unë kam folur për këtë që e keni nënshkruar ju, dhe për vitin 2009, zotëri, unë tregova pak më herët, pata dëshirë, ju ftova këtu, jo të dilni jashtë, në mënyrë që t'i dëgjoni me korrektësi ato që kemi për t'i thënë. Pra, nuk keni investime në komunën e Gjilanit, janë do fasada të vogla, 50 mijë euro ndërtim i ri, rruga që e përmend Pogradit – Sublinë është vendlindja ime, unë e di atë më mirë se ju, nuk qëndron projekti në vitin 2009, ka qenë në vitin 2008, ndërsa rruga Kishnapolë dhe tjetër, pra prej 136 milionë e sa i kemi paraparë ju zotëri, ju nuk e keni ndarë asnjë cent për drejtimet Gjilan – Ferizaj, Gjilan – Preshevë, Gjilan – Bujanoc – Gjilan – Prishtinë. Urdhëroni, që ku shkruan këtu, ju e keni qar, unë jo, zero, zero, zero, zero investime, prandaj, ju lutem, të jeni korrekt.

KRYESUESI: Regjia, ia zgjatni kohën edhe një minutë, le ta përfundojë.

FATMIR REXHEPI: Sa i përket vlerësimit tim për ftesën që i kam bërë Grupit Parlamentar dhe Partisë, unë kërkoja që Partia dhe ju, Grupi Parlamentar t'i harmonizoni politikat, të mos bëhet ndarje regjionale, nuk është në interes të vendit, nuk të takon të jesh Kryeministër vetëm i një regjioni prej nga vjen ti, por mendo për krejt Kosovës. Ky ishte sugjerimi im kolegjial dhe si deputet, kjo qëndron në këtë projekt. Përndryshe, është e drejta e çdo deputeti në këtë rast edhe e imja ishte që t'ju ftoj, do të thotë, për ta korrigjuar, për ta plotësuar, të kundërtën edhe në politikë ka marrëveshje, por ka respektim të saj, në të kundërtën secili e ka të drejtën edhe si deputet, edhe si parti të mendojë për zhvillimin e vendit më shumë se sa për ndonjë qeveri aktuale. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Kryeministri një sqarim, thotë.

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: Faleminderit, zoti Rexhepi!

Unë përsëri veç një pyetje e kam për ju personalisht. Ju çka keni bërë në periudhën 2004 – 2007 për infrastrukturë? Keni investuar në Gjilan vetëm 1.8 milionë euro. Unë kam investuar me qeverinë që udhëheq 11 milionë euro vetëm në vitin 2008 për qytetin e Gjilanit. Tash mund edhe të mos ndihesh aq mirë, por ky është realiteti, po unë jam tepër krenar që qytetarët e Gjilanit ndihen mirë me këto investime. Për vitin 2009 planifikohen të investohen dhe do të investohen deri në 15 milionë euro. Për rrugët t'i

përmenda, nuk po ti përsëris, ndërsa edhe për fshatin tuaj kisha thënë që ta vizitoni më shpesh se po ndryshon, ndërsa shumë që e përmende, unë nuk po flas vetëm për Gjilanin, po flas për 33 komuna. Sivjet thashë do të investohen 15 milionë, ndërsa ti nuk e ke parasysh fare që kemi ndarë 80 milionë dollarë për fillimin e autostradës Vërmicë – Merdare – Prizren – Prishtinë. Mirë, pra, me dollarë kemi bërë llogaritjen edhe me euro – janë 55 milionë euro, rreth 80 milionë dollarë, nëse gabojmë për një apo dy. Por, dua të theksoj se kjo autostradë nuk është mashtrim, kjo ëndërr e qytetarëve të Kosovës të jesh i bindur dhe je i ftuar qysh sot të marrësh pjesë në ceremoninë e fillimit të punimeve që do të ndodhin shpejt. Ajo është rruga e qytetarëve të Kosovës, është rruga e Kosovës, është rruga e perspektivës, e zhvillimit dhe e integritetit edhe kombëtar, edhe...

Në anën tjetër, ju e dini se janë ndarë mjete për vazhdimin e autostradës në drejtim të Pejës, Fushë Kosovë – Aeroport deri në fshatin Gjurgjicë, nëse nuk e di ku shtrihet Gjurgjica, është afër Orllatit e Orllati është afër Komoranit, në drejtim të Pejës.

Ndërsa, gjithashtu janë ndarë mjete për vazhdimin e autostradës Prishtinë – Milloshevë, në drejtim të Vushtrrisë, në drejtim të Mitrovicës dhe po përfundon dizajni për autostradën në drejtim të Ferizajt, Kaçanikut dhe Shkupit.

Prandaj, ju kisha ftuar që shifrat, faktet, realitetet t'i lexoni me vëmendje dhe të mos i japim konotacion fushatës elektorale. Ulu, llogaritni investimet në kohën tuaj dhe llogaritni investimet në kohën e qeverisjes aktuale, edhe për vitin 2008, edhe për vitin 2009 dhe rritje kanë ndodhur jo vetëm për Gjilanin, por në të gjitha komunat. Faleminderit !

**KRYESUESI:** Faleminderit, zoti Kryeministër!

Vazhdojmë me diskutuesin e radhës Vezira Emrush, le të përgatitet deputeti Zylfi Merxha.

**VEZIRA EMRUSH:** Hvala lepa na datu reč!

Pažljivo sam slušala sve svoje kolege poslanike koje istovremeno pozdravljam,

Pozdravljam Kabinet vlade i Predsedništvo,

Danas na dnevnom redu znamo dobro da imamo Izveštaj rebalansa budžeta za 2009. godinu, koji se donosi na osnovu usvojenog budžeta za 2009. 2010. i 2011. godinu, u paketu znači od 2008 do 2011. godine.

Ovaj rebalans je bio jako potreban današnjoj situaciji i samom Kosovu, međutim takav kakav smo ga dobili o ovom obliku, mogu da kažem da treba na početku da se vrati. Zašto ovo kažem? Meni je drago da sama sama ekonomista i da prvo nije pisan ekonomskom azbukom. Bilans nema prvo usvojeni bilans za 2009. godinu, budžet, ima rebalas. Mi kao poslanici ako hoćemo da analiziramo i da posmatramo neku stavku, nemamo prateće kolone, to je jedno. I to je jako važno, to je Zakon o knjigovodstvu.

Jako mi je žao da u ovom rebalansu, što je normalno, nismo očekivali, svaki rebalans se radi radi uštede. A ovaj rebalans se radi radi potrošnje, znači nema osnovni cilj rebalansa. Znamo da u regiji kriza, znamo da Kosovo nije zahvatila ta kriza iz jednog razloga zato što je naša ekonomska valuta plaćanja euro, a u regiji svako ima svoju monetu i plaća razliku za eruo i za dolar. Evo, to je jedina tačka zašto mi nismo pogođeni ekonomskom krizom u regiji, te ne smemo ni da se pravdamo na ime ove ekonomske kriza kada je u pitanju rebalans budžeta.

Ne mësojmë sot se pothuajse të gjithë në Kosovë janë të kënaqur me rebalansin e buxhetit. Ja tani do të japim një shprehje të përgjithshme të kësaj kënaqësie. Ja tani do të japim një shprehje të përgjithshme të kësaj kënaqësie. Ja tani do të japim një shprehje të përgjithshme të kësaj kënaqësie.

Më duket se është e vështirë të flasim për rebalansin e buxhetit, por unë do të përpiqem të flasim për rebalansin e buxhetit.

Një nga aspektet e rëndësishme të rebalansit të buxhetit është fakti se rebalansi i buxhetit ka qenë një sukses i madh. Ja tani do të japim një shprehje të përgjithshme të kësaj kënaqësie. Ja tani do të japim një shprehje të përgjithshme të kësaj kënaqësie. Ja tani do të japim një shprehje të përgjithshme të kësaj kënaqësie.

Edhe pse rebalansi i buxhetit ka qenë një sukses i madh, unë do të përpiqem të flasim për rebalansin e buxhetit. Ja tani do të japim një shprehje të përgjithshme të kësaj kënaqësie. Ja tani do të japim një shprehje të përgjithshme të kësaj kënaqësie. Ja tani do të japim një shprehje të përgjithshme të kësaj kënaqësie.

Jakaj është një nga aspektet e rëndësishme të rebalansit të buxhetit. Ja tani do të japim një shprehje të përgjithshme të kësaj kënaqësie. Ja tani do të japim një shprehje të përgjithshme të kësaj kënaqësie. Ja tani do të japim një shprehje të përgjithshme të kësaj kënaqësie.

KRYESUESI: Faleminderit, zonja deputete!  
Fjalën e ka deputetja Njomza Emiri, le të përgatitet deputetja Drita Maliqi.  
Më fal se këtu e kam shikuar pjesën poshtë, më fal zoti Merxha shumë, fjalën e keni ju, pastaj Njomza Emiri.

ZYLFI MERXHA: Zonja e zotërinj deputetë,  
Si plak i këtij Parlamenti rrallë po dal, po keni për të dëgjuar diçka, po më vjen keq që shumë pak vetë jemi, mirëpo këta çka jemi përditë jemi, ata që ikin, gjithmonë qashtu ikin.

Sot është fjala për një send shumë të madh, për buxhetin financiar për vitin 2009, të cilin e ka përgatitur ministri i Ekonomisë dhe Financave me kolegët e vet dhe sikur çdo zbrazësi që ka, edhe këtë herë ka një zbrazësi aty, që po jep vullnetin të flasim gjithçka... Kur po duhet të flasim, krejt jemi ekonomistë, e nëse ju kërkohet diçka si ekonomistë, thoni nuk jam ekonomist, kur po duhen juristë, krejt po bëhemi juristë. Unë nuk jam as jurist, as ekonomist, por do të flas si një politikan plak, e mos harroni se jemi të gjithë diplomatë këtu, krejt i kemi pasaportat. Faleminderit!

Unë do të flas kështu. Ka disa zbrazëtira të cilat kemi ende kohë t'i përmbushim, sigurisht ministri krejt i merr ato shënime, po mos ta rritim punën ta bëjmë kiamet, se nuk është kiameti, shiko sa nxehtë është jashtë. Unë kisha të them këtë, edhe pse

kurrkund s'jemi përmendur, më vjen keq ne pakicat, si romë. Unë jam një këtu, por jam për hasret, e ju jeni 120, prapë s'po ma dini Kisha për t'ju thënë këtë, duhet që Ministria t'i parashikojë edhe pakicat, që këtu e kemi një zyrë "7+", 4 x 3, shtatë vetë jemi aty. Kur na vjen një mysafir, Haxhi Merxha duhet të ngrihet në këmbë për të dëgjuar ai çka po kërkon të na pyes, e gjithmonë po vijnë te ne, se ne jemi pakicat, po dëgjojnë gjithëka kishe prej neve, e ne kurr gjë s'po u kallëzojmë atyre, krejt mirë po u flasim.

Zyra jonë ka dy kompjuterë, asnjëri s'punon. Kishte thënë ajo sekretarësja jonë t'i ndreqin, s'po bëjnë, kishin thënë t'i blejmë me paratë tona. Tash ne deputetë duhet t' i qesim paratë për të blerë kompjuterë dhe do ta bëjmë atë, se pa të s'bën, pa alet nuk lëvdohesh. Mirëpo, duhet që Parlamenti i Kosovës vërtet të interesohet pak edhe për këto zyra, pse s'i kemi ne, e dikush në një zyre 5 x 5, 6 x 6- dy vetë, tre vetë, e ne shtatë veta rrimë në aty zyrë, e tjera, e tjera sende që s'i kemi, ose një deputet që duhet ta ketë zyrën e vet, edhe atë s'e kemi.

Ne kësaj radhe çka dëgjuam, shumë sende ka mbërri zotëri ministër për t'i rregulluar edhe shumë para janë dhënë, edhe shumë para kemi. Pse i kanë harxhua, kurrkund s'i kanë gjuajtur, por kanë harxhuar, kanë blerë diçka, kanë ndrequr diçka, kanë bërë diçka. Mirëpo, ne po na duket nuk është në rregull, kurse është në rregull, pra për ato që s' janë në rregull, kemi prapë kohë nesër, pasnesër që ta përmbushim me këto fjalë që kanë thënë këtu si ekonomistë dhe do si juristë, që më mirë e dinë ligjin, i kanë treguar, sigurisht ministri do ta ketë atë parasysh.

Unë kisha thënë, prej tashti të mos na harrojnë ne pakicave këtu, se vërtet kurrkund nuk jemi dhe s'po lypim, se na kemi qëlluar vërtet njerëz të urtë, s'po bëjmë potere, s'po kapemi, s'po përllahemi, çka po na thoni - amin po bëjmë, e kësaj here edhe ne po lypim. Është për lavdi që vërtet Ministrisë së Punëve të Brendshme pak ua kishte rritur diçka atyre, por asnjë filin rroga e policëve që janë më të shkelur, nuk është rritur. Atyre duhet t'u rriten pagat, se ata s'e kanë ...

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet Merxha!  
Fjalën e ka deputeti Njomza Emini, le të përgatitet Drita Maliqi.

NJOMZA EMINI: I nderuar kryesues,  
Kabinet qeveritar,  
Edhe njëherë po shpreh shqetësimin tim personal që çdo dokument kur po shqyrtohet, që është i rëndësishëm për neve deputetët, pa dyshim, por edhe për qytetarët e Kosovës, nuk janë prezentë Kryeministri, zëvendëskryeministri dhe komplet Kabineti qeveritar, sepse buxheti nuk është vetëm për qytetarë, por këta janë të involvuar drejtpërdrejt nëpër linjat e tyre kryesore.

U thanë shumë vërejtje dhe unë deri tash çka dëgjova, duke ditur që kam hyrë për herë të parë në politikë, po them, dhe kam shpresuar që prej disave që kanë përvojë, do të mësoj diçka me gjuhën parlamentare apo edhe me eksperiencën. Unë po shoh këtu që, sinjerisht po them, përjashtim disave që bëjnë fushata dhe nuk e dallojnë Kuvendin, nuk e dallojnë prej asaj gjatë fushatës.

Po them që ky dokument ka pasur një rëndësi të veçantë dhe do të duhej ta marrim më seriozisht sa i përket këtij dokumenti, për shqyrtimin e buxhetit. Dhe, u në do të ndalem vetëm tek Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve. Është rritur një shumë, do të thotë, jo ku me ditë sa, sepse nuk po i përmend shifrat, aq sa u thanë këtu, që s'jemi

ekonomistë, mirëpo të paktën ne përballemi dhe e dimë, nuk ka nevojë të jemi ekonomistë, nuk ka nevojë as të jemi, por jemi në politikë dhe po i vërejmë këto mangësi.

Unë shpreh shqetësimin, po ashtu, edhe për rininë. Është bërë kjo fjalë, çdo politikan dhe çdo kush prej nesh, do të thotë, qeveritë paraprake që çdo herë e përmendin rininë vetëm si armatë që po investojmë, po bëjmë, mirëpo këtu çka i pashë në departamentet që është bërë dhe në fushat dhe projektet, nuk pash diçka konkrete që janë investuar tek ato. Është investuar, mirëpo le të specifikohen, që thuhet- mbrojtja e integritetit të të rinjve dhe ato që do të duhej.

Unë kam vërejtur edhe tek leximi që e kam bërë në dokument, që ka pasur investime që ndoshta nuk është dashur të merremi shumë me ato mëditje apo edhe për çështje teknike, se sa tek ato përmbajtjesore, se çka i nevojitet qytetarit të Kosovës. Kosova është anëtarësuar në Fondin Monetar Ndërkombëtar dhe në Bankën Botërore dhe unë jam skeptike se a janë marrë parasysh rekomandimet të cilat ia kanë adresuar Qeverisë. Edhe ato mjete që po i kemi, sipas Auditorit Gjeneral është parë edhe keqmenaxhimi i disa ministrive që janë, posaçërisht edhe tek Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sporteve. Është dashur edhe për neve, që të dimë, sepse vetëm kemi parë shifra dhe asgjë më shumë, se te kjo është diçka transparente dhe ne duhet ta dimë patjetër, por edhe çdo qytetar duhet ta dijë se ku po shkon paraja publike.

Unë nuk po e zgjasë më shumë, sepse aq shumë ka për t'u thënë, sa mendoj që edhe kjo që po e them unë dhe njerëzit që do të duhej të ishin këtu dhe t'i kenë parasysh, jam skeptike që do të ndryshohen.

Po ashtu, edhe Ministria, që erdhi edhe ministri i Ekonomisë, mendoj që ky dokument që na ka ardhur neve, na ka ardhur me aq shifra sa ne është dashur, unë personalisht është dashur 2 – 3 herë të afrohem afër, pavarësisht që i kam edhe syzat dhe është dashur ta shikoj mirë. Imagjinoni se sa ka qenë i vlefshëm ky dokument dhe kjo nuk e di a është bërë për çështje teknike apo për shkak të ruajtjes së parasë, por vihet një orë e gjysmë, do të thotë i bëjnë përsëri dhe ajo sa ka qenë e mjaftueshme për neve t'i dimë edhe t'i shprehim. Unë rekomandoj që mos të votohet. Unë nuk do ta votoj këtë projektbuxhet, me këto dobësi që janë dhe rekomandoj që të mos votohet, por të gjitha këto që i thamë ne t'i kemi parasysh dhe kur të vije në seancën tjetër, le të plotësohet dhe të dihet secili cent ku do të shkojë. Rekomandoj, po ashtu, dhe kam pritur që kjo qeveri do të investojë më shumë te rinia. Ne i shohim të rinjtë nëpër kafene, shohim që nuk është investuar nëpër qendra kreative që do të duhej të investohen tek ato, e jo t'i marrim, që është përmendur edhe te makinat, okej, le të merren edhe makinat, mirëpo le të merren me një shumë që ato t'i kenë sa për nevojat e tyre elementare dhe jo të shkojnë në mëditje, as ne nuk e dimë se ku kanë shkuar realisht, se s'i kemi edhe të qarta. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit, deputete!

Fjalën e ka deputetja Drita Maliqi, le të përgatitet deputeti Mark Krasniqi.

**DRITA MALIQI:** Faleminderit, zoti kryesues!

Përsëritje për të gjithë,

Ky material i ofruar që po e diskutojmë sot gjatë kësaj seance nga Qeveria, a mund të themi se është politikisht i drejtë i investimeve të ndara në tërë territorin e Republikës së Kosovës? Thellësisht jam e shqetësuar pse e keni ndarë në mënyrë rajonale prej nga vjen Kryeministri dhe ministrat e tij. Unë nuk pajtohem me këtë politikë të ndarjes së këtij buxheti. Kërkoj të shqyrtohet mundësia e përmirësimit dhe e ndarjes së mjeteve në

mënyrë lineare për gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës, sidomos te investimet kapitale dhe të precizohen qartë. Pra, formën e tillë të Projektligjit për rishikimin e buxhetit nuk e përkrah dhe kërkoj urgjentisht të korrigjohet.

Ndërsa, desha ta vazhdoj diskutimin tim, por Kryeministri nuk është këtu, sepse sa i përket komunës së Gjilanit, u cekën shumë projekte, domethënë, të realizuar brenda këtij viti, mirëpo vlen të theksoj se projektet e realizuara lirisht mund të them se kanë vazhduar apo kanë qenë në kontinuitet të vitit 2007, kështu që besoj që gjithë qytetarët e komunës së Gjilanit e dinë se kush ka qeverisur në vitin 2007 në Gjilan, kështu që qeveria aktuale vjen prenë shirita dhe ka filluar ka kohë fushatën në Gjilan. Kështu që, më falni, ju përshëndes!

KRYESUESI: Faleminderit, zonja deputete!

Fjalën e ka kërkuar për një sqarim ministri i Ekonomisë dhe Financave, zoti Ahmet Shala.

MINISTRI AHMET SHALA: Të nderuar deputetë,

I nderuar kryesues, faleminderit për dhënien e fjalës. Unë, në fakt, me qëllim që të saktësoj saktë disa nga komentet paushalle që u dhanë këtu, sidomos për çështjen e autoveturave, desha ta nxjerrë me laps gjatë punës time këtu për secilën ministri një nga një dhe po ashtu ndërkohë kam angazhuar ekipin tim që të më sjellë për secilën ministri në detaje, pjesën e automjeteve të ashtuquajtura automjete dhe më lejoni për informimin tuaj dhe të publikut t'i them në detaje disa gjëra.

Në Kodin -Blerja e automjeteve, nuk hyn vetëm automjeti ,siç u tha këtu, i një ministri apo diçka. Vetëm katër ministra kanë kërkuar dhe, mbase shumica prej tyre me arsyeshmëri, blerjen e veturave për nevojat e veta, por në këtë kod janë përfshirë edhe blerja, për shembull, e kamionëve për Ministrinë e Sigurisë ose Ministrinë e Forcës, Forcën e Sigurisë së Kosovës, automjet kamionë 3.5 PE, automjet jo taktik, 5 piruna, 20 tonë kamionë, autobus e tjera e tjera, kështu mos të hyj t'i numëroj, janë 1.960.000 euro vetë pajisje për Forcën e Sigurisë së Kosovës.

Janë standardizimi i flotës, për shembull, për automjetet e BMC-së për Zyrën e koordinatorit të TMK-së, automjetet transportues për kancerin e gjirit që janë në Ministrinë e Shëndetësisë, janë automjetet për Presidencën, për shembull, janë automjetet për Kuvendin e Kosovës, këtu keni kërkuar edhe minibus dhe të tjera dhe konsideroj që shumica prej tyre janë të nevojshme, sidomos në flotën e Forcës së Sigurisë, përveç nevojave të Policisë, që janë automjete të blinduara dhe të nevojshme për policinë. Por, shumica e institucioneve që kanë qenë nën UNMIK-un një vjet më parë, disa kanë transferuar, tani TMK-ja në qershor ka transferuar, ka nevojë për mjete të reja. Të tërat këto nuk kalojnë shumën prej 10 milionë eurove në planifikimin e rregullt, nuk ka mjete të reja ndarëse, përveç ndonjë rasti të veçantë tani me rishikim të buxhetit.

Pra, shifrat e nxjerra që unë i kam këtu, mund t'i shikoni në çdo kohë dhe për secilën ministri i kam nxjerrë dhe më vjen keq që u keqpërdor ky podium këtu nga disa deputetë të respektuar në mënyrë bombastike për të thënë se 12 milionë euro janë për kerre. Nuk janë 12 milionë euro për kerre, janë për pajisje të Forcës së Sigurisë, të ambasadave, natyrisht, të spitaleve, të TMK-së dhe të shumë institucioneve të rëndësishme, të zjarrfikësve e të tjerë që janë një nga një të cilat unë kërkoja nga stafi im që t'mi nxjerrë dhe të gjitha janë të listuara këtu. Këtë desha ta them, ndjeja obligim më shumë ndaj

qytetarëve dhe atyre që vërtet dëshirojnë të dëgjojnë zërin e arsyes dhe të vërtetës dhe jo propagandave të pa argumentuara këtu që u përdorën këtu në këtë podium. Faleminderit!

KRYESUESI: Shkojmë më tutje, konsideroj se çështja e makinave është e konsumuar mjaft sot. Vazhdojmë, fjalën e ka deputeti Mark Krasniqi. Zoti Kryeministër, nëse aktualizon tani, edhe të tjerëve u jap fjalën.

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: Përsëri edhe një sqarim. Mjetet që janë, që u përmendin gjëja të veturave, nuk janë vetura për zyrtarët e Qeverisë dhe çdo makinë që pretendon se është përfshirë për zyrtarët e Qeverisë së Republikës së Kosovës, nuk qëndron. Prandaj, mjetet që ndahen për ambasada, ne jemi shtet dhe do të investojmë. Mjetet që ndahen për ushtri, ne jemi duke formuar- ushtrinë FSK-n, do të ndahen mjete. I përmendi shumë mirë është, është mirë që ke mundësi, kemi kursyer, po investojmë, po ndërtojmë ushtri moderne. Mjetet për zjarrfikës ato duhet të blihen, edhe për ambasadën nevojiten makina ju e dini shumë mirë si funksionojnë.

Prandaj, mjetet të cilat u pretendua t'i vishen Qeverisë nuk qëndrojnë, këto mjete janë të ndara për institucionet që i përmendi ministri i Ekonomisë dhe Financave, përndryshe mund t'i lexojmë një nga një për të gjitha, për kamionë, për zjarrfikës, për çështje tjera që janë të specifikuar, por çdo makinë që pretendohet t'i hidhet si kërkesë e zyrtarëve të Qeverisë së Republikës së Kosovës nuk qëndron.

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Kryeministër!

Ardian, emrin nuk ua ka përmendur. Shiko, është konsumuar kjo, është tejkaluar kjo pjesë. Mirë, e ke fjalën për një replikë, 2 minuta, sa është e paraparë.

ARDIAN GJINI: Prapë sikur herën e kaluar, nuk po flasim kurrgjë në ajër, 70 mijë euro thotë veturë për ministrin e Financave, 70 mijë euro thotë për ministrin e Kulturës, që mos të shkoj edhe unë mbasandaj. Krejt çka përmendi ministri i Financave po t' i mbledhim, unë kam bërë elektro, di të mbledh, zotëri ministër, kam dhënë matematika, mos u befaso, janë diku 3 milionë euro, me 2 milionë euro të Ministrisë së FSK-së, nëse janë aty, e që nuk janë në fakt. Domethënë, 2 milionë euro plus një gjysmë milioni Ministria e Punëve të Jashtme, plus krejt të tjera çka i përmende, krejt bëjnë 3 milionë. Ku po të mbesin edhe 9 milionë, ministër, tregona nëse doni t'i lexoni, lexoni krejt listën edhe po i mbledhim atëherë.

KRYESUESI: Faleminderit! E ka fjalën Kryeministri.

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: Unë përsëri, pasi që po shoh që s'po kupton, ose po dëshiron ta keq informojë opinionin publikë, për hir të sqarimit të opinionit publik, asnjë makinë nuk është e predispozuar për asnjë ministër dhe zyrtar të Qeverisë së Republikës së Kosovës. Nëse ju dilni kundër që të blihen automjete moderne për ushtrinë e Kosovës, atëherë vota e juaj le të jetë kundër edhe vazhdojmë.

KRYESUESI: Faleminderit!

Fjalën e ka kërkuar edhe ministri i Forcës së Sigurisë, zoti Fehmi Mujota.

MINISTRI FEHMI MUJOTA: Faleminderit, zoti kryesues!

I nderuar Kryeministër,  
Të nderuar kolegë ministra,  
Të nderuar deputetë,

Vërtet, për një moment unë kisha një konfuzion, nuk bëhet fjalë për vetura në formë çfarë fliste Ardian Gjini apo bëhet fjalë për automjetet për të cilat tash ka argumente të plota? Dhe, unë do t'i them taksativisht se çka përmban Plani i punës së Ministrisë së Forcës së Sigurisë për blerje dhe unë besoj se ju në një moment tjetër do ta miratoni edhe dyfish këtë shumë, madje- madje s'do të bënim asnjë fjalë në këtë Parlament, do t'i përcillni disa rrugë të tjera për të pajisur forcën në mënyrë moderne.

Prandaj, po numëroj vetëm disa prej tyre që bëjnë shumë e paraparë, atë që e prezantoi ministri i Financave.

Kemi, ju lutem, kamion 3.5 tonë, automjete jo taktike, ka kamionë të tjerë që bëjnë bartjen me bazament të ulët, vlerat e tyre janë 170 mijë, 280 mijë, 130 mijë është kamion me bazament të ulët, autobus, minibus, për bartjen e pjesëtarëve të Forcës së Sigurisë, janë 280 mijë euro, kamionë për zjarrfikës janë 320 mijë euro, ka cisterna që kushtojnë 70 mijë euro, bartës, përkatësisht largues të kontejnerëve nga rruga për emergjencë 200 mijë euro, pastaj kamionë mobil 6 x 6 - 150 mijë euro, autoambulancë për nevojat emergjente të Forcës së Sigurisë në vlerë prej 80 mijë euro, buldozerë në vlerë prej 100 mijë euro, vinç në vlerë prej 100 mijë euro, ekskavatorë në vlerë prej 200 mijë euro, dhe plus tani kemi edhe projekte tjera, kushte të standardizuara dhe të tjera. Po, këtu po përfundoj, këtu kemi një milion e 900 mijë euro blerje për Forcën e Sigurisë. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti ministër!

Vazhdojmë, jo, jo Ardian! Vazhdojmë, do të thotë, fjalën e ka deputeti Mark Krasniqi.

MARK KRASNIQI: Faleminderit!

I nderuar kryesues,

Zoti Kryeministër, zëvendëskryeministër dhe ministra,

Të nderuar deputetë,

Kur është planifikuar Buxheti i vitit 2009, për ndërtim kapitalë nuk kemi pasur mundësi financiare që të ndahet një shumë më e madhe se 50 milionë për ndërtimin e autostradës Durrës – Prishtinë. Tash, ditëve të fundit, situata ka ndryshuar për të mirën tonë, me inkuadrimin e Republikës së Kosovës në Bankën Botërore dhe në Fondin Monetar Ndërkombëtar, ku mund të merren kreditë me kushte më të volitshme.

Megjithatë, po thuhet se buldozerët dhe makineria tjetër e nevojshme do t'ia fillojnë punën në ndërtimin e kësaj autostrade deri më 1 nëntor të këtij viti. Afati 1 nëntor është kohë kur makineria dhe buldozerët duhet të strehohen dalëngadalë në garazhe e të pushojnë deri në prill afërsisht, kështu që nuk do të punohet disa muaj asnjë metër, që themi.

Kjo autostradë duhet të jetë në planin e parë të ndërtimeve kapitale dhe të fillojë ndërtimi i saj sa më parë. Kosovarët, të cilët ia dinë rëndësinë ekonomike, politike dhe veçanërisht rëndësinë kombëtare kësaj autostrade, mendojnë që duhet lënë ndërtimet e çdo rrugës tjetër, të sigurohen mjetet e nevojshme nga institucionet ndërkombëtare financiare e të fillojë puna sa më parë. Madje, në popull kam dëgjuar edhe vetë, thuhet se në qoftë se nuk ka mundësi tjetër, atëherë mundësia duhet të gjendet duke shitur arin e nuseve kosovare për fondin e autostradës Durrës – Prishtinë, të këtij korridori kombëtar me rëndësi historike.

Me fillimin e punimeve në këtë objekt të madh, krijohet mundësia për punësimin e një numri të konsiderueshëm të kosovarëve të papunë. Përveç kësaj, krijohet mundësia që sa më parë të shfrytëzohet mundësia shumë e madhe për shfrytëzimin ekonomik dhe turistik, ndoshta, të portit të Shëngjinit, të cilin Kryeministri i Shqipërisë, Sali Berisha, ia ka dhënë në dispozicion Republikës së Kosovës.

T'i lëmë rrugët e rrugicat e katundeve, të shkojmë edhe 2 – 3 vjet nëpër baltën nëpër të cilën kemi shkuar me shekuj dhe ta ndërtojmë këtë rrugë me rëndësi historike, ekonomike, kombëtare edhe ndërkombëtare. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, deputet!  
Një sqarim, Kryeministri.

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: Jo, jo nuk është replikë, sqarim është.  
Edhe njëherë e theksoj, u tentua të atribuohen si shpenzime të Qeverisë së Republikës së Kosovës për vetura dhe unë dua të besoj se ky pretendim për t'ia veshur Qeverisë këtë çështje, nuk qëndron dhe besoj se tash qytetarët u sqaruan, por unë dua t'ju njoftoj se bash edhe asnjë cent në këtë vit të rishikimit nuk do të shpenzohet për vetura, për ministra apo zyrtarë të Qeverisë, asnjë cent për vetura.

Ndërsa, mjetet që janë për FSK, për inteligjencë, për ambasada, për formimin e institucioneve të reja shtetërore, në atë drejtim kemi obligim kushtetues dhe do t'i kryejmë këto obligime. Prandaj, ju ftoj edhe juve të jeni më mirëkuptues dhe mbështetës në këtë drejtim, se duhet të ndërtohen institucione dhe duhet të funksionojnë. Por, e theksoj, asnjë cent në procesin e rishimit të buxhetit për ministra dhe zyrtarë të Qeverisë, edhe nëse është bërë ndonjë kërkesë, nga ky moment anulohen ato kërkesa.

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Kryeministër,  
Vazhdojmë me deputeten e radhës, Synavere Rysha, le të përgatitet deputeti Ramadan Gashi.

SYNAVERE RYSHA: Faleminderit, zoti kryesues!  
Të nderuar deputetë,  
Sot, kur po debatojmë për një projektligj mjaft të rëndësishëm siç është rishikimi i buxhetit, po vërehet se edhe kësaj radhe ky material ka arritur me mjaftë dobësi dhe të meta, siç edhe ka ndodhur në momentin kur na ka ardhur projeksioni për vitin 2009 i buxhetit.

Nga pasojat dhe si rezultat i mos përgatitjes së mirë apo një planifikimi jo të drejtë dhe jo profesional, kemi rastin ku gati 1/3 e buxhetit na ndryshon me rishikim. Unë si ekonomiste e kuptoj rishikimin si një plus apo minus që duhet të derivojë, që të ndryshojë nga projeksioni nga buxhetit për vitin 2009 diku rreth 5 deri 10%, mirëpo të ndryshojë diku në substancë materiali për 30%, mua më duket kjo më tepër se papërgjegjësi apo një përgatitje jo e mirë e këtij materiali.

Si do që të jetë, ajo që ndoshta s'u përmend nga asnjë deputet, për mua ishte shqetësuese pjesa e parë apo ajo pak pjesë e shkruar, sepse kryesisht kemi të bëjmë me tabela dhe ndoshta ka qenë pak vështirë të lexohen, por megjithatë është arritur të kuptohen gjërat, pjesa tabelare- neni 1 i projeksionit të rishikimit të buxhetit, ku kemi të bëjmë me pagesat e paradhënies. Unë mendoj se pjesa e parë dhe paradhënie deri në 15% janë të mjaftueshme për kontratat të cilat do të lidhen me kontraktorët. Mirëpo, pjesa tjetër ku

fillon, domethënë te paragrafi i fundit, neni 1, pas pranimit të kërkesës dhe arsyeshmërisë së saj me shkrim nga organizata buxhetore dhe pas miratimit të ministrit, Qeveria mund ta miratojë pagesën e paradhënies në vlerë jo më të lartë se 30%. Të nderuar, a ju duket pak 30% të vlerës së kontratës para se të fillojë puna ta paguani, mua kjo më duket më tepër se absurde. Apo ndoshta Qeveria ka menduar në atë avazin e vet që 15% të japë paradhënie, ndërsa 15% të jetë ajo kuota apo ajo pjesa që do ta marrë Kryeministri apo ministrat, sepse kjo është pjesë e korrupsionit. Prandaj, unë do të kërkoj, si deputete, që kryesisht Komisioni të fokusohet te kjo pjesë dhe 15% i dytë i cili nuk e di për çka është menduar, të hiqet dhe në asnjë mënyrë të mos figurojë në projeksionin buxhetor të vitit 2009, domethënë në këtë rishikim, sepse është e tepërt nëse një kompani do të fillojë me 3 milionë euro një projekt, një milion euro ta marrë avancë, atëherë a po themeloni një kompani të re dhe doni t'i parapërgatitni kushtet apo po mendoni për atë pjesën që ndoshta 15% t'i mbesin kompanisë si paradhënie, ndërsa 15% ta marrë ai që po e negocion. Prandaj, kjo duhet të jetë një logjikë, unë ndoshta shpresoj të jem gabim, mirëpo në qasje të një auditori, sepse kam punuar një kohë dhe e shoh këtë si rrezik.

Duke pasur parasysh se është një rrezik që mund të ndodhë në Qeverinë aktuale, është mendimi im që ky 15% i dytë absolutisht është i papranueshëm dhe nuk ka nevojë të mbetet në projeksionin buxhetor të vitit 2009. Kjo është kërkesa ime dhe mendoj se do të përkrahet edhe nga deputetët tjerë.

Sa i përket pjesës tjetër të rishikimi i buxhetit, unë do të kisha pritur një rishikim në favor të investimeve kapitale, mirëpo të zvogëlohen investimet kapitale dhe të rritet pozicioni i mallrave dhe shërbime, domethënë buxheti të shkojë me rishikim në shpenzime, kjo po më duket mua shumë e pakuptim dhe po më duket se dikujt nuk i ka mjaftuar paratë e ndara në fillim të vitit 2009, mirëpo ka kërkuar edhe në gjashtëmujor të këtë rishikim dhe të kërkojë shpenzime më tepër.

Ndërsa, zvogëlimi i pozicionit të ardhurave, të hyrat e përgjithshme të zvogëlohen, edhe kjo për mua nuk qon te një logjikë e shëndoshë. Kjo bie te logjika se në fund të vitit kur të raportohet, të kemi të hyra të parashikuara më të vogla, që në fund të lavdërohem se kemi arritur ta përmbushim planin, dinamikën 80%, 100% apo ta tejkalojmë. Mirëpo, kjo mua më jep të kuptoj se diçka nuk po ecën në planifikimin e të ardhurave, Qeveria është në krizë për grumbullimin e këtyre mjeteve, prandaj që në start, që në gjashtëmujorin e parë ka paraparë zvogëlim të hyrave dhe kjo për mua është për një periudhë kaq të shkurtër të mos kemi një dinamikë dhe të mos kemi një plan buxhetor njëvjeçar dhe të na ndryshojë me këtë përqindje kaq të madhe, për mua është e papranueshme.

Prandaj, në këtë formë unë nuk do ta përkrah. Shpresoj se ky projeksion do të korrigjohet në komisionin funksional nga kontributi i secilit deputet. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit, deputete Rysha!

Fjalën e ka deputeti Ramadan Gashi, le të përgatitet deputetja Myrvete Pantina.

**RAMADAN GASHI:** Faleminderit zoti kryesues!

I nderuari zoti Kryeministër, Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Unë nuk do të flas për Projektbuxhetin si proces, pasi që kjo është e paraparë të ndodhë si e tillë dhe mendoj se rishikimi i buxhetit bëhet për t'u ridestinuuar mjetet dhe është e drejtë e Qeverisë që të bëjë ridestinimin.

Nuk e kam ndërmend të polemizoj me kolegët e mi, por dëshiroj të them pak fjalë për Skenderaj, pasi që kam qenë kryetar i komunës tetë vjet e gjysmë atje dhe e di se i frymon Skenderaj dhe e di saktë se sa është investuar në Skenderaj, sidomos në dy legjislaturat e mëparshme, por para se të hyj në ndonjë detal, të përkujtoj se Skenderaj ka më se 1200 fëmijë jetimë, ka më se 1200 të vrarë dhe martirë civilë, ka mbi 240 dëshmorë dhe vërtet nëse bëhet ndonjë investim në Skenderaj në ndërtimin e infrastrukturës dhe të jetës në Skenderaj, duhet të ndihemi mirë, sepse ajo ndihmë shkon vërtetë te këto kategori.

Skenderaj vërtet është një komunë shumë e pazhvilluar dhe ndarja e mjeteve buxhetore vetëm për kokë banori, e cila ka ndodhur deri tash, mendoj se e ka dëmtuar Skenderaj se edhe pse ka 75 mijë banorë, Skenderaj merr vetëm për 50 mijë banorë buxhet.

Mendoj se Qeveria e Kosovës është dashur të ketë një fond të veçantë për përkrahjen e viseve të pazhvilluara, e që aty ka qenë edhe Skenderaj dhe kanë qenë edhe plot komuna tjera që do të përfitonin.

Nëse shohim projekte të cilat për Skenderaj janë duke u zhvilluar shumica tani janë rreth kompleksit memorial në Prekaz, rrugët për Prekaz – Tërnovc, Prekaz – Polac, Prekaz – Skenderaj, rrugët Vushtrri – Skenderaj, do të thotë janë projekte të karakterit kombëtar dhe të karakterit regjional, do të thotë janë thjesht detyra të Qeverisë dhe detyra të Kuvendit, sepse në vitin 2005 është hartuar një ligj i cili kompleksin përkujtimor e ka shpallur si projekt kombëtar dhe e ka dhënë si obligim të Qeverisë. por që 4 – 5 vjet atje është filluar për çdo vit ndahen një milion, 2 milionë, 3 milionë dhe nuk shpenzohen as 1/3 e këtyre parave dhe vetëm bëhet bartja, sepse vërtetë punët ngecin më të madhe.

Rruga Vushtrri – Skenderaj është filluar në vitin 2006, është rrugë regjionale, rrugë të tilla në Kosovë të atij statusi më nuk kemi të pandërruar. Do të thotë është një rrugë shumë e rëndësishme dhe për çdo vit bëhet një investim shumë i vogël dhe vetëm bëhet një zvarritje, kësaj radhe është investuar pak më shumë, por shihet se prapë nuk do të arrijë të kryhet.

Bindja ime është se, nuk kisha dëshiruar të bëj ndarje në regjione krahinore qysh jemi mësuar t'i ndajnë, por ndoshta isha thirrur pak në regjione administrative siç janë regjioni i Mitrovicës, i Prishtinës, i Pejës e ta zëmë, kam përshtypje se në regjionin e Mitrovicës është investuar më së paku. Flas për dy legjislaturat e mëhershme, kjo legjislaturë shihet se ka një investim më të madh.

Më çudit fakti sepse asnjë deputet në legjislaturat e mëhershme nuk e ka ngritur zërin për investime regjionale e të thotë pse në regjionin e Mitrovicës nuk po ka investime? Sidomos, Ministria e Komunikacionit dhe e Transportit merrni shikoni dy qeveritë e mëparshme dhe merrni investime për regjionin e Mitrovicës dhe do ta shihni se sa janë bërë investime. Hiq pak investimeve që janë bërë në kompleks në krejt regjionin nuk del se janë bërë investime me 2 milionë euro gjatë një qeverie. Kështu që konsideroj se Mitrovica si regjion ku hyjnë Skenderaj, Vushtrria kanë qenë të lënë pas dore është interesant edhe nga ndërkombëtarët. Këtë e kam ngritur edhe në nivel regjional me administratorët me të KFOR-it dhe s'e di, secili thoshte Mitrovica është e komplikuar dhe anashkalonte edhe nga investimet.

Është sheshi Adem Jashari në Prekaz në të cilin si komunë kemi investuar 500 mijë euro, kemi investuar buxhetin e dy vjetëve në atë shesh, dy vjet kam kërkuar para nëpër

Qeveri dhe asnjë cent nuk më është dhënë, kurse janë dhanë ta zëmë edhe për buste të cilat kanë kushtua 5.000 euro 10.000 euro e tjera e tjera, do të thotë nuk kemi pasur përkrahje të duhur.

Është memoriali në Morinë, është memoriali i dëshmorit të UÇK-së ku janë të skalitur emrat e të gjithë dëshmorëve të Kosovës dhe Qeveria e Kosovës prej të parës e kjo është e treta asnjë cent se ka investua në Morinë, do të thotë ka investuar vetëm komuna dhe një fondacion amerikan të cilën vërtet e shfrytëzoj rastin ta falënderoj shumë. Nuk është lehtë për t'i parë edhe zhvillimet nëpër gjithë regjionin e Kosovës dhe .....

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet!

Vazhdojmë me deputeten Myrvete Pantina, le të përgatitet Berim Ramosaj.

MYRVETE PANTINA: Faleminderit, zotëri kryesues!

Buxhetin e rishikuar për vitin 2009 e karakterizon si rritja e të hyrave totale, ashtu edhe e shpenzimeve. Në masën më të madhe rritja e të hyrave buron nga dividendi i PTK-së që janë 200 milionë euro, për të cilat mendoj se duhet menduar mirë se për çka do të shpenzohen. Pastaj, parashihet rritja e të hyrave nga kufiri, janë këto rreth 40 milionë. Me qenë se në vitin 2009 parashihet një rritje më e vogël ekonomike në krahasim me vitin 2008, mendoj se realizimi i të hyrave të tilla megjithatë paraqet një plan shumë ambicioz. Po ashtu, parashihet rritja e të hyrave vetjake për 1.5 milionë euro.

Me rishikim të buxhetit parashihet edhe rritja e shpenzimeve në krahasim me buxhetin aktual për 260 milionë euro, por edhe në krahasim me të hyrat totale të rishikuara dhe atë rreth 47 milionë euro, gjë që tregon se pritet të kemi një deficit në buxhetin e këtij viti. Rritja më e madhe e shpenzimeve do të jetë në kategorinë e shpenzimeve kapitale për 123 milionë, në subvencione dhe në transfere për 48 milionë, në mallra dhe shërbime rreth 39 milionë euro, ndërsa për paga dhe mëditje rreth 36 milionë euro, por shpenzimet nuk përfundojnë me kaq. Janë paraparë pagesa e huave për ndërmarrjet publike në shumën prej 100 milionë eurove, pagesa për anëtarësim në Fondin Monetar Ndërkombëtar dhe Bankën Botërore, me të cilat deficitin e gjithëmbarshtëm do të arrijë në 182 milionë euro. Po thirrrem në tabelën një, për arsye se këtu u përmendën se deficitin do të jetë 108 milionë, prandaj unë po bohem në të dhënat që janë pasqyruar në tabelën numër një.

Parashtrohet pyetja prej cilave burimeve do të mbulohen të gjitha këto shpenzime? Për mua nuk është edhe aq tragjike nëse paraqitet deficitin në buxhet, do të thotë do të shpenzohet më shumë, do të thotë do të kemi mirëqenie më të madhe, qoftë si shpenzime kapitale apo subvencione dhe të gjitha ato, por duhet menduar mirë se në të ardhmen prej të cilave burime ato do të mbulohen.

Po të kishin karakter të krijimit të ardhurave, shpenzimet e planifikuara ato do të arsyetonin veten. Besoj se në të ardhmen do të realizohet një ndikim i tillë.

Ekziston edhe një mundësi tjetër që përmes rritjes së të hyrave buxhetore në të ardhmen të mbulohen këto shpenzime. Këto ditë nga Administrata Tatimore e Kosovës u dëgjua se obligimet tatimore të papaguara nga ana e firmave të regjistruara në Kosovës janë rreth 260 milionë euro, andaj me grumbullimin e tyre të hyrat buxhetore do të rriten dhe natyrisht do të zvogëlohet edhe evazioni fiskal.

Dua të theksoj se në emër të shpenzimeve kapitale me rishikim të buxhetit përfitojnë edhe me rishikim, pra përsëri përfitojnë më së tepërmi ministrinë që edhe me ndarjet

buxhetore, me projeksione për vitin 2009 kishin përfituar më së tepërmi. Është kjo Ministria e Transportit me 44 milionë rritje të buxhetit dhe Ministria e Arsimit me rreth 8 milionë rritje të buxhetit. Por me rishikim të buxhetit përfitojnë edhe disa ministri tjera: Ministria e Mjedisit me rreth 3 milionë, po ashtu është edhe Ministria e Administrimit e Qeverisjes Lokale rreth 3 milionë, Ministria e Drejtësisë, mbi 2 milionë, por dua të theksoj po ashtu se në të ardhmen duhet që me ndarjet buxhetore, do të thotë të kontribuojmë edhe në zhvillimin e përafërt edhe të sektorëve tjerë.

Për mua një sektor shumë i rëndësishëm është bujqësia, me subvencione bujqësia pritet të ketë një rritje të buxhetit për 3.6 milionë. Gjithsej buxheti prej ...

**KRYESUESI:** Faleminderit, zonja deputete!

Fjalën e ka deputeti Berim Ramosaj, le të përgatitet deputeti Gani Koci.

**BERIM RAMOSAJ:** Të nderuar kolegë deputetë,

I nderuar Kryeministër,

Kabinet qeveritar,

Faleminderit, prej kryesuesit!

Shiko, para se të shpalos këto çështje të cilat vërtetë na preokupojnë në këtë rishikim buxhetor, kam një vërejtje të përgjithshme.

Së pari, në pasqyra me qenë se është fjala për rishikim buxhetor ose me rebalanc, është dashur në secilën pasqyrë të paraqitet si ka qenë i planifikuar buxheti për vitin 2009 dhe si është bërë rishikimi me qëllim që deputetët të shohin cili është dallimi në këtë rishikim, sepse rishikimi buxhetor e ka arsyeshmërinë e një rishikimi vetëm në qoftë se harmonizohen planet dhe projektet me rrjedhën eventuale. Duke marrë parasysh se planin buxhetor për vitin 2009, në krahasim me realizimet që ka ndodhur ka ndryshim jashtëzakonisht të madh, atëherë është dashur që rishikimi buxhetor të reflektojë atë ndryshim. Ajo që më vjen keq më së shumti, të gjitha ata zëra buxhetorë të shpenzimeve, veçanërisht ato të shpenzimeve kapitale që kanë suficit, respektivisht nuk kanë realizuar projektet e tyre, edhe me rishikimin buxhetor nuk ka ndryshime në kuptimin e zvogëlimit të atij gepit midis shpenzimeve të planifikuara dhe të shpenzimeve të realizuara, kurse esenca e projektit, respektivisht e rishikimit buxhetor qëndron mu në këtë, në harmonizimin midis planit buxhetor për një vit dhe realizimeve buxhetore në këtë gjashtëmujor.

Së pari, në buxhet ndihet në vazhdimësi fryma e kontiunitetit nga lëvizjet buxhetore edhe të periudhave të kaluara, domethënë nuk ka ndryshime substanciale në kuptimin as të ndryshimit të zërave të shpenzimeve, as në ndryshimin e zërave të hyrave.

Dy, nuk është buxhet zhvillimor, por është vazhdimësi e gjendjes së amullisë dhe financimit të veprimtarive shoqërore deri në nivel të ekzistencës. Kjo flet më së mirë për zërat buxhetor që janë përafërsisht të ngjashëm: në arsim, teknologji, shëndetësi dhe stimulim të zhvillimit.

Raporti midis të hyrave buxhetore tarifore dhe atyre jo tarifore është prapë i pavolitshëm si dhe raporti midis të hyrave në kufi nga doganat dhe të hyrave tjera që ishte dashur të ndodhin si të hyra që mblidhen brenda biznesit, domethënë pas kryerjes së aktiviteteve biznesore, prapë është i pafavorshëm.

Ndarjet buxhetore për investime kapitale sipas projeksionit të këtij buxheti nuk do të thotë që gjenerojnë zhvillim, andaj në qoftë se me këtë rishikim buxhetor shihet në numra se ka rritje të investimeve kapitale, nuk do të thotë që gjenerojnë të ardhura kapitale, përkundrazi kryesisht rritjet janë në Ministrinë e Transportit, rritjet janë në blerje të pajisje të makinave, respektivisht investimeve kapitale që nuk gjenerojnë të ardhura, përkundrazi rritin konsumin.

Edhe së fundi ajo çka dua të theksoj, subvencionet dhe transferet rriten nga 2008 në 2009, derisa në 2008 ishin 209 milionë tani janë të parapara 258 milionë. Prapë ka arsyeshmëri të rritjes së subvencioneve në qoftë se do të reflektonin në Ministrinë e Bujqësisë, por me sa kam parë unë nuk ka ndryshime, janë ndryshimet krejtësisht kozmetike. Ndërsa, në veprimtari tjera subvencionet e prishin konkurrencën e mirëfilltë dhe e zvogëlojnë konkurrencën e të gjitha veprimtarive ekonomike dhe joekonomike në Kosovë në krahasim me vendet e tjera.

Ajo çka është e rëndësishme së fundit të them se nuk kemi një, edhe pse rishikimi buxhetor do ta kishte arsyeshmërinë e ndryshimeve, në krahasim me suficitin e realizuar nuk ka ndryshime. Prapë ato veprimtari, ata zëra që kem pasur deri tash suficit, prapë parashihen rritje të investimeve kapitale që nuk garantojnë zvogëlimin e suficitit fare.

Këto edhe shumë vërejte që kam kisha dashur më së miri t'ia adresoj ministrit dhe kisha kërkuar të më japë përgjigje në...

#### Drejtimin e seancës e rimerr Kryetari i Kuvendit, zoti Jakup Krasniqi

KRYETARI: Faleminderit, deputet!

Gani Koci, e ka rendin për fjalë si deputet, le të përgatitet Ibrahim Selmanaj. Regjia, fjala për Gani Kocin.

GANI KOCI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Kryesuesi i mëparshëm tha se u shterua çështja e veturave në diskutim, unë prapë do të kthehem atje dhe do ta trajtoj këtë çështje, për ata që nuk e kanë kuptuar drejt dhe nuk e kanë kuptuar qartë. Në këtë rast u mundua edhe ministri, po ishte modest në deklaratimet e tij, edhe Kryeministri, por unë do të shkoj më saktë t'i them disa shifra rreth kësaj çështje dhe të verifikohet ajo se shpenzimet e tërësishme në nivelin qendror dhe atë lokal janë 11 milionë e 816 mijë euro sa u përket automjeteve, se këtu u banalizua pak, vetura. Vetura është pak më e ngushtë si kuptim, ndërsa automjeti nënkupton të gjitha llojet që ecin me katër e më shumë rrotë, jo në dy. Në dy është biçikleta dhe nuk është fjala për biçikletat këtu.

Unë do të nisem prej Autoritetit të Ujit dhe të Hedhurinave, që shuma e përgjithshme për automjete është 1 milion e 481 mijë euro, që nënkupton blerjen e kompaktorëve, ndoshta e dinë njerëzit se çka janë këta kompaktorë, dhe që blerjet e tilla janë diku afër 7 lloje të automjeteve që i kanë përafërsisht çmime këtu dhe në tërësi bëjnë 1 milion e 481 mijë euro.

Pastaj e kemi Ministrinë e Shëndetësisë për dy automjete, i përmendi edhe ministri, automjete që ka pajisje për hulumtimin e kancerit të gjirit, që ato do të udhëtojnë, do të jenë mobile, do të shkojnë ndoshta nga fshati në fshat, dhe kjo nuk do të kushton 50 mijë euro, por kushton më shumë se 50 mijë euro, si dhe autoambulancë për transfuzionin

e gjakut, gjithashtu mobile me pajisje të veta që kushton shumë dhe të gjitha këto bëjnë diku 170 mijë euro.

Pastaj, e kemi Ministrinë e Punëve të Brendshme që ka 3 milionë e 258 mijë euro për blerjen e automjeteve dhe këtu ka të bëjë me shërbimin policor që ka dy lloje të automjeteve, automjete për operacione speciale dhe ato nuk janë automjete që kushtojnë 20 mijë e 30 mijë euro, por kush e di se çfarë janë këto automjete, nuk ka nevojë t'ua shpjeguar dhe kemi për shërbime të mbështetjes, po ashtu që janë shumë speciale dhe në tërësi arrijnë kjo shifër 3 milionë e 258 mijë euro.

E kemi Ministrinë e Forcës së Sigurisë që i përmendi ministri nuk dua të potencoj po krejt janë 2 milionë e 160 mijë euro.

Pastaj, Zyrën e Rregullatorit të Energjisë me 40 mijë euro, Organin Shqyrtues si organ i ri që nuk mund pa automjete, është 85 mijë euro.

Gjykatën Kushtetuese si institucion i ri që i duhet automjetet – për ata është diku mbi 80 mijë euro.

Komisioni i Konkurrencës si agjencion i ri i krijuar dhe që për herë të parë ndoshta futet në buxhetin e Kosovës, që i duhen automjete edhe këtij me shumën diku afër 30 mijë euro.

Pastaj doganat, që duhet vërtet të specializohen edhe me automjete speciale në 418 mijë euro.

Qendren e Inteligjencës të Kosovës ose Autoritetin e Inteligjencës së Kosovës- është një autoritet shumë i veçantë dhe që diku mbi 300 mijë euro është pajisje me vetura. Dhe dua t'ju them edhe një shpenzim që duket mjaft i madh në këtë rast i Komisionit të Pavarur për Media që për sa i përket monitorimit të subjekteve mediale që u duhet një automjet i specializuar me pajisje të veçanta digjitale që bëjnë monitorimin edhe të frekuencave edhe të hapësirës në këtë drejtim dhe ato mjete janë diku 400 mijë euro dhe po të futet lapsi të gjitha këto bëjnë 11 milionë e 800 mijë euro.

Deri më tani nga qeveritë e kaluara jemi pas mësuar të themi qeveritë e veturave me këtë qeveri deri më tash kemi thënë se është Qeveri e rrugëve dhe e shkollave dhe tash kur kemi krijuar institucione të reja siç janë Forca e Sigurisë, pastaj e Mbrojtjes, s'po i përmend edhe Shërbimin diplomatik atje...

**KRYETARI:** Faleminderit!

Tani është fjala për deputetin e parafundit, Ibrahim Selmanaj, le të përgatitet i fundit për sot, Lutfi Haziri.

**IBRAHIM SELMANAJ:** Faleminderit, zoti Kryetar!

Unë nuk do ta zgjas shumë, po do të kërkoj që në transkript ta shohim llogarinë të cilin e bërë parafolësi im dhe do të dalë se në vlerën e përgjithshme, nëse nuk ka gabuar ndonjë numër, del diku vlera 8 milionë. Ndërsa do ta përkujtoj Kryeministrin e Republikës së Kosovës, zotin Hashim Thaçi, se ka folur gjithë ditën me Ahmet Isufin, kurse Ahmet Isufi nuk ka qenë këtu. Kaq.

**KRYETARI:** Ju faleminderit!

Diskutuesi i fundit, Lutfi Haziri.

LUTFI HAZIRI: Faleminderit!

LUTFI HAZIRI: Zoti Kryetar, faleminderit!

Kryeministër, Kabinet qeveritar,

E di që debati ka qenë i gjatë dhe është diskutua shumë. Janë dy arsye kryesore që po e marr fjalën.

E para është, që në mëngjes kam thënë në emër të Grupit Parlamentar ne e mbështesim, në parim, por roli ynë pozitiv në komision do të jetë deri në momentin e fundit edhe ju lutem këtë... mos e injoroni, sepse anëtarët e Kabinetit qeverisës do ta kenë të servuar dokumentin në leximin e dytë me rolin tonë pozitiv. Nuk kemi thënë kurrgjë tjetër dhe mendoj që në rrafshin e debatit, të diskutimit kemi dashur ta japim kontributin tonë. Pra, ky është qëndrim i Grupit Parlamentar të LDK-së dhe të instancave të LDK-së.

Nën dy, jam i detyruar, sepse moralisht kur bëjmë krahasime mes qeverive, administratave në periudha të caktuara kohore, nuk duhet të harrojmë se investimi më i madh i asaj Qeverie apo e kësaj Qeverie ka të bëjë me progresin apo ka të bëjë me një hap më shumë që duhet ta çojmë popullin, shoqërinë, institucionin përpara.

Natyrisht që krahasimet mund të qëndrojnë, por jam i obliguar të them që investimi më i madh i Kabinetit të kaluar edhe i opozitës ka qenë çështja e statusit dhe nëse i zhvlerësojmë angazhimet tona sot për një debat që mund të personalizohet, fatkeqësisht, nganjëherë nuk i kontribuon rolit tonë të përbashkët pozitiv që duhet ta ndërtojmë në të ardhmen.

Unë e di që shpeshherë lodhmi me këto fjalë, por t'i sjellim krahasimet e qëndrueshme, ju lutem, sepse krahasimet e mira e ndihmojnë që kjo Qeveri ta çojë çështjen një hap më shumë se çka mund ta çojë dikush tjetër. Faleminderit!

KRYETARI: Konsideroj që debati është harxhuar. Është mirë që “por” të mos i bëni shumë, se mund të ndodhë ato të hiqen krejt. Thash, mos bëni shumë “por” se mund të hiqen krejt. Pra, le të marrin vesh, se ata që duhet të marrin vesh, e marrin vesh.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë, në parim. Votojmë tash. Regjia, jemi në procedurën e votimit, votojmë tash.

Konstatohet se me 62 vota “për”, 30 “kundër” dhe 2 abstenime, Kuvendi miratoi, në parim, Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2009.

Në bazë të Rregullës 35.10 të Rregullores së Punës së Kuvendit, ngarkohet Komisioni për Buxhet dhe Financa, si komision funksional dhe raportues, që për seancën e radhës t’ia paraqet Kuvendit raportin me rekomandime, me mundësi që edhe komisionet tjera t’ia paraqesin rekomandimet Komisionit për Buxhet dhe Financa, si komision funksional dhe raportues.

Kryetar i Komisionit, a jeni të gatshëm ju që raportet me rekomandime t’i bëni për nesër? Atëherë, mbetet 28 korriku. Urdhëro! Jo unë nuk mund ta caktoj për nesër, nëse Komisioni për Buxhet dhe Financa nuk është dakord për nesër. Urdhëro, atëherë

Komisioni le të dalë jashtë që të merren vesh, kurse ne e vazhdojmë me rendin e ditës. E di që do të shkoni në pushime, por mund të shkoni edhe prej 1 gushtit. Komisioni, le të merret vesh, unë e përfill vendimin e komisionit.

Vazhdojmë me pikën e radhës:

- **Shqyrtimi i raportit të Komisionit Parlamentar ad-hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për anëtarë të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës, nga komuniteti serb**

Komisioni parlamentar ad-hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për anëtarë të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës, në pajtim me Rregulloren numër 2008/2 për ndryshimin e Rregullores nr. 2001/36 për Shërbimin Civil ka intervistuar kandidatët për anëtarë të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës dhe Kuvendit ia ka paraqitur raportin me rekomandime.

Raporti i Komisionit, së bashku me dokumentet u është shpërndarë deputetëve. Ftoj Kryetarin e Komisioni ad-hoc, zotin Hydajet Hyseni, që para deputetëve të Kuvendit ta arsyetojë Raportin me rekomandime. E ka paraqitur. Mirë, atëherë është radha e shefave të grupeve parlamentare.

Në emër të Partisë Demokratike, kush e do fjalën? Ramë Buja. Jeni pajtuar, mirë.

Ftoj kryetarët e grupeve parlamentare që të propozojnë nga një anëtarë për Komisionin votues. Nga PDK-ja kush e do fjalën?

RAMË BUJA: Nga Partia Demokratike e Kosovës, Adem Grabovci.

KRYETARI: Faleminderit! Nga LDK-ja?

LUTFI HAZIRI: Nga LDK-ja, deputeti Arsim Rexhepi.

KRYETARI: Faleminderit! Nga AAK-ja?

Regjia, fjalën deputetit Ardian Gjini.

ARDIAN GJINI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Nga AAK-ja, vjen deputeti Rasim Selmanaj. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, nga AKR-ja?

IBRAHIM MAKOLLI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Nga AKR-ja, deputetja Suzan Novobrdaliu.

KRYETARI: Faleminderit! Nga LDD?

LULZIM ZENELI: Nga LDD-ja, propozohet deputetja Synavere Rysha.

KRYETARI: Faleminderit! Nga Grupi Parlamentar “7+”.

DŽEZAIR MURATI: Iz naše grupe dolazi poslanik Enis Kervan.

KRYETARI: Faleminderit! Nga Grupi Parlamentar SLS,

Bojan Stojanović: Hvala gospodine predsedniče! Iz Parlamentarne grupe SLS, gospoda Hafiza.

KRYETARI: Faleminderit!

Lus kandidatët, t'i zënë vendet e tyre, të Komisionit votues.

(Ndërprerje e incizimit)

KRYETARI: Vazhdojmë me votimin e fshehtë:

Adem Grabovci, Adem Hajdaraj, Adem Salihaj, Agim Velu, Ahmet Isufi, Ali Lajçi, Alush Gashi, Anita Morina, Ardian Gjini, Armend Zemaj, Arsim Bajrami, Arsim Rexhepi, Bahri Hyseni, Bajram Kosumi, Behgjet Pacolli, Berat Luzha, Berim Ramosaj, Besa Gaxherri, Bojan Stojanović, Branislav Grbić, Bujar Bukoshi, Danush Ademi, s'është a, Donika Kadaj, Dragisha Miriç, s'është, Drita Kadriu, Drita Maliqi, Driton Tali, Xhezair Murati, Edita Tahiri, Elheme Hetemi, Emrush Xhemajli, Enis Kervan, Enver Hoxhaj, Eqrem Kryeziu, Esat Brajšori, Etem Arifi, Et'hem Çeku, Fatmir Limaj, Fatmir Rexhepi, shkuan këta, Fatmire Berisha, Fehmi Mujota, le të përgatiten Flora Borvina, Gani Buçinca, Gani Geci, Gani Koci, Gjylnaze Sylja, Hafize Hajdini, Hajdin Abazi, Haredin Hyseni, Hajredin Kuçi, Haki Shatri, Hashim Thaçi, Heset Cakolli, Hydajet Hyseni – Kaloshi, Ibrahim Gashi, Ibrahim Makolli, Ibrahim Selmanaj, Ismet Beqiri, Kaqusha Jashari, Jakup Krasniqi, Kolë Berisha, Kosara Nikoliq, Dragan Dimiq, Luljeta Shehu, Lulzim Zeneli, Lutfi Haziri. Mahir Yagcılar, Mark Krasniqi, Melihate Tërmerkolli, Memli Krasniqi, Mihajlo Sëqepanović, Mimoza Ahmetaj, Myfera Shinik, Mursel Halili, Myrvete Pantina, Myzejene Selmani, Naim Maloku, Naim Rustemi, Nait Hasani, Naser Osmani, Naser Rugova, Nekibe Kelmendi, Nerxhivane Dauti, Nexhat Daci, Njomza Emini, Numan Baliq, Nurishahe Hulaj, Qamile Morina, Radmilla Vujović, Ramadan Avdiu, Ramadan Gashi, Ramë Buja, Ramë Manaj, Rasim Selmanaj, Rita Hajzeraj, Riza Smaka, Rustem Mustafa, Sabri Hamiti, Sadik Idriz, Safete Hadërgjonaj, Sala Berisha – Shala, Sanije Aliaj, Selville Halimi, Shkumbin Demaliaj, Skënder Hyseni, Sllavisha Petković, Slobodan Petrović, Shpresa Murati, Suzan Novobrdaliu, Synavere Rysha, Teuta Hadri, Vezira Emrush, Vlladimir Todorović, Vlora Çitaku, Xhavit Haliti, Xhevdet Neziraj, Zafir Berisha, Zef Morina, Zylfi Merxha, Zylfije Hundozi.

(Ndërprerje e incizimit)

KRYETARI: Të nderuar deputetë,

Vazhdojmë. Ftoj përfaqësuesin e Komisionit që ta shpallë rezultatin e votimit.

ARSIM REXHEPI :

**Raport**  
**për rezultatin e votimit për zgjedhjen e një anëtarit të Këshillit të Pavarur**  
**Mbikëqyrës të Kosovës**

Në mbështetje të nenit 65.1 të Kushtetutës së Kosovës dhe nenit 1 të Rregullores nr. 2008/12 për ndryshimin e Rregullores nr. 2001/36 për Shërbimin Civil të Kosovës, Komisioni votues, i formuar me vendim në seancën plenare, datë 23 korrik 2009, në përbërje nga një përfaqësues i secilit grup parlamentar: Adem Grabovci, Arsim Rexhepi, Rasim Selmanaj, Suzan Novobrdaliu, Synavere Rysha, Enis Kervan dhe Hafize Hajdini. Në votim kanë marrë pjesë 92 deputetë. Për zonjën Irena Svetiq Ahmeti kanë votuar 44

deputetë, për Nebojsa Azdejkoviçin kanë votuar 40 deputetë, kurse të pavlershme janë 8 fletëvotime.

Në bazë të rezultateve të votimit në pajtim me Rregullën 31.3 të Rregullores së Punës së Kuvendit dhe nenit 1 të Rregullores nr. 2008/12 për ndryshimin e Rregullores nr. 2001/36 për Shërbimin Civil të Kosovës, konstatohet se Irena Svetiq Ahmeti është zgjedhur anëtare e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Republikës së Kosovës, me mandat 5 vjeçar. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, deputet!

Pra, konstatoj se Kuvendi zgjodhi Irena Svetiq Ahmeti anëtare të KPM të Shërbimit Civil të Kosovës.

Nëse jeni të disponuar të vazhdojmë me pika të tjera, sonte mund të vazhdojmë deri në orën 22:00. A jeni dakord a jo? Do të thotë, nuk jeni të disponuar të vazhdojmë, por të vijmë nesër në orën 10:00. Atëherë, mirë u pafshim nesër në orën 10:00. Ju lutem, veç një minutë, Gani Koci, cili është mendimi i Komisionit për Buxhet dhe Financa?

GANI KOCI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Në një konsultë të shpejtë me shumicën e anëtarëve të Komisionit, u morëm vesh që nesër deri në orën 15:00 të përgatitet seancë e re për miratimin e amendamenteve që do t'i përgatit Komisioni nesër. Këtu kanë abstenuar ose kanë qenë kundër dy anëtarë të komisionit, ndërsa pjesa tjetër që e përbën shumicën kanë qenë pro kësaj zgjidhjeje. Prandaj, nesër në orën 15:00 do të ketë seancë të re për miratimin e amendamenteve eventuale të Draftit për rishikimin e buxhetit.

KRYETARI: Faleminderit!

Vazhdojmë nesër në orën 10:00, kurse seancën e re në orën 15:00.

\* \* \*

**E premte, 24 korrik 2009, ora 10:00**

**Vazhdimi i seancës, të filluar më 23 korrik 2009**

**Drejton seancën: Kryetari i Kuvendit, zoti Jakup Krasniqi**

KRYETARI: Të nderuar deputetë,

Të nderuar zëvendëskryeministra, ministra,

Vazhdojmë me punimet e Seancës plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës, të filluar me 23 korrik 2009, me pikat e mbetura.

Konstatoj se në sallë janë të pranishëm 62 deputetë, që do të thotë se janë plotësuar kushtet për të filluar me punë.

Vazhdojmë me pikën e gjashtë të rendit të ditës, por para se të fillojmë me pikën e gjashtë të rendit të ditës, fjalën e ka kërkuar shefi i Grupit parlamentar të SLS-së, Bojan Stojanović. Urdhëro, Bojan!

BOJAN STOJANOVIĆ: Hvala, predsedniče!

Uvaženi ministri,

Uvažene poštovane kolege poslanici,

Želim pre početka dnevnog reda da zatražim od vas kao predsednika Skupštine i od Sekretarijata Skupštine, da u toku dana, dok traje ova sednica, da se pozabavimo jučerašnjim izabirom jednog člana za Nezavisni nadzorni odbor i želim da se pozovem na treće poglavlje Ustava i da u međuvremenu vi razmotrite to i u skladu sa vašim mogućnostima ponovite taj odabir i da to bude danas na dnevnom redu. Hvala!

KRYETARI: Ju falemidnerit! Edhe pse vërtet kjo është dashur të thuhet dhe para votimit, megjithatë unë po kërkoj prononcimin lidhur me thirrjen që e bëre, keni të drejtë, por po e kërkoj prononcimin e shefave të grupeve parlamentare.

(Reagime nga salla)

Atëherë, po ia jap fjalën edhe një herë. Ju lutem, shefat e grupeve parlamentare dëgjoni kërkesën e shefit të Grupit Parlamentar të SLS, Bojan Stojanoviçi. Regjia, Bojanit ia jepni edhe njëherë fjalën!

BOJAN STOJANOVIĆ: Hvala vam predsedniče!

Još jednom, kao predsednik Srpske zajednice i šef Parlamentarne grupe tražim da iznadжете mogućnost da se jučerašnje glasanje za jednog člana Nezavisnog nadzornog odbora ponovi i naravno, pozivam se na Ustav jer tražim da se razmotri dali ima tih mogućnosti da se to glasanje ponovi, jer mi nismo zadovoljni načinom na koji je to juče uradjeno i na ispoštovanje dogovora koji smo imali pre početka te procedure.

Naravno, ukoliko vi smatrate da ne postoje zakonske osnove, mogućnosti, to ne dozvoljava ni zakon, ni Ustav, ni Poslovnik Parlamenta da za to dobijemo obrazloženje. Ukoliko postoji, da se ispoštuje naš zahtev i da se to glasanje još jednom danas ponovi. Hvala!

KRYETARI: Unë krejt çka dua, mundem t'u sqaroj juve shefave të grupeve parlamentare, Bojani po kërkon të njëjtën procedurë që është ndjekur kur i kemi zgjedhur anëtarët e Gjykatës Kushtetuese, do të thotë, unë po ua sqaroj. Ju e dini, për anëtarët e Gjykatës Kushtetuese është kërkuar, është dashur një herë të votojnë komunitetet pakicë, pastaj të votojë i gjithë Kuvendi. Të njëjtën procedurë është duke e kërkuar edhe në këtë rast Bojani dhe mendoj që po të shikohet edhe me dokumentin e Presidentit Ahtisari, të drejtën e vet e ka bazuar. Prandaj, po e kërkoj prononcimin e shefave të grupeve parlamentare.

Shefi i Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, Ramë Buja, pastaj me radhë.

RAMË BUJA: Zoti kryetar!

I nderuar Kabinet qeveritar,

Të nderuar dhe të respektuar kolegë deputetë,

Unë nuk e di ndonjë rast që është bërë ngjashëm si kjo. Nëse vërtet kjo koïncidon dhe përputhet me Pakon e Ahtisarit dhe sjell vërtet vlerë, ne megjithatë e mbështesim, por është vërtet një precedencë, një veçanti që po ndodhë në Kuvendin e Kosovës.

KRYETARI: Precedencë nuk është. Lutfi Haziri e ka fjalën!

LUTFI HAZIRI: Zoti Kryetar!

Zëvendëskryeministra, ministra,

Procedura e votimit për anëtarët e Bordit Mbikëqyrës dhe ka qenë sipas Rregullores dhe sipas kërkesës ligjore. Votimi është i lirë dhe deputetët e kanë dhënë votën e vetë, është përfunduar dhe në aspektin ligjor gjithçka është e përmbyllur sa i përket Grupit Parlamentar të LDK-së. Ndoshta emri çon peshë për kolegun tonë nga SLS-ja, por ajo është çështje e vullnetit të shumicës së deputetëve, kjo nuk mund të ndryshohet dhe nuk vjen në parimin votës së dyfishtë kjo kategori e zgjedhjes në Parlament.

KRYETARI: Në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Ardian Gjini!

ARDIAN GJINI: Ju faleminderit, zoti Kryetar!

Edhe për grupin tonë do të ishte plotësisht legjitime nëse konsultohen të gjitha aspektet ligjore. Nuk kemi asnjë gjë kundër kërkesës legjitime, mirëpo mendojmë se ndoshta kishte për të qenë mirë ndërkohë të kemi edhe sqarim ligjor për këtë çështje. Në parim, nuk kemi problem me kërkesën. Ju faleminderit!

KRYETARI: Në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, Ibrahim Makolli.

IBRAHIM MAKOLLI: Ju faleminderit, zoti Kryetar!

Edhe për Grupin Parlamentar të AKR-së është po e njëjta gjë që e tha edhe parafolësi. Duhet të konsultohet ligji dhe nuk e di nëse ligji përcakton qartazi formën e zgjedhjes, por do të ishte mirë që në të ardhmen mos të shndërrohen në praktika të tilla, paraprakisht të analizohen ligjet dhe të veprohet në pajtim me të. Përndryshe, për ne nuk është problem çfarëdo që të vendoset për procedurat e mëtutjeshme.

KRYETARI: Në emër të LDD-së, Lulzim Zeneli.

LULZIM ZENELI: Ne jemi të bindur se dhe seanca plenare ka respektuar plotësisht Rregulloren e Kuvendit të Kosovës dhe ligjet të cilat e kanë rregulluar atë çështje dhe në përputhje me të edhe duhet të adresohet kjo çështje. Nuk besoj që ka dikush kundër normave ligjore të cilat Kuvendi i Kosovës i ka ndjekur deri më tash. Nëse ka ndonjë dilemë, do të duhej të sqarohet, prandaj e kemi, besojmë në ekspertizën e stafit juridik që ekziston në Kuvendin e Kosovës. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit!

Në emër të Grupit “7+” Xhezair Murati.

DŽEZAIR MURATI: Ahtisarijev zakon jasno u nekim momentima odredjuje dvokružni sistem biranja kada su u pitanju manjinske zajednice, jer one uvek mogu biti preglasane ako su im interesi nekada povredjeni, tako da smatramo da ima elemente za ovakav zahtev i mi u potpunosti podržavamo zahtev SLS-a za ponovno glasanje kandidata za Nadzorni organ.

KRYETARI: Kryetari i Komisionit ad-hoc, Hydajet Hyseni.

HYDAJET HYSENI: Ju faleminderit, zoti Kryetar!

Pa vënë në dyshim motivet që i bëjnë për të shtruar një çështje të tillë kolegët, madje edhe duke bërë përpjekje që të mirëkuptojmë kërkesën e tyre, mendoj megjithatë se ne duhet të funksionojmë siç kemi funksionuar deri tash, në bazë të akteve ligjore, në bazë të të cilave edhe e kemi bërë zgjedhjen edhe të një anëtari të komuniteteve joshumicë dhe këtu nuk ka asnjë dilemë.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës nuk i nënshtrohet të njëjtës procedurë të cilës i nënshtrohen disa institucione tjera edhe për arsyen, mendoj unë, dua të interpretoj, sepse Rregullorja në bazë të cilave bëhet përzgjedhja, ndanë posaçërisht kandidatët e komuniteteve jo shumicë dhe në këtë rast ka qenë fjala për zgjedhjen e anëtarëve nga këto përbërje. Prandaj, nuk ka pasur mundësi mbivotimi e të tjera. Rregullorja fare qartë thotë se duhet të respektohet përbërja etnike dhe dy anëtarë janë të komuniteteve joetnike dhe thotë në 8.5 se brenda periudhës 21 ditësh, pas përfundimit të afatit, Komisioni ad-hoc rekomandon dy kandidatë për çdo vend të lirë të punës në KPM, në bazë të kompetencave të integritetit dhe përkushtimit të tyre dhe pika vijuese brenda periudhës të mëtejme kohore prej 14 ditësh, Kuvendi i Kosovës emëron njërin prej dy kandidatëve të rekomanduar për vend të lirë të punës bazuar në shumicën e votave të deputetëve të Kuvendit që janë të pranishëm dhe që votojnë. As me Kushtetutë, as në dokumentin e zotit Ahtisari, Propozimi gjithëpërfshirës, nuk ka dispozita që imponojnë rregull tjetër për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës. Kërkesa që mund të ketë një kuptim, por dua të sqaroj vetëm se kjo çështja e emrit që u përmend këtu, ka qenë edhe në procesin e përzgjedhjes. Është shtruar dhe është dëshmuar nga kandidatja se ajo i përket kombësisë serbe dhe në të janë përmbushur kushtet ligjore, statutore dhe në përputhje me konkursin që ajo të jetë kandidate e barabartë me gjithë kandidatët tjerë.

Dua ta njoftoj Kuvendin dhe opinion se ne e kemi përsëritur këtë konkurs por, për fat të keq, ka pasur një mosinteresim të duhur të kandidatëve, prandaj edhe praktikisht kanë mbetur të njëjtit kandidatë që kanë qenë edhe në procedurën e mëparshme, kurse një nga arsyet pse është përsëritur, ka qenë pikërisht për të pasur edhe më shumë kandidatë, do të thotë edhe më shumë mundësi zgjedhjeje dhe përmbushje të kërkesave. Respektimi eventual i kërkesës së kolegëve, do të thoshte që të bëjnë precedencë që gjithkund ku ka përbërje të tilla, të imponojnë çelësin e dyfishtë. Mendoj se kjo është përtej normales dhe do të ketë efekte negative, koftra produktive edhe sa i përket realizimit të të drejtave të komuniteteve minoritare. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit! Slobodan Petroviq e ka kërkuar fjalën!

SLLOBODAN PETROVIĆ: Zahvaljujem se predsedniče!

Uvažene kolege,

Ako ste pažljivo pratili izlaganje šefa Poslaničke grupe Samostalne liberalne stranke, on je jasno rekao da je juče svakako glasanje bilo u skladu sa zakonom i absolutno niko sa naše strane nije rekao da je to protiv zakonito, ali mi koristimo priliku upravo onu koju imamo u skladu sa Ustavom. Ja verujem da vi znate da je Ustav najviši akt, znači 3 poglavlje, član 57 jasno govori da je to sve što dolazi u interesu zajednica, da je naša obaveza da reagujemo, i mislim da je to naj dobronamerniji predlog sa naše strane. Absolutno i jasno i glasno smo rekli, ukoliko je u skladu sa Ustavom i zakonom, da je to sa naše strane predloženo. Ukoliko nije, ukoliko vi procenite da to nema zakonsku snagu, odnosno da nije u skladu sa Ustavom, aposlutno nemojte podržati. Svakako to jeste u skladu sa Ustavom i mislimo da će taj prdlog, koji je dala Samostalna liberalna stranka samo unaprediti demokratičnost u ovom parlamentu. Svakako ne kritikovati jučerašnje glasanje i želim da se zahvalim svima onima koji su glasali juče i pokazali demokratiju u prvom svetlu. Još jednom želim da potvrdim ono što je rekao šef Poslaničke grupe da smo se absolutno pozvali na Ustav koji nam garantuje da se sve ono što je vezano za manjinske zajednice, tražimo našu zaštitu. Hvala!

KRYETARI: Ju faleminderit! Fjalën e ka kërkuar deputeti Sabri Hamiti.

SABRI HAMITI: Ju faleminderit, zoti Kryetar!

Unë e kërkoja fjalën para se të fliste deputeti Hydajet Hyseni, që unë kujtoj se në mënyrë shteruese e shpjegoi problemin. Është rrezik të bëhen precedenca. Votimi ka qenë i fshehtë, është bërë sipas rregullave, kanë kandiduar dy kandidatë të nacionalitetit serb, është zgjedhur njëri. Vota ka qenë e fshehtë. Kjo mënyrë e interpretimit, nëse doni në instancën e fundit, është dezavuumi i votës së fshehtë, që është rrezik për demokracinë dhe askush nuk mund të paragjykojë kush qysh ka votuar, minoritetet sa i kanë dhënë njërit e sa tjetrit. Unë e konsideroj votimin të rregullt dhe ka dhënë një rezultat. Nuk kemi pasur kandidatë të shumicës e të pakicës, zgjedhja është bërë në bazë të rregullës në mes të pakicës, ka fituar një kandidat dhe unë besoj se kjo është çështje e mbyllur. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit! Gani Koci!

GANI KOCI: Zoti kryetar!

Unë vetëm dua ta lexoj rregullën 3.7 të Propozimit gjithëpërfshirës të përzgjedhjes së statusit të Kosovës. Do të thotë, për miratimin e ndryshimit apo shfuqizimin e ligjeve të paraqitura në vijim, i ka në mënyrë taksative në të cilat ligje dhe në të cilat raste përdoret rregulla që u kërkuar, do të kërkohej shumica e anëtarëve të pranishëm dhe që votojnë të Kuvendit, që u përkasin partive, iniciativave qytetare dhe kandidatët e pavarur të cilët janë deklaruar se u përkasin komuniteteve, të cilat nuk janë shumicë në Kosovë, siç është përcaktuar në nenin 3.2: a) të gjitha ligjet të cilat ndryshojnë kufijtë komunalë, themelojnë apo shuajnë komunitet, përcaktojnë shtrirjen e pushteteve të komunave dhe pjesëmarrjen e tyre në marrëdhëniet ndërkomunale dhe tejkuftare: b) Ligjet të cilat implementojnë të drejtat e komuniteteve dhe të pjesëtarëve të tyre, përveç atyre të përcaktuara me Kushtetutë, ligjet për përcaktimin e gjuhëve, ligjet për zgjedhjet lokale, ligjet për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore, ligjet për liritë fetare apo për marrëveshje me komunitetet fetare, ligjet e arsimit dhe ligjet për përdorimin e simboleve, duke përfshirë simbolet e komunitetit dhe festat publike. Në qoftë se është kështu në mënyrë taksative e përcaktuar qartë, nuk ka një veçanti se si duhet të zgjedhet anëtari i Komisionit Mbikëqyrës, në këtë rast, që është votuar më herët.

Prandaj, sinjerisht, nuk do duhej të krijonim raste që do të na përcjellin në çdo rast tjetër që mund të na vijë pastaj. Është e përcaktuar mënyra edhe e zgjedhjes së gjyqtarëve, e gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese edhe e Gjykatës Supreme që përcaktohen në mënyrë taksative dhe nuk kemi dispozitë të veçantë me Propozimin gjithëpërfshirës të Ahtisarit dhe as të Kushtetutës që e përcakton këtë formë të zgjedhjes të anëtarit nga komuniteti në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës.

KRYETARI: Bojan Stojanović e ka fjalën!

BOJAN STOJANVOIĆ: Hvala, gospodine predsjedniče!

Ja se izvinjavam što po treći put uzimam reč, ali vidim da se ovde razvija jedna polemika. Ja stvarno nisam želeo da se ovo desi i ne želim da e nastavi. Zato sam na samom početku rekao da želim da vi sa vašom stručnom ekipom, jer mislim da stvarno imate dobru volju, dobru nameru i kapacitete da dobro protumačite sve ovo što se ovde u javnosti čita. Tačno je da ni u članu 81. Ustava ne piše da se bira Nezavisni nadzorni organ, ali ako se mnoge stvari koje se tiču zajednica biraju duplom većinom i gde treba zajednice da se pitaju, ja mislim da bi to trebalo da ispoštujemo, jer postoje neki kodeksi koje možda i nemožemo da napišemo. Ovde imamo dve parlamentarne grupe koje prerdstavljaju zajednice i obe parlamentarne grupe daju podršku i traže da se to ponovi,

ne narušavajući proces tajnosti glasanja, možemo i na taj način da obavimo glasanje i s druge strane da se vratim na Ad-hoc komisiju, da razjasnim zato što je ovde otišlo u javnosti da kao zbog većeg broja kandidata, ako se vratimo unazad videćemo da su to isti kandidati koji su bili i prošlog puta i ništa nismo dobili, nego smo možda pripremali teren za neke stvari. Stvano bi voleo da prekinemo sa ovom raspravom, da vi pogledate, analizirate to zajedno sa sekretarijatom Skupštine i da donesete odluku koju ćemo mi svakako prihvatiti, znači nemamo nameru da ovde napravimo neke... ili bilo šta, to nam nije namera, nego da probamo da ovo rešimo na najdemokratičniji način u skladu sa zakonom i propisima. Hvala vam!

KRYETARI: Ju faleminderit! fjalën e ka kërkuar deputetja Melihate Tërmkollli

MELIHATE TËRMKOLLI: Ju faleminderit!

Në fakt, atë që u deshtë të thuhet, u tha nga shumica e deputetëve këtu, në veçanti nga kryesuesi i Komisionit ad-hoc, zoti Hydajet Hyseni, dhe po ashtu edhe nga kryetari i Grupit Parlamentar të LDK-së. Por, sido që të jetë, unë mendoj se ky debat duhet të mbyllet. Është e vërtetë dhe pajtohem me zotëriun që tha më herët, por duhet të mbyllet në mënyrën ashtu siç e parashohin rregullat ligjore dhe Kushtetuta.

Rregullat ligjore dhe Kushtetuta nuk kërkojnë ekspertizë, prandaj ky nuk është rast për asnjë farë ekspertize dhe për asnjë farë konsultimi me sekretarin e Kuvendit apo ndonjë departament tjetër të Zyrës ligjore. Kjo është çështja e rregullave kushtetutare, parlamentare, të cilat i vendos Parlamenti i Kosovës dhe nëse ky Parlament i Kosovës ka për të bërë një asi precedenti, është më mirë sot të shkojmë në shtëpi dhe mos të dukemi më këtu pari. Me krejt respektin për të gjithë, janë rregullat e tejkaluara, i kemi na shumë të qarta, janë të tejkaluara krejt ato të drejta dhe ato mundësi që u janë dhënë minoriteteve në Kosovë dhe nëse edhe ky tejkalim tejkalohe, unë nuk di, atëherë, me çfarë parimesh dhe me çfarë rregullash kemi për të punuar më këtu. Kuvendi i Kosovës ka punuar mbi bazën e rregullave të plota, nëse nuk i pëlqen dikujt ai person, është çështje e tij dhe kisha për t'ju lutur shumë këtu, edhe disa kryetarë të grupeve parlamentare, që po koketojnë, si Ardian Gjini, duke shkelur rregullat, kisha për t'ju lutur shumë që të jemi... Jo, jo, më fal, logjika e robit njëherë e përgjithmonë në këtë vend duhet të pushojë. Logjika e robit në këtë Kuvend dhe e koketimeve jokushtetuese, joligjore duhet të pushojë. Jo, më falni! Ju faleminderit, shumë!

KRYETARI: Ardian Gjini, replikë.

ARDIAN GJINI: Nuk jam kah e marr vesh çka pati Meli, ama nuk kam nevojë të koketoj me askënd. Ju jeni në pushtet bashkë me ata. Unë vetëm thashë i këqyrni aspektet ligjore, nëse aspektet ligjore lejojnë, ne jemi në rregull. Kjo ke maksimumi. Nëse e di që nuk duhet, trego që nuk duhet dhe e mbylлим temën. Ju faleminderit!

KRYETARI: Unë po e ngarkoj Komisionin për Legjislacion, do të thotë pasi ta kemi pauzën e kafesë, ta kemi një rekomandim nga Komisioni.

Vazhdojmë me rendin e ditës. Pika e gjashtë e rendit të ditës:

## **6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për mbrojtjen e ajrit nga ndotja**

Në bazë të Rregullës 35, pika 1 e Rregullores, janë përmbushur Kushtet për shqyrtim dhe miratim në parim të këtij Projektligji.

Ftoj Ministrin e Ministrisë të Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, zotin Yagcilar, që në emër të Qeverisë së Republikës së Kosovës para deputetëve të Kuvendit të Kosovës ta prezantojë Projektligjin

MAHIR YAGCILAR: Ju faleminderit, zoti Kryetar!

I nderuari kryetar,

Të nderuar zëvendëskryeministra, ministra

Të nderuar deputetë,

Në vazhden e ndërtimit të infrastrukturës së re ligjore në fushën e mjedisit, veçanërisht në zgjidhjen e problemeve të mbrojtjes së ajrit nga ndotja në Republikën e Kosovës, roli i veçantë i dedikohet Ligjit për mbrojtjen e ajrit nga ndotja.

Nxjerrja e këtij Ligji është i nevojshëm për faktin se me ligjin ekzistues shumë çështje nuk janë përfshirë, duke filluar nga përkufizimet që janë detyrim i dalë nga Direktiva e Bashkimit Evropian mbi vlerësimin dhe menaxhimin e cilësisë së ajrit dhe Direktiva e Bashkimit Evropian lidhur me vlerat e kufizuara për dyoksidin e sulfurit, dyoksidin e azotit, oksidet e azotit, grimcave dhe plumbit në ajrin mjedisor dhe këto informata të jenë në dispozicion të publikut.

Legjislacioni në fuqi, si ligjet dhe rregulloret e UNMIK-ut, nuk janë zbatuar për faktin se janë në kundërshtim me rrethanat e reja të krijuara dhe në kontradikta njëra me tjetrën dhe kanë penguar ushtrimin e përgjegjësive të institucioneve kompetente për mbrojtjen e ajrit nga ndotja. Ligji është i hartuar në harmoni me standardet e Bashkimit Evropian, sipas teknikave të reja juridike, me një koncept fleksibil të zbatueshëm në sistemin juridik të Republikës së Kosovës.

Projektligji për mbrojtjen e ajrit nga ndotja ka 42 nene dhe adreson të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me krijimin e një strukture complete gjithëpërfshirëse dhe përmbajtësore të mbrojtjes së ajrit nga ndotja, por gjithashtu në harmoni me normat dhe direktivat e Bashkimit Evropian, si Direktiva e Bashkimit Evropian 96/62 dhe Direktiva e Bashkimit Evropian 99/30 për SOE II dhe NOE II dhe NOX.

Të nderuar deputetë,

Projektligji për mbrojtjen e ajrit nga ndotja në mënyrë më përmbajtësore dhe më të saktë adreson rregullimin e çështjeve që kanë të bëjnë me mbrojtjen e shëndetit të njeriut, faunën, florën dhe vlerat natyrore e kulturore të mjedisit, me qëllim për një mjedis me ajër të pastër. Projektligji është hartuar në bazë të rregullave të përcaktuara në nenin 28 të Rregullores për Punën e Qeverisë së Kosovës. Gjatë hartimit të Projektligjit, për bazë është marrë legjislacioni i shteteve të regjionit - anëtare të Bashkimit Evropian. Projektligji është në harmoni me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe me ligjet që janë të përafërta me dispozita *acquis-communitaire* të Bashkimit Evropian.

Projektligji nuk përmban elemente diskriminuese, si dhe për zbatimin e këtij Projektligji nuk nevojiten mjete shtesë buxhetore. Gjithashtu, dëshiroj t'ju informoj se kemi filluar edhe me sistemin e kontrollimit të cilësisë së ajrit, ku janë caktuar edhe pikat e vendosjes së aparateve monitoruese. Ne, si ministri, participojmë me 30%, ndërsa 70% nga donacionet.

Të nderuar deputetë,

Duke besuar se Projektligji për mbrojtjen e ajrit nga ndotja në masë të konsideruar ofron kushte të nevojshme për krijimin e infrastrukturës ligjore për zvogëlimin e ndotjes së ajrit nga ndotja, ju lus që ta përkrahni Projektligjin me shpresë që Ligji do të miratohet shpejt dhe të hyjë në fuqi, sepse është i domosdoshëm dhe në funksion të zhvillimit dhe të përmirësimit të jetës së qytetarëve tanë. Ju faleminderit për vëmendje!

KRYETARI: Ju faleminderit, ministër!

Radha është për shefat e grupeve parlamentare ose në emër të grupeve parlamentare. Nga Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike fjalën e ka kërkuar Elheme Hetemi.

ELHEME HETEMI: Ju faleminderit, i nderuari Kryetar!

Të nderuar deputetë,

I nderuar Kabinet qeveritar,

Projektligji për mbrojtjen e ajrit nga ndotja adreson të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me krijimin e një strukture complete gjithëpërfshirëse dhe përmbajtjesore në përputhje me normat juridike që rrjedhin nga legjislacioni i BE-së. Ky Projektligji gjithashtu adreson në mënyrë përmbajtjesore dhe specifike çështjet që kanë të bëjnë me mbrojtjen e shëndetit të njeriut, faunën, florën, vlerat natyrore kulturore të mjedisit nga ndotja e ajrit. Ky projektligj gjithashtu garanton të drejtën e qytetarëve për të jetuar në një mjedis të pastër.

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e përkrah në parim këtë projektligj, ndërsa të gjitha propozimet që dalin nga kjo seancë, nga deputetët edhe propozimet e tjera, vërejtjet e tjera që do të vijnë nga palët e interesit, do të shqyrtohen në komisionin funksional. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës, Zef Morina e ka kërkuar fjalën.

ZEF MORINA: Ju faleminderit, zoti Kryetar!

Përshëndetje Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Në fakt, ky projektligj është plotësim ose ndryshim i ligjit ekzistues, i Ligjit 20004/30, por pasi që ky ligj, i cili është miratuar më herët, nuk i plotëson normat dhe standardet e kërkuara sipas direktivës të Bashkimit Evropian, është dashur që nga sponzoruesi ose nga Ministria të rishikohet. Me qenë se, siç shihet, ka një ndryshim mbi 50% ose 60%, në fakt Ministria ka kërkuar që ky ligj të ripunohet ose të bëhet një ligj i ri, kështu që duke pasur parasysh kushtet dhe rrethanat për të cilat tani ky ligj po përgatitet, është shumë normale që ky ligj duhet të fillojë nga e para.

Projektligji për mbrojtjen e ajrit nga ndotja përfshin të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me krijimin e kushteve në përputhje me normat juridike që rrjedhin nga direktiva ose legjislacioni i BE-së. Andaj, Grupi Parlamentar i LDK-së e përkrah në parim ligjin dhe përmes anëtarëve të komisionit do t'i eliminojë mangësitë që mund të hasen gjatë amendamentimit. Ju faleminderit!

KRYETARI: Në emër të AAK-së, Naim Maloku e ka fjalën.

NAIM MALOKU: Ju faleminderit, zoti Kryetar!

Kabinet qeveritar,

Të nderuar ministra,

Deputetë,

Grupi Parlamentar i AAK-së mirëpret shqyrtimin e këtij projektligji në Kuvendin e Kosovës edhe për arsye se Kosova po ballafaqohet me nivelin e lartë të ndotjes së mjedisit, posaçërisht të ajrit. Më lejoni që duke i dhënë mbështetje në parim në emër të Grupit Parlamentar këtij Projektligji, zotin ministër ta orientoj në shqyrtimin edhe një herë të 4 neneve të këtij projektligji. Unë mendoj se komisioni parlamentar funksional që ka për ta shqyrtuar këtë projektligj, duhet të përqendrohet kryesisht në katër nene. Neni 4, përcaktimi i normave dhe standardeve të cilësisë së ajrit, gjithmonë në këto nene kemi vlerat kufitare të emisionit. Ne kemi përkufizime se çka do të thotë kjo, por nuk i kemi ato vlera të përcaktuara ose një tabelë të atyre vlerave në këtë ligj.

Neni 4, paragrafi 1, thotë: “vlerat kufitare e cilësisë së ajrit, vlerat e synuara, pragjet e alarmit për materiet ndotëse dhe data e hyrjes së tyre në fuqi, në propozim të Ministrisë me akt të veçantë, i përcakton Qeveria”. Pra, ne nuk i kemi me këtë ligj të përcaktuara vlerat kufitare të misionit. Pastaj, te neni 10, paragrafi 1, të nderuar deputetë, vetëm t’ju citoj se çka përshkruhet në paragrafin 1: “Dispozitave të këtij ligji i nënshtrohen impiantet me djegie me fuqi termike të barabartë ose më të madhe se 50 megavat tonë, si dhe impiantet me fuqi termike më të vogël se 50 megavat tonë”. Pse atëherë ky kufi, kur i njëjti paragraf ka të bëjë edhe me ato më të barabarta ose më të mëdha se 50 ose më të vogla se 50.

Pastaj, në paragrafin 3, thotë: “Qeveria me propozim të Ministrisë, me akt të veçantë përcakton vlerat kufitare të emetimit dhe kërkesat për monitorim të ndotësve për sektorë dhe renovimin e impianteve ekzistuese”. Po ju orientoj të shikoni nenin 16, kemi të bëjmë me paragrafin 1, ku valët e rënda tek të cilat përmbajtja e sulfurit e tejkalon 1% të masës, nuk mund të shfrytëzohen si lëndë djegëse për impiante për djegie prej 1 janari 2014. Do të thotë, keni parasysh, pra, gjatë tërë ligjit. Ligji hyn në fuqi 15 ditë pas miratimit në Kuvend të Kosovës, ndërsa kemi në disa raste vlerat, pra tejkalohe, shkon nga 1 janari 2014, ndërsa neni 39 thotë kështu: “Prodhuesit, importuesit, eksportuesit, transportuesit, tregtarët dhe përdoruesit komercial të pajisjeve, të prodhimeve materiale dhe të substancave që ndotin ajrin, nuk i përmbahen legjislacionit vendor dhe standardeve të BE-së, pra dënohen me gjobë 60.000 deri në 100.000 euro. Ky nen tani vjen plotësisht në kundërshtim me nenet e tjera, të cilat i përmenda më parë në këtë projektligj.

Edhe një herë, duke e mbështetur në parim këtë projektligj, ftoj ministrin që të japë një përkushtim, pra Departamenti i cili e ka këtë projektligj, ndotjes së ajrit, kontrollimit të ajrit në shqyrtimin e mëtejshëm të këtij projektligji në komision funksional, në mënyrë që këto nene të mos vijnë në kundërshtim njëri me tjetrin. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit, deputet! Në emër të AKR-së, Heset Cakolli e ka kërkuar fjalën.

HESET CAKOLLI: Ju faleminderit, zoti Kryetar!

I nderuari Kabinet qeveritar,

Të respektuar kolegë deputetë,

Projektligji për mbrojtjen e ajrit nga ndotja ka për qëllim të rregullojë dhe t’ju garantojë qytetarëve të Kosovës për të jetuar në një mjedis me ajër të pastër si dhe të mbrojë shëndetin e njeriut.

Kuvendi i Republikës së Kosovës ka nxjerrë disa ligje që kanë për qëllim mbrojtjen e mjedisit, por gjendja në terren nuk ka ndryshuar në drejtimin pozitiv edhe më tutje,

ndërsa ky projektligj, pas aprovimit të tij në Kuvend dhe hyrjes në fuqi, do t'i plotësojë shumë mangësi të ligjeve të tjera dhe me zbatimin e tij gjendja e ajrit në Kosovë shpresojmë se do të përmirësohet. Ky projektligj ka gjithsej 42 nene, por për t'u zbatuar në praktikë është paraparë që Ministria të nxjerrë akte të veçanta nënligjore, e kjo do të ndikojë sigurisht në kohën e fillimit të zbatimit të tij në praktikë.

Grupi Parlamentar i Aleancës Kosova e Re, në parim e mbështet këtë projektligj, edhe pse kemi disa vërejtje konkrete në nene të caktuara. Unë me këtë rast po e përmendi, për shembull, nenin 2, ku bëhet fjalë për përkufizimet. Për shembull, fjala është për impiantet dhe vlerat kufitare të emisioneve. Është mirë të harmonizohet me Ligjin për parandalimin dhe kontrollin e integruar të ndotjes, si dhe me ligjet e tjera.

Gjithashtu, neni 14, pika 2, ku thuhet: "Normat e emisioneve nga burimet e lëvizshme i përcakton Qeveria me akte të veçanta me propozim të Ministrisë". Ne mendojmë se duhet të jetë Ministria e Transportit dhe Post-telekomunikacionit të Kosovës pasi që këto norma është dashur t'i definojë kjo Ministri para se të fillojë të bëhet homologimi i automjeteve në Kosovë. Sipas direktivave të Bashkimit Evropian, këto norma janë të definuara me euro 1, euro 2, euro 3 deri në euro 5, që ka filluar të zbatohet në vitin '92, '96, euro 3 në vitin 2000, euro 4 në vitin 2005 dhe euro 5 fillon në vitin 2009 dhe janë të dhëna vlerat kufitare të automjeteve të emisioneve para homologimit dhe vlerat kufitare pas një periudhe të caktuar të eksplotimit. Vërejtje tjetër kemi edhe në nenin 10, pika 1, sepse ne mendojmë që duhet të definohet saktë kufiri më i ulët i impianteve me fuqi termike e jo të mbetet më vogël se 50 megavat tonë.

Ky Projektligj ka implikime buxhetore. Vetëm për vitin 2009 është paraparë projekti me vlerë prej 500.000 euro për krijimin e rrjetit për mbikëqyrjen e cilësisë së ajrit në Kosovë, që ndërlidhet me këtë projektligj. Mirëpo, unë mendoj se ministri e sqaroj pjesëmarrjen e buxhetit të Kosovës në këtë projekt, për çka unë e përsëris dhe është mirë të bëhet monitorimi i ndotjes së ajrit në Kosovë. Pra, në fund, Grupi parlamentar i Aleancës Kosova e Re do të angazhohet për të dhënë kontributin e vet nëpër komisionet ku do të shqyrtohet ky projektligj në fazat vijuese. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit! Në emër të LDD-së, deputeti Lulzim Zeneli e ka fjalën.

LULZIM ZENELI: Ju faleminderit, zoti Kryetar!

Një ligj çfarë sot po e diskutojmë, është aq i nevojshëm që Kosova ta ketë në formatin e tillë që, të paktën, për destinim do ta ketë ndryshimin e gjendjes reale apo një angazhim pak më serioz në krijimin e përgjegjësive të reja, të cilat fatkeqësisht në këtë segment në Kosovë mungojnë.

Ajo çka do të duhej sot të plotësonte një gamë të zbrastë ky ligj, kur dihet fakti se Kosova aspiron edhe në aspektin ekonomik, energjetik të ndërtojë kapacitete të reja, atëherë nevoja për këtë ligj është shumë e domosdoshme. Po e them, një ligj kualitativ, çfarë e kanë vendet e rajonit dhe një ligj kualitativ çfarë e kanë vendet të cilat sot me një këmbë janë anëtare të BE-së. E kemi fjalën për vendet, siç është Kroacia dhe të tjerat, të cilat e kanë të avancuar një legjislacion të tillë. Ajo çka i mungon këtij ligji dhe që ky ligj duhet ta ketë, është se ky ligj nuk përmban asnjë masë parandaluese të ndotjes së ajrit. Ky ligj nuk përmban asnjë masë për pakësimin e ndotjes së ajrit. Ky ligj nuk e ka të sqaruar një kapitull që është shumë serioz, që duhet të jetë qendër e këtij ligji, e ato janë masat për detektimin dhe përcjelljen e burimeve që emitojnë ndotje. Ky ligj duhet të detajojë sistemin e monitorimit, i cili do të vendoset në nivel nacional, dhe po ashtu

t'i detajojë përgjegjësitë lokale. Përcjellja dhe monitorimi do të duhej të ishte baza e këtij projektligji, çfarë i mungon. Ajo çka duhet të kemi parasysh se po krijojmë ligje apo po ndërtojmë një legjislacion dhe thirrmi ose është keqpërdorim ose është kamuflim në direktivat e Bashkësisë Evropiane. Mund të merrni me mend nenin 16, pika 1, ku thotë: “përmbajtja e sulfurit në derivate djegëse nuk duhet të tejkalojë 1%”. Ky është përcaktim i politikës së Qeverisë së Kosovës. Mirëpo, unë vetëm dua ta kujtoj ministri, përkatës se nga 1 tetori 1994, në të gjitha vendet e Bashkësisë Evropiane përqindja e sulfurit në derivate djegëse është 02.2% dhe kjo është avancuar më 1 tetor 1996, që përqindja e sulfurit në derivate djegëse është 0.05%. Mund ta merrni me mend se një normë të tillë sa është larg Kosova ta adaptojë dhe plotësojë. Inkurajoj Ministrinë dhe e përshëndes që ka paraparë që me këtë buxhet, me rishikimin e buxhetit të ndajë fonde për krijimin e një sistemi për monitorimin e ajrit, mirëpo duhet ta kemi parasysh se Kosova deri tash nuk ka pasur, është thirr në disa rezultate të cilat kanë qenë tejet dekurajuese edhe ato të mangëta që kanë qenë. Ajo çka kërkohet prej Ministrisë është që ta shtojë efikasitetin e vet, duke e ditur se për vitin që po e lëmë pas, në vitin 2008, vetëm 27% i ka shfrytëzuar mjetet për investime kapitale, derisa ky resor ka nevojë shumë të madhe dhe ka nevojë për investime kapitale në fushën e mjedisit dhe sidomos tash në monitorimin e ndotjes së ajrit, duke përjashtuar edhe segmente tjera, e aq më shumë, që në debatin kosovar po zhvillohet një debat sa i përket ndërtimit të kapaciteteve të reja energetike dhe kemi pasur edhe lajthitje të opinionit lidhur me mundësitë e teknologjive të reja, të cilat do të instalohen në kapacitetet “Kosova e re” dhe mund ta marrim me mend se një teknologji e tillë, qoftë në opinionin shkencor botëror ende nuk është zbuluar. “Carboncatchers” e përdorin shumë ekspertë të ashtuquajtur vendorë, ndërsa në botën perëndimore një gjë e tillë vetëm në vitin 2015 pritet të testohet. Mund ta merrni me mend se ku qëndron problematika, ndërsa një ligj i tillë nuk parasheh norma të tilla. Krejt është lënë hapësirë që me akte nënligjore të rregullohen. Unë e sugjeroj ministrin përkatës që shumë me seriozitet më të madh t'i qaset kësaj problematike për arsye se problematika është shumë komplekse. Unë besoj që Ministria do të gjejë hapësirë dhe forcë që t'i shfrytëzojë edhe kapacitetet që i ka Kosova në këtë fushë. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit, deputet! Në emër të Grupit Parlamentar “7+”, deputetja Shpresa Murati e ka fjalën.

ŠPRESA MURATI: Hvala, predsedniče!

Poštovani ministri,

Kolege poslanici,

Postojeći Zakon o zaštiti vazduha od zagađenja nije ispunjavao uslove i standarde za zaštitu vazduha od zagađenja, što je predstavljalo smetnju za njegovo sprovođenje. S toga je Ministarstvo za zaštitu životne sredine i prostornog planiranja, videlo za shodno da ovaj zakon procesira kao nov.

Odredbe ovog nacrta zakona garantuju prava građana da žive u čistoj životnoj sredini i čistom vazduhu koji je osnov za zdravlje ljudi i čitavog eko-sistema, flore i fauna. Za izradu ovog nacrta zakona, kao osnova je služilo zakonodavstvo Slovenije i Hrvatske. Nacrt zakona je dobro izradjen, sveobuhvatan, detaljno reguliše pitanja iz ove oblasti, s toga ga Parlamentarna grupa „7+“ u načelu podržava. Hvala!

KRYETARI: Ju faleminderit!: Në emër të SLS-së, Mursel Halili

MURSELJ HALJILJI: Gospodine predsedniče,

Dame i gospodo prisutni,

Parlamentarna grupa SLS će podržati u načelu ovaj nacrt zakona. Smatram da je potreban, čak šta više trebalo je mnogo ranije da dodje u skupštinsku proceduru, ali i ovo je dobar pokazatelj da se ide u pravom pravcu. Hvala!

KRYETARI: Atëherë, është radha e deputetëve për diskutim. Fillojmë me deputetn Mimoza Ahmetaj.

MIMOZA AHMETAJ: Ju faleminderit, zoti Kryetar!

Të nderuar ministra,

Të nderuar deputetë,

Ligji në fjalë është më se i domosdoshëm për vendin tonë sepse me këtë do t'u sigurohet qytetarëve tanë të jetojnë në ambient me ajër më të pastër. Ligji i deritanishëm, ashtu siç u përmend nga shumica e deputetëve, nuk ka përfshirë shumë çështje, norma dhe standarde të kërkuara për mbrojtjen e ajrit nga ndotja.

Për rëndësinë e këtij ligji do të thirresha edhe në një hulumtim të cilin e ka bërë Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik kohë më parë, më sakët në prill të këtij viti, me të cilën e përcakton situatën mjaft të rëndë të ajrit, sidomos në Prishtinë, por pa i anashkaluar edhe qendrat tjera industriale në Kosovë. Ky Institut vjen në disa përfundime se ndotja e ajrit në Prishtinë shumë shpesh i kalon normat e lejuara. Shkarkimet nga automjetet, grimcat e suspenduara dhe pluhuri që krijohen në rrugët e kryeqytetit kontribuojnë në rritjen e ndotjes së ajrit duke shkaktuar probleme shëndetësore, si vështirësi në frymëmarrje, probleme në sistemin kardiovaskular, dëmtim të sistemit imunitar, anemi, çrregullime të sistemit imunitar dhe çrregullime të shikimit e tjerë. Rritja e intensitetit të qarkullimit të automjeteve, numri i tyre në rritje, përdorimi i karburanteve pa kontroll me përmbajtje të lartë të plumbit, përdorimi i lëndëve djegëse për ngrohje, ndërtimet pa plan dhe pa leje, afrimi i qendrave të banuara pranë zonave industriale, pakësimi i zonave të gjelbëruara, janë disa nga indikatorët që ndikojnë në rritjen enorme të ndotjes së ajrit.

Si zakonisht, grupet më të ndjeshme të popullatës nga ajro-ndotja janë fëmijët dhe personat me sëmundje kronike, ku si pasojë shfaqen sëmundjet respiratore, astma, alergjia, çrregullimet e zhvillimit mendor, tumoret e fëmijëve dhe çrregullimet endokrine. Në bazë të Raportit të vitit 2008 të këtij Instituti, janë regjistruar gjithsej 13 mijë 136 sëmundje ngjitëse të organeve respiratorë apo 12% nga raportimi total i sëmundjeve ngjitëse. Nga këto përfundime, në konkluzionet dhe në rekomandimet të cilat ky Institut i sjellë, nga 8, në të parën përmendet që urgjentisht do të duhej të përpilohej një plan aksioni për përmirësimin e cilësisë së ajrit dhe të aprovet me procedura urgjente nga Parlamenti ynë.

Dihet mirëfilli se ujërat dhe ajri e kanë rëndësinë e posaçme, përveç faktit që janë burim i jetës dhe shumë shpesh mund të jenë edhe burim i sëmundjeve, ato së bashku nuk i takojnë vetëm një territori, hapësirë, por reflektojnë në gjithë regjionin edhe më lartë, sepse nuk kanë kufij. Domosdoshmërinë e ekzistencës së këtij ligji, po ashtu e bën edhe fakti se në Raportin e parë të progresit të Komisionit Evropian, në pikën 79 përmendet që Kosova ende nuk ka zhvillime që mund të raportojnë në fushën e kualitetit të ajrit dhe po ashtu përmendet mungesa e legjislacionit relevant dhe mungesa e rrjetit të monitorimit të kualitetit të ajrit. Me kalimin e këtij ligji, pritët përfundimi i hartimit të strategjisë për cilësinë e ajrit, gjë e cila është duke u hartuar dhe drafti i parë pritët shumë shpejt të vijë nga Ministria dhe diçka që nuk ka ekzistuar deri më tani, e që do të

pasohet nga rrejtji për monitorimin e ajrit, gjë të cilin Qeveria e ka vënë në prioritet dhe shumë shpejt pritet ardhja e pajisjeve për monitorimin ajrit. Personalisht e përkrah Ligjin, në parim, për rëndësinë vitale që ka në shoqërinë tonë. Ju faleminderit!

Drejtimin e seancës e merr anëtari i Kryesisë, zoti Naim Maloku

KRYESUESI: Ju faleminderit, zonja deputete!

Fjalën e ka deputetja Sanije Aliaj, le të përgatitet deputetja Luljetë Shehu.

SANIJE ALIAJ: Ju faleminderit, zoti kryesues!

I nderuar zëvendëskryeministër,

Të nderuar ministra,

Të nderuar deputetë,

Projektligji për mbrojtjen e ambientit nga ndotja është përpjekje e institucioneve për ta rregulluar mbrojtjen e ajrit nga ndotja dhe rregullimin mjedisor të hapësirës ku jetojmë, por Projektligji bën pjesë edhe në pakon e ligjeve për arritjen e standardeve për integritet e Kosovës në Bashkimin Evropian.

Duke u nisur nga fakti se Ligji ekzistues për mbrojtjen e ambientit nga ndotja 2004/30, nuk i kishte të përfshira standardet dhe detyrimet që dalin nga Direktiva 96/92 për menaxhimin e cilësisë së ajrit, riprocedimin e këtij projektligji e shoh si përkushtim për ta rregulluar këtë fushë më mirë, që qëllim parësor ka ruajtjen e një mjedisi të patër dhe të shëndetshëm.

Projektligji parashikon masa të cilat do të kontribuojnë në përballimin e ndotjeve konform të zhvillimeve të qëndrueshme ekonomike, si dhe sanksionon të drejtat dhe detyrimet e institucioneve për krijimin e standardeve për mbrojtjen e ajrit nga ndotja. Të gjithë e dimë se mbrojtja e ajrit nga ndotja është problem qenësor i Ministrisë për Mbrojtjen e Ambientit dhe Planifikimit Hapësinor. Për momentin, Kosova nuk ka industri të zhvilluar. Trepça ku ka qenë mjedisi që ka prodhuar më shumë ndotje, tani nuk funksionon. Nuk funksionojnë edhe shumë të tjera, përveç Termoelektranës, por deponitë urbane rurale, ku bëhet djegia e hedhurinave ndikojnë në ndryshimin e klimës dhe të mjedisit natyror, prandaj prodhuesit vendorë, importuesit dhe eksportuesit duhet të përqendrohen në uljen e faktorëve ndotës deri në kufijtë e caktuar përmes këtij projektligji. Ndotja e atmosferës ndikon në mjedisin natyror, sepse shkarkimet e ndotësve atmosferikë, që janë zhvillimi i vrullshëm i sektorit të transportit, përdorimi në shkallë të madhe të automjeteve të përdorura, administrimi jo i mirë i mbeturinave urbane, zhvillimi i sektorit të ndërtimit pa plan dhe shfrytëzimi pa kritere i burimeve dhe resurseve natyrore, rezulton me angazhimin e Ministrisë përmes këtij Projektligji me përcaktimin e mënyrave dhe të metodologjisë për përcjelljen e emisioneve të gazrave serë për stimulimin e përdorimit të teknologjisë dhe jetësimin e programeve dhe të projekteve nga ana e Ministrisë, lë shpresë për një të ardhme më të mirë.

Neni 28 i projektligjit rregullon planifikimin e mbrojtjes së ajrit nga ndotja përmes strategjisë së cilësisë së ajrit, planit të veprimit, planeve lokale, si dhe raporteve për zbatimin e planeve që përcakton Ministria e Mjedisit dhe e Planifikimit Hapësinor.

Neni 33 rregullon monitorimin e ndotjes së ajrit. Edhe pse Projektligji për t'u zbatuar do të plotësohet me akte nënligjore të veçanta, konsideroj se Projektligjit duhet shtuar disa nene që definojnë mekanizmat që duhet të kenë përgjegjësi për të bërë monitorimin

e zbatimit të ligjit nga ana e Ministrisë për menaxhimin dhe vlerësimin e cilësisë së ajrit në bashkëpunim me institucionet lokale.

Kurse neni 24 përcakton një varg masash, në rastet ku paraqitet smogu, që është përzierje e mjegullës, të tymit dhe të pluhurit. Ministria ndërmerr masa e nuk ka të definuar përmes këtij Projektligji masat për parandalimin e ndotësve të ajrit dhe për evitimin e tyre.

Unë udhëtoj çdo ditë nga Ferizaj në Prishtinë. Sa të arrij në kryqin e Lipjanit, shoh që Prishtina fillon ditën e re me smog mbi hapësirën e vet qiellore. Ligji i mëparshëm është miratuar dhe ka hyrë në fuqi në vitin 2004, Cilat ishin masat e deritanishme që ka ndërmarrë Qeveria për evitimin e pluhurit të dendur në kryeqendrën e Kosovës nga Termocentrali në Obiliq. Mirë është kur bëhen ligjet, por ato duhet edhe të zbatohen, sepse faktorët e ndotjes çdo ditë po rriten dhe po e rrezikojnë shëndetin e qytetarit dhe po e ndotin atmosferën.

Masat ndëshkuese në projektligj lënë shpresë që në të ardhmen ta kemi një ambient më të mirë. Projektligjin e përkrah në parim, me shpresë që në procedimin e mëtejshëm të bëhet edhe më funksional dhe më i zbatueshëm, që të kemi në të ardhmen një ambient të pastër dhe të shëndetshëm. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit! Fjalën e ka deputetja Luljeta Shehu, le të përgatitet, deputetja Gjylnaze Syla.

LULJETA SHEHU: Ju faleminderit, i nderuari kryesues!

I nderuari zëvendëskryeministër,

Të nderuar ministra

Të nderuar deputetë,

Ndotja e ajrit mbi normat e lejuara vazhdon të shkaktojë situatë alarmante mbi shëndetin e popullatës. Problemi i ndotjes së ajrit nuk po trajtohet me seriozitetin e nevojshëm. Përkundrazi, vazhdon të jetë një problem shumë i rëndë në të gjitha nivelet dhe nuk kemi asnjë strategji reale të shprehur dhe të zbatuar për mbrojtjen e ajrit, i cili në Kosovë është mjaft i ndotur, për mos marrjen e masave reale për bllokimin e ndotjes së tij. Unë mendoj se çështja e mbrojtjes së ajrit nga ndotja nuk po trajtohet ashtu si duhet të trajtohet dhe nuk po e zë vendin që duhet zërë dhe realisht nuk po shoh të ketë një debat të qartë për këtë çështje dhe mendimet e qarta për këtë çështje nga organi përkatës, i cili vazhdon të mos ngrejë probleme. Ka një mungesë në sensibilizimin e opinionit në përfshirjen e tij në mbrojtjen e ajrit nga ndotja. Mjedisi në Kosovë është kthyer në një mjedis me shumë probleme të mëdha, që kërkon një zgjedhje dhe një strategji sa më të shpejtë. Mungon edhe transparenca, sepse organi përkatës nuk publikon të dhëna dhe konceptet e tij.

Unë mendoj se ndotja e ajrit duhet parë në disa nivele për t'u zgjidhur. Këtu kemi të bëjmë me ndotjen nga gazrat toksike, që vijnë nga makinat dhe industria. Në këtë pikë, shikoj se vazhdon përsëri termocentralet të jenë një ndotës i madh i ambientit dhe po ashtu fabrikat e çimentos siç është, për shembull, në Han të Elezit, mandej Obiliqi, Mitrovica, që kanë shkallë më të lartë të ndotjes së ajrit. Së dyti, nuk po tentohet të pengohet ndotja e ajrit nga makinat. Së treti, ndotja e ajrit nga pluhurat me grimcat e mëdha që vijnë nga ndërtimet pa kriter. Kompanitë që ndërtojnë, nuk kanë asnjë detyrim për të krijuar një punë me një ndotje sa më të vogël të mjedisit. Përkundrazi, baltërat dhe pluhurat janë gjithkund. Duhet të ketë interesim të Ministrisë për detyrimin e kompanive

që t'i zbatojnë të gjitha normat që duhet për mbrojtjen e mjedisit. Punimet kryhen në kushtet e trafikut në rrugë.

Së katërti, ndotja e ajrit vjen edhe nga mbeturinat dhe nuk ka asnjë masë sensibilizuese ndaj opinionit të publik. Nuk shoh një vullnet dhe qoftë një zbatim të masave që mjedisi ynë të mos vazhdojë të shkatërrohet, ashtu siç po ndodhë çdo ditë. Duhet urgjentisht të përpilohet një plan aksioni për përmirësimin e cilësisë së ajrit. Largimi i menjëhershëm i automjeteve të vjetra nga qarkullimi, pajisja e të gjitha automjeteve me katalizatorë, përforcimi i rrjetit të trafikut urban me karburant ekologjik, rritja e sipërfaqeve të gjelbëruara të qyteteve dhe shumë alternativa tjera për mundësinë e mosndotjes së mjedisit ku jetojmë. Prandaj, duhet që këtë ligj që po e shqyrtojmë dhe që do të miratohet, të mundohemi ta zbatojmë që të jetojmë në një vend të pastër dhe të shëndoshë. Për ta pasur një ambient të tillë, anëtarët e komisioneve gjegjëse duhet të japin kontributin e tyre, në mënyrë që ky projektligj t'i përcaktojë të dhënat për treguesin e cilësisë së ajrit, zonat e mbrojtura, njoftimet për ndotjen e ajrit e tjerë. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit! I ftoj deputetët që të përqendrohen në ligj. Fjalën e ka deputetja Gjylnaze Syla, le të përgatitet deputeti Driton Tali.

GJYLNAZE SYLA: Ju faleminderit, zoti kryesues!

E nderuara ministre,

Tenderuar ministra,

Deputetë të nderuar,

Sot po flasim për një çështje shumë të rëndësishme, për të cilën e dimë të gjithë se Kosova është një ndër vendet më të ndotura në Evropë, prandaj mbrojtja nga ndotja e ajrit dhe krijimi i cilësisë shumë më të mirë të ajrit, është çështje shumë e rëndësishme për Kosovën. Për ta mbështetur këtë, unë do të bazohem së pari në disa të dhëna.

E para, mjafton vetëm fizikisht të qëndrojmë në Prishtinë ose të shkojmë deri në Kastriot dhe ta ndiejmë vetë se sa është niveli i ndotjes së ajrit. E dyta, janë raportet e ndryshme, siç është Raporti i Iniciativës Kosovare për Stabilitet, e cila thotë se kur termocentralet e KEK-ut punojnë me kapacitet të plotë, prodhojnë 74 herë më shumë emisione se sa lejohen me standardet evropiane. Po ashtu, aktualisht termocentralet lirojnë në atmosferë 25 tonelata pluhur dhe hi. Termocentrali "Kosova A" prodhon një sasi të madhe të dyoksidit të karbonit dhe ndihet ndikimi i tij në shëndetin e njerëzve, sidomos të fëmijëve, të pleqve dhe të grave shtatzënë. Dyoksidi i karbonit është gjithashtu shkaktar numër një i ngrohjes globale. Të dhënat tjera janë - Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike, i cili së voni ka dhënë të dhënat të cilat flasin për shkallën e lartë të emisioneve të materieve, sidomos të dyoksidit të azotit në ajër.

Nga ana tjetër, vetë Organizata Botërore e Shëndetësisë ka treguar në vazhdimësi ndikimin në shëndetin e njeriut që ka ajri ndotur, sidomos në mushkëri, duke filluar nga kanceri i mushkërive, po ashtu edhe në zemër, në sistemin e gjakut, në të pamur, në sistemin imunitar e tjerë. Të gjitha këto të dhëna shqetësuese i tregova për arsyetimin se sa është me rëndësi që Kosova të përqendrohet në mbrojtjen e ajrit dhe në krijimin e një infrastrukture ligjore adekuate. Deri më sot kjo fushë është rregulluar me Ligjin 2004/30 të paraqitur përmes Rregullores së UNMIK-ut.

Bazuar në sqarimet e Ministrisë, Projektligji i ri është sjellë për shkak se ka pasur opstrukcion në zbatimin e këtij ligji ose mangësi të këtij ligji dhe po ashtu pse kanë

dashur të arrihen standardet e BE-së dhe se është bërë një ndryshim aq i madh i ligjit, që është paraqitur nevoja për një projektligj të ri.

Megjithatë, zoti ministër, unë nuk e kam të qartë dhe mendoj që ju në memorandum shpjegues është dashur ta shpjegoni se cilat dispozita ligjore nuk janë zbatuar, çfarë ka penguar të zbatohet dhe sa është e zbatuar ky ligj në praktikë? Këto të dhëna janë të rëndësishme për të ditur që mekanizmat e reja ose dispozitat e reja të ligjit, që ju i keni propozuar, do të jenë më efektive në praktikë dhe do ta rregullojnë këtë fushë, dhe kjo është vërejtja ime e parë.

Sipas vlerësimit tim, nuk është bërë shumë dhe nuk është zbatuar ky ligj në praktikë për të pasur një pasqyrë të qartë se çfarë duhet ndryshuar dhe këtë po e them se mjafton të shikohet se nuk ka ndonjë ndryshim, qoftë në prodhuesit e energjisë, të cilët janë ndotësit më të mëdhenj, apo në numrin e madh të automjeteve që sillen në Kosovë ose edhe në pjesët e gjelbëruara. Ndoshta këtu mund të përmendi vetëm rastin e Kryeministrit, i cili mbolli fidanë, por ja që ajri përsëri është i ndotur.

Sa i përket projektligjit, konsideroj se është dashur njëherë të kemi politika të qarta të mbrojtjes së ajrit, do të thotë, cilat janë ato politika ministër? Sipas projektligjit, mendoj që ky projektligj është shumë i përgjithësuar, shumë çështje specifike, të cilat kanë të bëjnë sidomos me masat e parandalimit nga ndotja apo edhe të vetëmbrojtjes së ajrit, nuk janë përfshirë. Po ashtu, edhe përbërësit e veçantë të ajrit, si bashkëdyzimet organike të avullueshme, të cilat janë kancerogjene apo toksike, që ndikojnë në dëmtimin shëndetit të njeriut, thuhet se përcakton me akte nënligjore të cilat do të zbatohen pas 18 muajve. Pastaj, është e paqartë se cilat janë obligimet e ministrive të veçanta. Përgjatë tërë ligjit thuhet se Ministria e Ambientit përcakton rregullat, kurse Qeveria aprovon, atëherë kush në praktikë, cila pjesë e Ministrisë, cili dikaster i Ministrisë do t'i vë në jetë rregullat të cilat do t'i përcaktojë Ministria. Është shumë e paqartë, duhet të përcaktohet cila ministri çfarë do të bëjë.

Përndryshe, autoriteti qendror për të krijuar standardet dhe detyrimin e respektimit të rregullave në mbrojtjen e ajrit nga ndotja është Ministria. Mendoj se edhe masat e monitorimit, zoti ministër, nuk janë të mjaftueshme dhe është dashur të jenë më të fuqishme. Pastaj, një pjesë e ligjit që flet për detyrimet e përgjithshme, burimet e ndotjes, thuhet se për ndërtimin e impianteve të reja dhe për renovimin e impianteve ekzistuese duhet të përdoren teknologji më të mira të mundshme. Kjo nuk mjafton për zbatimin e këtij ligji ose për të siguruar ajër cilësor.

Tjetra është se Ministria e Transportit bën disa rregulla që kanë të bëjnë me mbrojtjen e ajrit gjatë përdorimit të motorëve me djegie të brendshme, që i bien automjeteve. Në qoftë se është kështu, si do të bëhet atëherë harmonizimi dhe bashkëpunimi ndërmjet Ministrisë suaj dhe Ministrisë së Transportit apo edhe të ministrive të tjera.

Sa i përket harmonizimit me legjislacionin e BE-së, konsideroj se ky është i pjesërishëm edhe pse me projektligj tentohet të përafrohet me dy direktiva të BE-së 96/62 për menaxhimin e cilësisë së ajrit dhe të Direktivës së BE-së për SO<sub>2</sub>, NO<sub>2</sub>, oksidet e azotit dhe grimcat e tjera të suspenduara në ajër dhe mjedis. Këto nuk janë të mjaftueshme, sidomos duke marrë parasysh faktin se BE-ja tani po bën legjislacion të ri për eliminimin e ndotjes nga industritë e rënda, si të çelikut, impiantet e energjisë dhe rafineritë, ashtu që do të përmbushë standardet e reja deri në vitin 2016. Pra, BE-ja është duke bërë paketë legjislative, e cila përmban 7 ligjet ekzistuese për cilësinë e

ajrit. Edhe pse thuhet në projektligj se nuk priten implikime buxhetore, megjithatë në qoftë se zbatohen standardet e BE-së, duhen mjete shtesë buxhetore për projektet e caktuara. Unë propozoj që të krijohet një fond për tërheqjen e investimeve, bashkëfinancimeve për projektet e mëdha dhe jo ashtu siç keni propozuar ju, që të merren nga buxheti i Kosovës.

Zoti ministër,

E kam një pyetje për Ju, për të ditur se sa do të zbatohet në praktikë ky Ligj. Na tregoni se a është siguruar shuma prej gjysmë milioni për krijimin e rrjetit për monitorimin e cilësisë së ajrit në Kosovë, meqenëse në shqyrtimin e buxhetit që kemi pasur dje, nuk ka ekzistuar në pasqyrën e buxhetit një gjë e tillë, nuk ka ekzistuar gjysmë milionëshi për këtë, prandaj duhet ta dimë se a i keni siguruar këto?

Në fund, a mund të na informoni se a janë ndarë ose paraparë mjetet për strategjinë dhe planin e veprimit, meqenëse këto janë qenësore për zbatimin e këtij Ligji. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Fjalën e ka deputeti Driton Tali, le të përgatitet deputetja Zylfije Hundozi.

DRITON TALI: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar të pranishëm,

Unë këtë ligj e lexova dhe mund të them se kjo mund të jetë çdo gjë, por jo ligj. Mendoj se Qeveria tash ka filluar edhe të bëhet cinike. Na sjellë një ligj në kohën kur është hapur debati për “Kosovën e Re” që drejtpërsëdrejti e konfronton këtë ligj dhe e bën të kotë këtë ligj dhe ne këtu humbim kohë, flasim, kallëzojmë përralla për bukuritë tona natyrore, për ujërat tona të pastra, ujërat tona të pasura e tjera e tjera, por esenca është në kundërshtim. Andaj, mos të bëjmë hajgare, ta heqim këtë ligj krejt, sepse edhe ashtu nuk është ligj, Ligji nëse nuk ka standarde, nëse nuk ka norma, nuk është ligj. Kjo jetë sikurse një tekst i diturisë natyrore. Vetëm shikoni se çka shkruan në nenin 19 për mbrojtjen e shtresës së ozonit, thotë: “Mbrojtja e shtresës së ozonit ka të bëjë me substancat që e dëmtojnë shtresën e ozonit, prodhimet dhe pajisjet që i përbëjnë këto substanca”, mos ta lexoj krejt, tamam tekst i librave shkollorë.

Përmenden këtu në faqe 13, se janë lexuar, po them direktivat që dalin nga acqius-communitaire. Përmenden disa direktiva, do me thënë të vitit '96, të Këshillit të Evropës, dhe direktiva të vitit '99. Por, ato janë tejkaluar tash, i kemi direktivat e vitit 2001 që kërkah hiq nuk jemi. Është, për shembull, kjo Direktiva e Unionit Evropian për Uzinat me Djegie të Larta, e cila automatikisht e kundërshton nivelin e ndotjes së “Kosova B”, e mos të flasim për “Kosovën e Re”. “Kosova B” i tejkalon normat për 10 fish, ndërsa “Kosova A” i tejkalon 40 fish, dhe këto standarde duhet të implementohen deri në vitin 2020. Do të thotë, dikush atje në Ministrinë e Mbrojtjes së Ambientit i ka ditur këto sende, andaj na ka sjellë një ligj tra-la-la, tra-la-la pa asnjë normë, pa asnjë standard. Unë po befasohem me zotin Lulzim Zeneli, si njohës i kësaj lëmie që është, kurrë nuk tha. Madje, madje edhe e përkrahu. Unë nuk jam që nuk e përkrah ligjin, i cili është për mbrojtjen e ambientit, ama ligj të jetë për mbrojtjen e ajrit. Ky ligj nuk mbron kurrë, kur nuk e përmend asnjë normë. Vetëm një statistikë e përmend dhe ajo është e tejkaluar. Pra, 1% e sulfurit në lëndët djegëse. Do të thotë, ne as standardet e viteve '70 të Unionit Evropian nuk mund t'i përmbushim. Paramendo tash për vitin 2020, kur në 2020 do të ndërtohet termocentrali “Kosova e Re” me 2000 megavat, do të thotë ne e dimë që për një megavat rrymë kërkohet një ton linjit të Kosovës, një ton

linjit i Kosovës i ka 17% hi, do të thotë një llogaritje të thjeshtë ta bëjmë për ta ndërtuar një megavat të tillë, mbesin rreth 3.4 tonë hi për një orë dhe ju më tregoni mua, zoti ministër, a i keni paraparë këto?

Pastaj, a i keni paraparë standardet për emitimin e NOx dhe SO2 dhe të hirit fluturues dhe më tregoni se ku i keni qitur ato standarde për ta bërë ligj këtë projektligj. Unë nuk jam i interesuar për të lexuar libër të diturisë natyrore këtu, të më tregohet se ndotja e ajrit është e keqe, është e dëmshme, eureka. Këtu vijnë edhe kritika e RTK, u prek shkarazi ç'ka të bëjë me këtë ligj dhe ka të bëjë me detyrën e atij institucioni si Televizion publik pikërisht me termocentralin kosovar, që pikërisht bie në kundërshtim të drejtpërdrejtë, shumë të vrazhdët me këtë projektligj, po i themi projektligj, se nuk është projektligj. Shkojnë, manipulohet atje me thëngjill të pastër, u përmend këtu "kapja e karbonit" që po e zëmë në vitin 2015 po "kapet karboni" me teknologjitë e sofistikuar në përfundim, se në Kosovë hiq se hiq, por çka do t'i bëjmë ati karboni, ku do ta deponojmë?

Flitet për thëngjill të pastër, thëngjill të pastër ende në universitetet e njohura nuk janë duke mundur ta prodhojnë, e lëre më 2015 të fillojë "Kosova C" me thëngjill të pastër. "Kosova C" që do të përdorë linjit të Kosovës me vlerë të pastër kalorifike 6.28 deri 9.21 megaxhul për kilogram, ndërsa thëngjilli i dobët mesatar e ka 23 deri 38 megaxhul për kilogram, do me thënë është për rreth 375% më i dobët dhe kjo 375% më i dobët nënkupton NOx më shumë, nënkupton dyoksid karbonit më shumë, nënkupton monoksid të karbonit më shumë, do me thënë të gjithë këto gazra të cilat janë shumë mirë të sakta, të parapara dhe të ndaluara në direktivat e Unionit Evropian, atje ku dëshirojmë ne të shkojmë. Tash Kosova i injoron ato, mundohet t'i imponojë rregulla Unionit Evropian. Thotë njeriu se Unioni Evropian është në zor për neve, e jo ne në zor për Unionin Evropian. Andaj, po ju them sinjerisht, mos t'ua sheh dikush këtë projektligj, se ky nuk është projektligj, mund t'i thoni çka të doni. Derisa nuk ka standarde, derisa nuk ka norma që të ndalojë diçka ligji, aty është kuptimi i ligjit. Ky është muhabet i thate, nuk bën të ndotet ambienti, duhet ta ruajmë ambientin, këto i lëmë për në shkollat fillore, atje profesorët t'i edukojnë nxënësit. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, deputet! Fjalën e ka deputetja Zylfije Hundozi dhe i fundit të përgatitet deputeti Riza Smaka.

ZYLFIJE HUNDOZI: Zoti kryesues,

Zotëri ministra,

Kolegë deputetë,

Ndotja e ajrit është problem me të cilin përballen shumë shtete, por tanimë ai është një problem global e jo vetëm i shteteve veç e veç. Në Shqipëri, në statistikën e fundit mësojmë se 1400 njerëz vdesin nga kanceri në vit dhe si shkaktar numër një konsiderohet ndotja e ajrit. Te ne në Kosovë, për shkak të mosfunksionimit të mirëfilltë të sistemit informativ në shëndetësi, Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik nuk ka dalë me shifra konkrete, por nga eksperiencia e përditshme e mjekëve që merren me shërimin e sëmundjeve respiratorë, mund të thuhet se edhe te ne ky numër nuk është i vogël. Kështu që ka qenë koha e fundit, që një ligj për mbrojtjen e ajrit të vjen në Kuvendin e Kosovës.

Gjer më tash nuk ka pasur kurrfarë mbrojtje të ajrit në mënyrë institucionale nga ndotësit e ndryshëm. Kjo gjë iu është ë lënë në ndërgjegje qytetarëve dhe si rezultat për shëndetin e njeriut i përmenda më parë. Mos rregullimi i mbrojtjes së ajrit nga ndotja nga

ana institucionale, është paraqitur edhe si vërejtje në Raportin e progresit të Komisionit Evropian të vitit 2008. Është shqetësuese se harmonizimi, gjegjësisht vlerësimi i këtij projektligji për përafrimin me ligjet e njëjta me ato të Bashkimit Evropian, nuk mund të bëhet plotësisht nga ana e Parlamentit tonë, gjegjësisht Komisionit për Integritet Evropian, se shumë veprimtari që mbështeten në direktivat e Këshillit të Evropës, të datës 96/62 dhe të datës 27 shtator 1996 mbi vlerësimin dhe menaxhimin e cilësisë së ajrit në mjedis, do të rregullohet me akte nënligjore, të cilat Komisioni për Integritet Evropian nuk do të mund t'i rishikojë, kështu që frikohem se ky ligj do të kthehet prapë në Kuvendin e Kosovës, atëherë kur Kosova të nënshkruaj marrëdhënie kontraktuese me Bashkimin Evropian. Por, e kam edhe një shqetësim. Ligjet që kalojnë nëpër Kuvendin e Kosovës nuk zbatohen në jetën e përditshme dhe kjo çështje ka qenë, gjithashtu, vërejtje në Raportin e progresit të Komisionit Evropian. Kjo gjë u vërtetua edhe dje në debatin për Projektligjin për buxhet, ku morëm vesh se Qeveria ka ndarë 12 milionë euro për blerjen e veturave. Të gjitha këto me kubikazhë të madhe, të cilat e ndotin ambientin më tepër se automjetet e thjeshta, gjë që e ka bërë Prishtinën qytetin më të ndotur në Kosovë.

Mendoj se Qeveria duhet ta rishikojë këtë vendim. Kur kryetarët e shteteve të Bashkimit Evropian shkojnë me biçikleta në vendet e punës, munden edhe ministrat dhe kryeministri ynë t'i zëvendësojnë automobilat me biçikleta dhe kështu të japin shembull për qytetarët se si duhet të ruhet ajri nga ndotja. Është e qartë (por jo, mos qeshni, se përnjëmend duhet këta të jenë së pari shembull për qytetarët e të tjerët i përcjellin) edhe nga diskutimet e kolegëve më herët se ky ligj ka nevojë për një rishikim dhe përpunim të detajizuar. Rekomandoj që Ministria të fuqizojë me këtë ligj institucionet që do ta bëjnë monitorimin e ndotjes së ajrit, që mund të vjen nga kapacitetet e reja energjetike dhe t'i monitorojë ndotjet që janë duke u bërë nga kapacitetet e vjetra të blloqeve të termocentraleve dhe të Ferronikelit. Të respektohet parimi - ndotësi paguan. Ne dëshirojmë që ta shohim Kosovën në Bashkimin Evropian. Prandaj, të bëhen publike rezultatet e monitorimit të ajrit në Kosovë, që të gjithë ta dimë se sa jemi të eksponuar. Ju faleminderit!

**KRYESUESI:** Për replikë është paraqitur deputeti Lulzim Zeneli, por me vonesë zoti deputet, herën tjetër shtype pullën!

**LULZIM ZENELI:** Replika ishte ndaj deputetit Driton Tali, se u lidh me diçka që ndoshta nuk e kemi sqaruar. Ne e shohim të nevojshme, qoftë si komision parlamentar, qoftë edhe si deputetë, që ta kemi një ligj më kualitativ, të paktën t'iu përafrohet atyre standardeve çfarë do t'i dëshironim në vitin 2015. Me këtë projektligj nuk garantohet ndryshimi i gjendjes, ne e themi, mirëpo ajo çka ne na nevojitet, na nevojitet të paktën një bazë, një nismë për të ecur. Unë jam shumë i vetëdijshëm se nuk plotëson asnjë direktivë, asnjë standard evropian, mirëpo ne duhet të krijojmë kritere, të paktën unë mendoj kesi soji, në bazë të brumit çfarë e kemi këtu.

Aktualisht, Qeveria e Republikës së Kosovës nuk e ka prioritet mjedisin, ne jemi këtu koshientë, për arsye se çështjet që kanë të bëjnë me zhvillimin ekonomik, nuk tërhiqen nga ana e parimit të qëndrueshmërisë ekologjike, ekonomike dhe sociale. Këtë parim, kujtoj që duhet ta ndjekim edhe me këtë ligj. Unë besoj që komisioni funksional do të ketë mjaft kohë për ta bërë, mirëpo ajo çka tha Driton Tali pak më herët, ka të bëjë me dokumentet të cilat unë besoj që Kuvendi i Kosovës duhet t'i diskutojë dhe ajo ka të bëjë me strategjinë, me vlerësimin strategjik mjedisor, që pritët të vijë nga ana e Qeverisë për kapacitetet e reja energjetike dhe vlerësimin e ndikimit në mjedis, që duhet ta bëjnë Qeveria lidhur me çdo impiant që i tejkalon mbi 50 megavat. Prandaj, të gjitha këto

inkorporohen në këtë ligj, mirëpo janë tema të cilat duhet të ndahen. Është një specifikë që kujtoj që duhet të trajtohet në mënyrë më gjithëpërfshirëse. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ka të drejtë kundër replikë Driton Tali një minutë, ju lutem!

DRITON TALI: Unë për aq sa di, zoti kryesues, ligji duhet të ndalojë diçka, për atë është ligj, apo të lejojë diçka. Ky ligj nuk ndalon kurrëgjë hiq. Tash mua më vjen keq nëse Lulzim Zeneli ka punuar në këtë ligj dhe nuk dua ta..., por ky ligj nuk rregullon asgjë përveç që na shpjegon se duhet ta mbrojmë ambientin. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Jo, nuk ka më replikë, Lulzim! E pate të drejtën. Deputeti Riza Smaka e ka fjalën. Urdhëroni, deputet Riza Smaka, e kenë fjalën!

RIZA SMAKA: I nderuari, zoti kryesues,

Zoti Kryeministër,

Ministra,

Deputetë të nderuar,

Nuk mund të vihet në diskutim se do të duhej, do të duhej... Është një dokument ligjor tepër i nevojshëm, padyshim tepër i nevojshëm. Thjeshtë thënë, ajri në Kosovë është tepër i ndotur, ndotet për çdo ditë pamëshirshëm dhe dëmtohet e rrezikohet shëndeti i qytetarit të Kosovës, i cili mjerisht kurrfarë mbrojtje shëndetësore nuk ka nga shkaku më i thjeshtë se nuk ka as sigurim shëndetësor. Prandaj, do të duhej që në konceptin e ligjit të ndërtoheshin aso dispozita me të cilat do të angazhoheshin më shumë titullarë bartës obligativ, debitorë për ta aplikuar këtë ligj jo vetëm, po e zëmë, një apo asnjë.

Nga titulli i ligjit nuk reflektohet se është fjala për ligj të ri apo për Ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për mbrojtjen nga ndotja. Kjo del nga dispozita e nenit 41 të këtij ligji. Kadastra për ajrin nuk do të duhej të mbaronte me referim Agjencionit për Statistikë, se ajo, natyrisht, statistika ka nevojë për këto të dhëna...(Zoti kryesues, mundësisht pak le të disiplinohen kolegët, se po flasin shumë, po bëjnë shumë zhurmë, po ia humbin autoritetin Kuvendit të Republikës së Kosovës, seancës, mirë është që të jemi të disiplinuar)...dhe përfundimisht, për t'u aplikuar një ligj duhet të ketë sanksione dhe duhet të precizohet titullari i cili do të ishte i obliguar për implementimin e sanksioneve, që nuk është rasti konkret. Në vigjiljen e reformës në gjyqësor pritet me bazë që gjykatat kundërvajtëse të abrogohen dhe më pastaj, po e zëmë, ende nuk është dizajnuar koncepti se cilat gjykata apo cilat institucione do t'i aplikojnë sanksionet kundërvajtës. Së paku në këtë ligj ishte dashur të precizohet përderisa do të bëheshin ndryshimet, ndryshimet do të bëheshin, më pastaj do të aplikoheshin ato ndryshime dhe plotësime. Përfundimisht, unë angazhohem që këtë ligj ta përpunojmë në procedurën që na pret, me seriozitet të madh dhe t'i precizojmë edhe sanksionet, se janë dhënë kuturu, si të them, disi duket është përshtypja me një ngutshmëri apo mungesë të durimit elementar për t'u koncentruar, për ta bërë një punë të mirë. Ta bëjmë një ligj të mirë dhe ta sigurojmë aplikimin e tij nëpërmjet instrumenteve që do t'i kishim inkorporuar në këtë dokument. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit! Kryeministri Hashim Thaçi e ka fjalën.

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: Ju faleminderit, zoti Maloku!

Të nderuar deputetë,

Pasi që këtu u ngritën çështje edhe sa i përket ndotjes së ambientit, po pasi përsëri nuk po mund t'i iket temës së energjetikës dhe privatizimeve, dëshiroj t'i them dy-tri fjalë.

E para, mendoj që duke e vlerësuar kontributin e secilit sa i përket përmirësimit të ambientit. Qeveria e Republikës së Kosovës ka ndërmarrë masat e nevojshme, veprimet e nevojshme dhe ka vizion të qartë për këtë çështje. Përkundrazi, këto përkushtime kanë bërë që t'i rrisim edhe investimet për ambient, për zgjerimin e hapësirave të gjelbërimit dhe kemi filluar me moton "Një qytetar, një fidan" dhe tepër mirë që ata kritikues që tash po i përmendin, ata fidanë veç kanë filluar të rriten dhe t'i japin frytet e veta dhe unë besoj se do të sjellin freski edhe në taborin kundërshtues, por ky aksion do të vazhdojë edhe në të ardhmen dhe jemi të vendosur dhe për mua dhe për Qeverinë që të punojmë bashkërisht. Ambienti është një prej pikave apo prioriteteve prej më kryesorëve dhe shëndeti i njerëzve, natyrisht, dhe do të vazhdojë edhe në këtë vit, por do të vazhdojë edhe në vitet e ardhshme. Ndërsa, sa i përket sektorit të energjetikës dhe disa çështjeve tjera, duhet të them se në procesin e ndërtimit të termocentralit "Kosova e Re", i kam theksuar kapacitetet dhe tash e dimë të gjithë -1000 megavat plus 1000 megavat me një partneritet shumë unik, shumë të qëndrueshëm, shumë efektiv me të gjithë partnerët më relevantë ndërkombëtarë.

Kemi arritur që të kemi qartësim të procesit edhe të periudhës kohore, por edhe të standardeve, të periudhës kohore për fillimin e ndërtimit të termocentralit "Kosova e Re", gjithashtu për procesin e privatizimit të "Kosovës B", por me insistimin, gjithashtu, të Qeverisë së Republikës së Kosovës edhe për periudhën kohore të mbylljes së ndotësit më të madh në Kosovë - Termocentralit "Kosova A", që planifikohet të mbyllet diku në vitin 2014.

Shoh, gjithashtu, që ka pretendime kundërshtuese edhe për ndërtimin e termocentralit të Zhurit, që gjithashtu është një projekt madhor që do të sjellë investitorë ndërkombëtarë për mbi 300 milionë euro, me një kapacitet prej 300 megavatësh. Shoh, gjithashtu, pretendime kundërshtuese për privatizimin e distribuimit të KEK-ut edhe të Valës, por edhe kundërshtimin e koncesionit të Aeroportit.

Unë dua të theksoj sa i përket termocentralit "Kosova e Re" se termocentrali "Kosova e Re" do të jetë model i standardeve të termocentraleve në Evropën Juglindore, sa i përket edhe ambientit, do të jetë model. Ndërsa, sa iu përket kundërshtimeve për privatizim, dua të theksoj se definitivisht këtu i kemi dy koncepte: konceptin shumë të qartë të qëndrimeve, që kemi si koalicion djathtistë, dhe qëndrimin të mentalitetit të së kaluarës, apo ultra majtistë të ekonomisë së planifikuar. Ju faleminderit, shumë!

**KRYESUESI:** Ju faleminderit!

E dëgjuat përfaqësuesin e Qeverisë.

Të nderuar deputetë, ka marrë fund debati. Sipas Rregullores të Punës së Kuvendit unë punoj. Përfaqësuesi i Qeverisë, ishte Lulzim! Ju faleminderit, Mimoza Ahmeta gjithashtu, ju faleminderit! Kërkoj të konfirmohet prezenca në sallë.

(Reagime nga salla)

Ju e keni pasur mundësinë në fillim, si kryetar i komisionit funksional, zoti Zeneli. Ne nuk kemi kuorum. Janë 58 deputetë në sallë. I ftoj deputetët që të kthehen në sallë për shkak se kemi hyrë në procedurë të votimit.

(Reagime nga salla)

Përndryshe, unë jam i detyruar ose të vazhdoj debatin me pikën tjetër, ose ta përfundoj seancën dhe të vijmë të hënën pastaj prapë. Si të doni, unë nuk mundën të vijë. Lus regjinë që t'i ftojë deputetët në sallë!

Ne mund të vijmë nesër prapë, nuk ka problem. Na kemi hyrë, ky është vazhdim i seancës, seanca duhet të përfundojë.

(Ndërprerje e shkurtër e incizimit)

Lus deputetët dhe regjinë që të përgatitemi për votim. Pra, votojmë në parim Projektligjin për mbrojtjen e ajrit nga ndotja.

Votojmë, tash.

Ju faleminderit!

Konstatoj se me 61 vota “për”, 11 “kundër” dhe 1 abstenim, është miratuar në parim Projektligji për mbrojtjen e ajrit nga ndotja. Në sallë ishin 70 deputetë.

Në bazë të Rregullores së Punës, Kuvendi i ngarkon këto komisione:

- Komisionin për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural dhe Planifikim Hapësinor, si komision funksional,
- Komisionin për Legjislacion dhe Gjyqësi,
- Komisionin për Buxhet dhe Financa,
- Komisionin për Komunitete dhe
- Komisionin për Integritet Evropian

Komisionet duhet që brenda 2 muajve nga shqyrtimi i parë, Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime.

Të nderuar deputetë, janë dy kërkesa: Komisioni për Buxhet dhe Financa dhe Komisioni ad-hoc për RTK-në, që të merret një pauzë. Unë i ftoj anëtarët e këtyre komisioneve që të dalin nga salla dhe nëse kemi kuorum për debat, unë e lus Kuvendin që ta vazhdojnë debatin me pikën e ardhshme të rendit të ditës, në mënyrë që seancën ta përfundojmë sot dhe mos ta vazhdojmë nesër.

(Ndërprerje e shkurtër e incizimit)

I lus deputetët që t'i zënë vendet e punës. Lus deputetët që janë në sallë t'i zënë vendet e punës.

Kalojmë në pikën e shtatë të rendit të ditës:

## **7. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për financimin e programeve të veçanta të banimit**

Konstatimet hyrëse:

Në bazë të Rregullës 35 pika 1 të Rregullores së Punës, janë përmbushur kushtet për shqyrtim... (Lus deputetin Demalijaj që ta zë vendin e punës. Po të lutem po, ose po e ndërpresim dhe vijmë një ditë tjetër)... janë përmbushur kushtet për shqyrtim dhe miratim në parim të këtij Projektligji. Ftoj ministrin e Mjedisit dhe të Planifikimit

Hapësinore, zotin Mahir Yagcilar, që në emër të Qeverisë së Republikës së Kosovës, para deputetëve të Kuvendit ta prezantojë Projektligjin. E keni fjalën, zoti ministër!

MINISTRI MAHIR YAGCILAR: Ju faleminderit, zoti kryesues!

I nderuar kryesues,

I nderuar Kryeministër,

Të nderuar ministra,

Të nderuar deputetë,

Banimi është çështje vendimtare për stabilitet social, shëndet dhe zhvillim kualitativ të mirëqenies së shoqërisë njerëzore të çdo vendi. E drejta në banim gjithnjë e më shumë është prezent në kuadër të politikave globale për rregullimin e politikave sociale të banimit, si dhe e rregulluar me konventa ndërkombëtare.

Banimi si shfrytëzuesi më i madh i hapësirës ndikon në rrjedhën e zhvillimit të gjithmbarshëm të shoqërisë dhe njëherësh është komponentë e rëndësishme e zhvillimit socio-ekonomik, gjegjësisht të standardit jetësor. Sektori i banimit është segment i gjerë dhe kompleks i cili ndërlidhet edhe me sektorë të tjerë të shoqërisë.

Gjatë luftës 1998/99 sektori i banimit dhe i ndërtimit, përkatësisht fondi i banimit në Kosovë është dëmtuar plotësisht ose pjesërisht për 27% ose rreth 120.000 shtëpi të shumës së përgjithshme të fondit të banimit. Ndërtimi i objekteve banesore me karakter social ka filluar në vitin 2003 nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor. Është koofinancuar nga komunat, Qeveria dhe donatorët, të cilat banesa iu dedikohen familjeve të pastrehë të cilat jetojnë në qendrat kolektive të përkohshme dhe atyre që nuk kanë përfituar nga procesi i rindërtimit të shtëpive nga donatorët, kurse përparësi në sigurimin e strehimit kanë kryesisht femrat kryefamiljare, fëmijët bonjakë e të tjerë.

Nga ky program gjatë katër viteve Ministria e Mjedisit dhe e Planifikimit Hapësinor, në bashkëpunim me komunat dhe donatorët, ka realizuar 9 projekte për ndërtimin e objekteve banesore për banim social me mbi 200 banesa në këto komuna, si: Skenderaj, Deçan, Mitrovicë, Klinë, Malishevë, Gjilan, Gjakovë, Obiliq dhe Lipjan.

Të nderuar deputetë,

Përmes këtij Projektligji si instrument ligjor, krijohen parakushtet për banim të qëndrueshëm për të gjithë qytetarët e Kosovës, duke marrë parasysh edhe nevojat për banim të familjeve që jetojnë në kushte joadekuate të banimit, si dhe krijimin e një sistemi funksional, nga i cili do të udhëhiqen programet dhe asistencë e shtetit në fushën e banimit, për rregullimin e çështjes së banimit për kategoritë e popullatës të cilat në mënyrë vetanake nuk mund të sigurojnë banim të përshtatshëm dhe të qëndrueshëm.

Me fjalë të tjera, ky Projektligj synon të rregullojë dhe të udhëheqë programe të sigurimit të banimit për kategoritë e ndryshme sociale të popullsisë me të ardhura të ulëta përmes subvencionimit të qirave sociale, si dhe në sigurimin dhe rregullimin e truallit me infrastrukturë e të tjera. Ligji për financimin e programeve të veçanta të banimit përcakton rregullat dhe procedurat administrative mbi mënyrën e planifikimit, të administrimit dhe të sigurimit të programeve të veçanta për banim social për grupe të qytetarëve, të cilat nuk e kanë të zgjidhur çështjen e banimit apo nuk kanë hapësirë të mjaftueshme për banim për të gjithë qytetarët e Kosovës, në mënyrë të barabartë dhe jo diskriminuese.

Ky Projektligj trajton dhe rregullon çështjen e banimit, si në vijim: programet e veçanta të banimit, duke përfshirë ndërtimin e banesave për banim kolektiv social dhe dhënien e të njëjtave me qira. Subvencionimin e qirave nga tregu i lirë, programet për pajisjen e truallit me infrastrukturë, përcaktimin e kritereve dhe të procedurave për përzgjedhjen e familjeve përfituese sipas ligjit, por gjithashtu për financimin e programeve të veçanta të banimit të përshkruara në këtë Projektligj. Gjithashtu, menaxhimin e programeve të veçanta të banimit, duke i identifikuar autoritetet përgjegjës për implementimin e programeve dhe menaxhimin e të njëjtave.

Format e asistencës së zgjidhjes të nevojave të banimit, të planifikuara përmes këtij ligji, bëhet përmes ndërtimit të banesave për banim social dhe dhënien e tyre me qira për qytetarët me të ardhura të ulëta dhe gjithashtu subvencionimin e qirave nga tregu i lirë i banesave.

Politikat dhe financimi i programeve të veçanta të banimit bazohen në praktikat dhe përvojat e vendeve të rajonit dhe të Bashkimit Evropian.

Të nderuar deputetë,

Ju ftoj që ta votoni Projektligjin, në parim, dhe besoj që me kontributin e juaj ky Projektligj do të jetë më i mirë dhe i kompletuar. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti ministër! Hapi debatin për diskutim në parim. Kryetari ose raportuesi i Komisionit funksional për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural dhe Planifikim Hapësinor nuk e ka kërkuar fjalën.

Përfaqësuesit e grupeve parlamentare. Në emër të PDK-së, unë e shoh këtu, Sala Berisha Shala e ka fjalën.

SALA BERISHA SHALA: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Përsëritet, zoti Kryeministër Thaçi!

Të nderuar Kabinet qeveritar dhe ju kolegë deputetë dhe ju gjithë të pranishëm,

Kemi në shqyrtim të parë Projektligjin për financimin e programeve të veçanta të banimit. Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e ka shqyrtuar dhe analizuar me vëmendje këtë projektligj dhe e ka mbështetur fuqishëm, në parim.

Sipas këtij projektligji, për familjet të cilat nuk kanë mundësi financiare të bëjnë pagesën e qirasë, shteti subvencionon deri në 50% të shumës së qirasë që duhet të paguaj familja. Subvencionimi i qirasë, që përfiton çdo familje, bëhet nga të ardhurat e komunave dhe me aprovimin e kuvendit komunal. Komuna që nuk arrin të realizojnë të ardhura të mjaftueshme, mund të financohen nga Buxheti i Kosovës. Për më tepër, me këtë projektligj Qeveria e Kosovës vazhdon të tregojë, përkatësisht të shpreh përkushtimin dhe interesimin për grupet e caktuara të qytetarëve, të cilët me buxhetin e tyre familjar nuk arrijnë ta zgjedhin çështjen e banimit të qëndrueshëm.

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e mbështet në parim. Kontributin e mëtejshëm do ta japim në komisionin funksional, gjatë fazës së amendamentimit. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, ftoj deputeten Fatmire Berisha ta marrë fjalën.

FATMIRE BERISHA: Jo, më falni, unë jam paraqitur si diskutuese.

KRYESUESI: Anita Morina Saraçi e ka fjalën.

ANITA MORINA SARAÇI: Ju faleminderit, zoti kryesues!

I nderuar Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës e ka shqyrtuar Projektligjin për programet e veçanta të banimit. Mendojmë se është i rëndësishë së veçantë pasi që përmes këtij projektligji krijohen kushte më të mira për familjet ekonomikisht të dobëta, të cilat mund të përfitojnë nga programet e veçanta të banimit. Kategorizimi i këtyre familjeve do të bëhet nga kuvendet komunale dhe ne mendojmë se me qenë se subvencionimi bëhet nga Qeveria, komuna dhe donatorët e tjerë, atëherë për kategorizimin e familjeve duhet të formohet një komision i përbashkët nga Qeveria, gjegjësisht Ministria për Mjedis dhe Planifikim Hapësinor dhe komunat, në mënyrë që ky kategorizim të jetë më transparent.

Grupi parlamentar i LDK-së e mbështet në parim këtë projektligj.

KRYESUESI: Ju faleminderit, deputete!

Më lejoni që të kufizohem për pak qaste nga roli i kryesuesit dhe në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së të mbështes në parim këtë Projektligj. Edhe në mandatet e kaluara qeveritë kanë pasur qasje konstruktive dhe kanë investuar në ndërtimet e tilla për nevojat e veçanta, ka qenë barrë kryesisht e Ministrisë për Mjedis dhe Planifikim Hapësinor dhe Ministrisë për Punë dhe Mirëqenie Sociale. Është mirë që sot, pra, para deputetëve të Kuvendit ka ardhur miratimi i këtij ligji, që të gjitha këto ndërtimet në të ardhmen, pra, të kenë bazën ligjore dhe mos të ketë probleme me të cilat janë ballafaquar komunat dhe ministrinë gjatë procesit të financimit dhe pastaj ndarjes së këtyre banesave.

Pra, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së mbështes në parim këtë projektligj. Ju faleminderit!

Të nderuar deputetë, vazhdojmë. Në emër të Grupit parlamentar të AKR-së, deputeti Hëset Cakolli e ka fjalën.

HESET CAKOLLI: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar ministra,

Të respektuar kolegë deputetë,

Projektligji për financimin e programeve të veçanta të banimit është i një rëndësie të veçantë, sepse krijon kushte për banim të veçantë për familjet ose individët të cilët nuk kanë mundësi ekonomike t'i përballojnë ofertat e tregut të lirë të banesave.

Të nderuar deputetë,

Ne jemi dëshmitarë se edhe më tutje në Kosovë një numër i caktuar i njerëzve jetojnë në kushte të shumta të vështira banimi. Prandaj, në të ardhmen besojmë se ky ligj do të rregullojë çështjen e banimit për këtë kategori të njerëzve. Ky projektligj ka gjithsej 28 nene. Neni 4 i këtij projektligji i përcakton kategoritë e familjeve që mund të përfitojnë nga programet e veçanta të banimit, ndërsa neni 6 përcakton kufirin minimal dhe maksimal të të ardhurave për familjet që mund të përfitojnë nga programi për banesa me qira.

Në nenin 17 pika 1, thuhet se programet e banimit mund të financohen nga tre financues të mundshëm. Ne mendojmë se duhet të hiqet fjala “mund” dhe të zëvendësohet me fjalën “duhet” me ligj. Ndërsa, Grupi Parlamentar i Aleancës Kosova e Re, në parim e mbështet këtë Projektligj, por kontributin tonë përmes përfaqësuesve tanë do ta japim në ato komisione ku shqyrtohet projektligji në fjalë. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, deputet.

Në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, Lulzim Zeneli e ka fjalën.

LULZIM ZENELI: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Së pari, shpreh revoltën për arsye se kam të drejtë në replikë kur përmendet emri, gjithsesi, dhe së dyti, kujtoj që Kryeministri e bëri një ndërhyrje të tillë në këtë projektligj dhe foli për diçka që nuk ishte në rendin e ditës, por do të ishte mirë për të gjitha ato çka tha Kryeministri, këtij Kuvendi le t’ia sjellë VSM-në, Vlerësimin strategjik mjedisor të impiantit të ri që pretendon të ndërtohet, duke respektuar ligjin, duke respektuar ligjin që e ka nxjerrë Kuvendi i Kosovës dhe, së treti, Grupi parlamentar i LDD-së, mbështet këtë projektligj për arsye se deri tash kjo çështje është rregulluar përmes rregulloreve të veçanta, qoftë në nivelin lokal, qoftë në nivelin qendror, mirëpo prapë kam një vërejtje për Ministrinë e Mjedisit dhe të Planifikimit Hapësinor, se programet për banime të veçanta që përfshihen në këtë projektligj për vitin 2008 kanë qenë të planifikuara dhe mjetet kanë qenë të alokuara dhe nuk janë realizuar në komunën e Pejës dhe në komunën e Gllogocit. Kjo është një vërejtje që nuk guxon të na përcjellë për arsye se nevojat janë aq të mëdha, e dimë të gjithë, dhe nuk guxojmë të krijojmë aq komoditet sa që mos të bëjmë planifikime për të cilat pastaj realizimi mungon. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit! Deputet, ju më detyruat që të përgjigjem në vërejtjet e juaja në kryesimin e seancës. Ju keni pasur replikë në fjalën e Driton Talit, dy minuta. Pastaj, deputeti Driton Tali ka pasur të drejtë me Rregullore në kundër replikë dhe me këtë mbyllet, një minutë. Ndërsa, Kryeministri ka pasur fjalën në emër të Qeverisë të Kosovës, pra në fund të debatit për ligjin, në bazë të Rregullores. Është përfaqësues i Qeverisë dhe nuk e ka tejkaluar kohën prej 10 minutave sa e ka të drejtën përfaqësuesi i Qeverisë. Se çka flet tash brenda asaj kohe, nuk mund t’ia përcaktojmë askujt. Kjo ishte. Më falni deputetë.

Në emër të Grupit parlamentar “7+”, deputeti Sadik Idriz

SADIK IDRIZ: Hvala, predsedavajući!

Parlamentarna grupa „7+“ će u načelu podržati Nacrt zakona o finansiranju posebnih programa stanovanja sa naznakom da ovaj zakon ima potrebe da bude u nekim članovima preciznije odredjen, kada su u pitanju donatori, kada su u pitanju korisnici iz ovog programa, posebno neke kategorije, ugrožene kategorije Romi i ostali, znači u ovom periodu, kategorije zajednica. Smatram da će naša Grupa, znači naši članovi u komisije dati svoj doprinos i mi čemo u načelu podržati ovaj nacrt zakona. Hvala!

KRYESUESI: Ju faleminderit, deputetë. Në emër të Grupit të SLS-së, nuk ka të paraqitur dhe vazhdojmë me debatin. Deputetët, sipas radhës së paraqitjes. Fjalën e ka deputeti Driton Tali, le të përgatitet deputetja Vezira Emrush.

DRITON TALI: Jo, zoti kryesues, e kam tërhequr fjalën. Ishte një replikë e vogël me Kryeministrin, por pasi nuk është këtu, mendoj se nuk është e ndershme nga ana ime.

KRYESUESI: Ju faleminderit! Nuk keni pasur, ne jemi në pikën e rendit, Ligji është duke u debatuar në parim. Deputetja Vezira Emrush e ka fjalën, le të përgatitet deputetja Fatmire Berisha.

VEZIRA EMRUSH: Hvala lepa na datu reč.

Pozdruvlljam Predsedništvo,

Gospode ministre i kolege poslanike,

Pred nama danas imamo jako vaŝan zakon, sa kojim se planira da se pribliŝno pomogne jendom sloju gradjana koji nemaju mogućnost, finansijsku mogućnost za osnovnu ŝivotnu potrebu stanovanja. Medjutim, ja hoću, pošto je, verujem da vreme danas nije 5 minuta, ali hoću da stavim segmente oko finansiranja, verujem da smo svi paŝljivo proćitali zakon. Zakon kaŝe da se finansira iz budŝeta, kosovskog buŝeta i da se finansira iz lokalne samouprave opštine i od strane donatora.

Ja moram da kaŝem da zakon nije dobro definisan. Zakon ne moŝe da se finansira. Drŝava mora da stvori fondove, fondove za izgradnju stanova za solidarnost. Znaći, da prepozna kategorije kojima je potrebna pomoć, finansijska dodatna. Mi nemamo te fondove. Ja apelujem da se ovaj zakon doradi, da se definišu fondovi, da ne bi bilo zloupotrebe od strane centralne i lokalne vlasti gde se izdvajaju sredstva koja ne mogu da se prate. Samo imamo osnivanje jednog savetodavnog saveta, izvinite moram da proćitam: Centralni savet za stanovanje koji se finansira po potrebi kada treba u formi da se sastane za dnevnicke za svoje sastanke. Moramo da ovo dobro definišemo, da proćitamo zakone i fondove kako se ova grupa reguliše u regiji. Ja dajem ovo do znanja iz jednog ostvarljivog cilja i interesa koje mogu da ostvare ovde pojedinci iz Vlade, mi poslanici, ministri, opštinski rukovodioci, gde moŝemo da napravimo ugovore sa sopstvenom lićnom zaradom, gde moŝemo na trŝište da prepoznamo stanove i da uzmemo u zakup, te molim da se prvo formira Fond za solidaronst koji će sve ove namenske ciljeve da reši.

Pozdruvlljam zakon, ali zakon bez fonda, bez svoje osnove nije zakon. Hvala!

KRYESUESI: Ju falemidnerit! Fjalën e ka deputetja Fatmire Berisha, le të përgatitet deputeti Hydajet Hyseni-Kaloshi.

FATMIRE BERISHA: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar ministra,

Deputetë të respektuar,

Me Projektligjin për financimin e programeve të veçanta të banimit, të hartuar nga Ministria e Mjedisit dhe e Planifikimit Hapësitor, na është bashkëngjitur edhe vendimi i Qeverisë së Kosovës për hartimin e të njëjtit nga kjo Ministri, memorandumit shpjegues, vendimi për procedimin e këtij Projektligji në Kuvend, deklarata e pajtueshmërisë me legjislacionin e BE-së, si dhe vlerësimi i ndikimit buxhetor.

Projektligji për financimin e programeve të veçanta të banimit është i sistemuar brenda 8 krerëve, me gjithsej 28 nene. Dua të bëj një ecje nëpër projektligj me qëllim që t'i sheshoj disa vërejtje të cilat sipas vlerësimeve nga komisionet përkatëse, do të gjejnë vend.

Po filloj me kreun e dytë, neni 3, mendoj që në këtë nen duhet të qëndrojë titulli - Financimi i programeve të veçanta të banimit, nga se pjesa tjetër e këtij titulli është e

përfshirë në nenin 4, Kategoritë e familjeve që përfitojnë, jo që mund të përfitojnë, por që përfitojnë nga programet e veçanta të banimit.

Në nenin 5, Kriteret për përcaktimin e radhës së përparësisë, në natyrën e gjuhës do të duhej që në këtë nen të jetë titulli: Radha e kriterëve të përcaktuara, që përcaktojnë përparësitë, për të vazhduar pastaj te verifikimi i gjendjes ekonomike dhe të familjes jo, por verifikimi i gjendjes ekonomike të familjeve ose të familjes. Te kreu i 5-të, një harmonizim i nevojshëm gjuhësor, i cili nuk korrespondon me këtë përkthimin që e kemi në gjuhën serbe, madje edhe në gjuhën angleze, për të vazhduar deri te titulli i këtij projektligji, që lidhet me kreun e 6-të, Financimi i programeve të veçanta për banim, që është pra edhe titulli i Projektligjit, te bartësit e implementimit e jo implementimi. Pastaj, te neni 21, Këshilli Qendror për Banim do të ishte kështu, po të ishte ky Ligj për banim, por në të vërtetë ky është Projektligj për financimin e programeve të veçanta të banimit, prandaj korrespondon me atë që edhe Këshilli Qendror për Banim të jetë Këshill Qendror, të emërtohet pra si Këshill Qendror për Financimin e Programeve të Veçanta për Banim.

Përafërsisht këto do të ishin ato vërejtjet e mia që lidhen me projektligjin që po e shqyrtojmë sot. Hartuesit e këtij projektligji iu kanë referuar përvojave të vendeve të rajonit, konkretisht përmendet Ligji për banim në Slloveni dhe ai i Shqipërisë, Ligji mbi banimin urban dhe programet sociale. Hartuesve të këtij Projektligji mendoj që ju ka shkaktuar një dilemë ngase kanë qëndruar në mes të dy pozicionimeve kështu, a të hartohet një ligj i mirëfilltë për banim, apo të hartohet një ligj i mirëfilltë për kategorinë sociale. Unë mendoj që, po të kishim një vizion të qartësuar lidhur me kategorinë e përfituesve të këtyre rasteve, edhe Ministria dhe hartuesit e këtij projektligji do ta kishin bërë punën më lehtë. Ne, pra, si do t'i qasemi problemit të banimit për familjet që nuk kanë mundësi të krijojnë vetë hapësirë banimi. Të hartojmë programe të veçanta banimi për kategoritë e veçanta të popullsisë, do me thënë ta thellojmë praktikën e ndërtimit për raste sociale apo t'i përfillim ato praktika të mira të Ministrisë së Arsimit, të filluara më herët, edhe të Ministrisë të Punës dhe Mirëqenies Sociale, e cila referon që përfituesit e këtyre familjeve që e përbëjnë atë pjesën më të madhe të tyre, fëmijët pra, të inkuadrohen e jo qendrat kolektive të mbesin të veçuara prej përfituesve tjerë. Do me thënë, kjo krijon atë dilemën më të madhe, që do të duhej ta sqaronte edhe hartuesi ose sponsorizuesi i këtij ligji, a do të krijojmë, pra, qendra kolektive në të cilat do t'i sistemojmë vetëm rastet sociale, gjë që sipas mendimit tim nuk është e mirë, apo këto raste sociale do t'i inkuadrojmë jo vetëm në qendrat kolektive, sepse në një të ardhme jo të largët, në bazë të përvojave që i kanë edhe vendet tjera të Evropës, në përgjithësi, edhe të rajonit, ndoshta në mënyrë jo shumë të shprehur tregojnë se është shumë vështirë që në një të ardhme jo të largët, këto qendra t'i zhbllokojmë në njëfarë mënyre. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, deputete! Fjalën e ka deputeti Hydajet Hyseni, le të përgatitet deputeti Riza Smaka.

HYDAJET HYSENI: Ju faleminderit, zoti kryesuese!

Zonja e zotërinj deputetë,

Të nderuar ministra,

Më lejoni t'ju përshëndes të gjithëve!

Përshëndes edhe ligjin që na është sjellë sot për shqyrtim, një ligj që dua ta them që në fillim, me një përmbajtje bukur sociale, bukur të majtë, nëse mund ta them ashtu, shumë

të majtë për një Qeveri që është e koalicionit dhe po e proklamoi me pompë përcaktimin e saj djathtistë.

Në të vërtetë, sido që t'i kualifikojmë krahët tanë, shoqëria kosovare është një shoqëri shoqërisht vulnerabël, shoqëri që sapo ka dalë nga lufta dhe është plotë probleme sociale, prandaj e konsideroj krejt të natyrshme, qoftë edhe për një qeveri të djathtë, që t'i kushtojë kujdesin e duhur aspektit social. Më e mira është, që në faza si kjo e jona, të jetë një qasje me të dy krahët, me të djathtë e me të majtë. Kur hiqet një krah, trupi mbetet sakat, zonja e zotërinj. Po, sido që të jetë, Ligji është i nevojshëm dhe vërtet do përshëndetur përpjekjet që po bëhen për të investuar në këtë drejtim.

Ajo që mua më bën përshtypje, është fakti se është një ligj që është punuar mirë, ç'është e vërteta, por nuk janë përfshirë të gjitha kategoritë e dëmtuara edhe në aspektin e banimit dhe mendoj që do të ishte mirë të theksohen posaçërisht familjet e dëshmorëve, familjet e invalidëve të luftës, të veteranëve të luftës, të pensionistëve dhe do të dëshiroja ta potencioja veçanërisht, se zakonisht po harrohet, kategoria po ashtu e dëmtuar në vazhdimësi dhe në kohë të gjatë e ish të burgosurve politikë.

Zonja e zotërinj,

Ju e dini se shumë disidentëve u është marrë pasuria, u janë marrë banesat edhe sot e asaj dite, jo vetëm ata, po familjet e tyre janë shoqërisht të dëmtuar. Është e nevojshme që të trajtohen, më në fund, konform praktikave të vendeve fqinje. Nëse janë marrë ligjet nga vendet që u përmendën, do të ishte mirë të shikohet edhe ky aspekt.

Ligji është pretendues dhe mua më pëlqen kjo qasje, por nuk e shoh edhe mbulesën adekuate financiare, prandaj e mbështes, por kam dilema rreth asaj, ta zëmë, nëse merret një angazhim që të mbulohet qiraja 50% për të gjithë ata që nuk janë në gjendje të paguajnë qira dhe ne e dimë që janë të shumta familjet që nuk janë në gjendje ta paguajnë qiranë. Do të ishte mirë të dimë sa janë të tillë, ose që kanë hapësirë më të vogël se sa është e nevojshme, siç është në dispozitat e këtij ligji. Do të ishte mirë të jetë e precizuar sa dhe, natyrisht, kjo pastaj edhe të ketë llogaritjen financiare. Ju e dini se ndonjë ligj që është proceduar nga Kuvendi, edhe pse është dizajnuar në atë mënyrë që në fazën e parë të mos prodhojë implikime financiare, por të krijojë parakushtet për zgjidhje graduale, megjithatë po mbahet i bllokuar vërtet për arsye të pakuptueshme për muaj të tërë, sepse thuhet se kemi deklaratën financiare. Do të duhej një sqarim edhe për këtë çështje.

Nuk është sqaruar sa duhet për mendimin tim dhe ka nevojë çka ka ndodhur me fondin e banesave që janë juridikisht ose në pikëpamje pronësoro – juridike të pa zgjidhura, të ish strukturave shtetërore, që në vendet tjera fondi i tillë është përdorur edhe për destinime të tilla, duke përfshirë këtu, do të thotë, edhe ato banesa që kanë qenë të ish-nomenklaturës ushtarake, policore e tjera, që nuk është më këtu, e tjera që ka qenë e jashtme. Është koha që edhe Kosova të pozicionohet konform praktikave të vendeve të tjera në këtë drejtim dhe të jetë pak a shumë edhe pjesë e procesit të suksesionit.

Kam vërejtje, po ashtu, në dispozitën 27, është dispozitë shfuqizuese, është thënë, dhe dispozitë e cila rregullon vetëm raportin e ligjit pasi të miratohet, natyrisht, me aktet nënligjore, por jo edhe me dispozitat ligjore që e rregullojnë këtë materie. Mbetet e paqartë dhe do të kishte vështirësi në zbatimin e tyre po të mos korrigjohej. Besoj që këto dhe vërejtjet tjera do të merren parasysh gjatë procesit të amendamentimit dhe me këto vërejtje e mbështes. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit! Deputeti Riza Smaka e ka fjalën, le të përgatitet e fundit, deputetja Elheme Hetemi.

RIZA SMAKA: I nderuari zoti kryesues!

Ministra dhe deputetë,

Unë vlerësoj se ky dokument është dashur të na vinte më herët e ta kishim miratuar edhe shumë më herët, sepse nevoja është imediate për aplikimin e këtij ligji. Natyrisht, në procedurat deri në miratim do të bëjmë atë që mund ta bëjmë për ta përmirësuar tekstin dhe disa çështje përmbajtjesore.

Unë, konkretisht do të isha angazhuar tash, në parim, te neni 5, ku janë përcaktuar kriteret për përcaktimin e radhës së përparësisë për sigurimin e banimit për personat që do të ishin benificiar, që të hyshin këtu të papunët, se këtu trajtohen vetëm ata dhe ato që janë të punësuar dhe pagat e tyre, ndërsa ata që nuk janë të punësuar diskreditohen dyfish, a trefish, sa të dush, do të thotë ata pothuaj se nuk trajtohen fare, por vetëm ata që kanë paga. Prandaj, fillimisht do të duhej ata që nuk kanë paga, që nuk kanë të ardhura, nuk kanë të hyra, ta kenë një status prioritar, më pastaj këta që kanë paga kush ka më të ulëta, kush ka më të larta, gjasat më të vogla me poenë për t'u kualifikuar për të marrë bazë për banesë.

Po asisoj do të isha angazhuar që të plagosurit, që kanë plagë në trup, të trajtohen këtu si kategori edhe të trajtohen edhe pjesëmarrësit në luftë, ka shumë pjesëmarrës që kanë marrë. Na kemi përvoja të mira të mëparshme, bie fjala, ata që kanë marrë pjesë në luftën e drejtë, ju lutem, kanë pasur stazh të benifikuar, kanë pasur prioritet në kushtet e njëjta për t'u punësuar, madje edhe familjarët e ngushtë, në kushtet e njëjta kanë pasur prioritet. Prandaj, medoemos do të duhej të inkorporohej kjo kategori këtu në këtë dispozitë.

Me nenin 21 është përcaktuar ngritja, konstituimi i Këshillit Qendror për Banim. Kjo është njëfarë dukurie që vërehet edhe te aktet ligjore tjera, pothuajse sa akte ligjore që i miratojmë, aty së pakut një e them, do të thotë ndonjë edhe dy-tri organe që themelohen. Ju lutem, kjo është një dukuri e panevojshme, sepse po krijohen shumë organe të administratës që ngarkojnë buxhetin edhe që pothuajse nuk kanë çfarë të bëjnë, sikundër të kërkohej raport, jo mujor, por tremujor, nuk besoj që do të kishin mundur për ta bërë një gjysmë faqe punë për ta prezantuar se ja këtë punë e kemi bërë. Çfarë do të bënte ky Këshill Qendror për Banim, duhet të jepte mendim, vlerësim, atë e dinë çdo kush, çështjen banesore, ju lutem, në përgjithësi, e di edhe bujku, edhe blegtori, edhe filozofi e tjera e tjera, bile nëse ke durim, mund të dëgjosh me orë të tëra për të dhënë referime.

Te neni 26, nuk do të duhej të jetë kështu dhe kjo është njëfarë praktike, kështu bile së paku po na bie në etapën e parë. Gjashtë muaj ditë i jepet Ministrisë kohë për të bërë, po e zëmë, një rregullore apo një udhëzim administrativ. Ne fare mirë e dimë se akti ligjor pas miratimit do të duhej të aplikohet, por shpeshherë nuk mund të aplikohet poqe se nuk ka udhëzime. Do të duhej që ministria përkatëse, nuk aludoj tani në Ministrinë, por në përgjithësi, do të duhej që paralelisht me trajtimin, me diskutimin e aktit ligjor, të bënte draftin e akteve nënligjore të caktuara, në mënyrë që ato t'i bënte brenda një javë dite edhe ato do të ishin instrumente integrale me ligjin që do ta mundësonin aplikimin, se synimi ynë është që të bëjmë ligje të mira, t'i aplikojmë e jo vetëm t'i bëjmë, t'i miratojmë, të japim raporte se kemi bërë ligje edhe ato nuk miratohen, nuk aplikohen pa këto instrumente që janë, që quhen udhëzime apo në të vërtetë akte

nënligjore. Në parim, do me thënë, angazhohem që ky akt ligjor të miratohet në procedurë. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit! Deputetja Elheme Hetemi e ka fjalën, dhe i fundit, deputeti Sabri Hamiti.

ELHEME HETEMI: Ju faleminderit, kryesues!

Duhet të them paraprakisht se nuk pajtoj absolutisht, nuk pajtoj me dy parafolësit e mi kur kategoritë sociale i ngatërrojnë me kategoritë e luftës. Unë mendoj se në nenin 5, kriteret për përcaktimin e radhës së përparësisë janë të specifikuara shumë mirë. Ky Projektligj është për kategoritë sociale dhe kategoritë e luftës absolutisht nuk duhet t'i ngatërrojmë me këtë projektligj dhe me kategorinë sociale. Ata duhet të trajtohen në formën e merituar dhe me ligje të veçanta dhe janë të trajtuar me ligje të veçanta.

Kush ka përparësi, janë kriteret e përcaktimit, si statusi i banimit, lartësia e të ardhurave, gjendja shëndetësore, invaliditeti, struktura e familjes dhe shumë drejt është e paraqitur se me udhëzim administrativ mund të caktohen kriteret e tjera. Kjo ishte vërejtja ime me parafolësit dhe mospajtushmëria ime që kategoritë e luftës të trajtohen në kategori sociale. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Replikë, Hydajet Hyseni e ka fjalën, 2 minuta.

HYDAJET HYSENI: Unë për dallim, pajtohem plotësisht me parafolësen time dhe kolegen time, sepse ajo që kolegja do të thotë, është që të mos trajtohen këto kategori si puro sociale, sepse ato meritojnë më shumë, por problemi është se disa kategori të tilla ende nuk po trajtohen sa duhet as si kategori sociale. Për fat të keq, në këto kategori i kemi futur në Ministrinë e Çështjeve Sociale dhe trajtohen me ligje e me tjera në atë kategori dhe ne nuk po arrijmë të sigurojmë as përkrahjen e duhur sociale. Por, për të sqaruar qëndrimin tim edhe për ato që theksova, unë kam parasysh gjithmonë, do të thotë, këto kategori, me veçoritë që kanë, natyrisht ata që bëjnë pjesë në kategoritë e rrezikuara sociale. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit! Deputeti Sabri Hamiti e ka fjalën.

SABRI HAMITI: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Do të përpiqem t'i nënvizoj dy-tri probleme. Unë e përkrah Ligjin dhe mendoj që është i nevojshëm dhe i dobishëm. Këtu pati interpretime, sidomos Hydajeti, ... e majtë, e djathtë. Nuk përcaktohen ideologjitë e partive, e majtë, e djathtë, a merren me jetën sociale. Merren të dy kategoritë. Problemet janë të filozofisë së zhvillimeve, cila si krijon pasuri për të ndihmuar jetën sociale. Unë, te nenet 4, 5 dhe 9, që në njëfarë mënyre përcaktojnë kategoritë e përfituesve, do ta futsha një kategori - të rinjtë që krijojnë familje. Kjo është themelore. Natyrisht, duhet të ndihmohen ata që kanë nevojë sociale, por të kemi kujdes për familjet e reja dhe të rinjtë që krijojnë familje, që janë riprodhimi dhe ngritja e shoqërisë së shëndoshë. Mendoj që duhet të futet si kategori e veçantë.

Tutje, në nenin 17, ku flitet për paratë ose fondet që do të përdoren, unë pajtohem, me sa dëgjova mirë, më duket mirë e dëgjova kolegen Emrush, që këtu duhet të krijohet fond i sigurt i të hollave, fond i Qeverisë për këto kategori, për këtë ligj, për aplikimin e këtij ligji, sepse unë po ju them që kanë ndodhur situata edhe qesharake. Ka komuna, nuk po ua përmendi emrat, kanë krijuar banesa të përfituara përmes lejeve të ndërtimit dhe çka

ka ndodhur? Ju kanë dhënë banesa atyre që kanë, me arsyetimin se ata që nuk kanë, nuk mund ta paguajnë qiranë. Besoni që kështu ka ndodhur! Do të shkojmë në këso situatash paradoksale, të cilat kanë funksionuar dhe funksionojnë edhe sot. Duke pasur parasysh të gjitha këto probleme, unë po them që ligji është i nevojshëm, veç se duhet të krijohet fondi i veçantë për këtë tip të veprimtarisë. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Është fakt që është përmendur emri i Vezira Emrush, por nuk di a ka shumë vend për replikë. Replikë, 2 minuta, Vezira Emrush e ka fjalën.

VEZIRA EMRUŠ: Ja se posebno zahvaljujem kolegi i jako mi je milo da pratimo diskusije jedni drugih, svoje diskusije koje su pozitivne. Ja sam svoj komentar dala da bi dala doprinos za zakon, ne samo da se utvrdi na ime zakona fond, novčani fond koji će biti normalno izdvajanje na centralnom i lokalnom nivou po procentima, nego i da se prepozna fond kao nekretnine koje su danas na tržištu oslobodjene, kao što su vojni objekti i ostali objekti gde možemo i kolektivno da damo i prepoznamo pomoć ovoj kategoriji. Hvala!

KRYESUESI: Ju faleminderit! Para se t'ia jap fjalën përfaqësuesit të Qeverisë, ministrit, lus regjinë që t'i ftojë deputetët të kthehen në sallë se për dy-tre vetë na mungon kuorumi për votim. Ministri Yagcilar e ka fjalën!

MAHIR YAGCILAR: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Gjithashtu dëshiroj t'i falënderoj të gjithë deputetët për diskutimet dhe përkrahjen. Ligjin deri sot nuk e kemi pasur, ky është një projektligj, por në bazë të udhëzimit administrativ, siç e keni cekur, zoti kryesues, janë bërë 9 projekte, kështu që nevojitet ligji, infrastruktura ligjore të vazhdojë me këto projekte. Ligji nuk është klasik social, është për çështje ose programe të veçanta. Në këtë aspekt ne e kemi ndërruar emrin prej "banimit social" në "programe të veçanta". Sa i përket çështjeve sociale, do të jetë përgjegjëse Ministria e Mirëqenies Sociale. Buxheti planifikohet me vitin e rregullt buxhetor. Në qoftë se parashikohet fondi, do të ishte ndoshta edhe më mirë, por në qoftë se jo, atëherë bëhet planifikimi për çdo vit në bazë të vijave buxhetore të rregullt. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, ministër!

Në sallë janë 55 deputetë. Nuk ka kuorum për votim. Vazhdojmë. Fjalën e ka shefi i Grupit Parlamentar të LDK-së, Lutfi Haziri.

LUTFI HAZIRI: Zoti kryesues!

Më lejoni që për shkak të angazhimeve që ka Grupi Parlamentar prej orës 13,00, të kërkoj një pauzë të drekës, në mënyrë që të vazhdojmë pas dite me seancë plenare.

KRYESUESI: Kush është për pauzë deri në orën 14:00 tani? Po. Pauzë deri në orën 14:00. Ju lutem, të vini saktësisht në orën 14:00 për shkak se i kemi edhe 4 pika të rendit të ditës. Pauza deri në orën 14:00.

### **Vazhdimi i seancës pas pauze**

### **Drejtimin e seancës e mori Kryetari i Kuvendit, zoti Jakup Krasniqi**

KRYETARI: Të nderuar deputetë, po e vazhdojmë pikën e tetë dhe po e lëmë të votojmë së bashku për pikën e 7 dhe 8 kur ta kemi kuorumin e nevojshëm.

Në bazë të Rregullës 35 pika 1 të Rregullores së Punës, janë përmbushur kushtet për shqyrtim dhe miratim, në parim, të këtij projektligji. Është pika e tetë:

**- Shqyrtimi i parë Projektligjit për tatimet në të ardhurat personale**

Ftoj ministrin për Ekonomi dhe Financa, zoti Ahmet Shala, që në emër të Qeverisë të Republikës së Kosovës, para deputetëve të Kuvendit, ta prezantojë Projektligjin. Ju kisha lutur që mos të ketë shumë diskutime, por qëndrimet e grupeve t'i prezantojnë shefat e grupeve parlamentare. A jeni dakord? Ju faleminderit!

MINISTRI AHMET SHALA: I nderuari, zoti Kryetar!

Të nderuar Kabinet qeverisës,

Të nderuar deputetë,

Kam nderin dhe kënaqësinë që para jush sot të paraqes Projektligjin për tatimin e të ardhurave personale.

Ky Projektligj është hartuar nga Ministria e Ekonomisë dhe Financave dhe në bashkëpunim me përfaqësues të komunitetit të biznesit dhe palë tjera të interesit dhe është bazuar në standardet dhe praktikat më të mira të vendeve të Bashkimit Evropian dhe të vendeve në regjion.

Qëllimi i këtij Projektligji është krijimi i një ambienti sa më të favorshëm për biznes dhe investime, gjithnjë duke e ruajtur stabilitetin fiskal dhe ekonomik të Republikës së Kosovës.

Dispozitat e këtij Projektligji janë përafruar si me legjislacionet e vendeve të regjionit, ashtu edhe me legjislacionet e shteteve të Bashkimit Evropian. Ky projektligj i adreson të metat në legjislacionin e tanishëm, përkatësisht i tejkalon të gjitha të metat në të ardhurat personale, me ç'rast bizneset janë trajtuar ndryshe nga ato që i janë nënshtruar tatimit në të ardhurat e korporatës. Në këtë mënyrë, aq sa ka qenë e mundur, është bërë harmonizimi i legjislacionit tatimor për të dy llojet e tatimeve, si për tatimin e të ardhurave personale, ashtu edhe në atë të korporatave.

Projektligji do të jetë më i avancuar në disa aspekte, të cilat trajtojnë çështjet e dividendit, të amortizimit, dispozitat e borxhit të keq, si dhe disa dispozita tjera administrative të cilat janë më të favorshme, si për tatimpaguesit, ashtu edhe për Administratën Tatimore të Kosovës.

Projektligji avancon dhe zgjeron listën e të ardhurave të përjashtuara, siç janë dividendet, të ardhurat nga fitimi në lojërat e fatit, pagesat e pensioneve, asistencë sociale e paguar nga Qeveria e Republikës së Kosovës, trashëgimia, shpenzimet edukativo-arsimore, bursat dhe shpenzimet e trajnimit. Projektligji është harmonizuar me marrëveshjen gjithashtu të IPA-s, pra të instrumentit para anëtarësimit, nënshkruese e të cilës është edhe Republika e Kosovës dhe duhet t'iu përmbahet rregullave të kësaj marrëveshjeje.

Përpos tjerash, në këtë projektligj është paraparë edhe zgjerimi i të hyrave, siç e thashë, të përjashtuara, në atë mënyrë që nënkontraktuesit ndërkombëtarë të jenë të liruar. E gjithë kjo është bazuar në parimin që nënkontraktuesit ndërkombëtarë paguajnë deri më tani tatim në dy vende, në vendin ku ata janë të regjistruar dhe në vendin ku e kryejnë veprimtarinë. Nëse nënkontraktuesit nuk do të liroheshin në

legjislacionin tatimor të Kosovës, ata do të mund të gjenden në një situatë që të paguajnë tatim të dyfishtë dhe në këtë mënyrë Kosova të mos bëhet vend atraktiv për kryerjen e investimeve. Andaj, ky Ligj konsideroj që i tejkalon të gjitha këto aspekte, të cilat deri më tani fatkeqësisht kanë qenë prezentë.

Duhet cekur që lirimet janë të lidhura me projektet specifike të investuara nga qeveritë ose organizatat ndërkombëtare, gjithashtu, ashtu siç është e definuar në projektligj në mënyrë shumë të specifikuar. Po ashtu, përmes këtij Ligji në mënyrë shumë specifike rregullohen edhe këto çështje. Nëse nënkontraktuesi ose kontraktuesi primar ka të ardhura nga aktivitetet tjera të biznesit dhe qëndron më shumë se 183 ditë në Kosovë, për këto të ardhura ai do të paguaj tatim. Është fjala se 183 ditë janë më shumë se 50% e vitit, përkatësisht më shumë se sa 6 muaj.

Me qëllim të eliminimit të tatimit të dyfishtë, pasi që sipas nenit të sistemit të tanishëm, dividendi tatohet dy herë, gjë që destimulon investimet, siç e thashë, dhe paraqet barrë për bizneset qofshin vendore, qofshin ndërkombëtare, Projektligji ndryshon rregullat e trajtimit të dividendit në atë mënyrë që dividendi definitivisht lirohet nga tatimi.

Projektligji parasheh që çdo marrëveshje ndërkombëtare e nënshkruar nga Ministri i Ekonomisë dhe Financave lidhur me heqjen e tatimeve të dyfishta do t'i shfuqizojë dispozitat e këtij ligji. Janë avancuar po ashtu edhe dispozitat e borxhit të keq, të cilat janë harmonizuar me legjislacionin e vendeve anëtare të Bashkimit Evropian. Rregullat e borxhit të keq kanë qenë në një mënyrë ngarkesë për bizneset kosovare për arsye se kriteret që një borxh të shpallet si borxh i keq, aktualisht janë goxha të komplikuar si për tatimpaguesin, ashtu edhe për Administratën Tatimore të Kosovës. Tani rregullat për trajtimin e borxhit të keq në këtë projektligj janë më të thjeshta, por gjithsesi kemi pasur kujdes që kriteret të jenë të kufizuara deri në atë masë që nuk e ngarkojnë biznesin me procedura të tepërta, si dhe në anën tjetër tatimpaguesit nuk i është lënë hapësirë që ta shfrytëzojë Administratën Tatimore të Kosovës si një mbështetje kreditore dytësore lidhur me menaxhimin e biznesit të vet.

Në Projektligj janë avancuar dispozitat lidhur me bartjen e humbjeve tatimore pasi që është paraparë mundësia e bartjes së humbjes tatimore deri në shtatë periudha të njëpasnjëshme tatimore, në krahasim me pesë periudha të njëpasnjëshme, që ishin deri tani prezentë. Në këtë aspekt, dispozitat e bartjes së humbjeve tatimore për bizneset në Ligjin për të ardhurat personale janë harmonizuar me dispozitat e bartjes së humbjes tatimore me Ligjin për të ardhurat e korporatave dhe është bërë trajtimi i barabartë i bizneseve, si për ato që i nënshtrohen tatimit në të ardhurat e korporatës, ashtu edhe për ato që i nënshtrohen tatimit në të ardhurat personale.

Në projektligj janë avancuar dispozitat administrative, si deklarimi i tatimit dhe pagesat. Pagesat do të bëhen në bazë të qarkullimit bruto, ku tatimpaguesve u është lënë mundësia të zgjidhin të paguajnë tatim real, duke i njohur të gjitha shpenzimet e lejueshme e të parapara me këtë projektligj, apo të bëjnë pagesën e tatimit në bazë të qarkullimit të tyre, si dhe natyrës së veprimtarisë 3% të të ardhurave bruto nga tregtia, transporti, bujqësia dhe veprimtaritë e ngjashme ekonomike të çdo tremujori, por jo më pak se 37,5 euro për tremujor ose 5% të të ardhurave bruto nga shërbimet, nga veprimtaritë profesionale, të zanatit, të argëtimit dhe të ngjashme në çdo 3 muaj, por jo më pak se 37 euro për 3 muaj.

Për të mos e zgjatur, Projektligji ka 11 kapituj dhe 51 nen. Projektligji është në përputhshmëri me parimet themelore për hartimin e legjislacionit dhe teknikat legjislative. Unë nuk desha të zgjasë shumë për të mos e ripërsëritur, në projektligj, sikurse që është vendosur vitin e kaluar, e dini që të ardhurat janë zvogëluar konform vendimit edhe të Kuvendit të Kosovës, që për të ardhurat personale mujore deri në 80 euro është 0 taksa, për të ardhura mujore prej 80 deri 250 4%, 250-450 - 8% dhe mbi 450 - 10%. Pra, janë barazuar edhe me tatimet në korporata.

Besoj që me këto që u thanë dhe me të tjerat që janë thënë deri më tani, do ta kemi mbështetjen e Kuvendit për të kompletuar këtë paketë fiskale, e cila është shumë e rëndësishme për zhvillimin ekonomik dhe reformën fiskale në Republikën e Kosovës. Ftoj deputetët që ta mbështesin dhe besoj që me këtë do ta bëjmë një rumbullakim shumë të nevojshëm për reformën fiskale në Republikën e Kosovës. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit! Kryetari i Komisionit për Buxhet dhe Financa, a e do fjalën a nuk e do? Mirë. Ju faleminderit! Kalojmë te shefat e grupeve parlamentare.

Në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës, Safete Hadergjonaj.

SAFETE HADERGJONAJ: Ju faleminderit, zoti Kryetar!

Ne dëgjuam arsyeshmërinë e këtij projektligji nga Ministri i Financave. Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike e ka shqyrtuar këtë projektligj dhe e përkrah. Projektligji mbi tatimin në të ardhurat personale po e përmbyll atë pakon e ligjeve, që në njëfarë mënyre e avancojnë sistemin tatimor, i cili do të kontribuojë po ashtu sikurse edhe ligjet e tjera në krijimin e ambientit më të përshtatshëm për biznesin dhe për investimet në përgjithësi. Me këtë projektligj sistemi tatimor iu afrohet shumë standardeve dhe praktikave të Bashkësisë Evropiane, sepse në këtë projektligj është e rregulluar çështja që ka të bëjë me të ardhurat personale, do me thënë në përgjithësi rregullohet më mirë çështja e dividendit, të amortizimit, të borxhit të keq, e po ashtu edhe dispozitat tjera janë shumë më të avancuara në krahasim me ato që kanë qenë dhe janë shumë më të avancuara si për Administratën Tatimore, po ashtu edhe për tatim paguesit.

Prandaj, ne si grup parlamentar kemi menduar ta përkrahim në parim këtë projektligj dhe kontributin tonë e japim përmes anëtarëve tanë që janë pjesë e komisionit funksional, përkatësisht të Komisionit për Buxhet dhe Financa. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike, Armend Zemaj e ka kërkuar fjalën.

ARMEND ZEMAJ: Ju faleminderit, zoti Kryetar!

Të nderuar Kabinet qeveritar,

Kolegë deputetë,

Projektligji për tatimin e të ardhurave personale është ligj i cili taton personat fizikë në të ardhurat e tyre që mund t'i kenë realizuar. Në fillim dua të potencohet se ky ligj është në shumë çështje e përafruar dhe i harmonizuar me Ligjin e tatimit në të ardhurat e korporatave. Është shumë me rëndësi që me këtë ligj taten, do me thënë përfshihen të ardhurat nga veprimtaria ekonomike e individit, pagat, qiratë, përdorimi i pasurisë së paprekshme nga interesi, fitimet në kapital, fitimet në lotari dhe nga pensioni.

Përmbajtja e këtij ligji është strukturuar në 11 kapituj dhe 51 nen, përmes të cilave janë trajtuar definicionet dhe përkufizimet e domosdoshme që kanë të bëjnë me tatimpaguesin që i nënshtrohet tatimit, si dhe të ardhurat të cilat tatohen. Ajo çka është me rëndësi, sepse ligji e përcakton normën e tatimit, që është një ndrydhim në të ardhurat personale, e cila normë është e përshkallëzuar si në vijim, për të ardhurat bruto vjetore të realizuara i përmendi edhe ministri në afate mujore, në i kemi edhe vjetore.

Ligji ka përfshirë edhe të ardhurat e lejuara nga tatimi në të ardhura personale, si rrogat e personelit të huaj të ambasadave, të organizatave qeveritare dhe joqeveritare, të KFOR-it, të përfaqësuesve ndërkombëtarë civilë, të EULEX-it, të UNMIK-ut, të Kombeve të Bashkuara, të ardhurat nga poliset e sigurimit të jetës, dividendët, të ardhurat nga fitimet në lojërat e fatit, përveç fitore në lotari, shpenzimet edukativo-arsimore që punëdhënësi paguan për të punësuar, të studentëve e tjerë. Gjithashtu, këtu është dhënë edhe sqarimi në lidhje me trajtimin e borxheve të këqija, zhvlerësimin si dhe amortizimin.

Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës pasi që të pajtohet me të gjitha këto çështje të rregulluara, si në kohën e pagesës në tatimin e të ardhurave personale dhe që është rregulluar edhe pagesa me katër këste paradhënie dhe në fund të vitit bëhet një deklaratë vjetore nga bizneset e mëdha individuale në bazë të të ardhurave reale, si dhe rimbursimi i tatimit të paguar.

Grupi parlamentar i LDK-së e përkrah në parim dhe do ta japë kontributin e vet edhe në komisionet funksionale. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Haki Shatri e ka kërkuar fjalën.

HAKI SHATRI: Ju faleminderit, zoti Kryetar!

Grupi Parlamentar i Aleancës ka vlerësuar që ky ligj, në kuadër të ligjeve të pakos fiskale, është ligji më i mirë i përgatitur. Si të tillë, e përkrahim. Disa mangësi që kemi vërejtur, shpresojmë që do të eliminohen. Por, kemi një vërejtje që nuk lidhet me këtë ligj. Do të ishte e rendit që Qeveria të na bie njëherë Ligjin për të ardhurat personale, e pastaj Ligjin për tatimin në të ardhurat personale. Shpresojmë se do të na e sjellin edhe atë ligj shpejt në Kuvend. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, deputeti Riza Smaka e ka fjalën.

RIZA SMAKA: I nderuar zoti Kryetar,  
Ministra,  
Deputetë,

Ky dokument juridik është përgatitur mirë teknikisht dhe e trajton tematikën që e ka në fokus në mënyrë gjithëpërfshirëse dhe të qartë dhe si i tillë do të duhej të kalonte nëpër procedura deri në miratim, por me disa korreksione të caktuara. Do të ishim angazhuar që, me qenë se veç është drafti i ligjit, të bëhen edhe draftet e rregulloreve, të udhëzimeve administrative dhe kjo praktikë të bëhet edhe për aktet ligjore tjera, në mënyrë që të miratohet akti ligjor brenda dy-tri javëve, e jo këtu që thuhet brenda gjashtë muajve apo disa drafte një vit, po e zëmë, që të lëshohen edhe udhëzimet edhe instruksionet administrative se shpeshherë pa to shumë dispozita ligjore mbeten të pa aplikueshme.

Në këtë tekst duhet të bëhen harmonizimet e termave të caktuara që tash për tash nuk janë. Po e zëmë, në disa vende thuhet - Ligji për të ardhura personale, në disa vende thuhet për të ardhurat individuale, e duhet të jemi konsekuent o kështu, o ashtu, ama njëri term duhet të jetë kudo në mënyrë konzistente.

Në këtë ligj disa kategori juridike nuk janë, janë prekur, janë rregulluar më mëngët se sa me ligjet që i rregullojnë ato çështje, siç është Ligji për organizatat biznesore. Prandaj, nuk ishte dashur fare të preken temat e tilla, po t'i referohen ligjit me germën e vogël, ligji është në fuqi dhe Ligji për organizatat biznesore i normon shumë mirë këto statuset, prej entitetit biznesor, prej biznesit personal, partnershipit gjeneral, të limituar, korporatës, kompanisë e tjera, se këtu janë prekur, ama një përqindje e vogël është rregulluar edhe me kolizion të konsideruar me ato dispozitat e ligjit special për këtë tematikë. Po asisoj disa terma nuk janë konzistente, herë thuhet pasuri e patundshme, e herë e paluajtshme. Edhe në anglisht thuhet immovable dhe diku thotë real estate, do të thotë duhet të përcaktohet që nga fillimi termi i caktuar dhe kudo të aplikohet.

Te neni 4 duhet të meditojmë më tepër se mos po del këtu një kontra rregullativë që do t'i destimulonte qytetarët tanë që punojnë në botën e jashtme ose që e kanë statusin e dyfishtë e tjera, sepse objekti i tatimit këtu sipas diksionit të kësaj dispozite del se edhe të ardhurat që i realizon në Kosovë, në rregull, ama ato jashtë që të tatimohen edhe në Kosovë, supozoj se nuk ka shtet në Evropë, së paku në Evropë jo, që nuk i tatimon të ardhurat atje. Të mos të bëhet tash tatimim edhe atje, edhe këtu. Ajo do të ishte dënim i pamërituar për qytetarët tanë që kanë gatishmëri e kanë vullnet për të investuar, për të vepruar në Kosovë. Duhet të jetë çështje me siguri gjatë diskutimeve për debat serioz, se interesi, norma interesore, dividendi, po e zëmë, trashëgimia të jenë apo të mos jenë si lehtësira tatimore, jashtë tatimit, se mund ta supozojmë këtë: Primosi i ka 1 milion euro, po e zëmë, të depozituara. Mund ta imagjinojmë sa do ta ketë normën interesore. Ato janë fitime, a mos të ketë tatimim, nuk do të ishte në rregull. Ose dividendi, dividendi është profiti nga aksionet. Prandaj, aty duhet të meditojmë mirë dhe të marrim edhe komperativisht si është në vendet e ngjashme me ne dhe të riformulojmë dispozitën, sa i përket tatimit të këtyre kategorive.

Ky dokument përmban një kaptinë që quhet - Dispozita ndërkombëtare. Këtë duhet ta heqim krejt, se dispozitat ndërkombëtare, na i kemi në Kushtetutë taksativisht sipas enumeracionit, të cilat dispozita ndërkombëtare aplikohen drejtpërdrejt pa ratifikim, a tjerat ku ratifikohen, kështu që nuk është praktikë që në listë të thuhet dispozita ndërkombëtare me ligj, se ligji është kategori juridike më e ulët se Kushtetuta, e Kushtetuta është kategori juridike më e ulët se sa dispozitat ndërkombëtare që aplikohen drejtpërdrejt, po e zëmë, rezultat e tjera.

Përfundimisht, ky ligj nuk përmban dispozita ndëshkimore, e duhet t'i përmbajë, medoemos duhet t'i përmbajë. Me siguri iu ka ra në sy kolegëve hyrja në fuqi e këtij ligji, nuk është sipas standardeve të deritashme. Këtu e kemi thënë, mirë është thënë, veç po e nënvizoj: "hynë në fuqi pas publikimit e aplikohet nga 1 janari të vitit 2010", që kjo është praktikë e mundshme dhe që justifikohet me intencën e ligjit.

Përfundimisht, ju lutem, ky është një dokument që do të duhej të miratohej në procedurë, por gjithsesi, zoti Shatri e theksoi me vend që ishte dashur ta kemi Ligjin për të ardhura personale, fillimisht, ai është bazamenti, ai është objekti, e më pastaj ky ligj

të pasonte atë ligj ose mbas, si të them, më pak të përshtatshëm, që paralelisht këto dy akte t'i kishim në diskutim. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit, deputet! Në emër të LDD-së, fjalën e ka kërkuar deputetja Synavere Rysha.

SYNAVERE RYSHA: Ju faleminderit, zoti Kryetar!

Edhe Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Dardanisë, pas shqyrtimit të këtij ligji e përkrah, në parim, Ligjin për tatimin në të ardhura individuale, duke pasur parasysh se ky ligj ka filluar të zbatohet nga janari i këtij viti, sidomos ajo pjesa pozitive ku është fjala për uljen e tatimeve. Mirëpo, gjatë shqyrtimit të këtij ligji është parë se ka disa mangësi dhe janë disa vërejtje, por megjithatë ne këto do t'i japim përmes anëtarit tonë në komisionin funksional, përkatësisht në Komisionin për Buxhet dhe Financa. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit, në emër të Grupit Parlamentar “7+”, Myfera Shiniq e ka fjalën.

MYFERA SHINIK:

Teşekkür ederim!

Kişisel Gelir Vergi Yasa Tasarısı, oldukça iyi hazırlanmış bir tasarı, ancak diğer bazı yasalarda görüldüğü gibi, Kosova dışındaki ülkelerin yasalarından yararlanırken, Kosova'nın fiziki ve coğrafi durumuna dikkat etmemiz gerekir ve varolan şartları gözönünde bulundurarak, şartlara göre düzenledikten sonra tartışmaya sunulması gerekir. Örneğin, 22. maddede diğerleri arasında, gemilerin satın alınmasındaki vergiler görülmektedir. Bu Kosova'nın bulunduğu coğrafisine ters düşmektedir, bunların gözönünde bulundurulacağına inanarak, Kişisel Gelir Vergi Yasa Tasarısının birinci okunuşunu 7+ Parlamenter Grubu olarak kabul ediyoruz ve ikinci okunuşuna kadar Fonksiyonel Komisyonuna katkılarımızı sunacağız.

Teşekkür ederim.

KRYETARI: Ju faleminderit! Në emër të Grupit SLS, Mursel Halilaj e ka fjalën.

MURSELJ HALILJAJ: Gpospodine predsedniče,

Dame i gospodo prisutni,

Parlamentarna grupa SLS će da podrži ovaj Nacrt zakona u načelu. Hvala!

KRYETARI: Ju faleminderit! Fjalën e ka kërkuar ministria Nekibe Kelmendi.

NEKIBE KELMENDI: Ju faleminderit, zoti Kryetar!

Të nderuar deputetë,

I nderuar zëvendëskryeministër,

Të nderuar ministra

Unë kam një koment të shkurtër në cilësinë e deputetes, lidhur me nenin 6 të Ligjit që po diskutohet.

Në nenin 1 është thënë, citoj: “Për secilën periudhë tatimore, pas një janarit 2009, tatimi në të ardhura ngarkohet sipas shkallëve në vijim”, e tjera.

Në nenin 2, gjithashtu është thënë, citoj: “Për secilën tatimore para 1 janarit 2009, tatimi në të ardhura ngarkohet sipas shkallëve në vijim”, e tjera. Mendoj se as kjo normë ligjore

nuk mund të zbatohet retroaktivisht, sepse parim ndërkombëtar, parim në të drejtën është që asnjë ligj nuk mund të ketë veprim retroaktiv. Prandaj, propozoj që paragrafi 1, sa i përket fillimit të tatimit të qëndrojë nga 1 janari 2010, kur edhe Ligji fillon të zbatohet, kurse paragrafi 2, duhet të fshihet tërësisht. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit, Deputeti Berim Ramosaj e ka fjalën.

BERIM RAMOSAJ: Ju faleminderit, zoti Kryetar!

Edhe unë mendoj, edhe pse nuk jam jurist, në fakt sipas procedurave elementare juridike, ligji hyn në fuqi në momentin e nënshkrimit. Andaj, ky nen që parasheh, ndoshta është gabim teknik, se ishte dashtë të vlejë prej 1 janar 2010, e jo retroaktivisht sepse, tek e fundit, edhe Komisioni për Buxhet dhe Financa, në qoftë se ka parë konsekuencat buxhetore, mundet t'i shohë në periudhën e ardhshme, e jo në periudhën e kaluar. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit! Këta që janë lajmëruar vonë, nuk po ua jap fjalën më. Shkumbin Demaliaj e ka fjalën.

SHKUMBIN DEMALIAJ: Ju faleminderit, zoti Kryetar!

Është e domosdoshme gjithë kjo, por meqenëse ligji bazë, Ligji për të ardhurat personale ende nuk ka ardhur, nuk është rregulluar në Kuvendin e Kosovës, kur është fjala për tatimin në të ardhurat e punëtorëve që punojnë jashtë shtetit, mendoj se ne ende nuk e kemi krijuar bazën ligjore për këtë çështje. Kjo ishte ajo vërejtja e vetme që kisha, sepse këto institucione e kanë shkatërruar Shërbimin Qendror të Punësimit dhe ne nuk kemi një mekanizëm shtetëror, sepse ekziston dhe është i themeluar me ligj, është fjala për Rregulloren 2001/27 për Ligjin e punës në Kosovë. Ekziston Shërbimi Qendror i Punësimit ku mund të mbahen evidencat për të gjithë punëtorët që punojnë jashtë shtetit dhe si tatimpagues që kishin pasur t'i kontribuojnë vendit tonë, ata nuk janë të regjistruar dhe nuk kanë asnjë obligim ndaj Kosovës në këtë rast për shkak se nuk i kemi rregulluar në mënyrën institucionale këtë çështje. Kështu që, për në të ardhmen mbetet, nëse ata kishin dashur që kontributojnë të tyre t'i adresojnë drejt Buxhetit të Kosovës, është dashur t'ua mundësojmë me ligj edhe në kuadër të këtij shërbimi, sepse në të ardhmen nuk dihet, ndoshta kishte pasur kushte më të mira Kosova që t'ju ofrojë mundësi më të mira për dalje në pension edhe atë stazh të punës ta adresojnë drejt Kosovës e jo drejt vendeve atje ku e derdhin djersën e tyre. Kjo ishte ajo përpjekja ime që të ndihmoj në këtë rast, sepse nuk kemi asnjë të drejtë, për shkak se me ligj nuk është e rregulluar kjo çështje, edhe pse përmendet në atë Rregullore të UNMIK-ut, sepse edhe Ligjin për marrëdhënie pune nuk e kanë nxjerrë institucionet e Kosovës, gjegjësisht nuk ka ardhur në Kuvend. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit! Diskutuesi i fundit që mendova se do ta marrë fjalën kësaj radhe, është Driton Tali.

DRITON TALI: Ju faleminderit, zoti Kryetar!

Siç e dini, unë që në fillim, kur ka ardhur reforma fiskale, është quajtur reforma fiskale, e pata pas kundërshtuar këtë idenë e tatimit linear, ndonëse ministri pati tentuar që ta arsyetojë me atë që Kosova të jetë sa më atraktive për investuesit e huaj. Është dashur të hapet njëfarë debati këtu, ndonëse kjo ide ka qenë që nga viti 2005, sa më kujtohet mua, që të diskutohet dhe të bëhet reforma në tatim, por me këtë shkallë, pos asaj që janë privilegjuar të pasurit apo ata të cilët kanë të ardhura më mëdha, e që për PDK- në, si parti e djathtë, i fle në parim, por në esencë nuk është atraktive. Ne kemi mundur që

investuesit e huaj totalisht t'i heqim nga tatimet edhe në të ardhura për të qenë Kosova sa më atraktive për ta, por jo edhe qytetarët e Kosovës për shkak se ne jemi të obliguar të kontribuojmë sipas mundësive dhe ajo sipas mundësive, në kuptimin financiar ia jep kuptimin tatimi i ashtuquajtur tatimi progresiv, do të thotë me shkallë, varësisht nga të ardhurat që i marrin qytetarët e Kosovës. Pra, ata të cilët marrin më shumë, duhet të paguajnë më shumë. Ka qenë edhe një arsyetim tjetër që është thënë se me këtë tatim do t'i inkurajojnë apo do t'i motivojnë më shumë tatimpaguesit që t'i paraqesin të ardhurat e tyre. Unë nuk besoj, sepse ata të cilët i fshehin të ardhurat e tyre, do me thënë bëjnë evizion fiskal, ata do të bëjnë për çfarëdo kohe, do me thënë për ta rritur efikasitetin në vjeljen e tatimit, duhet që të sofistikohen mekanizmat përgjegjës, e jo në këtë mënyrë për shkak se ata edhe ashtu nuk do t'i paguajnë. Kemi të bëjmë me një soj të njerëzve të cilët janë të pandërgjegjshëm dhe ata si të tillë do të ngelin.

Ka edhe vërejtje të tjera, por po them, nenin 6, dhe unë po çuditem edhe disa parti tjera politike, të cilat në programet e tyre pikërisht e kanë pasur tatimin progresiv, pse e përkrahin këtë, por pasi PDK-ja është bërë parti e djathtë, munden edhe të tjerat të bëjnë çdo gjë. Ju faleminderit!

**KRYETARI:** Driton, ne kemi treguar këtu se edhe të djathtët, edhe të majtët, të gjithë shkojnë. Në vazhdim, kërkohet deklarimi me votim për miratimin në parim të Projektligjit.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash. Në sallë janë 79 deputetë.

Konstatohet se me 68 vota “për”, 2 “kundër”, 5 abstenime, Kuvendi miratoi në parim Projektligjin për tatimin në të ardhura personale.

Në bazë të Rregullores së Punës, ngarkohen këto komisione:

- Komisioni për Buxhet dhe Financa, si komision funksional,
- Komisioni për Legjislacionin dhe Gjyqësi,
- Komisioni për Komunitete, dhe
- Komisioni për Integritet Evropian

Komisionet duhet që brenda 2 muajve nga shqyrtimi i parë, Kuvendit t'i paraqesin raportin me rekomandime.

Vazhdojmë me votimin sipas pikës 7, të Projektligjit për financimin programeve të veçanta të banimit.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash.

Me 69 vota “për”, 2 “kundër” dhe 6 abstenime, Kuvendi miratoi në parim Projektligjin për financimin e programeve të veçanta të banimit.

Në bazë të Rregullores së Punës, Kuvendi ngarkon këto komisione:

- Komisionin për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural dhe Planifikim Hapësinor, si komision funksional,
- Komisionin për Legjislacionin dhe Gjyqësi,
- Komisionin për Buxhet dhe Financa,
- Komisionin për Komunitete, dhe

- Komisionin për Integritet Evropian.

Komisionet duhet që brenda 2 muajve, nga shqyrtimi i parë, Kuvendit t'i paraqesin raportin me rekomandime.

Nëse ju jeni dakord, tri pikat tjera i lëmë për më vonë, tani ta bëjmë një pauzë dhe vazhdojmë me seancën e re. Urdhëro, Berim Ramosaj e ka fjalën.

BERIM RAMOSAJ: Ju falënderoj shumë, Kryetar, që ma dhe fjalën, por nuk është pak e qartë kjo për mua, pse Komisioni për Integritet Evropian ta shqyrtoj një fenomen apo ky komision funksional të merret me problemin e financimit të këtyre shtëpive dhe çështje të tjera, ku në fakt nuk mund të japë asnjë kontribut, sepse nëse është menduar se ai komision e shikon a është në harmoni me proceset evropiane, atëherë po e shohin edhe komisionet tjera dhe e marrin atë pëlqim.

KRYETARI: Ju faleminderit! Komisioni për Integritet Evropian do t'i shikojë standardet a po plotësohen a jo. Do të thotë, po e marrim një pauzë, e pastaj vazhdojmë me seancë të re. Jeni dakord? Ju faleminderit!

### **Vazhdimi i seancës së paradites**

Kemi edhe tri pika të rendit të ditës të seancës së paradites. Nëse dëshironi, mundemi ta marrim edhe një pauzë. Jo. Vazhdojmë.

Pika e nëntë e Seancës paraprake ishte:

### **9. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për përcaktimin e të drejtave dhe mbrojtjen e topografisë së qarqeve të integruara**

Në bazë të Rregullës 35.1 të Rregullores së Punës, janë përmbushur kushtet për shqyrtimin dhe miratimin në parim të këtij Projektligji. Ftoj ministrin e Ministrisë për Tregti dhe Industri, zotin Lutfi Zharku, që në emër të Qeverisë së Republikës së Kosovës, para deputetëve të Kuvendit të prezantojë Projektligjin.

MINISTRI LUTFI ZHARKU: I nderuar kryetar!

Kryeministër,

Zëvendëskryeministra,

Të nderuar ministra,

Të nderuar deputetë,

Më lejoni që shkurtimisht ta paraqes qëllimin, rëndësinë dhe fushën e rregullimit të Projektligjit për mbrojtjen e topografisë së qarqeve të integruara. Me këtë Projektligj hartojmë bazën ligjore për mbrojtjen dhe regjistrimin e topografive që qarqeve të integruara në Republikën e Kosovës.

Ky Projektligj është në vazhden e ligjeve të fuqi, të cilat mbrojnë dhe rregullojnë sferën e pronës industriale në Kosovë. Deri më tani kemi Ligjin për marka tregtare, Ligjin për patentim dhe Ligjin për dizajnin industrial, të cilët krijojnë kushte për mbrojtjen dhe regjistrimin e objekteve të pronës industriale siç janë: markat tregtare, patentat dhe dizajnet industriale, kurse procedurat për regjistrime dhe mbrojtjen e topografive që qarqeve të integruara, si objekte të pronës industriale, kanë qenë të pasanksionuara me

ligj. Prandaj, miratimi i këtij ligji do të krijojë kushte dhe do të vendosë procedurat për regjistrimin dhe mbrojtjen e topografive të qarqeve të integruara, si objekte të pronësisë industriale.

Projektligji parasheh që Zyra për Pronësi Industriale e cila funksionon në kuadër të MTI-së, të japë të drejtën për regjistrim dhe mbrojtje të topografisë. Një topografi mund të regjistrohet dhe të mbrohet vetëm nëse është origjinale. Zyra e Pronësisë Industriale mban regjistrin e topografive të aplikuara. Të drejtat regjistrohen për afat dhjetëvjeçar, kurse kërkesa për regjistrim të së drejtës për topografi bëhet përmes përfaqësuesve të autorizuar që i caktojnë vetë kompanitë apo pronarët e qarqeve topografike.

Për regjistrim të topografisë, Zyra lëshon certifikatë të regjistrimit, e cila publikohet në Buletinin zyrtar të saj. Projektligji përcakton edhe procedurat e ankesës, nëse pala është e pakënaqur me vendimin e Zyrës për Pronësi Industriale. Projektligji për vitin 2009 nuk parasheh ndikime buxhetore, kurse që nga viti 2010 parashihet shtimi për dy zyrtarë në Zyrën për Pronësi Industriale. Projektligji është i bazuar në Direktivën Evropiane 87/54, kurse miratimi i tij plotëson një nga kërkesat në proceset e integritimeve evropiane në sferën e pronësisë industriale dhe ndikon në krijimin e një ambienti më miqësor për tërheqjen dhe mbrojtjen e investimeve në Kosovë, të cilat janë një ndër prioritetet tona.

Duke qenë të vetëdijshëm për rëndësinë e këtij projektligji dhe duke pasur parasysh nevojën e avancimit të kuadrit ligjor në fushën e pronësisë industriale në përgjithësi, ju rekomandoj që këtë projektligj ta shqyrtoni dhe miratoni në këtë seancë plenare. Ju faleminderit për vëmendje!

KRYETARI: Ju faleminderit!

Kryetari i Komisionit, e do fjalën? Jo. Shefat e grupeve parlamentare? Mirë. Në emër të Partisë Demokratike fjalën e ka kërkuar Kqusha Jashari.

KAQUSHA JASHARI: Ju faleminderit, i nderuar Kryetar!

I nderuar Kabinet Qeveritar

Kolegë deputetë,

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike e përkrah Projektligjin për përcaktimin e të drejtave dhe mbrojtjen e topografisë së qarqeve të integruara, në leximin e parë. Ne konsiderojmë se me aprovimin e këtij Ligji do t'i përmbushim detyrimet që dalin në kuadër të anëtarësisë së Zyrës së Pronësisë Industriale të Kosovës në organizatat botërore të pronësisë dhe gjithashtu duhet të ceku se ky projektligj e ka mbështetjen në Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

Ky Ligj është plotësim i sistemit për mbrojtjen e pronësisë industriale dhe rregullon një fushë mjaft të rëndësishme, i rregullon kushtet, procedurat për regjistrimin e të drejtave dhe mbrojtjen e topografisë, gjithashtu mbrojtjen e të drejtës së mbrojtjes së topografisë për të gjithë krijuesit, pastaj regjistrimin e topografisë, shënimi, licencimin, tarifën, gjithashtu edhe shkeljen e së drejtës.

Propozimi i projektligjit është bërë në bashkëpunim me disa ministri, me Ministrinë e Financave, Ministrinë e Shërbimeve Publike, me Shërbimin Doganor të Kosovës. Edhe kjo do të thotë se ka qenë koordinimi i punës dhe harmonizimi me ligjet e tjera. Me shqyrtimin e mëtutjeshëm në procedurën e Kuvendit, me siguri do të bëhen edhe sqarime tjera edhe plotësime eventuale. Që ka qenë pak diskutim mes nesh, ka qenë në

lidhje me titullin e ligjit dhe unë mendoj se duhet titullin ta shikojmë se a është adekuat, sepse teksti është shumë më i qartë se sa titulli që pak i ka disa dilema se a është përkthimi bukal apo diçka tjetër, por te na ka qenë në diskutim se a është titulli në rregull. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit! Në emër të LDK-së, deputeti Armend Zemaj e ka fjalën.

ARMEND ZEMAJ: Ju faleminderit, Kryetar!

I nderuar Kabinet qeveritar,

Së pari përshëndesim sponzoruesin për një ligj mirë të hartuar dhe të strukturuar në mënyrën e duhur, pasi që ky projektligj për mbrojtjen e topografisë së qarqeve të integruara rregullon kushtet dhe procedurat për regjistrimin e të drejtave dhe mbrojtjen e topografisë së qarqeve të integruara, si dhe zbatimin e këtyre të drejtave.

Fusha që rregullon ky projektligj është në pajtim me direktivat e Bashkimit Evropian dhe Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës e mbështet në parim. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Ethem Çeku e ka fjalën.

ETHEM ÇEKU: Ju faleminderit, zoti Kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Kabinet qeveritar,

Edhe grupi ynë parlamentar e mbështet në parim këtë projektligj dhe mendoj që është një projektligj i mirë dhe plotëson një vakum ligjor që ka ekzistuar deri me tani. Kërkoj nga Ministria që t'i përshpejtojë edhe disa projektligje të tjera për t'i sjellë që ta plotësojë një vakum ligjor që nevojiten, posaçërisht sa i përket çështjes së investimeve të jashtme në Kosovë. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, deputetja Myzejane Selmani e ka fjalën.

MYZEJANE SELMANI: Ju faleminderit, zoti Kryetar!

Përshëndetje për të gjithë,

Pikë së pari përshëndetje për ministrin që kësaj radhe e ka sjellë Ligjin në normat çfarë është dashur të silllet, një ligj brenda Kuvendit të Kosovës. Është një ligj i rëndësishëm, mirëpo shpreh mendimin që ministri të përgatitet ndoshta edhe për Organizatën Botërore të Tregtisë, pasi është rasti këtu t'i them, se janë mundësitë më të mira tash se kurdoherë tjetër. Është mundësia në dorën e ministrit dhe, besoj, ministri për të mirën e Kosovës duhet të punojë pak më shumë në këtë rast, se tani është rasti më i volitshëm për Kosovën.

Ndërsa, nëse kaloj te ligji, mund të them se ligji në të gjitha nenet e veta është i qartësuar mjaft mirë, që shumë rrallë ndodhë që ligjet vijnë të qartësuar kështu si është ky ligj këtu. Është ligj që rregullon shumë qartë, u tha, topografitë e qarqeve të integruara, janë dispozitat me të cilat duhet të merret, procedurat e mbrojtjes, rregullimin e përgjithshëm të procedurave çfarë duhet të mbrohet, të drejtat dhe kufizimet, mbrojtja e regjistrimit. Mirëpo, kisha për t'u ndalur vetëm te një nen, ndoshta mos gjatë hartimit është lëshuar diçka, se këtu thuhet qartë te neni 20, dispozitat kalimtare, shuma e kompensimit të dëmit përcaktohet në marrëveshje ndërmjet pronarit

të të drejtës të topografisë së mbrojtur dhe personit i cili ka shkaktuar atë. Nëse nuk arrihet marrëveshja, masat ndëshkuese do të merren sipas dispozitave ligjore në fuqi. Kishte për të qenë me e rrugës, se ti nuk mund t'ju japësh mundësi të merren vesh, se ligji bëhet me një arsye të prerë, nëse i thyen ato kondita, atëherë menjëherë vijnë masat. Kështu, të gjitha mundësitë tjera çka mund të plotësojmë në anën teknike dhe juridike, besoj që do të kompletohet brenda komisionit. Grupi Parlamentar i AKR-së e përkrah në tërësi ligjin.

KRYETARI: Ju faleminderit, deputete! Në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, deputeti Naser Rugova e ka fjalën.

NASER RUGOVA: Ju faleminderit, zoti Kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Anëtarë të Kabinetit qeveritar,

Në vazhden e plotësimit dhe të rregullimit të kësaj fushe me legjislacion adekuat, kemi para vetes një ligj të hartuar mirë, i cili në mënyrë strikte adreson shumë gjëra që deri me tani në vendin tonë nuk kanë qenë të rregulluara dhe njëkohësisht krijon edhe kondita më të favorshme edhe për investime të huaja.

Zoti ministër,

Te Zyra e Pronësisë Industriale, ku thuhet që ministri i Tregtisë dhe Industrisë, në propozim të Zyrës së Pronësisë Industriale nxjerr akt nënligjor që përcakton tarifat për topografitë e përcaktuara nga ky projektligj. Këtu duhet, besoj, që me akt nënligjor në mënyrë shumë precize të përcaktohen këto, sepse edhe ministri, edhe legjislativi, por edhe palëve të interesuara, në instancë të fundit edhe gjyqësori për konteste të ndryshme ua lehtëson punën.

Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Dardanisë do ta përkrah në parim këtë projektligj, mirëpo po vazhdon praktika e vjetër që këto projektligje të kostoja financiare dhe për sigurimin e mjeteve buxhetore për zbatimin në praktikë të këtij ligji, nuk janë të harmonizuara me Kornizën afatmesme të shpenzimeve dhe kjo është një vërejtje serioze dhe po më vjen mirë që Departamenti i Buxhetit pranë Ministrisë së Ekonomisë dhe Financa po i cekë në mënyrë permanente, sepse e vë në pikëpyetje edhe Ministrinë, e vënë në pozitë të palakueshme edhe ministrin që ta zbatojë këtë ligj, sepse nesër mund të fillojnë proceset, marrëdhëniet e ndryshme kontraktuale dhe moszbatimi i ligjit në praktikë po na vë në sprovë, që pastaj ta rishqyrtojmë këtë ligj apo të marrim edhe hapa të tjerë.

Po e citoj, do të thotë, Deklaratën financiare të Ministrisë për Ekonomi dhe Financa edhe te çështja kur duhet angazhuar mbase staf shtesë për zbatimin e këtij ligji, kur bën apel në njëfarë forme që duhet të përcaktohen burime dhe fonde shtesë të financimit, ndërsa vendimet për rritjen e stafit duhet të bëhen në pajtim me ligjin. Sigurisht që duhet të bëhen në pajtim me ligjin, sepse nëse ne prodhojmë ligje, pranojmë staf dhe këto nuk bëhen në pajtim me ligjin, atëherë ku është efekti i kësaj. Ne do t'i japim kontributet tona në komisionet funksionale dhe, edhe një herë, në parim e mbështesim dhe është një nga ligjet e mira që kanë ardhur kohëve të fundit në Parlament. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit, deputet! Në emër të Grupit Parlamentar “7+”, Enis Krvan

ENIS KERVAN: Ju faleminderit, zoti Kryetar!

Entegre edelen ilçeler topografisinin korunmasına ait Yasa Tasarısı, entegre edilen ilçeler topografisinin korunmasını, hakların kaydedilmesi süreçlerini ve tüm bu hakların gerçekleşmesini düzenlemektedir. Bu Yasa Tasarısının düzenlemiş olduğu alan, Avrupa Birliğinin direktifleriyle uyumludur. Bu Yasa Tasarısına göre, endüstri sahipliliği kurumu, topografinin kaydedilmesiyle korunması hakkını vermektedir. Bu kurum, şu anda Ticaret ile Endüstri Bakanlığı çerçevesinde çalışmaktadır. Bu Yasa Tasarısına göre, entegre edilen ilçelerin bir topografisi, topografi kaydına geçirildikten sonra, korunum altına alınacaktır. Endüstri sahipliliği kurumu, gereken verilerle kayıt defterine geçirilmesiyle, ilgili sertifikayı hazırlayarak, onu endüstri sahipliliği kurumunun resmi bülteninde yayımlıdır. Fakat, korunum altında bulunan topografi sahibi, ruhsatın verilmesiyle, onun istifa edilmesine izin vermelidir.

Bu Yasa Tasarısına göre, topografi hakkı, ruhsat hakkının aktarılması ya da korunum altında bulunan topografinin Yasal statüsündeki herhangi bir diğer değişiklik bunların resmi bülteninde yayınlanması ve endüstri sahipliliği kurumunun yapmış olduğu diğer topografik hizmetlerinin, topografik kaydına geçirilmesi için tarifelerle uyumlu olarak vergi ödeme zorunlu olmalıdır. Endüstri sahipliliği kurumunun önerisi üzerine, Ticaret ile Endüstri Bakanlığı, bu Yasa Tasarısıyla öngörülen topografi tarifelerini belirleyen altyasa akidini de hazırlamalıdır.

Korunum altında bulunan topografinin hak sahipleri, tazminatla birlikte hakların çiğnenmesinin önlenmesiyle ilgili gereken önemlerin alınmasını isteyebilir. Korunum altında bulunan topografi hakkına saygı göstermeyen özel ya da tüzel kişi, meydana gelen zararın tazmin edilmesine ait genel ilkelere göre, beliren zarar için sorumlu olacaktır. Dolayısıyla bütün bunları gözönünde bulundurarak, 7+ Parlamenter grubu, sözkonusu Yasa Tasarısının ilk okunuşunu benimsemektedir.

KRYETARI: Ju Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të SLS-së, Mursel Halili e ka fjalën.

MURSELJ HALILJI: Hvala, gospodine predsedniče!

Gospodine, predsedniče Vlade,

Dame i gospodo ministri,

Kolege poslanici,

Parlamentarna grupa SLS se pridružuje svim ostalim parlamentarnim grupama koje su dale pozitivan tekst i ton ovom nacrtu zakona. Samatramo da je istovremeno zakon od posebne važnosti, s toga čemo podržati ovaj nacrt zakona u načelu. Hvala!

KRYETARI: Ju faleminderit! Deputeti i fundit që e ka kërkuar fjalën, është deputeti Riza Smaka.

RIZA SMAKA: I nderuar zotëri Kryetar!

Zotëri Kryeministër, ministra dhe deputetë të respektuar,

Konsideroj se ky dokument është bërë mirë. Natyrisht, kurrë nuk ka dokument të përkryer, me qëllimin më të mirë, bonafide, disa sugjestione. Po e zëmë, ka dispozita që ndërthuren apo supervenohen me dispozitat e Ligjit për të drejtat e autorit, e ai është ligj special, lex specialis derogat lex generalis, që do të thotë ato ashtu e kështu janë primare. E, tash, meqenëse ato janë krejtësisht të kompletuara, nuk do të ishte e rendit, as e vendit që ne tani me këtë parcialisht t'i prekim disa çështje që atje janë të rregulluara krejtësisht edhe në kontekst me shumë dispozita që janë në ndërlidhshmëri të ndërsjellë. Po asi soji, edhe disa dispozita që i referohen mbrojtjes juridike civile, e që

janë tematikë juridike civile, që janë të rregulluara fare mirë me Ligjin civil. Konsideroj se është qasje e gabuar kur thuhet -masat ndëshkimore, e është fjala për kompensimin e dëmit apo për rimbursimin e dëmit, për zhdëmtimin, se nuk mund të merret zhdëmtimi apo rimbursimi i dëmit si ndëshkim, nuk është fjala për ndëshkim, por është fjala për dëmin poqë se ekziston. Këtu është fjala për dëmin material, por mund të jetë edhe moral dhe, natyrisht, është fjala për rivendosjen e ekuilibrit të pasurive të humbura me këtë, që do ta kompensonte atë.

Këto do të ishin disa sugjerime. Natyrisht, në procedurat e ardhshme do të përpiqemi që të japim një kontribut me projekt amendamente që ta bëjmë këtë ligj edhe më të mirë edhe ta miratojmë. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit, të respektuar deputetë! Në vazhdim kërkohet deklarimi me votim për miratimin, në parim, të këtij Projektligji. Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim dhe votojmë tash.

Në sallë kemi 73 deputetë.

Me 65 vota “për”, asnjë “kundër” dhe asnjë abstenim, Kuvendi miratoi, në parim, Projektligjin për përcaktimin e të drejtave dhe mbrojtjen e topografisë së qarqeve të integruara.

Në bazë të Rregullores së Punës së Kuvendit, Kuvendi i ngarkon këto komisione:

1. Komisionin për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion, si komision funksional.
2. Komisionin për Legjislacion dhe Gjyqësi,
3. Komisionin për Buxhet dhe Financa,
4. Komisionin për Komunitete, dhe
5. Komisionin për Integritet Evropian.

Komisioni duhet që brenda 2 muajve nga shqyrtimi i parë, Kuvendit t’ia paraqesin raportin me rekomandime.

Vazhdojmë me pikën e radhës:

#### **10. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për parandalimin dhe luftimin e krimit kibernetik**

Në bazë të Rregullës 35.1 të Rregullores së Punës, janë përmbushur kushtet për shqyrtim dhe miratim, në parim, të këtij Projektligji. Ftoj ministrin e Transportit dhe Post-Telekomunikacionit, që nuk e kemi këtu. Kush e prezanton këtë projektligj nga Qeveria? Arsim Bajrami do ta prezantojë.

ZËVENDESKRYEMINISTRI HAJREDEIN KUÇI: Ju faleminderit! Natyrisht që në mungesë të ministrit të Transportit, ju e di që e keni marrë Ligjin me kohë dhe e keni vërejtur që ligji është i punuar sipas standardeve ndërkombëtare, në përputhje të plotë edhe me Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Ju ftoj në emër të Qeverisë që ta votoni Ligjin në parim, në leximin e parë t’i jepni vërejtjet tuaja dhe besoj që ky ligj është i mirë për fushën e kibernetikës. Ju faleminderit!

(duartrokitje ne sallë)

KRYETARI: Në emër të Partisë Demokratike, fjalën e ka kërkuar deputetja Edita Tahiri.

EDITA TAHIRI: Zoti Kryetar, jo në emër të Partisë Demokratike, por në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së. Ju faleminderit! Ju përsëndes, shkurt, sepse me të vërtetë jemi në një shpejtësi. Padyshim që kjo fushë e problemeve që krijohen me përdorimin e teknologjisë informative dhe telekomunikuese po krijon shqetësime dhe probleme në planin individual të njerëzve dhe veçmas ka goditur botën e grave. Mirëpo, kohët e fundit ka nisur edhe bota mashkullore të goditet dhe të keqtrajtohet nga kjo formë e keqpërdorimit.

Ligji që po vjen apo projektligji, tregon sensin e Qeverisë së Kosovës dhe të Ministrisë përkatëse që me kohë të fillojmë ta vejmë nën kontroll këtë dukuri dhe të zbatojmë ligjin si formë e parandalimit të dukurisë. Katër çështje që desha shkurt t'i theksoj dhe që mendoj se ky ligj duhet qartësisht t'i definojë, janë:

1. Që privaciteti i individëve dhe i qytetarëve në një vend demokratik të ruhet në nivelin më të lartë.
2. Që siguria e viktimave të qartësohet me një nen të caktuar sepse, zakonisht, viktimat janë ato që shpesh po përfundojnë edhe me vetëvrasje, e ky është fenomen botëror, e kam fjalën.
3. Meqenëse tani Qeveria e Kosovës është në realizimin e Programit për vendosjen e Internetit nëpër shkolla, duhet të ketë një nen i cili kufizon përdorimin e spektrit të gjerë të Ueb sajtit dhe të kufizohet për ato informacione që, në fakt, stimulojnë përdorimin e Teknologjisë Informative si formë e krimit.
4. Për hartuesit e ligjit, desha t'ua jap një vërejtje terminologjike, s'e kam zakon të flas për terminologji, por nuk është fjala për krimin kibernetik. Kibernetika është një shkencë në vete, ndërsa këtu është fjala për saiber crime dhe fjala saiber është vetëm prefiks i fjalës kibernetikë. Prandaj, propozimi është ky, pra të jetë Projektligj që ndërlidhet me krimin e teknologjisë informative dhe të komunikimit apo Projektligj për saiber krimin, por kurrësi jo për krimin kibernetik. Dhe, nëse ka domethënë nevojë, duhet të thirren ekspertët, sepse kibernetika është shkencë që merret me lidhmërinë e njeriut me automatizmin. Ju faleminderit!

KRYETARI: Mendova se po e kursejmë, por janë paraqitur në emër të grupeve parlamentare. Po fillojmë me Grupin Parlamentar të Partisë Demokratike. Nerxhivane Dauti e ka fjalën.

NERXHIVANE DAUTI: Ju faleminderit, zoti Kryetar!

Do ta paraqes prezantimin tim në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës.

Lëmia e krimit kibernetik është e rëndësishme, por edhe mjaft komplekse. Kjo për faktin se legjislacioni i BE-së nuk i rregullon çështjet penale, përkatësisht është kompetencë ekskluzive e shteteve anëtare që i rregullojnë me legjislaturën tyre kombëtare.

Grupi Parlamentar i PDK-së e ka konsideruar në legjislaturën e dytë të këtij Kuvendi si nevojë të padiskutueshme rregullimin me ligj të kësaj fushe, prandaj edhe ka iniciuar kohë më parë miratimin e këtij ligji. Mirëpo, në legjislaturën e dytë, ky Kuvend, në seancën e 4 qershorit 2007, vendosi që Projektligjin që sot po e shqyrtojmë t'ia kthejë Qeverisë së Kosovës për rihartim dhe, po në të njëjtën seancë, miratoi Rezolutën për përkrahjen e parimeve të Konventës së Këshillit të Evropës kundër krimit në fushën e kibernetikës.

Sistemet kompjuterike sot paraqesin mundësi shumë të madhe për punë efikase dhe të suksesshme, por në të njëjtën kohë krijojnë hapësira për keqpërdorime dhe krime elektronike që, po qe se nuk adresohen në mënyrë të shpejtë, mund të sjellin probleme dhe krime për shoqërinë dhe organet shtetërore.

Hartimi i Projektligjit për parandalimin dhe luftimin e krimit kibernetik shihet si një hap i duhur dhe i nevojshëm që bëhet në funksion të preventivës së këtyre krimeve, e në rastet më ekstreme, të dënimit të veprave penale që rezultojnë nga kibernetika dhe sistemet kompjuterike.

Pjesë e veçantë e draftit është edhe procedura e ndjekjes së kryerësve të këtyre krimeve. Në mënyrë që krimi kibernetik të mos mbetet i mangët dhe i kufizuar vetëm brenda territorit shtetëror të Republikës së Kosovës, ligji në dispozitat e veta parasheh edhe bashkëpunimin ndërkombëtar, komunikimin dhe bashkëpunimin e institucioneve përkatëse të Republikës me homologët e tyre në vendet tjera.

Projektligji është në përputhje me aktet normative të BE-së, në pajtim me parimet e Konventës së Këshillit të Evropës kundër krimit në fushën e kibernetikës dhe të Konkluzioneve të Samitit të Selanikut për shoqëritë informative, të datës 1 korrik 2005.

Ligji i propozuar plotëson një zbrazësi juridike të konsiderueshme ashtu që krijon një infrastrukturë ligjore të domosdoshme.

Ligji që tani po e shqyrtojmë do të përbëjë një bazë të fortë ligjore që do t'i eliminojë problemet në praktikë. Kuvendit i është sjellë një ligj vërtet i mirë. Në disa çështje duhet evituar disa mangësi të cilat besoj se janë të korrigjueshme gjatë procesit të amendamentimit.

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e mirëpret dhe përshëndet sjelljen në Kuvend të këtij ligji me rëndësi të veçantë jo vetëm për imazhin e Kosovës së re, por edhe për funksionimin e shoqërisë së re demokratike dhe sundimin e Ligjit.

Në emrin tim personal dhe të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës konsideroj se Ligji duhet miratuar në shqyrtim të parë, ndërsa kontributin tonë do ta paraqesim në fazën e amendamentimit të tij. Ju faleminderit për vëmendje!

**KRYETARI:** Faleminderit, deputete! Në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Fatmir Rexhepi e ka kërkuar fjalën. Janë dy Rexhepa, edhe Arsimi, edhe Fatmiri, por Fatmiri ishte i pari.

**FATMIR REXHEPI:** Po, po, ashtu është, Kryetar. Faleminderit! Arsimi ngutet nga pak, s'u mësuar hala në LDK. Prandaj, unë para se të flas për këtë, me leje, do me thënë të shefit të Grupit Parlamentar të LDK-së, unë do ta falënderoj ministrin e Financave për

zotimin dhe premtimin publik në emër të Qeverisë që e bëri lidhur me harmonizimin e politikave për investimet që i tha pak më herët për vitin 2010, pra edhe për Gjilanin edhe për qendrat e tjera.

Projektligji për luftimin e krimeve në kibernetikë, meqenëse është ligji i parë në këtë fushë, ka rëndësinë e vet. Ne në parim jemi marrë vesh ta përkrahim, sepse ky projektligj vjen si rrjedhojë e një zhvillimi të hovshëm të teknologjisë informative dhe të sistemit kompjuterik që sot është i pranishëm në shoqërinë tonë dhe në Kosovë, si në familje, në biznes, në institucione shtetërore, por në të njëjtën kohë sistemi kompjuterik ka mundësuar edhe hapësira të tjera, të cilat mundësojnë keqpërdorime, prandaj adresohen në mënyra të ndryshme, qoftë në problemet që mund të dalin dhe mund të sjellin në shoqëri, por edhe në organet shtetërore. Prandaj, ky projektligj mjaft mirë brenda 29 neneve të tij është i strukturuar dhe është në funksion të një preventive, pra të këtij krimi të mundshëm në sistemet kompjuterike gjatë përdorimit të tyre, por ka paraparë edhe masat e sigurisë, qoftë ato në lirinë e komunikimit apo të çështjeve që janë brenda kësaj fushe. Në mes tjerash, po e potencoj edhe atë se në dispozitat e veta ky parasheh edhe një bashkëpunim në relacionet ndërkombëtare, që po ashtu do të vë rregull edhe brenda shoqërisë sonë gjatë përdorimit të tij. E përkrahim në parim, do të marrim pjesë në amendamentimin e tij përmes komisioneve funksionale. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, deputet! Në emër të AAK-së, deputetja Donika Kadaaj – Bujupi e ka fjalën.

DONIKA KADAJ-BUJUPI: Faleminderit, Kryetar!

Të nderuar deputetë,

Të nderuar përfaqësues të Qeverisë,

Në këtë hov të zhvillimit të teknologjisë informative sigurisht që ligji është domosdoshmëri dhe jo vetëm aprovimi i tij, por edhe monitorimi i zbatimit. Teknologjia informative ka ofruar mundësi që njerëzit të kryejnë punët më shpejt dhe më me efikasitet, me kosto më të ultë dhe shërbim cilësor. Mirëpo, si rrjedhojë e zhvillimit të teknologjisë informative dhe komunikimit, është një brengë konstante që përcjell këtë zhvillim e ajo është shfrytëzimi i këtyre pajisjeve për çështje abuzive me persona të caktuar.

Me theks të veçantë, shqetësimi ynë është për nenin 16, ku vetëm shkarazi përmendet abuzimi me fëmijët, e që në realitet është shqetësim shumë i madh dhe dukuri që po përhapet në vendin tonë, ashtu siç po përhapet edhe në gjithë botën. Që kjo dukuri është shumë serioze, flasin edhe raportet e ndryshme, në mesin e tyre edhe Raporti studimor i Qendrës për Barazi Gjinore, i cili ngreh shqetësimet për raste të shumta të abuzimeve, sidomos të vajzave të reja – të miturave brenda botës virtuale, e që për pasojë shumë herë përmban materiale të dhunshme, të cilat pas publikimit kanë bërë që të kemi edhe tragjedi të ndryshme deri tek vetëvrasjet dhe në shumtën e rasteve kur ka pasur të bëjë me materiale të montuara.

Prandaj, Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, me qëllim që të kontribuojë në avancimin e vetë ligjit, por me theks të veçantë në zbatimin e tij, mendojmë se duhet të kultivohet një qasje më serioze në trajtimin e këtyre çështjeve nga institucionet, të cilat sipas Kushtetutës së Kosovës janë përgjegjëse për rendin, ligjin dhe sigurinë e qytetarëve. Në këtë radhë janë Ministria e Punëve të Brendshme dhe Ministria e Drejtësisë. Institucionet përgjegjëse për ruajtjen e rendit shoqëror dhe zbatimin të ligjit do të duhej të zhvillonin programe konkrete për përndjekjen dhe dënimin e gjithë

individëve që merren me këtë lloj veprimtarie kriminale. Për Ministrinë e Arsimit, e cila me pompozitet promovoi projektin e kompjuterizimit të shkollave, mirëpo asnjëherë nuk kërkoi nga ofruesit e shërbimeve instalimin e mekanizmave mbrojtës. Një shembull është Parents control systems, i cili do të pamundësonte që fëmijët tonë gjatë punës në kabinete të keqpërdoren përmes rrjetit, i cili deri tani është komplet i pambrojtur. Gjithashtu, edhe për Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale të hartojë politika më të mira sociale, që do të përkujdesen për viktimat e keqpërdorura nga pajisjet teknologjike.

Duke e aprovuar në parim, Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës mendon që ekzekutivi duhet të ketë një qasje më serioze në zbatimin dhe monitorimin e zbatimit të këtij ligji, sidomos kur kemi parasysh faktin që është një shqetësim mjaft i madh që një numër i madh i ligjeve të rëndësishme të veçantë, të cilët kalojnë nëpër këtë Kuvend, nuk zbatohen fare. Prandaj, kemi një dilemë, që edhe ky ligj për të cilin me shumë përkushtim kontributin do ta japim edhe pranë komisioneve përkatëse funksionale, të zbatohet dhe të bëhet një monitorim i përafërt, sepse është definitivisht një ndër ligjet e rëndësishme të veçantë. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së deputetja Muzejene Selmani e ka fjalën.

MUZEJENE SELMANI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Që në fillim mund të them se pajtohem me deputeten Tahiri se përkthimi i këtij projektligji nga gjuha angleze në gjuhën shqipe nuk është i rendit çfarë është përkthyer këtu – Ligji për parandalimin dhe luftimin e krimit të kibernetikës, se kibernetika si shkencë është një lëmi shumë e madhe, këtu është krejt diçka tjetër në pyetje. Gjatë shqyrtimit të këtij projektligji, Grupi parlamentar i AKR-së vëren se ka mangësi bukur të mira në këtë projektligj. Për implementimin e këtij ligji duhet të marrë pjesë edhe Ministria e Drejtësisë në bashkëpunim me Ministrinë e Punëve të Brendshme, njëkohësisht Ministria e Transportit në bashkëpunim me Shërbimin e Inteligjencës së Kosovës, se çdo zhvillim i madh i informatikës apo i telekomunikacionit, në përgjithësi i IT, prek të gjitha shtresat e shoqërisë në Kosovë, sidomos të rinjtë që janë pjesë e pasojave të zhvillimeve të hovshme që ndodhin në gjithë botën. Mirëpo, kisha për të potencuar, në nenin 9 duhet të qartësohen pak më qartë veprat penale kundër integritetit dhe disponueshmërisë së të dhënave të sistemeve kompjuterike. Janë disa çështje këtu që edhe kolegja pak më parë e potencoi te çështja e personave të mitur apo më mirë të themi te fëmijët, neni 16, që duhet të kihet një kujdes shumë më i madh, të potencohet edhe me ligj që të jetë shumë strikt, mirëpo gjatë amendamentimit të këtij ligji në shqyrtim brenda komisioneve mund të them se ndodh që mund të përmirësohet, por kontributi duhet të jepet prej të gjithëve që të dalë një ligj i cili mund të zbatohet në praktikë. Se problemi më i madh i përfundimit të këtij ligji është se a do të mund të zbatohet në praktikë, se është ligj fitimprurës edhe për buxhetin e Kosovës por zbatueshmëria e tij do të jetë shumë e komplikuar. Faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së Naser Rugova e ka kërkuar fjalën.

NASER RUGOVA: Faleminderit, zoti Kryetar!

Edhe Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Dardanisë e ka shqyrtuar me vëmendje një ligj mbase shumë të nevojshëm dhe që po hartohet për herë të parë në legjislacionin e Kosovës. Problemet që kanë të bëjnë me këtë fushë me piraterinë, krimin në lëmin e kibernetikës dhe të teknologjisë informative të avancuar, ka qenë domosdo që edhe në

shtetin tonë kjo fushë të rregullohet me ligj. Konsideroj që ligji ka nevojë të plotësohet edhe me amendamente të tjera strikte, por është një ligj që në substancë përfshin të gjitha obligimet që i ka shteti dhe funksionimi i institucioneve shtetërore në këtë fushë tejet të rëndësishme dhe senzitive, që ka të bëjë në radhë të parë me obligimet e pronarëve dhe të administratorëve të sistemeve të caktuara që menaxhojnë apo ofrojnë shërbime të teknologjisë informative, pastaj veprat penale kundër konfidencialitetit, integritetit dhe disponueshmërisë së të dhënave të sistemeve kompjuterike, që në botën demokratike dhe të zhvilluara është shumë aktuale, pastaj te interceptimi i pa të drejtë, transferet e paautorizuara, jemi dëshmitarë të falsifikimeve apo edhe të piraterisë me kode bankare e tjera, e tjera dhe si shtet që po ndërtojmë kapacitetet në vazhdimësi, duhet që edhe sistemit bankar, edhe institucioneve tjera, po edhe investitorëve të mundshëm thjeshtë t'u krijojmë siguri të përcaktuar në mënyrë strikte me ligj. Pastaj, edhe pengimi i funksionimit të sistemeve kompjuterike që interferojnë, pengojnë apo merren edhe me pirateri të informatave, konsideroj që në nenin 12, pastaj edhe në nenin 13, prodhimi, posedimi dhe tentativat e paautorizuara që aktualisht ndodhin çdo ditë në Kosovë, janë të rregulluara në një masë të konsiderueshme. Është me rëndësi që të nxirren edhe disa udhëzime administrative apo akte nënligjore që vlejnë për nenin 14, veprat penale lidhur me kompjuterët, po edhe shkaktimi i humbjes së pronës, që janë gjëra jetike për funksionimin normal të jetës, të zhvillimit të biznesit dhe të pronës së qytetarit.

Ne do të japim kontributin tonë në vazhdimësi në komisionet funksionale duke e mbështetur në parim këtë projektligj. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, deputet! Në emër të Grupit Parlamentar “7+”, deputeti Sadik Idriz e ka kërkuar fjalën.

SADIK IDRIZ: Hvala, predsedniče! Parlamentarna grupa „7+“ će u načelu podržati ovaj zakon i smatramo da je izrada ovog nacrt zakona pravi korak u funkciji sprečavanja kriminala i kažnjavanja krivičnih dela koje su rezultat zloupotrebe kompjuterskih sistema i kibernetike. Medjutim, pošto smo dosta umorni, ja neću svoju diskusiju nastaviti, mi ćemo dati podršku i daćemo svoj doprinos u komisijama. Hvala!

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar SLS, shefi i Grupit Bojan Stojanović e ka kërkuar fjalën.

BOJAN STOJANOVIĆ: Hvala gospodine predsedniče! Naravno i mi smo dobili na vreme ovaj nacrt zakona i Parlamentarna grupa Samostalne liberalne stranke će ga podržati, jer mi svi znamo da je sad nekako svetski trend i hit upravo taj kriminal iz ove oblasti i mogu se napraviti velike zloupotrebe tako da je neophodno da i mi regulišemo ovu oblast, ali teško je pričati na kraju, prethodnici su sve rekli vezano za ovaj nacrt zakona. Mi ćemo se kroz komisije truditi da damo svoj skromni doprinos kako bi ga unapredili, a evo bliži se kraj ove sednice i mi ćemo posle ovoga otići da se sulfrujemo na more a kad se bude usvojio zakon, vrtićemo se kući pa ćemo da sulfrujemo bezbedno i na internetu. Hvala!

KRYETARI: Faleminderit! Tani i kemi edhe nja 3 deputetë që e kanë kërkuar fjalën. Ibrahim Makolli e ka fjalën.

IBRAHIM MAKOLLI: Faleminderit, zoti Kryetar! Unë vetëm do të doja të jepja një sugjerim ose vërejtje, në veçanti te neni 16. Është shumë e vërtetë që ky ligj ndoshta i është dashtë vendit edhe më herët, sepse qytetarët e Kosovës nuk kanë qenë të mbrojtur

në këtë fushë. Por, unë po përmend vetëm te çështjet e sanksionimit, që konsideroj se do të duhej të ishin më të ashpra në këto raste, në veçanti te pornografia me fëmijë përmes sistemeve kompjuterike, ku kemi sanksione të ulëta. Ta zëmë, neni ..., paragrafi 1, thotë “dënohet me burgim deri në 3 vjet, ndërsa nëse kualifikohet se është kryer në rrethana rënduese, dënohet deri në 10 vjet”. Në vazhdim pastaj, në paragrafin 2 e keni vetëm tentativa, do të thotë, deri në 3 vjet. Do të sugjeroja që sanksionet sa u përket krimeve në këtë fushë të ishin më të ashpra me qëllim të mbrojtjes së qytetarëve nga abuzimet që mund të vijnë nga veprimet përmes kësaj forme. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Ardian Gjini e ka fjalën.

ARDIAN GJINI: Faleminderit, zoti Kryetar! Dy ose tri çështje në lidhje me ligjin. Fillimisht, derisa isha duke diskutuar jashtë dhe fillova të them fjalë të mira, dikush më tha – s’po mund të besoj që po thua diçka mirë për një ligj të Qeverisë. Dhe, i thashë, as unë s’po mund të besoj se ka ardhur një ligj i mirë.

Po, në rregull, duhet thënë fillimisht se është një ligj i mirë, një ligj i punuar mirë që ka ardhur. Disa probleme mund të dalin, dy ose tri, të cilat do t’i potencoj. Çështja e parë është, kush e ka hartuar ligjin edhe për shkak se ligji është hartuar në Ministri të Transportit e të Telekomunikacionit. Është përvjedhur një temë tek neni 6 pika 2. Thuhet që të dhënat ruhen edhe në Ministrinë e Transportit, përpos në institucionet tjera. Tani, një problem është këtu. Ministria e Transportit është ministri e visë, e cila nuk ka infrastrukturë njerëzore sikur Ministria e Punëve të Brendshme ose Ministria e Forcës së Sigurisë ose edhe Agjencioni i Inteligjencës së Kosovës për ruajtje të informatave. Do të thotë, nuk është ministri e specializuar për të pasur informata të cilat duhet të ruhen. Dhe, vetë fakti se është hartuar në këtë ministri, aty shkruhet se edhe Ministria e Transportit i ruan këto informata. Mendoj se duhet Policia, Agjencioni i Inteligjencës e jo Ministria e Transportit, po përsëris se nuk ka infrastrukturë për ruajtje të informatave sekrete. Kjo është një çështje, që mendoj se është e rëndësishme për këtë ligj, që komisioni ta ketë parasysh. Gjuha u përmend disa herë. Është e vërtetë që emri nuk korrespondon me materien e cila trajtohet në ligj. Unë nuk kam arritur që ta shoh, shembull të marrim se si në Shqipëri është emërtuar ligji që trajton materie të njëjtë, mirëpo kishte për të qenë mirë që eventualisht komisioni të shohë se si quhet atje dhe ta huazojë emrin për shkak se nuk është adekuat.

Dhe, e fundit, që e kisha thënë tani është, po më vjen mirë që Agjencioni për Integritet Evropianë më në fund nuk na ka sjellë një listë me përkthime prej shqipes në anglisht dhe prej anglishte në shqip, po më duket se dy-tri vërejtje që i kam bërë në foltore kanë pasur efekt.

Do të thotë, është një ligj i mirë. Pajtohem me atë që i tha në emër të Grupit deputetja Kadaj. Nuk jemi pajtuar me buxhet, por po me këtë ligj, pajtohemi. Faleminderit!

KRYETARI: Edhe kjo, mirë është! Deputeti i fundit është Riza Smaka.

RIZA SMAKA: Zotëri, Kryetar!

Tri çështje parimore: Një, titulli nuk është adapt me përmbajtjen e tekstit ligjor dhe i referohet vetëm preventivës, a çdo akt ligjor duhet t’i referohet edhe preventivës, edhe represives, sepse kjo i bien kësisoj, të dalësh në lum, me duar, me gishta nuk ndalet krejt uji e ata që kapërcen, atëherë represivja, prandaj këtu del se ky është vetëm për parandalim, apo jo. Edhe kësi soj, mandej del njëfarë defekti.

Dy, me këtë ligj është e papresedencë që me ligj të këtillë të caktohen veprat penale. Veprat penale caktohen me Kodin penal, kurrësi me akte tjera ligjore, apo jo. Prandaj, kjo duhet të pastrohet gjatë procedimit deri në miratim.

Dhe, e treta, ky ligj, edhe sikundër të ishte i përkryer, a s'ka ligj të përkryer, as kurrësi në jetë s'ka të përkryer, nuk do të mund të aplikohet fare sikundër mos të inkorporohet në të edhe një kaptinë për dispozitat ndëshkimore, sepse janë harruar krejtësisht ato. Ndoshta i ka përgatitur sponsori dhe delete - i kanë rënë diku, prandaj duhet të inkorporohet kaptina për dispozitat ndëshkimore, e veçantë. Veprat penale nuk mund të caktohen me këtë akt ligjor dhe titulli duhet të jetë i përshtatshëm, që do të përpiqem me një projektamendament për të dhënë një kontribut edhe në këtë drejtim. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, të nderuar deputetë e deputete. Në vazhdim, kërkohet deklarimi me votim për miratim të Projektligjit, në parim.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash:

Me 81 vota “për”, asnjë “kundër”, 1 abstenim, Kuvendi miratoi në parim Projektligjin për parandalimin dhe luftimin e krimit kibernetik.

Në bazë të Rregullores së Punës, ngarkohen këto komisione:

1. Komisioni për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion, si komision funksional,
2. Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi,
3. Komisioni për Buxhet dhe Financa,
4. Komisioni për Komunitete dhe
5. Komisioni për Integritet Evropian.

Komisionet duhet që brenda 2 muajve, nga shqyrtimi i parë, Kuvendit t'i paraqesin raportin me rekomandime.

Dhe, kalojmë në pikën e njëmbëdhjetë të rendit të ditës:

#### **11. Shqyrtimi i Propozim-vendimit të Qeverisë së Kosovës për shpalljen e hapësirës zonë me interes të veçantë ekonomik për ndërtimin e Hidrocentralit “Zhur”**

Qeveria e Republikës së Kosovës, në pajtim me Ligjit për planifikimin hapësinor, ka hartuar dhe Kuvendit i ka paraqitur për shqyrtim dhe miratim Propozim-vendimin për shpalljen e hapësirës zonë me interes të veçantë ekonomik për ndërtimin e Hidrocentralit “Zhur”.

Komisioni për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, në pajtim me dispozitat e Rregullores së Punës ka shqyrtuar propozim-vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Kuvendit i ka rekomanduar miratimin e tij në seancë plenare.

Ndërsa, Komisioni për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion ka shqyrtuar Propozim-vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe nga propozuesi ka kërkuar material shtesë.

Propozim-vendimi i Qeverisë, së bashku me rekomandimet e komisionit funksional, u është shpërndarë deputetëve.

Ftoj përfaqësuesin e Qeverisë të prezantojë Projekt-vendimin.

MINISTRJA JUSTINA PULA-SHIROKA: I nderuar Kryetar!

I nderuar Kryeministër,

Të nderuar zëvendëskryeministra,

Deputetë,

Ministra,

Më lejoni që para jush të prezantoj Propozim-vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës për shpalljen si zonë me interes të veçantë ekonomik të hapësirës ku planifikohet të ndërtohet Hidrocentrali “Zhur”.

Qeveria e Republikës së Kosovës, me datën 31.10.2008, mori vendim për themelimin e Komitetit ndërministror për shqyrtimin e mundësisë së zhvillimit të projektit të Hidrocentralit “Zhur” duke zgjedhur formën më të mirë të mundshme në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Ky komitet, me qëllim të zbatimit të vendimit të Qeverisë, me datën 21.1.2009, ka themeluar grupin teknik punues, i cili ka përcjellë hartimin e studimit të fizibilitetit. Ky studim i rishikuar i fizibilitetit, përveç pjesës tekno-ekonomike, në këtë fazë përfshin edhe komentet mjedisore dhe sociale. Studimi final i fizibilitetit është prezantuar me datën 3.6.2009 para Kryeministrit, Komitetit ndërministror dhe publikut të gjerë. Rezultatet dhe konkluzat e këtij studimi kanë sjellë tek përfundimi që zona e studiuar e Hidrocentralit “Zhur” të shpallet zonë me interes të veçantë ekonomik. Ndërkaq, me datën 19.6.2009, Qeveria miratoi kërkesën e Ministrisë së Energjisë dhe Minierave dhe i propozoi Kuvendit që të shpallë këtë zonë me interes të veçantë ekonomik me sipërfaqe prej 19.41 kilometra katrorë, të cilat janë identifikuar me studimin e fizibilitetit. Kjo sipërfaqe prej 19.41 kilometra katrorë përfshin: prurjet e rrjedhave nga vargmalet e Sharrit, tunelet gravituese, kanalet, akumulimin artificial Plavë, akumulimin artificial Brezë, Hidrocentralin “Zhur 1”, objektin e hidrocentralit, tunelet me presion, gypin i çelikut me presion, kyçjen në rrjet, Hidrocentralin “Zhur 2”, objektin e hidrocentralit, kanalin e mbyllur, tunelet gravituese, tunelin e hapur, gypin e çelikut, kyçjen në rrjet e tjera.

Me qëllim të sqarimit të mëtejshëm, më lejoni t’ju informoj se Ligji për planifikim hapësinor kërkon hartimin e planeve për zona me interes të veçantë për hapësira të cilat kërkojnë regjim të veçantë të organizimit, zhvillimit, shfrytëzimit dhe mbrojtjes së hapësirës. Andaj, qëllimi i shpalljes së kësaj zone me interes të veçantë është pikërisht hartimi i Planit hapësinor për zonën me interes të veçantë ekonomik. Me këtë veprim mundësohet zhvillimi i kontrolluar i hapësirës në zonën me vlerë të veçantë ekonomike.

Vendimi i Qeverisë, i datës 19.6.2009, pika 4, obligon Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor të hartojë Planin hapësinor për këtë zonë, ashtu siç kërkon neni 12 i Ligjit për planifikimin hapësinor.

Të nderuar deputetë,

Aprovimi i këtij vendimi nga ana juaj sot i hap rrugë Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor që të fillojë punën rreth hartimit të planit, i cili po ashtu, kur të përfundojë drafti, do të dorëzohet në Qeveri për miratim paraprak dhe i njëjti dorëzohet në Kuvend për aprovim përfundimtar. Këtë e parashikon edhe neni 12.6 i Ligjit për planifikimin hapësinor.

Marrja e këtij vendimi ka rëndësi të veçantë pasi që fuqizon edhe më tej vendimin e komunës së Dragashit, të datës 30 qershor 2009, me të cilin ndalohet ndërtimi i çfarëdo objekti në zonat kadastrale të fshatrave Brezë, në Buçe dhe Zym.

Duke shpresuar në mirëkuptimin tuaj, ju ftoj që të shpallni këtë zonë me interes të veçantë, me të cilën krijohen kushtet për zhvillim të projektit duke u bazuar në vendimin e Qeverisë dhe të mundësohet vazhdimi i hapave të mëtejshme të nevojshëm për kryerjen me sukses të këtij projekti. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, Salë Berisha – Shala e ka kërkuar fjalën.

SALA BERISHA-SHALA: Faleminderit, zoti Kryetar!

I nderuar Kryeministër, Kabinet qeveritar,

Kolegë deputetë dhe ju të pranishëm,

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e ka shqyrtuar dhe e mbështet Propozim-vendimin e Qeverisë së Kosovës për shpalljen e hapësirës zonë me interes të veçantë ekonomik për ndërtimin e Hidrocentralit “Zhur”.

Zona e identifikuar si zonë me interes të veçantë ekonomik gjendet në pjesën jugore të Kosovës, përkatësisht në jugperëndim të komunës së Prizrenit dhe komunës së Sharrit. Kjo zonë në tërësi ka një sipërfaqe, siç e tha edhe ministrja, prej 19.41 kilometra katrorë, duke përfshirë gjithsej 25 zona kadastrale, të vendburimeve të shtrira në Prizren dhe Sharr. Plani në fjalë do të përfshijë një vlerësim të aktiviteteve të planifikuara, ndikimin e tyre në mjedis dhe vlerësimin e hollësishëm të ndikimit pozitiv, sidomos të atij ekonomik.

Hartimi i Planit hapësinor për zonat me interes ekonomik bëhet duke u bazuar në Ligjin mbi planifikimin hapësinor, respektivisht neni 12 i këtij ligji në përputhje me Udhëzimin administrativ mbi elementet themelore të përmbajtjes së planeve hapësinore për zona të veçanta. Pse duhet mbështetur këtë propozim-vendim të Qeverisë. Përderisa Kosova është palë kontraktuese e Traktatit mbi themelimin e komunitetit të energjisë të Evropës Juglindore, për të cilin fakt është e obliguar të bëjë implementimin e politikave të BE-së për sektorin e energjisë, ndër të cilat kërkohet që një sasi e caktuar e energjisë elektrike të prodhohet nga burimet alternative të energjisë. Më saktësisht, politikat e BE-së parashihi që deri në vitin 2020 së paku 20% e energjisë së përgjithshme të prodhuar duhet të jetë nga burimet e ripërtëritshme siç janë uji, biomasa e tjera. Kosova, e dimë se aktualisht prodhon vetëm 3% të energjisë të bazuar në burime alternative. Dihet se aktualisht pjesa më e madhe e energjisë elektrike bazohet në termoenergji, përkatësisht në shfrytëzimin e linjtit.

Qeveria e Kosovës në vazhden e angazhimeve të vetave për përmbushjen e kritereve të kërkuara nga BE-ja dhe në përmbushjen e kërkesave për energji elektrike në Kosovë po bën një punë të madhe, kështu që në këtë kontekst, Ministria e Energjisë dhe Minierave

ka identifikuar disa projekte me të cilat mund të rritet pjesëmarrja e burimeve alternative në prodhimin e energjisë. Prandaj, një projekt i tillë, bazuar në burime alternative, është edhe ndërtimi i Hidrocentralit “Zhurit”, i cili bazohet në akumulimin artificial që duhet ndërtuar në afërsi të fshatit Brezë.

Duke marrë parasysh se Hidrocentrali “Zhur” paraqet më shumë se 50% të tërë hidropotencialit ujqor për prodhimin e energjisë në Kosovë, me implementimin e këtij projekti do të arrihen këto përfitime: krijimi i kapaciteteve të konsiderueshme gjeneruese të energjisë së ..., të cilat mungojnë në Kosovë, diversifikimi i kapaciteteve për prodhimin e energjisë, rritja e sigurisë së furnizimit me energji dhe stabiliteti i sistemit elektroenergjetik, përmbushja e një pjese të konsiderueshme të obligimit që del nga politikat e Bashkësisë Evropiane për pjesëmarrjen e burimeve alternative për prodhim të energjisë, investimet direkte nga jashtë, krijimi i burimit të ri të të hyrave në buxhetin e Kosovës, krijimi i vendeve të reja të punës dhe zhvillimi i komuniteteve lokale dhe të komunave.

Në fund, ju ftoj të mbështetni këtë vendim të Qeverisë, duke pasur parasysh edhe atë se gjithçka që është në raport miqësor me ambientin, në të mirën ekonomike, duhet hapur rrugë, krijuar kushte juridike për t’u implementuar. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Po shpresoj se diskutuesit në vazhdim na kursejnë në kohë. Në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Armend Zemaj e ka fjalën.

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit, Kryetar!

Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës e ka shqyrtuar me kujdes të veçantë shpalljen e interesit të veçantë ekonomik për ndërtimin apo ku do të ndërtohet Hidrocentrali “Zhur”.

Duke kuptuar edhe nga përshkrimi i qëllimit dhe i shpalljes së kësaj zone me interes të veçantë, ne mendojmë që duhet të përkrahet dhe njëherësh ministrinë përkatëse, si Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, që është zotuar për hartimin e Planit hapësinor për këtë zonë, dhe Ministria e Energjetikës, që të bëjnë edhe rregullimin dhe miratimin në afatin sa më të shpejtë dhe të kërkuara kohore. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të AAK-së Ethem Çeku e ka fjalën.

ETHEM ÇEKU: Faleminderit, zoti Kryetar! Realisht, Grupi ynë Parlamentar i mbështet të gjitha ato projekte që janë në favorin e zhvillimit ekonomik të Kosovës dhe që kanë një rregull në procedurat që kanë të bëjnë me fushën e caktuar, posaçërisht me një fushë e cila është e ndjeshme dhe të cilën jemi të interesuar për t’i dhënë mbështetje, që të kemi një progres, një zhvillim ekonomik të vendit tonë.

Pak jam i befasuar, sepse edhe në komision ku kemi diskutuar, e kemi kërkuar që të plotësohet dokumentacioni, të cilin unë e di që Qeveria i ka në sirtarët e vet dhe është pak e çuditshme se si ai dokumentacion, i cili është tek Ministria, tek Qeveria, nuk u sjellë në Parlament që të kemi shumë lehtë të japim një mbështetje. Dhe, e kam fjalën se është kryer një studim për

fizibilitetin e termocentralit, është bërë një vlerësim në ndikim dhe të gjitha këto do të kishin dhënë një mundësi të mirë që ne sot të debatojmë dhe ta mbështesim shpalljen zonë me interes të veçantë një hapësirë të caktuar, e po ashtu ky material duhet të ishte bashkëngjitur edhe vendimet e Asamblesë komunale të Sharrit – Dragashit dhe të

Prizrenit, të cilët e mbështesin që kjo zonë të shpallet zonë me interes të veçantë. Dhe, po ashtu, mendoj që koston e shpenzimeve Ministria e Ekonomisë dhe Financave duhet t'ia sillte Parlamentit edhe një çështje që ka të bëjë me çështjen e koston së shpalljes si zonë me interes të veçantë.

Dhe, në fund dua të ngreh edhe një problematikë shumë të ndjeshme. Kryeministër, jemi duke ndërtuar projekte të mëdha, duke planifikuar për ndërtimin e projekteve të mëdha. Planin hapësinor i Kosovës ka mbetur ende jashtë këtij Parlamenti, duke mos pasur mundësi që projektet zhvillimore të harmonizohen me planin hapësinor të Kosovës. Është qe disa vite që plani hapësinor ka mbetur ende pa u përfunduar dhe pa u kryer në Parlament. Mendoj që do të ishte e rrugës që krahas këtyre projekteve të mëdha, autostradave, ndërtimi i kapaciteteve të reja gjeneruese, hidrocentrali i Zhurit dhe projektet e tilla të jenë në harmoni me Planin hapësinor të Kosovës. Ne ju mbështesim që ta sillni planin dhe të shfrytëzohet racionalisht hapësira e Kosovës sa u përket këtyre projekteve. Edhe një herë ju ftoj që këto projekte të harmonizohen me Planin zhvillimor të Kosovës. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së Heset Cakolli e ka fjalën.

HESET CAKOLLI: Faleminderit, zoti Kryetar!

I nderuari kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Grupi Parlamentar i Aleancës Kosova e Re e ka shqyrtuar Vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës Numër 06/69 të datës 19.06.2009, si dhe rekomandimin e Komisionit funksional për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, të datës 07.07.2009, dhe i përkrah këto dy dokumente që të shpallet zonë e interesit të veçantë ekonomik hapësira me sipërfaqe prej 19.41 kilometra katrorë dhe kjo hapësirë me interes të veçantë ekonomik përfshin gjithsej 25 zona kadastrale të vendbanimeve të shtrira në komunën e Prizrenit dhe të Dragashit, ku planifikohet të ndërtohet Hidrocentrali “Zhur”.

Duke pasur parasysh se Hidrocentrali “Zhur” paraqet më shumë se 50% të tërë hidropotencialit ujqor për prodhimin e energjisë elektrike në vend dhe me ndërtimin e këtij hidrocentrali do të mund të arrihen përfitime të shumta ekonomike si për zonën, ashtu edhe për vendin në përgjithësi, prandaj Grupi ynë i jep mbështetje vendimit të Qeverisë. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së deputeti Naser Rugova e ka fjalën.

NASER RUGOVA: Faleminderit, zoti Kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Kabinet qeveritar,

Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Dardanisë konsideron se kur janë në pyetje projektet e mëdha nacionale, në këtë rast kur kemi të bëjmë me burime të ripërtërishme dhe alternative të energjisë, sigurisht se duhet ta kemi një konsensus nacional, po edhe institucional, që këto projekte të mbështeten, sepse është në interes të vendit tonë, të qytetarëve të Kosovës dhe hapin mundësi edhe për ardhjen e investimeve serioze në Kosovë.

Ministrja e paraqiti në mënyrë bukur precize, edhe pse mungojnë disa dokumente që do të duhej t'i kishin deputetët përfaqësues të popullit përpara. Sa i takon shpalljes si zonë me interes të veçantë ekonomik, një zone ku dihen këto dy qytete, Prizreni dhe Dragashi, kompleksi i Maleve të Sharrit e tjera, për rëndësinë e vet edhe historike, edhe turistike, po edhe për një ambient të pastër ekologjik, shpalljes zonë me interes të veçantë do të duhej t'i paraprinte një projekt i madh nacional - Plani rregullativ hapësinor dhe kjo zonë do të duhej të ishte si derivat, do të duhej të derivonte tani nga ai plan i madh, sepse nganjëherë po përballemi me politika ad-hoc, me vendime ditore që pastaj po jemi të detyruar si institucione t'i rishqyrtojmë, të hartojmë dokumente shtesë, të shpenzojmë mjete, mund, energji e të tjera. Mirëpo, kur është çështja te prodhimi i energjisë, hidroenergjisë, që është energji që prodhohet dhe nuk ka ndikim negativ në mjedis, që sipas të gjithë dokumenteve të BE-së do të duhej të ishte e ardhmja e prodhimit të burimeve energjetike në vend, sidomos për vendin tonë të vogël që nuk i ka as 11.000 kilometra katrorë dhe ne inkurajojmë Qeverinë që të shikojë mundësitë alternative që jo vetëm hidroenergja, por edhe aero-energja të jenë prioritete si burime alternative, sepse koha e termoenergjetikës dhe e ndikimeve enorme në ndotjen e ambientit mbase është politikë demode edhe e legjislacionit dhe e koncepteve të Bashkimit Evropian. Por, duke e ditur se i kemi ato kapacitete, duhet t'i shfrytëzojmë, duhet t'i orientojmë për të mirë të vendit, për të mirë të Kosovës, Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Dardanisë jo vetëm kësaj radhe, por kur ishte çështja edhe për trasenë e AOE-së nacionale –autostradës Merdare-Morinë-Durrës, do t'i mbështesim pa rezervë. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të Grupit “7+”, deputeti Sadik Idriz e ka fjalën.

SADIK IDRIZ: Hvala predsedniče! I Parlamentarna grupa “7+” podržava olluku Vlade Republike Kosova da proglasi zonom od posebnog interesa prostor na kome će se izgraditi Hidrocentrala “Zhur”.

Najveći deo investicija ovog projekta će biti na poručju opštine Dragaš, to je njeno zakonsko i ustavno ime, ovde smo čuli i neka druga imena. Ja ću vam kazati najstarije ime je Krakošta, ali je ustavno i zvanično ime ove opštine Dragaš i mislim da treba tako da se koristi.

Mi sa zadovoljstvom prihvatamo ovaj projekat. Inače projekat je star više od 30 godina, ideja je stara više od 30 godina i mislim da će biti od velikog interesa za kompletno Kosovo iz razloga što vodotoci četiriju reka koja izvire na Šari, a to su Čarlska, Restelička, Brodska i Plavska reka nijesu do sada iskorišćene i nadamo se da će ovim projektom biti iskorišćeni i da će interes imati svi građani Kosova. Mi dajemo punu podršku ovom projektu, odnosno da se proglasi zonom od posebnog interesa. Hvala!

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar SLS, deputeti Bojan Stojanović e ka fjalën.

BOJAN STOJANOVIĆ: Hvala, gospodine predsedniče!

Naravno, ja mislim da niko nije ni očekivao od nas da uradimo nešto drugo nego da podržimo jedan ovakav projekat. Mi ćemo i sutra i u budućnosti podržavati sve razvojne projekte koji će doneti dobro građanima koji žive na ovim prostorima, naravno, ne ulazeći u neke detalje, a čuli smo dosta od prethodnih govornika. Medjutim moje je lično iskustvo vezano za Ministarstvo energetike i imam veliko poverenje i mislim da na čelu tog ministarstva jeste prava osoba koja ima kapaciteta da dokumentaciju spremi veoma dobro i to je već pod nekim drugim zakonskim okvirima. Znači mi ćemo podržati ovaj

projekat i odmah što se naše grupe tiçe možete dobiti blanko projekat da ukoliko ima mogućnosti napravimo još deset ovakvih investicija. Hvala!

KRYETARI: Faleminderit! Do të thotë, shefat e grupeve në emër të grupeve përfunduan. Kemi edhe dy deputetë të lajmëruar për diskutim. Fjalën e ka tani deputetja Vezira Emrush.

VEZIRA EMRUSH: Hvala lepa na datu reč. Znamo svi da smo jako umorni, i ja se izvinjavam što sam se ovako kasno javila. Pozdravljam ponovo sve prisutne. Jako sam zainteresovana kada je u pitanje ova Hidrocentrala „Zhur“ kao gradjanka i ne samo kao poslanica ovde u Skupštini. Moram da dam do znanja da ovaj idejni projekat o ovoj hidrocentrali postoji punih 40 godina, da je od 1968. godine, molim da me poslanici prate u mom izlaganju, od 1968. godine postoji kao idejni projekat, kao idejni projekat je živeo punih 20 godina, od 1968. do 1988. godine, kada je konačno bilo utvrđeno da ekonomski ne postoji opravdanost, da kažem cene kilovata, koja bi bila proizvedena da bi se objekat ostvario u stvarnosti. Zašto ovo kažem? Mi znamo da je ovo kilovat energije sada ovde na Kosovu i onako skup i ponovo idemo ka jednom projektu da proizvodimo i dalje jedan skup kilovat, gde ćemo da akumuliramo vode kao što je navedeno, reka vode Plav, Broda, Restelice i Čajlana. Ja moram da vam kažem, ovde ima i stručnjaka i verujem, ja sam videla konkurs opštine Dragaš da je otvoren na ime 5 radnika za prijem koji će pratiti mogućnost za ostvarivanje ovog projekta. Ja moram da dam do znanja ovde, kao gradjanka da ove reke, celokupne reke u opštini Dragaš ne zadovoljavaju, imaju puni kapacitet od 45 da zadovolje samo proizvodnju 45 megavata. Mi nismo od ministarke danas dobili, kada bi se akumulirale vode, kada bi bila sušna sezona, kada bi bilo sve koliko bi nas to koštalo. Ja dajem do znanja da kao poslanici ovde dobijamo fizibilitet koliko košta, šta košta, koje kilometre, koliko će kilovat biti i koliko opravdanost i efikasnost ima u otplati. Imam još jedan predlog za vladu da pokuša ako meni kao poslanici ne veruje, da pokuša, ja sam ovo uradila fizibilitet sa nekoliko naših cenjenih inženjera, da pokuša da da u koncensiju, jer Balkan je jako zainteresovan za proizvodnju alternativne energije, da pokuša da da u koncensiju na 10, 20, 30 godina, ko će biti naš partner za izgradnju ove hidrocentrale. Meni je jako milo da se naša zona gore proglasi zonom od posebnog interesa, ali sa ovim potezom mi bi smo uništili jednu jedinu čistu ekološku zonu gde više moramo da znamo, gde moramo da se bavimo poljoprivredom, stočarstvom i voćarstvom i da Evropi nudimo zdravu hranu. Hvala lepa!

KRYETARI: Fjalën e ka deputeti i fundit, Ardian Gjini kësaj radhe.

ARDIAN GJINI: Faleminderit, zoti kryetar edhe një herë! Një pjesë të asaj që e pata në plan ta them unë, e tha parafolësja. Në fakt, po flasim për fizibilitetin, ajo për të cilën u referua deputetja Emrush, është fizibiliteti, një studim i cili është financuar nga Banka Botërore ka kohë dhe ekziston, do të thotë, dihet. Dhe, problemin që e shoh unë dhe që e shohim shumë prej nesh është - pse nuk ka ardhur përmbledhja ekzekutive e studimit të fizibilitetit në Kuvend, në mënyrë që deputetët të shohin çka po votojmë. Realisht, në esencë nuk jemi kundër, se është një projekt shumë atraktiv, mirëpo nëse e kishim parë studimin e fizibilitetit, kishim pasur mundësi të mendojmë edhe për aspektet tjera. Për çka po flas? Pse 30 vjet ose 40 vjet ka mbetur projekti si ide? Ka mbetur ekzakt për atë që e thotë studimi i fizibilitetit. Studimi i fizibilitetit thotë se për 300 megavatë fuqi të angazhuar, do të thotë fuqi të angazhuar, do të thotë në momentin kur do të ishin kyçur gjeneratorët, nuk do të mund të furnizohej me ujë hidrocentrali për më shumë se 4 muaj, realisht përafërsisht jemi duke folur për shumë pak dallim prej 4 muajve. Do të thotë, 2/3 e vitit hidrocentrali duhet të pushojë për shkak se nuk ka ujë të mjaftueshëm për t'i

furnizuar krejt kohën gjeneratorët me ujë. Thotë, ka rënie të madhe, ka rënie, do të thotë. Rënia është disa metra që e bën fuqinë e madhe, por nuk ka ujë për t'i mbushur turbinat për 12 muaj. Dhe, për sa po flasim në tash, nëse e kthejmë në energji, nëse e pjesëtojmë për 3, jemi duke folur për një sasi energjie pak më ndryshe se 300 megavatë për të cilët po na ofrohet këtu. Po flas për shkak se e di projektin që prej kohës kur kam qenë në pushtet. Totali i kësaj që po them unë, është që është herët për ta kaluar një vendim të këtillë, ka më tepër efekt politik se sa efekt praktik. Nuk kemi nevojë të hymë tash, duhet ta kenë deputetët e Kuvendit të Kosovës studimin e fizibilitetit përpara, se atëherë dimë për çka po flasim, sepse përndryshe po krijohet njëfarë ideje që kush e di çka po ndërtojmë në Zhur, e në esencë çmimi, kostoja, si në të kaluarën edhe tash është pak më e lartë. Në fund të fundit, duhet ta dimë ku do të përfundojmë, a do të vijmë në situatë që ne vetë të investojmë në një projekt që është i shtrenjtë, apo ka ndoshta investitorë potencialë. Në këtë rast, ne mendojmë se ka shumë të panjohura rreth Hidrocentralit të Zhurit, të cilat deputetët duhet t'i kenë të qarta para se të votojnë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Unë thashë, është diskutuesi i fundit. Mendoj që s'është mirë ta vazhdojmë këtë praktikë. Kur të themi i fundit, le të mbetet i fundit.

Të nderuar deputetë, përgatituni për votim dhe votojmë tash:

Konstatohet se me 69 vota "për", 8 "kundër", 1 abstenim, Kuvendi shpalli hapësirën zonë me interes të veçantë ekonomik për ndërtimin e Hidrocentralit "Zhur" në një sipërfaqe prej 19.41 kilometra katrorë sipas hartës së bashkëngjitur. Ju falënderoj!

Ju e dini që në fillim të seancës e kemi ngarkuar Komisionin për Legjislacion dhe Gjyqësi për ta dhënë një këshillë juridike dhe kisha ftuar kryetarin e Komisionit, zotin Bahri Hyseni që të na informojë për atë këshillë juridike.

BAHRI HYSENI: Faleminderit shumë, zoti Kryetar! Ne, pas autorizimit që kemi marrë nga Kuvendi i Kosovës jemi takuar si komision dhe respektojmë kërkesën legjitime të Grupit Parlamentar të SLS-së, mirëpo në bashkëpunim edhe me Grupin Parlamentar të SLS-së u pajtuam që rekomandimi të jetë në njërin nga seancat e ardhshme të Kuvendit të Kosovës.

KRYETARI: Edhe juve faleminderit! Të nderuar deputetë dhe deputete, mendoj se me këtë seancë po e përmbyllem sesionin pranveror të punës së Kuvendit.

Unë shfrytëzoj rastin t'ju falënderoj për angazhimet tuaja, duke kërkuar sidomos nga komisionet që në sesionin e dytë vjeshtor të kenë angazhim më të shtuar për miratimin e ligjeve në leximin e dytë. Dhe, kështu, deri të hënën e dytë të muajit shtator, Kuvendi është në pushim. Faleminderit!

Përgatiti:

Divizioni për Çështje Plenare dhe Procedurale